



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në mbledhjen e mbajtur me 21.11 2000 si dhe duke vepruar sipas nenit 24 të rregullores Nr, 2000/45 mbi vetëqeverisjen e Komunave Të Kosovës, nxori këtë:

VENDIM

Mbi zgjedhjen e Kryetarit të Komunës

I.

z.Lutfi Haziri zgjedhet Kryetar i Komunës së Gjilanit.

II.

Mandati i Kryetarit të Komunës zgjatë 2 vite.

III.

Ushtrimin e detyrës së Kryetarit z, Lutfi Haziri do ta ushtrojë që nga dita e miratimit.

IV.

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit.

Kuvendi i Komunës – Gjilan

Nr. 01-2440/2000
Gjilan, 21.11.2000

z,Ivo Shanc

Administrator Komunal
KB-së – Gjilan,

Vendimi ti dërgohet:
Të emëruarit
Arkivit
Drejt. së Adm. së përgj.



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në mbledhjen e mbajtur me 21.11 2000 si dhe duke vepruar sipas nenit 25 të rregullores Nr, 2000/45 mbi vetëqeverisjen e Komunave Të Kosovës, nxori këtë:

VENDIM
MBI ZGJEDHJEN E ZËVENDËSKRYETARIT TË KOMUNËS

I.

Z. Xhemajl Hyseni zgjedhet zëvendëskryetar i Komunës së Gjilanit.

II

Mandati i zëvendëskryetarit të Komunës zgjat 2 vjet.

III.

Ushtrimin e detyrës së zëvendëskryetarit, z. Xhemajl Hyseni do ta ushtroj që nga dita e emërimit.

IV.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

Kuvendi i Komunës – Gjilan

Nr. 01- 2440/2000
Gjilan, 21.11.2000

z. Ivo Shanc

Administrator Komunal i
KB-së Gjilan

Vendimi ti dërgohet:
Të emëruarit,
Arkivit
Drejt, së Adm. Së përgj.



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në mbledhjen e mbajtur më 21.11.2000. nxori këtë

VENDIM

Me 28.11.2000, me rastin e ditës së Flamurit në Komunën e Gjilanit nuk do të punohet në institucionet Komunale, ndërmarrjet, shkollat e subjektet tjera juridike.

Kuvendi u uron qytetarëve Ditën e Flamurit.

Kuvendi i Komunës- Gjilan

Nr. 01_2441/020
Gjilan, më 21.11.2000

KRYETARI
Lutfi Haziri



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Kuvendi i Komunës së Gjilanit duke u bazuar në nenin 3.1 (m) dhe N.14.4 të rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave në mbledhjen e mbajtur më 30.11.2000 nxori këtë.

Vendim

MBI PUBLIKIMIN E KONKURSIT PËR PUNIMIN E EMBLEMËS TË KOMUNËS SË GJILANIT.

-I-

PUBLIKOHET KONKURSI- për punimin e emblemes të Komunës së Gjilani.

-II-

Të drejtë pjesëmarrje në konkurs kanë të gjithë personat fizik dhe juridik.

-III-

Autori, punimi i të cilit do të zgjedhet për embleme të Komunës së Gjilanit nga Buxheti komunal do të shpërblehet me 1000 DM.

-IV-

Punimet do ti vlerësojë komisioni i emëruar nga Kuvendi Komunal.

-V-

Konkursi mbetet në mjetet e informimit publik.

-VI-

Konkursi mbetet i hapur gjerë më 17 dhjetor/ 2000

-VII-

Ofertat dorëzohen në arkivin e K.K- Gjilan në pliko të mbyllur me shenjën “ Konkursi për punimin e emblemes së Gjilanit.

Kuvendi i Komunës së Gjilani

Nr. 01-2261/020
Gjilan, 30.11.2000

KRYETARI
Lutfi Haziri



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në mbledhjen e mbajtur më datë 30.11.2000, në Gjilan, nxori këtë.

Vendim

Mbi emërimin e Kolegjit që do ta ndihmojë Kryetarin e Komunës dhe Kryeshefin Ekzekutiv në emërimin e Drejtorëve të Drejtorive.

Për anëtarë të kolegjit që do ta ndihmojë Kryetarin e Komunës dhe Kryeshefin Ekzekutiv në emërimin e drejtorëve të drejtorive, emërohen:

- 1) Shefqet Aliu
- 2) Naser Latifi
- 3) Shefik Kurteshi
- 4) Jakup Berisha
- 5) Bajram Fejzullahu

Mandati i anëtarëve të kolegjit përfundon me zgjedhjen e drejtorëve të drejtorateve. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

Kuvendi i Komunës – Gjilan

Nr. 01 _____
Gjilan, 30.11.2000

Kryetari i Kuvendit

Lutfi Haziri

Vendimi ti dërgohet:

-Të emëruarve

-Arkivit

-Drejt. Së Admini. Së Përgjithshme



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur me datë 22.12.2000, duke u bazuar në nenin 30.2 të rregullores 2000/45 mbi vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës, nxori këtë.

Vendim
PËR EMËRIMIN E KRYESHEFIT EKZEKUTIV

-I-

Emërohet z. Enver Muja Kryeshef Ekzekutiv i Kuvendit të Komunës së Gjilanit.

-II-

Z. Enver Muja detyrat dhe obligimet do t'i kryej në harmoni me nenin 30.2 të rregullores , Nr. 2000/45 mbi vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës dhe dispozitave të statutit të Komunës së Gjilanit.

-III-

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

Kuvendi i Komunës së Gjilanit

Nr. 01- 710/07
Gjilan, 22.12.2000

Kryetari i K K- Gjilan

Lutfi Haziri

Vendimi t'i dërgohet
Të emëruarit
Arkivës



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në mbledhjen e mbajtur më datë 12.12.2000, duke vepruar sipas nenit 3.1 (m) , nxori këtë.

Vendim

Mbi emërimin e Komisionit për zgjedhjen e Emblemen së Komunës së Gjilanit.
Për anëtarë të komisionit për zgjedhjen e Emblemes së Komunës së Gjilanit emërohen:

- 1) Fatmir Rexhepi
- 2) Nazmi Musa
- 3) Izmi Zeka
- 4) Sabri Shaqiri
- 5) Nagip Berisha
- 6) Mursel Jashari

Mandati i anëtarëve të këtij komisioni me zgjedhjen e Emblemes së Komunës së Gjilanit.
Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit

Kuvendi i Komunës – Gjilan

Nr. 01-2264/020
Gjilan, 12.12.2000

Kryetari i K.K-Gjilan
Lutfi Haziri

Vendimi t'i dërgohet
-Të emëruarve
- Arkivës



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 05.01.2001, e duke u vepruar sipas nenit, 3.1 (m) dhe nenit 14.4, të rregullores 2000/45 mbi vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës, nxori këtë:

VENDIM

Mbi përsëritjen e konkursit për punimin e Emblemës të Komunës së Gjilanit.

I

Përsëritet konkursi për punimin e Emblemës së Komunës së Gjilanit,

II

Të drejtë pjesëmarrje në konkurs kanë të gjithë personat fizik dhe juridik,

III

Autori, punimi i të cilit do të zgjidhet për emblemë të komunës së Gjilanit nga buxheti komunal do të shpërblehet me 2000 DM.

IV

Punimet do t'i vlerësojë komisioni i emëruar nga Kuvendi Komunal,

V

Konkursi publikohet në mjetet e informimit publik

VI

Konkursi mbetet i hapur 30ditë nga dita e publikimit,

VII

Ofertat dorëzohen në arkivin e KK, Gjilan në pliko të mbyllur me shenjën “ Konkursi për punimin e Emblemës së Gjilanit”.

Kuvendi i Komunës së Gjilanit

Nr. 01 .76/020/2001
Gjilan, 05.01.2011

Kryetari,
Lutfi Haziri



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 16.03.2001, e duke u bazuar në nenin, 11, pika 1 të Rregullores nr, 2000/45, mbi vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës, mori këtë:

Vendim

Për miratimin e Statutit të Komunës së Gjilanit

I

Miratohet Statuti i Komunës së Gjilanit.

II

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kuvendi dhe organet e administratës të Komunës së Gjilanit.

III

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit

Kuvendi i Komunës Gjilan.

Nr .01.1448/010
Gjilan, më 16.03.2001

Kryetari i KK-ës
Lutfi Haziri



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 16.03.2001, e duke vepruar sipas nenit 21, 2, nenit 21.4 dhe nenit 21.6 të Rregullores nr. 2000/ 45 mbi vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës mori këtë:

Vendim

Mbi ndryshimin dhe plotësimin e përbërjes së Komiteteve me anëtarë të rinj.

I

Ndryshohet dhe plotësohet përbërja e Komiteteve me anëtarë të rinj si vijon:

- 1) Në komitet për Politikë dhe financa, në vend të Z, Zijadin Maliqit emërohet Z. Jakup Bajrami.
- 2) Në komitetin për Planifikim dhe Resurse Natyrore emërohet Z. Abdyl Hasani-Zëvendëskryetar i Komitetit.
- 3) Në Komitetin për Personel dhe Punësim , në vend të Z. Jakup Bajramit, emërohet Z. Venhar Haziri
- 4) Në Komitetin për Arsim, zëvendëskryetar emërohet Z, Musa Qerimi , ndërsa në vend të Z, Mitat Maliqit , emërohet Znj, Nazmije Hasani.
- 5) Në Komitetin për pronë dhe Urbanizëm , emërohet Z, Murat Hoxha, anëtarë.
- 6) Në Komitetin për Zhvillim Ekonomik I shtohet edhe agro-kultura dhe në këtë Komitet në vend të Z, Zijadin Maliqit emërohet Z, Xhemajl Hyseni- Kryetari i këtij Komiteti. Në vend të Bejtush Isufit emërohet Z, Vehbi Kqiku.
Këtij Komiteti I shtohen edhe dy antarë nga Agrokultura : Z, Nehat Ramadani dhe Z, Nazmi Rapuca
- 7) Në Komitetin për Kulturë, Rini dhe Sport në vend të Z, Lutfi Haziri emërohet Z, Sabit Rrustemi, ndërsa Kryetare e këtij Komiteti emërohet znj, Dritë Maliqi.
- 8) Në Komitetin për Pronë dhe Urbanizëm në vend të Z, Hajdar Paqarada emërohet Z, Gani Neziri.

II

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

Kuvendi i Komunës Gjilan,
Nr .01.1390/020
Gjilan, 16.03.2001

Kryetari i KK-ës
Lutfi Haziri



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 16.03.2001, e duke u bazuar në nenin 74 të statutit të Komunës, dhe nenit 19,2 të Rregullores nr, 2000/45 mbi vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës mori këtë:

Vendim

Për caktimin e kompensimit të anëtarëve të Kuvendit dhe anëtarëve të Komitetit

I

Caktohet kompensimi për anëtarët e Kuvendit të Komunës në lartësi prej 100 DM, prej një seancë, ndërsa për anëtarë të Komiteteve në lartësi 50 DM për një seancë.

II

Shuma e përgjithshme mujore e kompensimit për një anëtarë të Kuvendit Komunal ose të Komitetit së bashku nuk mund të kalojë lartësinë prej 200 DM.

III

Kompensimi sipas pikës I dhe II të këtij vendimi do të aplikohet për pjesëmarrësit gjatë mandatit të tyre.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

Kuvendi i Komunës Gjilan

Nr .01.1488/020
Gjilan, 16.03.2001

Kryetari i KK-ës
Lutfi Haziri



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 11.04.2001 e duke u bazuar në nenin 12 (h) të statutit të Komunës nxori këtë:

VENDIM

Për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Qendrës për shërimin e personave me të meta mentale

I

Caktohet lokacioni në sipërfaqe prej 10 ari, ngastra kadastrale 1/1, 1-2 dhe 1/3, fleta poseduese 1750, Komuna kadastrale Gjilan.

II

Lokacioni i caktuar nga pika 1 e këtij vendimi do të përdorët për ndërtimin e Qendrës për shërimin e personave me të meta mentale.

III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit

Kuvendi i Komunës Gjilan

Nr. 01- 1898/020
Gjilan, 11.04.2001

Kryetari i KK-ës
Lutfi Haziri



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 11.04.2001, e duke u bazuar në nenin 21.2, nenin 21.4 dhe nenin 21.6 të Rregullores nr.2000/45 mbi vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës, dhe nenin 52 të Statutit të Komunës nxori këtë:

VENDIM

Për formimin e komitetit për Siguri dhe Emergjencë

- 1) Kryetari i KK-ës, Gjilan
- 2) Zv, kryetari i KK-ës, Gjilan
- 3) Kryetari i LDK-ës, dega në Gjilan
- 4) Kryetari i PDK-ës, dega në Gjilan
- 5) Kryetari i AAK-ës, dega në Gjilan
- 6) Përfaqësuesit e TMK-ës, nga zona e 6-të
- 7) Përfaqësuesit e SHPK-ës

II

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit

Kuvendi i Komunës – Gjilan

Nr. 01-2025/020
Gjilan, 11.04.2001

Kryetari i KK-ës

Lutfi Haziri



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë, 29.06.2001, e duke u bazuar në nenin 73 të Statutit të Komunës së Gjilanit, nxori këtë:

VENDIM
PËR EMËRIMIN E ZËVENDËSKRYETARIT TË DYTË TË KUVENDIT TË
KOMUNËS SË GJILANIT

I

Me këtë vendim emërohet z. Sasha Gjorgjeviq, zëvendëskryetar i dytë i Komunës së Gjilanit.

II

Z. Sasha Gjorgjeviq, funksionin e zëvendëskryetarit do ta ushtroj që nga data e emërimit.

III

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr. 01-1637/020
Gjilan, 29.06.2001

z. Ivo Shanc

Administrator komunal i KB-ës,
Gjilan.



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në mbledhjen e mbajtur më datë 29.06.2001, e duke u bazuar në nenin 12 alineja 1 pika (a) dhe (b), të Statutit të Komunës së Gjilanit, nxori këtë:

VENDIM

PËR APROVIMIN E PLANIT PËR ZHVILLIMIN E SHPEJT STRATEGJIK (RSDA 2002/2004) DHE PROGRAMIT PUBLIK PËR INVESTIME DHE REKONSTRUIM (PIP 2001/2002 DHE 2002/2004 TË KOMUNËS SË GJILANIT.

I

Aprovohet Plani për zhvillimin e shpejtë strategjik (RSDA 2002/2004) dhe Programi publik për investime dhe rikonstruim (PIP 2001/ 2002 dhe 2002/2004) i Komunës së Gjilanit.

II

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr. 01-3533/020
Gjilan, 29.06.2001

Kryetari i KK-ës
Lutfi Haziri



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Në mbështetje të nenit 95 dhe 96 paragrafit 2 të ligjit mbi matjen dhe kadastrën e tokave (Gazeta Zyrtare e Kosovës nr.12/80), Kuvendi i Komunës – Gjiçan merr:

VENDIM

**MBI CAKTIMIN E LARTËSIS SË PAGESAVE PËR SHËRBIMET QË I KRYEN
DREJTORIA PËR GJEODËZI, KADASTËR E PRONËSI**

Neni 1

Lartësia e kompensimit varet nga lloji dhe vëllimi i punëve, përkatësisht nga lloji dhe numri i të dhënave, ndërsa llogaritet sipas normës në orë, përkatësisht sipas llojit të punëve dhe numrit të të dhënave.

Neni 2

Kompensimi për parcelimin e tokës sipas PDU-ës në rajonin e qytetit, me shënimin e mezhdave të ngastrave, përpunimin e skicave të majtas, karterimin dhe llogaritjen e sipërfaqeve përfundimisht me regjistrin e ndërrimeve me gjendjen e re, për një ngastër është 200 DM, për ç' do ngastër me shumë në të njëjtin vend të matjes është 120 DM.

Neni 3

Kompensimi për parcelimin e tokës në vendbanime ku nuk ekziston zgjidhja urbanistike për matje sipas gjendjes ekzistuese, me përpunimin e skicave të matjes, karterimin dhe llogaritjen e sipërfaqeve përfundimisht me regjistrin e ndërrimeve me gjendje të re për një ngastër është 120 DM, ndërsa për çdo ngastër më shumë në të njëjtin vend të matjes është 80 DM.

Neni 4

Për matjet të cilat kanë të bëjnë në ndarjen veç e veç të ngastrave apo të ngastrave në grupe si dhe ndarjen e tërë ngastrës duke i përfshirë edhe punët teknike të zyrës, përkitazi me këto matje, paguhet kompensimi sipas sipërfaqeve të ngastrave siç vijon:

- ngastra në sipërfaqe deri në 10 ari.....80 DM
- ngastra në sipërfaqe prej 10 deri 50 ari.....100 DM
- ngastra në sipërfaqe prej 50 deri 100 ari..... 120 DM.

Neni 5

Për incizimin e objektit- shtëpisë me përpunimin e skicës së matjes, karterimin dhe llogaritjen, përfundimisht në regjistrin e ndërtimeve për një objekt është 100 DM.

Neni 6

Kompensimi për rivendosjen e mezhdave të ngastrës paguhet sipas sipërfaqes së ngastrës siç vijon:

- ngastra në sipërfaqe deri në 10 ari 80 DM
- ngastra në sipërfaqe prej 10 deri 50 ari 100 DM
- ngastra në sipërfaqe prej 50 deri 100 ari 120 DM.

Neni 7

Në rastin kur pala me të njëjtën kërkesë kërkon rivendosjen e mezhdave për më tepër se një ngastër, kompensimi zvogëlohet për 20%.

Neni 8

Kryesit të drejtpërdrejtë të punëve sipas këtij vendimi i takon kompensimi prej 15 %.

Neni 9

Të gjitha shërbimet në terren do të rriten për 25 % gjatë periudhës prej 1. Nëntor deri më 31 Mars.

Neni 10

Nëse transportin e stafit gjeodet dhe matjet e punës nuk i kryen pala të gjitha shërbimet rriten për 10 %.

Neni 11

Shfrytëzuesit e shërbimeve nga lëmi i matjes dhe kadastrit të instalimeve nëntokësore, e paguan kompensimin për incizimin e kryer dhe karterimin e instalimeve nëntokësore në origjinalet e punës sipas llojit, vëllimit të punëve dhe largësisë të instalimeve nëntokësore për metër.

- Elektro instalimi për 1m paguhet.....1DM
- Instalimi i ujësjellësit për 1m paguhet1DM
- Instalimi i kanalizimit për 1m paguhet.....1DM
- Instalimi i përçuesve për nxehje për 1m paguhet.....1DM
- PTT instalimet –kabllove për 1m paguhet.....1DM.

Neni 12

Punët vëllimore për kryerjen e të cilave nevojiten më shumë ditë pune në terren e zyre, si dhe përpunimi i planeve të situatave, incizimi i linjave të objektit, përpunimi i elaboratit kadastral gjeodezik dhe punët për të cilat nuk është e mundur aplikohen çmimet dhe normat nga nenet paraprake të këtij vendimi si dhe punët e tjera nga fushëveprimi i vetë i punës përcaktohen çmimet në mes të porositësit dhe Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër e Pronësi.

Për kryerjen e këtyre punëve drejtori autorizohet të lidhë kontratë mbi kryerjen e punëve si dhe përcaktimin e çmimeve të tyre.

Neni 13

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen të gjitha vendimet e mëparshme që kanë të bëjnë me kompensim.

Neni 14

Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi Komunal.

Nr01-3617/020
Gjilan, 29.06.2001

KRYETARI I KUVENDIT

Lutfi Haziri



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Në bazë të N.3, pika (ë) dhe N. 44.2 të Rregullores mbi vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës Nr. 2000/ 45 dhe të N.12 (ë) të Statutit të Komunës së Gjilanit.
Kuvendi i Komunës së Gjilanit në mbledhjen e mbajtur më 29.06.2001 nxori këtë:

VENDIM

**MBI RISHQYRTIMIN E KONTRATËS MBI CEDIMIN E TOKËS
NDËRTIMORE**

I

RISHQYRTOHET Kontrata Nr.463-9/97, e datës 24.02.1997 (protokolli i KK-ës Gjilan). Nr.198 e datës 24.02.1997 (protokolli i “Moravës së Binçës”), dhe Nr. 2/97 të datës 24.02.1997 (protokolli i AS Inxhiniering”) mbi cedimin e tokës ndërtimore të qytetit dhënë në shfrytëzim nga pronari i mëparshëm Komuna e Gjilanit në pronarët shfrytëzuesit e rinj.

- 1) Morava e Binçës” Gjilan- 50 % dhe
- 2) NTP” AS Inxhiniering” – Gjilan- 50%.

të këtyre palujtshmërive:

- 1) KK, Gjilan Ng. Kat. Nr. 3304; Fl. Posed. Nr.2593 K K. Gjilan, sipërfaqe. 1.26.80 Ha.
- 2) KK,Gjilan.Ng Kat.Nr.3299;Fl.Posed. Nr.2593. KK.Gjilan,sipërfaqe.1.59.86 Ha.
- 3) KK,Gjilan.Ng, Kat.Nr.3300;Fl. Posed. Nr.1736 KK.Gjilan,sipërfaqe.0.25.00 Ha.
- 4) KK, Gjilan Ng.Kat.Nr.3302;Fl,Posed.Nr.1736 KK.Gjilan,sipërfaqe.0.20.78.44Ha

Gjithsejtë sipërfaqe: 3.32.44 Ha

II

Autorizohet Kryeshefi i Ekzekutivit që me aktvendim të posaçme të emërojë komisionin për zhvillimin e bisedimeve me ndërmarrjen “Morava e Binçës”- Gjilan dhe NP. “AS Inxhiniering”- Gjilan për përgatitjen e propozim kontratës, marrëveshjes në lidhje me objektin e dedikuar për “ Qendër Tregtare” në pjesët e disa ngastrave kadastrale nga pika 1 e këtij vendimi.

III

Komisioni ka për detyrë që brenda 15 ditësh nga dita e nxjerrjes së këtij vendimi të hulumtojë bazën juridike të lidhjes së kësaj kontrate dhe kushtet tjera në lidhje me këtë kontratë- mbi cedimin e tokës ndërtimore dhe ti propozojë zgjidhje Kuvendit Komunal të Gjilanit respektivisht Komitetit për Politikë dhe Financa të KK-ës Gjilan, në harmoni me dispozitat pozitive ligjore të aplikueshme tani në Kosovë.

IV

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryeshefi i Ekzekutivit dhe Drejtoritë përkatëse të KK-ës në Gjilan.



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 29.06.2001, e duke u bazuar në nenin 12 alineja 1 pika (ë) dhe nenin 15 të Statutit të Komunës së Gjilanit nxori këtë:

VENDIM

PËR NDËRRIMIN E NGASTRËS KADASTRALE NR. 1492, ME NGASTRËN KADASTRALE NR. 1.

I

I lejohet znj, Nazmije Arifit nga fshati Miresh, ndërrimi i Ngastrës Kadastrale nr. 1429 që është pronë e saj, me kulturë –arë e klasit të 6 të, Komuna kadastrale- Miresh me sipërfaqe 00.02.04 Ha në të cilën ngastër tani e shfrytëzon Ekonomia e Pyjeve, lagja Mireshi I Vogël, fshati Caparë dhe Bukovik në vendin e quajtur Ledina e Poshtme, me Ngastrën kadastrale nr.1. Komuna Kadastrale- Miresh pronë e Komunës me sipërfaqe 00.02.04 Ha.

II

Palët nga pika I e këtij vendimi, procedurën e mëtejme rreth bartjes së pronësisë do ta rregullojë para organeve kompetente Komunale.

III

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

Kuvendi i Komunës – Gjilan



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 29.06.2001, e duke u bazuar në nenin 6 dhe nenin 12 alineja 2 pika (p), të Statutit të Komunës së Gjilanit nxori këtë:

VENDIM

PËR CAKTIMIN E LOKALIT PËR MUZE DHE GALERI NË KOMUNËN E GJILANIT

I

Me këtë vendim caktohet lokali për Muze dhe Galeri për zhvillimin e veprimtarisë së Artistëve figurativë, në ndërtesën e ish Mbrojtjes Popullore të Komunës së Gjilanit.

II

Me që në ndërtesën e ish Mbrojtjes Popullore është e vendosur Logjistika e Trupave të Mbrojtjes të Kosovës, më këtë vendim autorizohet Kryetari i KK-ës dhe Drejtoria për Kulturë , Rini dhe Sport që deri në gjetjen e lokalit të përshtatshëm për Logjistikën e TMK-ës, të caktojë një lokal tjetër ku përkohësisht do të vendosej Muzeu dhe Galeria për zhvillimin e veprimtarisë së Artistëve Figurativë të Komunës së Gjilanit.

III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i KK-ës dhe Drejtoria për Kulturë-Rini dhe Sport.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN.

Nr.01-3548/020



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Në bazë të nenit 12 alineja 1 pika (g) të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në mbledhjen e mbajtur më 29.06.2001, nxori këtë:

VENDIM

PËR RAJONALIZIMIN E SHKOLLAVE FILLORE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË GJILANIT

I

Me këtë vendim përcaktohet rajonalizimi I Shkollave Fillore me paralelet e ndara fizike, në territorin e Komunës së Gjilanit, me qëllim të përfshirjes sa më të përshtatshme të fëmijëve në edukimin Arsimin e obliguar fillor.

II

Në Shkollat Fillore të Komunës së Gjilanit, fëmijët prej moshës 6-15 vjeçar janë të detyruar të i vijnë mësimet sipas përcaktimeve të mëposhtme të këtij rrjeti.

1) Në shkollën Fillore “ **Thimi Mitko**” në Gjilan, mësimet i vijnë nxënësit që banojnë në këto lagje:

Nxënësit e Rrugës “Skënderbeu” nga hyrja në qytet nga Livoçi, përkatësisht prej ndërmarrjes private “ Bejta Komerc”, deri në fund të qytetit, duke u kthyer në rrugën që shpie për fshatin Malishevë deri të Qeshma e Kufcës. Pra tërë anën e djathtë të kësaj rruge e deri në rrugët si: Ana e majtë dhe e djathtë e rrugës “ Mulla Idrizi”, që shpie në drejtim të Fabrikës së Radiatorëve e që përkufizohen me rrajzën e Zabelit të Sait Agës, përkatësisht deri me fillimin e këtij vendimi, duke përfshirë në këtë kuadër edhe shtëpitë e anës së djathtë të lagjeve mbi ish mullirin e atij lokaliteti. Pastaj nxënësit e vendbanimeve të anës së djathtë të rrugës “Adem Jashari “ duke u kthyer në rrugën “ Ali Pashë Tepelena “ dhe duke përfshirë të anën e djathtë të saj deri tek rruga “ Fehmi Lladrovci”, dhe duke vazhduar në rrugën “Ali Pashë Tepelena”, ku bashkohet me rrugën “ Skënderbeu “ e cila përfshinë edhe kompleksin e banesave shoqërore në të djathtë dhe në të majtë të kësaj pjese të rrugës.

Kësaj shkolle fillore i përket edhe vendbanimi i qendrës së qytetit para parkut të qendrës së qytetit me shtrirje në të gjitha rrugicat që e lidhin qendrën e qytetit me rrugën “ Lidhja e Prizrenit”, deri te pika e ashtuquajtur (G), nga e cila fillon rruga “ Gursel Sylejmani”, që pas 70/100m. kthehet në rrugën që shpie deri te “ Varrezat e Dëshmorëve “, përkatësisht deri te pika (D), dhe që vazhdon në zbritje deri te pika e ashtuquajtur (C), bashkohet me rrugën e re qarkore që vazhdon të zbres më poshtë përtej asaj rruge në

drejtim të Livoçit të Poshtëm, deri në fund të vendbanimit të ri duke përfshirë këtu tërë anën e majtë të kësaj zbritjeje dhe tërë anën e djathtë të rrugës “ Skënderbeu”, përkatësisht rrugës “ Idrizë Seferi “ deri afër vendbanimit të Livoçit të Poshtëm, që përkufizohet në drejtim të daljes në rrugën “ Nëna Terezë” dhe në kthesë në Rrugën (G). Në rajonalizimin e “Thimi Mitko”, përfshihet tërë ana e majtë e rrugës “ Lidhja e Prizrenit deri te pika G”. me përjashtim të rendit të parë të rrugës Lidhja e Prizrenit prej përmendores deri te pika “G”. që i takojnë Shkollës Filllore “Musa Zajmi”, pra Shkollës Filllore “Thimi Mitko”. i takojnë të gjitha vendimet e përkufizuara në rrugët kryesore të prezantuara më lartë, pjesët e brendshme të vendbanimeve të cekura në të gjitha rrugët e përmendura të rendit të dytë dhe të tretë.

2). Në Shkollën fillore “Musa Zajmi” në Gjilan, mësimet I vijnë nxënësit që banojnë në këto lagje.

Nga jugperëndimi rajonalizimi i kësaj Shkolle përkufizohet me rrugën “Skënderbeu”, që shkon deri tek fundi i qytetit në drejtim të Bujanovcit, përkatësisht deri te ish Pompa E Benzinës, “INA” duke u kthyer në të majtë të lumit Gjilan deri te Pika “F”, dhe duke u kthyer nga pikë në rrugicën që shpie në drejtim të fundit ish rrugës “ 7 Korriku” dhe duke vazhduar në rrugën “Rashat Ymeri” në kthim prapa deri te rruga e parë nga ish “ 7 Korriku” që shpie në drejtim të rrugës “Reshat Mala”, duke u kthyer përsëri prapa në rrugën “Rexhep Mala” duke u kthyer përsëri prapa në rrugën “Rexhep Mala” dhe duke përfshirë tërë rrugën “Xheladin Hana”, deri te Rruga “Rexhep Mala”. Dhe deri te Xhamia e Medresesë, në këtë kompleksë përfshihen të gjitha vendbanimet e përkufizuara sipas kësaj ndarje të punës së majtë të këtyre rrugëve, kah brendësia e qytetit..

Obligues shkollor të “Musa Zajmi” janë edhe të gjitha vendbanimet e anës së majtë të rrugës “28 Nëntori”. Duke vazhduar me vendbanimet nën konvikt të nxënësve dhe të studentëve deri te lumi Dobrushë dhe duke vazhduar rrugën e parë të lagjes së Dardanisë deri te bashkimi i saj në rrugën “Ismail Qemajli”. Pa përfshirë këto shtëpitë e anës së majtë të kësaj rruge prej Ambulancës së Dardanisë deri te Lumi Dobrusha dhe deri te rruga “ Ismail Qemajli” që duhet ti takojnë Shkollës Filllore “Selami Hallaç”.

Rajonalizimi i kësaj shkolle përfshinë edhe lagjet –vendbanimet që gjenden në anën e majtë të Lumit Dobrushë deri në dalje të Qytetit- në veri duke përfshirë kështu tërë anën e djathtë të rrugës “ Lidhja e Prizrenit”. Dhe rendit të parë në të majtë deri te Pika “G” në këtë rrugë, (përveç një ndërtese shoqërore përballë përmendores). Dhe kjo rrugë deri te pika “G” dhe duke vazhduar deri te pompa e Benzinës në anën e Majtë dhe në anën e djathtë të rrugës prej pikës “G” tërë ana e djathtë e rrugës “D”, që del në “Kodrën e Dëshmorëve” dhe zbret në të djathtë deri te pika “F” që përkufizohet me rrugën qarkore të qytetit dhe më tutje zbret në drejtim të Lumit të Livoçit.

3). Në Shkollën Filllore “**Selami Hallaqi**” në Gjilan, mësimet i vijnë nxënësit që banojnë në këto lagje.

Nxënësit nga vendbanimet e “ Dardanisë i dhe II” dhe nxënësit e vendbanimeve të anës së djathtë të rrugës “ 28 Nëntori” prej Xhamisë së Medresesë deri në fund të rrugës, që shpie për Koretishë, përkatësisht Stanishor- ana e djathtë dhe e majtë e saj duke përfshirë edhe anën e majtë të rrugës “Rexhep Mala” deri te ish Furra e vjetër dhe në kthim të saj në të majtë në rrugën “Luigj Gurkuqi” që shpie deri në rrugën që qon kah ana e prapme e banjës dhe lidhet me rrugën e Stanishorit, duke përfshirë të gjitha vendbanimet e anës së majtë të përcaktuara sipas përkufizimit të mësipërm.

4). Në shkollën fillore “ Rexhep Elmazi” në Gjilan, mësimet I vijnë nxënësit që banojnë në këto lagje:

Në këtë shkollë janë të obliguar të vijnë nxënësit që gravitojnë kryesisht nga lagja e quajtur “Dheu i Bradhë” dhe disa pjesë tjera të qytetit të vjetër, edhe atë: Tërësisht nxënësit e vendbanimeve të Dheut të Bardhë, vendbanim që përkufizohet me rrugët “Luigj Gurakuqi”. Që fillon prej ish Furrës së vjetër në fund të rrugës “Rexhep Mala”. Dhe që shkon e bashkohet përkaj Banjës- pjesës së prapme të saj në rrugën e Stanishorit tërësisht ana e djathtë e saj, duke përfshirë edhe vendbanimet e saj që shtihen deri te lumi Gjilanka.

Në anën lindore rruga e parë që kthen në drejtim të ish “7 Korrikut” duke filluar nga fundi i rrugës “Rexhep Mala”. Dhe që me bashkimin e saj me ish “7 Korrikun”, kthen në të majtë dhe pas afërsisht 100-150m, kthen në të majtë dhe lidhet me pikën “F” përkatësisht me lumen Gjilanka, duke përfshirë tërë anën e majtë të saj dhe anën e djathtë të rrugës “Afrim Zhitija”.

Në kuadër të kësaj shkolle do të jenë edhe paralelet që formohen nga nxënësit shqiptarë të lagjes mbi Stanishorë, të Mihalicëve, si paralele e ndarë fizike për nxënësit e klasës I-IV-të.

5). Në shkollën fillore “Abaz Ajeti” në Gjilan, mësimet i vijnë nxënësit që banojnë në këto lagje: vendbanimet e anës së majtë dhe të djathtë të rrugës kryesore “Kadri Zeka”. Duke filluar nga ish organizata metalike në anën e majtë të rrugës “Adem Jashari” dhe duke vazhduar si përkufizim me rrugën “Ali Pashë Tepelena” deri në takimin e saj me rrugën “Fehmi Lladrovci” që shpie në drejtim të varrezave nën Kombinatin e Duhanit, duke përfshirë tërësisht anën e majtë të këtyre rrugëve pa përjashtim deri të shkolla fillore “Abaz Ajeti” dhe më tutje deri në hyrje të fshatit Velekincë nga Gjilani, ku vendbanimet e qytetit janë bashkuar me fshatin Velekincë.

Pastaj ana e majtë e rrugës “Kadri Zeka” përfshinë edhe vendbanimet që shtrihen deri në përfundim të lagjes së Zabelit të Sait Agës” prej aty ku përkufizohet me vendbanimin që duhet ti takojnë shkollës fillore “Thimi Mitko”, që e kemi theksuar në rajonalizimin e “Thimi Mitkos”.

Shkollës fillore “Abaz Ajeti” i takon edhe lagja e Kamnikut me tërë vendbanimet e reja që i takojnë këtij territori.

Vlen të theksojmë se në një të ardhme shumë të afërt duhet patjetër që të ndërtohet një objekt shkollorë në “Zabelin e Sait Agës dhe një objekt shkollorë në lagjen pas Pompës së Benzinës në drejtim të Fshatit Livoç, jo vetëm për tu shkarkuar me nxënës të tepërt objektet shkollorë të “Abaz Ajetit” dhe “Thimi Mitkos”, por në radhë të parë për tua ofruar shkollën më afër nxënësve të këtyre vendbanimeve, veçmas prej klasës I-IV, për të cilën rrugëtimi paraqet rrezik permanent.

Me ndërtimin eventual të një objekti me kapacitet më të madhe në fshatin Velekincë, paraqitet nevoja e domosdoshme që të rishqyrtohet rajonalizimi aktual i kësaj pjese, me qëllim që disa rrugë dhe vendbanime të qytetit që gjenden të bashkuara me Velekincë, të riorientohen në atë shkollë.

6). Në shkollën fillore” Dëshmorët e Kombit” në Livoç të Poshtëm, mësimet i vijnë nxënësit prej klasës I-VIII të fshatit Livoç i Poshtëm.

7) Në shkollën fillore “Ramiz Cërnica”, në Cërnice, mësimet i vijnë:

- Nxënësit prej klasës I-VIII të fshatit Cërnice
- nxënësit prej klasës. V-VIII të fshatit Kravaricë.ÇÇÇ
- nxënësit prej klasës. I-VIII të fshatit Vrapçiq.

- në paralelen e ndarë në Gumnishtë, mësimet I vijnë nxënësit prej kl. I-VIII, të fshatit Gumnishtë.

- në paralelen e ndarë në Kravaricë, mësimet i vijnë nxënësit prej kl. I-IV të fshatit Kravaricë.

8). Në shkollën fillore “Bashkim” në zhegër, mësimet i vijnë nxënësit prej kl. I-VIII të fshatit Zhegër.

- Në paralelen e ndarë në Haxhaj, mësimet e vijnë nxënësit prej kl. I-VIII të fshatit Haxhaj dhe prej kl. V-VIII të fshatrave Selishtë, Demiraj dhe Goden i Vogël.

- në paralelen e ndarë në Lladovë, mësimet i vijnë nxënësit prej kl. I-VIII të fshatit Lladovë dhe prej kl. V-VIII të fshatit Nasalë.

- në paralelen e ndarë në Selishtë, mësimet i vijnë nxënësit prej kl. I-IV të fshatit Selishtë.

- në paralelen e ndarë në Nasalë mësimet i vijnë nxënësit prej kl. I-IV të fshatit Nasalë.

- në paralelen e ndarë në Kurexh, mësimet i vijnë nxënësit prej kl. I-IV të fshatit Kurexh..

9). Në shkollën fillore “ Bajram Curri”. Në Shurdhan mësimet i vijnë nxënësit prej kl. I-VIII të fshatit Shurdhan, Çelik dhe Pidiç si dhe prej kl. V-VIII të fshatit Dunav dhe Stanqiq.

- në paralelen e ndarë në Dunav, mësimet i vijnë nxënësit prej kl. I-IV të fshatit Dunav.

- në paralelen e ndarë në Stanqiq, mësimet i vijnë nxënësit prej kl. I-IV të fshatit Stanqiq.

10). Në shkollën fillore “Esat Berisha” në Llashticë, mësimet i vijnë nxënësit prej kl. I-VIII të fshatit Lashticë..

11). Në shkollën fillore “ Idriz Hajrullahu” në Velekinë, Mësimet i vijnë nxënësit e klasës I-VIII të fshatit Velekinë..

- në paralelen e ndarë në Myqybabë, mësimet i vijnë nxënësit e kl. I-VIII të fshatit Myqybabë, Burincë dhe Lipovicë..

12). Në shkollën fillore “**Emin Duraku** “. Në Malishevë, mësimet i vijnë nxënësit prej kl. I-VIII në Malishevë dhe të Muhaxherëve të Malishevës, si dhe Malishevës së Epërme..

- në paralelen e ndarë në Uglarë, mësimet i vijnë nxënësit prej kl. I-VIII të fshatit Uglarë..

13). Në shkollën fillore “ Liria” në Pogragjë, mësimet i vijnë nxënësit prej kl. I-VIII të fshatit Pogragjë, nxënësit prej kl. V-VIII të fshatit Stublinë, nxënësit prej kl. V-VIII të fshatit Bilinicë,

- në paralelen e ndarë në Llovcë dhe nxënësit prej kl. V-VIII të fshatit Inatovc,

- në paralelen e ndarë në Sllubicë, mësimet i vijnë nxënësit prej kl. I-VIII të fshatit Sllubicë dhe të Muhaxherëve të Pogragjës.

- në paralelen e ndarë në Inatovcë, mësimet i vijnë nxënësit prej kl. I-IV të fshatit Stublinë dhe.

- në paralelen e ndarë në Stublinë , mësimet i vijnë nxënësit prej kl. I-IV të fshatit Stublinë, dhe

- në paralelen e ndarë në Bilinicë, mësimet i vijnë nxënësit prej kl. I-IV të fshatit Bilinicë.

14. Në shkollën fillore “ Nazmi Hikmet” në Doberqan mësimet I vijnë nxënësit prej kl. I-VIII të fshatit Dobërçan dhe lagjes së Muhagjerëve të Doberqanit.

- nxënësit prej kl. I-VIII të fshatit Dobërçan me mësim në gjuhën Turke.

- në paralelen e ndarë në Bukovik mësimet I vijnë nxënësit e kl. I-VIII të fshatit Bukovik dhe Caparë.

- në paralelen e ndarë në Petroc, mësimet I vijnë nxënësit prej kl. I-VIII të fshatit Petroc.

15. në shkollën fillore “ Skënderbeu” në Përlepnice, mësimet i vijnë nxënësit prej kl. I-VIII të fshatit Përlepnice dhe nxënësit prej kl. V-VIII të fshatit Kmetovc, Verbicë e Kmetovcit dhe Muhaxherët e Shillovës.

- në paralelen e ndarë në Makresh të Poshtëm, mësimet I vijnë nxënësit prej kl. I-VIII të fshatit Makresh I Poshtëm,

- në paralelen e ndarë në Kmetovc mësimet I vijnë nxënësit prej kl. I-IV të fshatit Kmetovc dhe Muhaxherëve të Shillovës.

- në paralelen e ndarë në Verbicë të Kmetovcit , mësimet I vijnë nxënësit prej kl. I-IV të Verbicës së Kmetovcit.

16. Në shkollën fillore “ Vatra e Diturisë” në Livoçë të Epër, mësimet I vijnë nxënësit e kl. I-VIII të fshatit Livoç i Epër.

-në paralelen e ndarë në pasjak, mësimet I vijnë nxënësit e kl. I-VIII të fshatit Pasjak dhe nxënësit prej kl. I-VIII të vendbanimeve mbi pompat e benzinës në dalje të qytetit të Rugës për Prishtinë (ana e majtë dhe e djathtë e vendbanimeve.

17. Në shkollën fillore “Zenel Hajdini” në Bresalc, mësimet I vijnë nxënësit e kl. I-VIII të fshatit Bresalcë dhe nxënësit prej kl. V-VIII të fshatit Ponesh.

- në paralelen e ndarë në Ponesh mësimet I vijnë nxënësit e kl. I-IV të fshatit Ponesh.

18. në shkollën fillore “ Afërdita” në Kishnapole, mësimet I vijnë nxënësit e kl. I-VIII të fshatit Kishna Pole, të Sllakovcit të Poshtëm dhe Dubovës si dhe nxënësit prej kl. I-VIII të fshatit Gadish.

- në paralelen e ndarë në Sllakovc të Epër, mësimet I vijnë nxënësit prej kl. I-VIII të fshatit Sllakovc të Epër.

- Në paralelen e ndarë në Gadish mësimet I vijnë nxënësit prej kl. I-IV të fshatit Gadish.

19. Në shkollën fillore “Fetah Qerimi” në Verbicë të Zhegovcit, mësimet I vijnë nxënësit prej kl. I- VIII të fshatit Verbicë të Zhegovcit.

- në paralelen e ndarë në Zhegovc, mësimet I vijnë nxënësit e kl. I-VIII të fshatit Zhegovc.

III

Obligohen shkollat nga pika II e këtij vendimi që t’ia zbatojnë këtë vendim në përpikëri..

IV

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Arsim e KK-ës Gjilan.

V

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi për rajonalizimin e shkollave fillore në territorin e Komunës së Gjilanit, 01. nr 61-10/85 i datës 17 Korrik 1985, dhe të gjitha vendimet tjera që rregullojnë këtë materie, përjashtimisht për nxënësit që vijojnë mësimet në gjuhën Serbe derisa të Kompletohen shënimet e nevojshme,

VI

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit

Kuvendi i Komunës – Gjilan

Nr. 01/ 3616/020
Gjilan, 29.06.2001

Kryetari i KK-ës
Lutfi Haziri



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 31.08.2001, e duke u bazuar në nenin 12 alineja 1 pika (ë) dhe (h) dhe nenin 48 alineja 3 dhe 4 të Statutit të Komunës së Gjilanit, nxori këtë:

VENDIM
PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E QENDRËS PËR
SHËRIMIN E PERSONAVE ME TË META MENTALE

I

Me këtë vendim caktohet lokacioni i ri për ndërtimin e Qendrës për shërimin e personave me të meta mentale me sipërfaqe prej 10 ari (sipërfaqja e përgjithshme 01.07.17 Ha), në ngastrën kadastrale nr. 1965/1, fleta poseduese nr. 1734, shfrytëzues Kombinati bujqësor “Agrokultura” KK-Gjilan.

II

Sipas këtij vendimi do të bëhet bartja administrative për sipërfaqen e lartshënuar nga ish pronari Kombinati bujqësor ‘ Agrokultura” në pronarin e ri- Kuvendin e Komunës Gjilan.

III

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi pushon të vlej vendimi Nr.;01-1898-020 i datës 11.04.2001 i nxjerr nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

IV

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

V

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr. 01-5437-10
Gjilan, 31.08.2001

Kryetari i KK-ës
Lutfi Haziri



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 31.08.2001, e duke u bazuar në nenin 12 alineja 1 pika (ë, h, j) të Statutit të Komunës së Gjilanit, nxori këtë:

VENDIM
PËR INKORPORIMIN E STACIONIT TË VETERINARIS NË KUADËR TË
DREJTORISË PËR BUJQËSI DHE PYLLTARI

I

Inkorporohet Stacioni i Veterinarisë në kuadër të Drejtorisë për Bujqësi dhe Pylltari si Shërbim i Veterinarisë – Sektor i veçantë.

II

Shërbimi i Veterinarisë do të përkujdeset për shëndetin primar të kafshëve shtëpiake, do të bëjë evidentimin dhe matrikulimin e kafshëve si dhe do të ndërmerret të gjitha masat profilaksie ndaj sëmundjeve të ndryshme infektive dhe zoonazova me çka do të mbrohet drejtpërdrejtë edhe shëndeti i njeriut.

III

Për stafin e Shërbimit të Veterinarisë vlejné të gjitha obligimet dhe normat e punës konform ligjeve të zbatueshme.

IV

Për zbatimin e këtij vendimi do të përkujdeset Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari.

V

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr. 01.5426-10
Gjilan, 31.08.2001

Kryetari i KK-ës
Lutfi Haziri



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 31.08.2001, e duke u bazuar në nenin 2 dhe nenin 48 alineja 3 dhe 4 të Statutit të Komunës së Gjilanit e me propozimin e komisionit për zgjedhjen e Emblemsë së Qytetit të Gjilanit, nxori këtë:

VENDIM
PËR CAKTIMIN E EMBLEMËS SË QYTETIT TË GJILANIT

I

Caktohet punimi i autorit me shifrën “ FLONI “ për Emblemsë të Qytetit të Gjilan.

II

Punimi për Emblema i shifrën “ FLONI “ sipas vlerësimit të komisionit i përmban të gjitha kriteret e kërkuara me konkurs siç janë :

- Elementet nga lashtësia e qytetit (Sahat Kulla, Kalaja e Pogragjës etj.)
- Elementet nga arkitektura dhe zhvillimi bashkëkohorë i qytetit.

III

Shenja e Emblemsë do të përdorët si shenjë identifikimi në të gjitha dokumentet e lëshuara nga organet e Kuvendit të Komunës së Gjilanit, objektet e Kuvendit Komunal dhe Institucionet Komunale.

IV

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Emblema – punime origjinal i autorit me shifrën “ FLONI “ – Qamil Llapashtica nga Gjilan.

V

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr. 01.5436/10
Gjilan, 31.08.2001

Krytari i KK-ës
Lutfi Haziri



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 31.08.2001, e duke u bazuar në nenin 4 të Statutit të Komunës së Gjilanit, nxori këtë:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR VERIFIKIMIN E SHTËPIVE TË
DJEGURA TË MINORITETIT ROMË

I

Formohet komisioni për verifikimin e shtëpive të djegura të minoritetit Romë me këtë përbërje:

- 1) Halim Huruglica
- 2) Ibrahim Salihu
- 3) Nehat Sherif
- 4) Një për. i Minor. Rom
- 5) Një për. , i UNMIK-ut.

II

Komisioni nga pika I e këtij vendimi do të merret me verifikimin e gjendjes së shtëpive të djegura, të dëmtuara dhe të uzurpuara të minoritetit Rom në Komunë dhe për punën e vet do të paraqes raport Kuvendit të Komunës së Gjilanit.

III

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

Kuvendi i Komunës- Gjilan.

Nr.01.5433/10
Gjilan, 31.08.2001

Kryetari i KK-ës
Lutfi Haziri



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Në bazë të nenit 13,44. al. 1. al.1 pika a dhe 74 të Statutit të Komunës së Gjilanit nr. 01-1448/010 të datës 16.03.2001, nenit 4 al. 4.1, 11 al. 13.3 pika b, al. 19.2 të Rregullores mbi vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës n. 2000/45, dhe ligjit në fuqi, Kuvendi I Komunës së Gjilanit, në mbledhjen e vet të mbajtur më 28.09.2001,nxjerrë:

RREGULLORE
MBI PËRCAKTIMIN E LARTËSIS SË KOMPENZIMIT ANTARËVE TË
KUVENDIT DHE NDALESAVE TË STAFIT TË SHËRBIMIT CIVIL
KOMUNAL

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohet lartësia e kompensimit të anëtarëve të Kuvendit dhe punëtorëve të shërbimit civil Komunal gjatë orarit të punës dhe jashtë orarit të punës, shpenzimet e udhëtimit mëditjet, reprezentacioni dhe shujta e nxehtë për punëtorë.

Neni 2

Me këtë Rregullore do të përcaktohen edhe kompensime tjera siç janë:

- Kompensimi i pagës gjatë përsosjes profesionale.
- Kompensimi i pagës gjatë zbatimit të procedurës disiplinore,
- Kompensimi i pagës gjatë ndërprerjes së punës para afatit të largimit,
- Kompensimi i pagës për zëvendësimin e punëtorit që mungon,
- Kompensimi për punën e natës,
- Kompensimi i komisioneve që formohet nga Kuvendi Komunal dhe organet Komunale,
- Ndalet në paga.

Punëtorët e shërbimit civil komunal kanë të drejtë sipas Rregullores mbi ndarjen e pagave dhe Rregullores mbi sistematizimin e vendeve të punës, por i nënshtrohen edhe ndalesave nëse krijohen kushtet për ndaljen e tyre të cilat do të rregullohen me këtë Rregullore.

Neni 4

KOMPENZIMI I FUNKSIONEËVE DHE ANTARËVE TË KUVENDIT

Kryetarit të Kuvendit Komunal i përcaktohet pagan ë shumë mujore prej 1000 DM. Nënkryetari të parë dhe të dytë të Kuvendit të Komunës, si dhe Kyeshëfit Ekzekutiv t'i përcaktohet pagan në shumë mujore prej 850 DM.

Neni 5

Anëtarëve të Kuvendit (kuvendarëve) për kohën e shpenzuar në séance të komiteteve dhe seancën e Kuvendit iu takon kompensimi I caktuar me këtë Rregullore.

Kompensimi për kohën e harxhuar në seancat e komiteteve ju takon edhe anëtarëve të komiteteve që nuk janë anëtarë të Kuvendit.

Neni 6

Anëtarëve të Kuvendit komunal për kohën e shpenzuar në seancën e kuvendit, iu takon kompensimi në shumë prej 100 DM.

Anëtarëve të komiteteve për kohën e shpenzuar në seancën e komiteteve ju takon kompensimi në shumë prej 50 DM.

Neni 7

Për pjesëmarrje në seancat e kuvendit dhe në seancat e komiteteve, kompensimi nuk mund të jetë më i lartë se 200 DM, në muaj.

Neni 8

Për realizimin e të drejtave nga neni i 6 i kësaj Rregulloreje është kusht pjesëmarrje në seancën qoftë ajo e komitetit apo e kuvendit në të kundërtën nuk i takon kompensimi.

Neni 9

SHPENZIMET E UDHËTIMIT

Punëtorin të cilin drejtori i drejtorisë e dërgon, ose vet shkon ta kryej ndonjë funksion apo detyrë zyrtare duhet ti kompensohen shpenzimet e udhëtimit. Udhëtimet mund të jenë Brenda Kosovës dhe udhëtimet jashtë Kosovës.

Neni 10

UDHËTIMET BREDA KOSOVËS

Udhëtimet Brenda Kosovës duhet të lejohet me shkrim nga drejtori i drejtorisë dhe kryeshefi ekzekutiv.

Neni 11

Nëse shkuarja dhe ardhja kryhet në të njëjtën ditë nuk do të ketë kompensim të shpenzimeve me përjashtim të shpenzimeve të transportit të cilat do të kompensohen në bazë të shpenzimeve të arsyetuara me vërtetim (biletë), në rastet kur nuk është siguruar transporti zyrtar.

Në qoftë se personi zyrtar shfrytëzon automjetin e vet për udhëtim për punë zyrtare do ti pranohen shpenzimet në shumë prej 20 % të çmimit të karburantit të harxhuar për Km.

Neni 12

Kur udhëtimi zyrtar përfundon me fjetje apo bujtje gjatë natës në Hotel, i cili gjendet lagr bazës, zyrtarit i takon kompensimi i shpenzimeve të fjetjes dhe ushqimit.

Për kompensim të shpenzimeve të cekura në alinenë e mëparshme të këtij neni duhet bërë kërkesa Brenda 2 ditë pune pas kthimit nga udhëtimi zyrtar.

Avansi para nisjes në rrugë zyrtare mund të jepet kur rrethanat e arsyetojnë se duhet dhënë.

Neni 13

UDHËTIMET JASHTË KOSOVËS.

Udhëtimet jashtë Kosovës lejohet dhe aprovohet me shkrim vetëm nga Kryetari i Komunës apo kryeshefi Ekzekutiv.

Neni 14

Kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit, mëditjes dhe shpenzimeve tjera jashtë Kosovës bëhet në përputhje me standardet dhe rregulloret e UNMIK-ut, Administratës civile.

Neni 15

MËDITJET

Punëtari i cili gjendet në udhëtim zyrtar Brenda Kosovës, por i cili nuk ka mundur të kthehet Brenda ditës i takon mëditja.

Mëditja për udhëtimet Brenda Kosovës do të jetë në shumë prej 80 DM, Brenda 24 orëve. Puna jashtë orarit të punës paguhet sipas orëve të shpenzuara dhe atë e rritur për 30% për orë punë.

Neni 16

REPREZENTACIONI

Kryetari i Kuvendit komunal, Zëvendës kryetari, kryeshefi ekzekutiv dhe drejtorët e drejtorive kanë të drejtë në reputacion pasi që janë persona me autorizime të veçanta dhe presin palë, mysafir dhe delegacione të ndryshme.

Reprezentacioni i kryetarit dhe nënkryetarit do të jetë në shumë vjetore prej 12.000 DM, Reputacioni i kryshefit ekzekutiv do të jetë në shumë vjetore prej 4.000 DM.

Reprezentacioni i drejtorëve të drejtorive do të jetë në shumë vjetore prej 10.000 DM, i cili do të ndahet në mënyrë proporcionale.

Neni 17

SHUAJTJA E NXEHTË PËR PUNTORËT

Punëtorëve të shërbimit civil komunal, iu takon participimi në një shujtë të nxehtë në shumë ditore 3 DM, për ditë pune.

Neni 18

FESTAT SHTETËRORE DHE FETARE.

Festat shtetërore dhe fetare sipas ligjit janë ditë pushimi.

Punëtorët të cilët për shkak të natyrës së punës janë detyruar të punojnë gjatë festive shtetërore dhe atyre fetare kanë të drejtë të shfrytëzojnë ditë të lirë si kompensim për ditën të cilën kanë punuar.

Neni 19

PËRGADITJA PROFESIONALE

Punëtorët që dërgohen në përsosje profesionale- trajnim jashtë qendrës komunale kanë të drejtë në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit, ushqimit dhe fjetjes – bujtjes nëse ato nuk e heq organizatori.

Punëtorët që bëjnë përsosjen profesionale – trajtimin Brenda komunës së Gjilanit nuk kanë kurrfarë të drejte në kompensim.

Neni 20

PROCEDURA DICIPLINORE

Kompensimi i pagës gjatë zbatimit të procedurës disiplinore bëhet 100/100, nëse punëtari edhe përkundër zbatimit të procedurës disiplinore i kryen detyrat e punës.

Kompensimi i pagës gjatë zbatimit të procedurës disiplinore bëhet 50/100, nga paga nëse punëtari është suspenduar deri në përfundimin e zbatimit të procedurës disiplinore.

Nëse me përfundimin e procedurës disiplinore vërtetohet pafajësia e punëtorit i kompensohet 50/100, i mbetur.

Neni 21

NDËRPRERJA E MARDHËNIES SË PUNËS

Punëtorit një muaj përpara afatit të largimit nga puna I ndërpritet marrëdhënia e punës por edhe për muajin vijues ka të drejtë në kompensimin e pagës.

Neni 22

ZËVENDËSIMI I PUNËTORIT

Punëtori që mungon nga puna më tepër se një muaj për shkaqe të arsyeshme mund të zëvendësohet me një punëtorë tjetër nga drejtori I drejtorisë me një punëtor tjetër të njëjtit kualifikim apo kategori kualifikuese.

Nëse një drejtorë I drejtorisë mungon, punëtori I cili caktohet të zëvendësoj drejtorin, realizon lartësinë e pagës së drejtorit.

Neni 23

PUNA E NATËS

Punëtorët të cilët janë të detyruar të punojnë në disa raste të veçanta natën, për kohën që punojnë të ardhurat iu rriten për 30 %.

E përcaktuar në al. të këtij neni nuk vlen për rojtarët dhe ata të cilët janë pranuar për punë të natës.

Neni 24

PUNA E KOMISIONEVE

Kuvendi komunal dhe organet respektivisht drejtorit formojnë AD HOK komisione profesionale për çështje të caktuara.

Neni 25

Komisioneve të formuara nga neni 24. i kësaj rregulloreje iu takon kompensim për kohën e shpenzuar për kryerjen e punëve profesionale të caktuara.

Për komisionet e formuara nga kuvendi komunal iu takon kompensimi dhe atë:

Për kryetarin e komisionit shuma prej 6 DM, për orë të shpenzuara dhe

Për anëtarë të komisionit shuma prej 5 DM, për orë të shpenzuara.

Për komisionet e formuara nga organet apo drejtoritë kompensimi do të jetë:

Për kryetarin e komisionit shuma prej 6 DM për orë të shpenzuara dhe

Për anëtar të komisionit shuma prej 5 DM për orë të shpenzuara.

Komisionet punën për të cilën janë formuar e kryejnë jashtë orarit të punës në të kundërtën nuk ju takon kompensimi.

Neni 26

Mjete e shpenzuara për punën e komisionit do të paguhet nga fondi I shpenzimeve të përbashkëta, ndërsa do të mbulohen nga kërkuesi I kryerjes së punëve.

Neni 27

NDALESA NË PAGA

Ndalesat në paga do të bëhen te ata punëtorë të cilët janë në pushim mjekësor.

Mungojnë nga puna pa arsye dhe ata të cilët nuk I kryejnë detyrat e përcaktuara ashtu siç

është e paraparë me rregulloren mbi sistematizimin e vendeve të punës dhe Rregulloren mbi marrëdhënien në punë.

Ndalesat për pushim mjekësor do të bëhen në bazë të ligjit i cili e përcakton shkallën e zbritjes nga paga.

Ndalesat për mungesë pa arsye nga do të bëhet në lartësinë e mëditjes së punëtorit që mungon në punë.

Për moskryerjen e detyrave me kohë të përcaktuara do të ndahen të ardhura personale në lartësi prej 30 % e mëditjes.

Neni 28

Kompensimi i të gjitha kategorive të cekura do të bëhet nga fondi i shpenzimeve të përbashkëta.

Neni 29

Për zbatimin e kësaj Rregullore do të kujdeset kryeshefi ekzekutiv dhe drejtorët e drejtorive të KK-ës Gjilan.

Neni 30

Kjo Rregulloreje hyn në fuqi ditën e miratimit në Kuvendin e Komunës së Gjilanit.

KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT

Nr.01.6172/020
Gjilan, 28.09.2001

Kryetari

Lutfi Haziri



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 30.11.2001, nxori këtë.

VENDIM
PËR PLOTËSIMIN E VENDIMIT PËR EMËRIMIN E KOMISIONIT PËR
PËRCJELLJEN E GJENDJES SË FAMILJEVE TË DËSHMORËVE DHE
VIKTIMAVE TË LUFTËS

I

Me këtë vendim bëhet plotësimi i vendimit për emërimin e komisionit për përcjelljen e gjendjes së familjeve të dëshmorëve dhe viktimave të Luftës Nr.01.290/020, i marrë nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e datës 25.05.2001.

II

Për anëtarë të komisionit për përcjelljen e gjendjes së familjeve të dëshmorëve dhe viktimave të Luftës emërohet:

1. Vlastimir Petroviq- anëtar

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr, 01.7408/020
Gjilan, 30.11.2001

Kryetari i KK-ës
Lutfi Haziri



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Në bazë të nenit 6 të Rregullores Nr. 2000/45 mbi vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës dhe nenin 54 dhe 55 të Statutit të Komunës së Gjilanit, nxori këtë:

VENDIM
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E PËRBËRJES SË KOMITETEVE

I

Me këtë vendim bëhet ndryshimi dhe plotësimi në përbërjen e disa komiteteve të Kuvendit të Komunës së Gjilanit.

II

Për anëtarë të rinj të Komitetit për Planifikim dhe Resurse natyrore Emërohen:

1. Habib Ymeri – anëtar
2. Ruzhdi Shabani – anëtar
3. Bahri Uka – zv. Kryetar i komitetit.

Ndërsa Rushit Avdiu, anëtar- emërohet kryetar i Komitetit për Planifikim dhe Resurse natyrore.

III

Për anëtar të Komitetit për Arsim, në vend të z, Ismajl Kurteshit emërohet:

1. Sami Hoxha – kryetar i komitetit.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr. 01.7409/020
Gjilan, 30.11.2001

Kryetari i KK-ës
Lutfi Haziri



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 30.11.2001, e duke u bazuar në shkresën e Prefektit, Kryetarit dhe të gjithë anëtarëve të Këshillit të Komunës së IEPPERIT të Belgjikës, nxori këtë:

VENDIM
PËR BASHKPUNIM ME KOMUNËN IEPPER TË BELGJIKËS

I

Ipët pëlqimi për bashkëpunim në mes të Komunës së Gjilanit – KOSOVË dhe Komunës IEPPER- BELGJIKËS.

II

Sferat e bashkëpunimit në mes të komunës së Gjilanit dhe Komunës IEPPER të Belgjikës, në fazën fillestare do të bartin porosinë e paqes dhe miqësisë, ndërsa në të ardhmen do të definohen fushat e bashkëpunimit.

III

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr.01.7467/020
Gjilan, 30.11.2001

Kryetari i KK-ës
Lutfi Haziri



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Në bazë të nenit 6.12 al.1 nën (ë) dhe 13 të Statutit të Komunës, nenit 2 pika 2.4 dhe 44 pika 44.1 dhe 44.2 të Rregullores mbi vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës nr. 2000/45 dhe ligjit në fuqi. Kuvendi i Komunës së Gjilanit në mbledhjen e vet të mbajtur më datë 30.11.2001 merr këtë:

VENDIM
MBI PËRCAKTIMIN E PRONËS SHTETRORE - KOMUNALE

Neni 1

Me këtë vendim përcaktohet prona shtetërore – Komunale me të cilën qeverisë dhe udhëheq Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

Neni 2

Pronë shtetërore – komunale, konsiderohet e tërë prona e cila titullar e ka shtetin-komunën dhe atë: pyjet, kullosat, lumenjtë, liqenet, ujërat minerale, rrugët publike, objektet sportive, qendrat rekreative , objektet afariste, xeheroret dhe objektet tjera me interes shtetëror- Komunal.

Neni 3

Pronë shtetërore – komunale, konsiderohet e tërë pasuria e cila titullar i ka subjektet ekonomike dhe jo ekonomike të Republikave të ish Jugosllavisë.

Neni 4

Pronë shtetërore- komunale, ,konsiderohet edhe prona e cila titullar nuk e ka shtetin-komunën por është shpallur tokë e nacionalizuar në bazë të Ligjit për nacionalizimin e ndërtesave me qira dhe tokës ndërtimore dhe të njëjtën pronarët e mëparshëm e kanë vetëm në shfrytëzim por jo edhe në posedim.

Neni 5

Për pronën nga neni 2.3 dhe 4 e këtij vendimi nuk mund të merret kurrfarë veprimi Juridik pa pëlqimin e Kuvendit Komunal.

Neni 6

Për pronën nga neni 2 dhe 3 i këtij vendimi, kujdeset kryeshefi ekzekutiv për përgatitjen dhe mbajtjen e shënimeve për tërë tokën dhe objektet të cilat i posedon apo i shfrytëzon kuvendi komunal në bashkëpunim me Drejtorinë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë.

Neni 7

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit në Kuvendin Komunal.

KUVENDI KOMUNËS SË GJILANIT

Nr.01.7331/020
Gjilan, 30.11.2001

Kryetari

Lutfi Haziri



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Kuvendi i komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 08.03.2002, e duke u bazuar në nenin 3.1 pika (ë) dhe (f) të Rregullores nr. 2000/45 mbi vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës dhe nenin 12 alineja 1 pika (ë) dhe (g) të Statutit të Komunës së Gjilanit, nxori këtë:

VENDIM
PËR VËRTETIMIN E INTERESIT TË PËRGJITHSHËM NË
NGASTRAT KADASTRALE NR. 1731 DHE 1732

I

Me këtë vendim vërtetohet se është në interes të përgjithshëm ndërtimi i objektit të Shkollës fillore të fshatit Kmetoc, në sipërfaqe prej 50 ari (pesëdhjetë ari) nga sipërfaqja e gjithëmbarshme prej 1 Ha 25 ari e 03 m, në ngastrën kadastrale nr. 1731 dhe 1732, fleta poseduese nr. 203, me kulturë shterpë- mal në vendin e quajtur “ Sekeresh”- Komuna kadastrale Kmetoc.

II

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Arsim.

III

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr. 01.1791/020
Gjilan, 08.03.2002

KRYETARI
Lutfi Haziri



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 29.03.2002, e duke u bazuar në nenin 12 alinea 1 pika (h) të Statutit të Komunës së Gjilanit, nxori këtë:

VENDIM
PËR APROVIMIN E MEMORANDUMIT PËR MIRKUPITIM

I

Me këtë vendim aprovetur Memorandumi për mirëkuptimin në mes të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Qështje Sociale nga njëra anë e Shkollës së Mjekësisë së Dotmouth (Partner Amerikan) dhe Aleancës ndërkombëtare shëndetësore Amerikane (AIHA) nga ana tjetër.

II

Pjesë përbërëse e këtij vendimi do të jetë teksti i Memorandumit për mirëkuptim i përkthyer nga Gjuha Angleze.

III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Shëndetësi dhe Çështje Sociale.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr. 01. 2450/020
Gjilan, 29.03.2002

KRYETARI
Lutfi Haziri



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Kuvendi i komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 29.03.2002, e duke u bazuar në nenin 3.1 pika (ë) dhe (f) të Rregullores nr. 2000/45 mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës dhe nenin 12 alineja 1 pika (ë) dhe (g) të Statutit të Komunës së Gjilanit, nxori këtë:

VENDIM
PËR VËRTETIMIN E INTERESIT TË PËRGJITHSHËM NË NGASTRËN
KADASTRALE NR. 572

I

Me këtë vendim vërtetohet se është në interes të përgjithshëm ndërtimi i objektit të Shkollës Filllore të fshatit Vrapqiq, në sipërfaqe prej 9 ari e 08 m (nëntë ari e tetë metra), në ngastrën kadastrale nr. 572, fleta poseduese nr. 40, me kulturë kullosë, klasa e pestë, pasuri shoqërore, në vendin e quajtur Golesh “ Lama e Moçme”. Komuna kadastrale Vrapqiq.

II

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Arsim.

III

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr. 01.2444/020
Gjilan, 29.03.2002

K R Y E T A R I
Lutfi Haziri



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 29.03.2002, nxori këtë:

VENDIM
PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E VENDIMIT PËR EMËRIMIN E
KOMISIONIT PËR PËRCJELLJEN E GJENDJES SË FAMILJEVE TË
DËSHMORËVE DHE VIKTIMAVE TË LUFTËS

I

Me këtë vendim bëhet plotësimi dhe ndryshimi i vendimit për emërimin e komisionit për përcjelljen e gjendjes së familjeve të dëshmorëve dhe viktimave të luftës Nr. 01.2901/020, i marrë nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e datës 25.05.2001.

II

Për anëtarë të komisionit për përcjelljen e gjendjes së familjeve të dëshmorëve dhe viktimave të luftës në vend të z. Vllastimir Petoviq emërohet:

1. Z. Slllobodan Saviq- anëtarë.

III

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, pushon të vlej vendimi për plotësimin e vendimit për emërimin e komisionit për përcjelljen e gjendjes së familjeve të dëshmorëve dhe viktimave të luftës i marrë nga kuvendi i Komunës së Gjilanit, nr. 01. 7408/020, i datës 30.11.2001.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr. 01. 2451/020
Gjilan, 29.03.2002

Kryetari i KK-ës
Lutfi Haziri



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 03.06.2002, e duke u bazuar në nenin 6 dhe nenin 12 alineja 2 pika (p) të Statutit të Komunës së Gjilanit, nxori këtë:

VENDIM
PËR CAKTIMIN E LOKALIT PËR GALERI NË KOMUNËN E GJILANIT

I

Me këtë vendim caktohet lokali për Muze dhe Galeri për zhvillimin e veprimtarisë së Artistëve pamor figurative, në hollin e katit të dytë të ndërtesës së Teatrit të Qytetit të Gjilanit, për zhvillimin e veprimtarisë së artit pamor të Komunës sonë dhe më gjerë.

II

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i KK-ës dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr. 01.3821/020
Gjilan, 03.06.2002

K R Y E T A R I
Lutfi Haziri



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 03.06.2002, e duke u bazuar në nenin 6 dhe nenin 12 alineja 2 pika (p), alinenë 2 pika (r) të Statutit të Komunës së Gjilanit, nxori këtë:

VENDIM
PËR CAKTIMIN E LOKALIT PËR SHTËPI TË RINISË NË KOMUNËN E
GJILANIT

I

Me këtë vendim lokalit për shtëpi të rinisë të Komunës së Gjilanit në objektin që deri më tani e kanë shfrytëzuar SHKA-t e qytetit, që ndodhet në rrugën “ Lidhja e Prizrenit “ dhe do të shfrytëzohet nga Qendra rinore e Komunës së Gjilanit.

II

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i KK-ës dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

III

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr. 01.3820/020
Gjilan, 03.06.2002

K R Y E T A R I
Lutfi Haziri



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën mbajtur më 03.06.2002, e duke u bazuar në nenin 12 alineja 1 pika (ë) dhe (h) dhe neni 48 alineja 3 dhe të Statutit të Komunës së Gjilanit, nxori këtë:

VENDIM
PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E SHTËPIS MBROJTËSE
PËR PACIENT KRONIK PSIKIATRIK

I

Me këtë vendim caktohet për ndërtimin e Shtëpisë për pacient kronik psikiatrik, me sipërfaqe prej 15 ari, ngastra kadastrale nr. 1/1, fleta poseduese nr. 1750 me kulturë – kullosë, Komuna kadastrale – Gjilan, pronë shtetërore.

II

Financimin e projektit për ndërtimin e Shtëpisë mbrojtëse për pacient kronik psikiatrik në lokacionin e përshkruar në pikën I të këtij vendimi do të bëjë Qeveria Zvicerane.

III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr.01. 3835/020
Gjilan, 03.06.2002

K R Y E T A R I
Lutfi Haziri



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën mbajtur më datë 03.06.2002, e duke u bazuar në nenin 12 alineja 1 pika (f) të Statutit të Komunës së Gjilanit, e në bazë të rekomandimit të Komitetit për pronë, nxori këtë:

VENDIM
PËR CAKTIMIN E LOKALIT TË PUNËS PËR DEPARTAMENTIN PËR
SIGURI CIVILE DHE GADISHMËRI EMERGJENTE NË GJILAN

I

Me këtë vendim caktohet lokali i punës për zhvillimin e aktivitetit të Departamentit për Siguri dhe Gadishmëri Emergjente në objektin e ish BVI-së së sigurimeve në rrugën “ Fehmi Lladrovcin “ në Gjilan.

II

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i KK-ës dhe Drejtoria për Siguri Publike dhe Emergjencë.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr. 01.4374/020
Gjilan, 03.06.2002

K R Y E T A R I
Lutfi Haziri



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën mbajtur më 03.06.2002, e duke u bazuar në nenin 12 alineja 1 pika (b) dhe (ë) të Statutit të Komunës së Gjilanit, nxori këtë:

VENDIM
PËR NDARJEN E LOKACIONIT – SIPËRFAQES SË TOKËS PËR NGRITJEN
E KOMPLEKSIT MEMORIAL – KULLËS “ AGIM RAMADANI “

I

Me këtë vendim ndahet lokacioni – sipërfaqja e tokës, në të cilën do të ngritët Kompleksi Memorial – Kulla “ Agim Ramadani” në Fshatin zhegër.

II

Kompleksi Memorial – Kulla “ Agim Ramadani” do të ngritët në ngastrën kadastrale nr. 2091 me sipërfaqe prej 1 ha, nga sipërfaqja e gjithëmbarshme prej 3.47.88 ha , fleta poseduese nr. 522 me kulturë – kullosë në vendin e quajtur “ Të Shkolla Zhegër “. Pasuri shoqërore Komuna Kadastrale – Zhegër.

III

Për zbatimin e këtij vendimi do te kujdeset Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr. 01.3830/020
Gjilan, 03.06.2002

K R Y E T A R I
Lutfi Haziri



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën mbajtur më datë 03.06.2002, e duke u bazuar në nenin 21.6 të Rregullores nr. 2000/45 mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës dhe nenin 54 dhe 55 të Statutit të Komunës së Gjilanit, nxori këtë:

VENDIM
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E PËRBËRJES SË KOMITETEVE

I

Me këtë vendim bëhen ndryshime dhe plotësime në përbërjen e disa Komiteteve të Kuvendit të Komunës së Gjilanit.

II

Në Komitetin për Pronë Emërohen:

1. z. Fahri Shaqiri, në vend të z. Murat Hoxha
2. z. Bojan Antiq, në vend të z. Slllobodan Stefanoviq.

Në Komitetin për ndërtim dhe Banim emërohet:

1. z. Branislav Milkoviq, në vend të z. Sreten Millosheviq.

Në Komitetin për Ndërmarrje dhe Shërbime Publike emërohet:

1. z. Antiq Stanko, në vend të z. Zoran Aksiq.

III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Zëvendëskryetari i KK-ës

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS- GJILAN

Nr.01. 3832/020
Gjilan, 03.06.2002

Kryetari i KK-ës
Lutfi Haziri



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën mbajtur më 03.06.2002, e duke u bazuar në nenin 12 alineja 1 pika (11) të Statutit të Komunës së Gjilanit, nxori këtë:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR EMËRIMIN E VENDBANIMEVE –
FSHATRAVE TË KOMUNËS SË GJILANIT

Me këtë vendim formohet Komisioni për Emërimin e vendbanimeve – fshatrave të Komunës së Gjilanit me këtë përbërje:

- | | |
|--------------------|---------------------|
| 1. Aliriza Selmani | 5. Adem Pajaziti |
| 2. Fehmi Rexhepi | 6. Tahir Arifi |
| 3. Xhavit Hajdari | 7. Ratko Stoilković |
| 4. Sabit Rustemi | |

II

Komisioni nga pika I i këtij vendimi për punën e vet do të paraqes raport para Kuvendit të Komunës së Gjilanit.

III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS- GJILAN

Nr. 01. 3833/020
Gjilan, 03.06.2002

K R Y E T A R I
Lutfi Haziri



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 21.11.2002, e në mbështetje të nenit 25 të Rregullores nr. 2000/45 dhe nenit 72 të Statutit të Komunës së Gjilanit, bie këtë:

VENDIM
PËR ZGJEDHJET E ZËVENDËSKRYETARIT TË KOMUNËS SË GJILAN

I

Me këtë vendim z. Xhemajl Hyseni zgjedhet Zëvendëskryetar i Komunës së Gjilanit.

II

Funksionin e Zëvendëskryetarit të KK-ës Gjilan, z. Xhemajl Hyseni do ta ushtroj që nga dita e zgjedhjes në këtë funksion nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

III

Z. Xhemajl Hyseni në këtë funksion zgjedhet me mandate katër (4) vjeçar.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit.

KUVENDI I KOMUNËS- GJILAN

Nr. 01.10131/020
Gjilan, 21.11.2002

K R Y E T A R I
Lutfi Haziri



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 21.11.2002, e në mbështetje të nenit 25 të Rregullores nr. 2000/45 dhe nenit 73 të Statutit të Komunës së Gjilanit, bie këtë:

VENDIM
PËR EMËRIMIN E ZËVENDËSKRYETARIT PLOTËSUES TË KOMUNËS SË
GJILANIT

I

Me këtë vendim z. Bozhidar PERIQ emërohet Zëvendëskryetar plotësues i Komunës së Gjilanit.

II

Funksionin e Zëvendëskryetarit të KK-ës Gjilan, z. Bozhidar Periq do ta ushtroj që nga dita e emërimit në këtë funksion nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

III

Z. Bozhidar Periq në këtë funksion emërohet me mandat katër (4) vjeçar.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit.

KUVENDI I KOMUNËS- GJILAN

Nr. 01.10133/020
Gjilan, 21.11.2002

K R Y E T A R I
Lutfi Haziri



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Duke u bazuar në nenin 92 dhe nenin 92 të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 11.12.2002 mori këtë:

VENDIM
PËR ZGJEDHJEN E KOLEGJIT PËR TË UDHËHEQ PROCESIN E
ZGJEDHJES SË KRYESHEFIT EKZEKUTIV

I

Me këtë vendim zgjedhet Kolegji në përbërje prej 5 anëtarëve i cili do ta ndihmoj Kryetarin e Komunës për të udhëheq procesin e zgjedhjes së Kryeshefit ekzekutiv të Kuvendit të Komunës së Gjilanit dhe do të ketë këtë përbërje:

1. Arben Mehmeti,
2. Qemajl Jonuzi
3. Selvije Shefkiu
4. Ali Arifi
5. Qemajl Mustafa

II

Kolegji në mesin e anëtarëve të vetë mund të emëroj persona të cilit nuk janë këshilltarë të Kuvendit të Komunës, bazuar në profesionalizëm, kualifikimet e tyre akademike ose eksperiencën që kanë në administratën publike, udhëheqjen e biznesit, financave apo lëmive Juridike.

III

Kolegji rekrutimin do ta bëjë me konkurs të hapur, do të shpallet vendi i punës dhe të interesuarit do të kenë mundësi për të konkurruar duke filluar nga dita vijuese e shpalljes së konkursit.

IV

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Kuvendit të Komunës së Gjilanit.

V

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS- GJILAN

Nr. 01.10133/020
Gjilan, 11.12.2002

zv. KRYETARI
Xhemajl Hyseni



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Në bazë të n.12.p. (a), (d) dhe p. (dh), të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në mbledhjen e mbajtur më 11.12.2002 nxori këtë.

VENDIM
PËR CAKTIMIN E PJESËS SË LAGJES “ ILIRIA “ PËR PROJEKTIN “
ZHVILLIMI I NJË LAGJEJE “

I

Komuna e Gjilanit cakton pjesën e lagjes “ ILIRIA “ – në Gjilan për Projektin “ ZHVILLIMI I NJË LAGJEJE “ në Gjilan.

II

Projekti “ Zhvillimi i një Lagjeje “ në Gjilan do të realizohet në bashkëpunim me qytetin IPER- Belgjikë.

III

Për përgatitjen e këtij Projekti lejohen mjete materiale në lartësi gjerë më 5000 (pesëmijë) Eurosh nga buxheti Komunal i Gjilanit.

IV

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Kuvendit të Komunës dhe organet komunale të Administratës së Gjilanit.

V

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr. 01.10132/020
Gjilan, 11.12.2002

Zv. Kyetari
Xhemajl Hyseni



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

bazë të n. 21.1 dhe n. 21.2 të Rregullores mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Komunës nr. 2000/45 n. 51 dhe 52 të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës në Gjilan në mbledhjen e mbajtur me 11.12.2002 mori këtë:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMITETEVE

I

Kuvendi i Komunës në Gjilan për këtë mandat formon këto Komitete:

1. Komiteti për Politikë dhe Financa,
2. Komiteti për ndërmjetësim,
3. Komiteti për Komunitete,
4. Komiteti për Planifikim, Resurse natyrore, Urbanizëm dhe Ambient,
5. Komiteti për Shëndetësi dhe çështje Sociale,
6. Komiteti për Arsim
7. Komiteti për Kulturë, Rini, Sport dhe çështje gjinore.
8. Komiteti për Pronë, Banim dhe Rindërtim,
9. Komiteti për Zhvillim Ekonomik , Biznes, Agrokulturë dhe Zhvillim Rural,
10. Komiteti për ndërmarrjet dhe Shërbimet Publike,
11. Komiteti për Siguri dhe Emergjencë

II

Komitetet nga pika I. e këtij vendimi duhet të kenë përfaqësim gjinore dhe të pasqyrojnë proporcionet e participimit të partive politike në Kuvendin Komunal të Gjilanit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr. 01.10131/020
Gjilan, 11.12.2002

Zv. Kryetari
Xhemajl Hyseni



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Duke u bazuar në nenin 51.52.53.54 dhe nenin 55 të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 11.12.2002 nxori këtë:

VENDIM
PËR CAKTIMIN E STRUKTURËS DHE PËRBËRJEN E KOMITETEVE TË
KUVENDIT TË KOMUNËS SË GJILANIT

I

Me këtë vendim caktohet struktura dhe përbërja e të gjitha Komiteteve të Kuvendit të Komunës së Gjilanit, dhe atë si vijon:

1. Komiteti për Politikë dhe Financa:

- Lutfi Haziri - LDK
- Xhemajl Hyseni - LDK
- Lirije Abdurrahmani - LDK
- Nazmi Musa - LDK
- Shefqet Murtezi - LDK
- Vehbi Salihu - LDK
- Qemajl Mustafa – PDK
- Izmi Zeka – PDK
- Ejup Uruqi - PDK
- Fadil Gashi - AAK
- Përfaqësuesi serb

2. Komiteti për Ndërmjetësim:

- Fehmi Mahmuti- LDK
- Hazbije Sadiku - PDK
- Përfaqësuesi serb
- Përfaqësuesi serb
- Përfaqësuesi serb
- Përfaqësuesi turk
- Përfaqësuesi rom

3. Komiteti për Komunitete:

- Rahim Bajrami – LDK
- Ramadan Kurteshi – LDK
- Mevlyde Ahmeti – PDK
- Përfaqësuesi serb
- Përfaqësuesi serb
- Përfaqësuesi turk
- Përfaqësuesi rom

4. Komiteti për Planifikim, Resurse Natyrore, Urbanizëm dhe Ambient:

- Selviqe Shefkiu – LDK
- Flamur Mushica – LDK
- Sevdije Hyseni – LDK
- Avdyl Aliu – LDK
- Florina Zymberi – PDK
- Ali Arifi – PDK
- Sabri Tahiri- PDK

1. Komiteti për Shëndetësi dhe Çështje Sociale:

- Shefqet Murseli – LDK
- Flamur Mushica – LDK
- Nazim Hajdari – LDK
- Xhavit Hajdari – LDK
- Salihe Mustafa – PDK
- Shaban Rexhepi- AAK
- Përfaqësuesi serb

2. Komiteti për Arsim:

- Bahrije Veseli – LDK
- Nazmi Musa – LDK
- Enver Bllaca – LDK
- Musa Musliu – PDK
- Rahim Azemi- PDK
- Mevlide Zejnullahu – AAK
- Përfaqësuesi serb

7. Komiteti për Kulturë, Rini, Sport, dhe Çështje Sociale:

- Dritë Maliqi – LDK
- Shpresë Hajdari – LDK
- Arta Rexhepi – LDK
- Nexhat Hajrullahu – LDK
- Bujar Nevzati – PDK
- Fadil Hajdari – PDK
- Përfaqësuesi serb

1. Komiteti për Pronë, Banim dhe Rindërtim:

- Isa Bunjaku – LDK
- Arben Mehmeti – LDK
- Hafize Halili – LDK
- Sami Ahmeti – LDK
- Gani Nezii – PDK
- Sami Hoxha – PDK
- Xhyzide Ismaili – PDK

2. Komiteti për Zhvillim Ekonomik, Biznes, Agrokulturë dhe Zhvillim Rural.

- Shukri Sylejmani – LDK
- Musa Shkodra – LDK
- Ramiz Ramadani – LDK
- Përfaqësuesi i LDK
- Ejup Qerimi – PDK

- Nazmi Rapuca – PDK
- Xhabir Ymeri – PDK

3. Komiteti për Ndërmarrjet dhe Shërbimet Publike:

- Vehbi Salihu – LDK
- Jakup Bajrami – LDK
- Emine Robelli – LDK
- Avdyl Halimi – LDK
- Azem Mujku – PDK
- Fahri Nuhiu – PDK
- Përfaqësuesi serb

4. Komiteti për Siguri dhe Emergjencë:

- Kryetari i KK- Gjilan
- Zv. Kryetari i KK- Gjilan
- Zv. Kryetari i dytë i KK- Gjilan
- Kryeshefi Ekzekutiv i KK- Gjilan
- Përfaqësuesi i TMK-ës
- Përfaqësuesi i SHPK-ës
- Përfaqësuesi i Policisë së UNMIK-ut
- Përfaqësuesi i KFOR-it
- Kryetari i LDK-ës
- Kryetari i PDK-ës
- Kryetari i AAK-ës

II

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset zëvendëskryetari i KK-ës Gjilan.

III

Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit.

KUVENDI I KOMUNËS- GJILAN

Nr. 01.10134/020
Gjilan, 11.12.2002

Zv. Kryetari
Xhemajl Hyseni



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 23.10.2003, e duke u bazuar në nenin 12 alineja 1 pika (ë), dhe alineja 2 pika (q) të Statutit të Komunës së Gjilanit, e në bazë të Rekomandimit të Komitetit për Politikë dhe Financa , nxori këtë:

V E N D I M

I

I epet në shfrytëzim bodrumi i sallës së Edukatës Fizike të ish Shkollës së mesme “Marin Barleti”, Shoqatës së Shenjëtarëve “Shqiponja” në Gjilan, për ushtrimin e veprimtarisë sportive në Shenjëtari.

II

Shoqata e Shenjëtarisë “Shqiponja” do të bëjë renovimin e bodrumit të objektit në bazë të projektit dhe kërkesës së ushtruar në Komitetin për Politikë dhe Financa.

III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit.

KUVENDI I KOMUNËS –GJILAN

Nr.01.10039 / 020
Gjilan, më 23.10.2003

KRYETARI,
Lutfi HAZIRI



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 18.12.2003, mori këtë:

V E N D I M
PËR MENAGJIMIN DHE FINANCIMIN E TEATRIT TË QYTETIT

I

Kuvendi i Komunës së Gjilanit si themelues i Teatrit të qytetit emëron Bordin mbikëqyrës prej 3 anëtarëve cili do të menaxhoj me Teatrin, me kë këtë përbërje:

1. Jahi Jahiu,
2. Shpresë Hajdari,
3. Avdush Cana,

II

Bordi mbikëqyrës do të zgjedhë Drejtorin e Teatri si dhe Këshillin artistik prej 5 anëtarësh.

III

Kuvendi i Komunës, Teatrit do t'i ndaj subvencion çdo vit, nga Buxheti i Komunës.

IV

Teatri obligohet që të realizoj 5 (pesë) projekte brenda vitit kalendarik.

V

Kuvendi i Komunës i jep në shfrytëzim Teatrit hapësirën e objektit, për mënyrën e shfrytëzimit të së cilës do të lidhet kontratë e veçantë.

VI

Teatri, nga të hyrat që realizon do t' i mbuloj shpenzimet tjera.

VII

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryeshefi ekzekutiv dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

VIII

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr.0111290 / 020 _____
Gjilan, më 18.12.2003

K R Y E T A R I
Lutfi HAZIRI



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 18.12.2003, e duke u bazuar në nenin 12 alineja 1 pika (ë) dhe nenin 48 alineja 3 dhe 4 të Statutit të Komunës së Gjilanit, e në bazë të rekomandimit të Komitetit për Pronë, Banim dhe Rindërtim, nxori këtë:

V E N D I M
PËR NDARJEN E SIPËRFAQËS SË TOKËS PËR NDËRTIMIN E
PUNKTIT TË MJEKËSISË FAMILJARE NË LAGJËN “DHEU I
BARDHË”-GJILAN

I

Me këtë vendim ndahet sipërfaqja e tokës prej 0,01.50 ha nga sipërfaqja e gjithëmbarshme prej 0.79.40 ha, për ndërtimin e Puntit të Mjekësisë familjare në Lagjen “Dheu i Bardhë”- Gjilan.

II

Objekti i Puntit të Mjekësisë familjare do të ndërtohet në ngastrën kadastrale nr.2053, pasuri shoqërore-rrugë, Fleta poseduese nr.1751, Komuna kadastrale-Gjilan.

III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, e cila edhe do të bëjë bartjen administrative të së drejtës së pronësisë, pa kompenzim, - Drejtorisë për Shëndetësi dhe Çështje sociale.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr.01.11295 / 020
Gjilan, më 18.12.2003

K R Y E T A R I
Lutfi HAZIRI



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 18.12.2003, e duke u bazuar në nenin 12 alineja 1 pika (ë) dhe (g), të Statutit të Komunës së Gjilanit, nxori këtë:

VENDIM
MBI NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT PËR NDARJEN E
SIPËRFAQËS SË TOKËS PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT TË SHKOLLËS
FILLORE “AGIM RAMADANI”-ZHEGËR

I

Me këtë vendim bëhet ndryshimi dhe plotësimi i Vendimit për ndarjen e sipërfaqes së tokës për ndërtimin e objektit të Shkollës fillore “Agim Ramadani” në fshatin Zhegër, Nr.01.6528/020, i nxjerr nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e datës 11.07.2003, dhe atë :

- Në pikën **I**, pjesa ku thuhet “0.60.42 ha” (gjashtëdhjetë ari e dyzet e dy metra) fshihet, dhe në vend të saj duhet të jetë “0.63.42 ha” (gjashtëdhjetë e tre ari e dyzet e dy metra).

II

Ky vendim do të jetë pjesë përbërëse e Vendimit për ndarjen e sipërfaqes së tokës për ndërtimin e objektit të Sh.F. “Agim Ramadani”-Zhegër, Nr.01.6528/020 i datës 11.07.2003.

III

Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit,

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr.01.11294 / 020
Gjilan, më 18.12.2003

K R Y E T A R I
Lutfi HAZIRI



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 30.12.2003, duke u mbështetur në nenin 42 të Statutit të Komunës së Gjilanit, e në bazë të Rekomandimit të Komitetit për Politikë dhe Financa, nxori këtë:

V E N D I M
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR NDRYSHIMIN DHE
PLOTËSIMIN E STATUTIT TË KOMUNËS SË GJILANIT

I

Formohet Komisioni për ndryshimet dhe plotësimet e Statutit të Komunës së Gjilanit, me këtë përbërje:

- | | |
|---------------------|-------------------|
| 1. Xhemajl Hyseni, | 5. Ramadan Leka, |
| 2. Arben Mehmeti, | 6. Sokol Haziri, |
| 3. Sadudin Berisha, | 7. Radovan Deniq, |
| 4. Nuhi Nuhiu, | |

II

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari dhe Kryeshefi ekzekutiv i KK-Gjilan.

III

Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr.01.11631 / 020
Gjilan, më 30.12.2003

K R Y E T A R I
Lutfi HAZIRI



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Në bazë të nenit 3.3. të Rregullores mbi Shërbimin Civil të Kosovës nr. 2001/36, nenit 8.5 dhe 35.1. pika (b) të Urdhëresës administrative nr. 2003/2 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-UT nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në mbledhjen e mbajtur me datën 20.02.2004, merr këtë

V E N D I M

- I. Që të gjithë drejtorëve të drejtorive në Shërbimin Civil komunal t'u përtërihen kontratat e punësimit deri më 31.03.2004.
- II. Me skadimin e kontratave të punësimit sipas pikës 1 të këtij vendimi, punësimi në shërbimin Civil Komunal për të gjithë drejtorët e drejtorive përfundon automatikisht.
- III. Me këtë vendim të njoftohen drejtorët e drejtorive
- IV. Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS - GJILAN

Nr.01.1511 / 020
Gjilan, më 20.02.2004

K R Y E T A R I
Lutfi Haziri



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Duke u mbështetur në nenin 12 alineja 1 pika (ë) të Statutit të Komunës së Gjilanit, e në bazë të më Rekomandimit të Komitetit për Pronë, Banim dhe Rindërtim, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 02.07.2004, nxori këtë:

V E N D I M
PËR NDARJEN E SIPËRFAQËS SË TOKËS PËR NDËRTIMIN E SERRËS

I

Me këtë vendim ndahet sipërfaqja e tokës prej 1000m², nga sipërfaqja e gjithëmbarshtëm prej 20.10.39 ha në vendin e quajtur “Gllama”, në anën e djathtë, afër Qendrës së Shëndetit Mendor, ngastra kadastrale Nr.1/1, fleta poseduese nr.1750

II

Sipërfaqja e tokës nga pika I të këtij vendimi do të përdoret për ndërtimin e një Serre, në të cilën do të punonin 30-40 klient me çrregullime mendore nga Qendra e shëndetit mendorë.

III

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë e Kk-Gjilan.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr.01.5792 / 020
Gjilan, më 02.07.2004

Kryetari i KK-së
Lutfi HAZIRI



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Duke u mbështetur në nenin 12 alineja 1 pika (p) dhe (t) të Statutit të Komunës së Gjilanit, e në bazë të rekomandimit të Komitetit për Kulturë, Rini dhe Sport, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në Seancën e mbajtur më 02.07.2004, nxori këtë:

VENDIM
PËR PËRKRAHJE PËR FORMIMIN E QENDRËS REGJIONALE PËR
TRASHIGIMI KULTURORE

I

Me këtë vendim përkrahet formimi i Qendrës Regjionale për Trashëgimi Kulturore e cila përfshinë Komunën e Vitisë, Komunën e Dardanës dhe Komunën e Artanës..

II

Selia e qendrës për Trashëgimi Kulturore është në Gjilan.

III

Kuvendi i Komunës së Gjilanit obligohet të sigurojë lokalin e nevojshëm për funksionimin e qendrës regjionale për Trashëgimi Kulturore.

IV

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e KK-Gjilan.

V

Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit.

KUVENDI I KOMNËS – GJILAN

NR.01.5794 / 020
Gjilan, më 02.07.2004

K R Y E T A R I
Lutfi HAZIRI



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Duke u mbështetur në nenin 110 të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 02.07.2004, nxori këtë:

V E N D I M
P Ë R
EMËRIMIN E DREJTORËVE TË DREJTORIVE KOMUNALE

I

Me këtë vendim emërohen Drejtorët e Drejtorive komunale dhe atë:

1. z. Halil Bllaca emërohet drejtor i Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme;
2. znj. Fitnete Mjaku-Hyseni emërohet drejtoreshë e Drejtorisë për Buxhet, Financa dhe Investime;
3. z. Agim Rexhepi emërohet drejtor i Drejtorisë për Arsim;
4. z. Agim Salihu emërohet drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Ndërmarrje Publike;
5. znj. Sevdije Hyseni emërohet drejtoreshë e Drejtorisë për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient;
6. z. Jashar Ramadani emërohet drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Çështje Sociale;
7. z. Murat Hoxha emërohet drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë;
8. z. Hazir Mustafa emërohet drejtor i Drejtorisë për Siguri Publike dhe Emergjencë;
9. z. Zvonko Petković emërohet drejtor i Drejtorisë për Bujqësi dhe Pylltari;

II

Drejtorët e emëruar sipas pikës I të këtij vendimi do të lidhin kontratë të punës me Kuvendin e Komunës së Gjilanit, sipas së cilës do të parashihen kushtet e punës dhe do të përcaktohet kohëzgjatja e kontratës.

III

Për zbatimin e këtij vendimi do të Kujdeset Kryetari dhe Kryeshefi ekzekutiv i KK-Gjilan.

IV

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

NR. 5797 / 020
Gjilan, më 02.07.2004

KRYETARI
Lutfi HAZIR



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Duke u mbështetur në nenin 12 alineja 1 pika (ë) dhe (h) të Statutit të Komunës së Gjilanit, e në bazë të Rekomandimit të Komitetit për Pronë, Banim dhe Rindërtim, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në Seancën e mbajtur më 02.07.2004, nxori këtë:

V E N D I M
PËR NDARJEN E LOKACIONIT AFËR QENDRËS SË SHËNDETIT MENDOR
PËR NDËRTIMIN E ANEKSIT TË QENDRËS

I

Me këtë vendim ndahet lokacioni afër Qendrës së Shëndetit Mendor për ndërtimin e aneksit të Qendrës, pronë e Stacionit të Veterinarisë, në sipërfaqe prej 230 m² nga sipërfaqja e gjithëmbarshme prej 0,10.00 ha, ngastra kadastrale nr. 2141, vendi i quajtur “Rasadnik/Veterinarsaka”, me kulturë-ndërtesë, oborr, arë, Fleta poseduese nr.1743, KK-Gjilan.

II

Shpenzimet për ndërtimin e Aneksit të Qendrës së Shëndetit mendorë do t'i bartin: 50 % nga buxheti i shërbimeve të Shëndetit Mendor, 25% nga buxheti i komunës dhe 25% nga KFOR-i Amerikan nga Kampi Montith.

III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë e KK-Gjilan.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr.01.5789 / 07
Gjilan, 02.07.2004

Kryetari i KK-së
Lutfi HAZIRI



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Duke u mbështetur në nenin 12 alineja 1 pika (ë) dhe (h) të Statutit të Komunës së Gjilanit, e në bazë të Rekomandimit të Komitetit për Pronë, Banim dhe Rindërtim, Kuvendi I Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 02.07.2004, nxori këtë:

V E N D I M
PËR DHËNJEN NË SHFRYTËZIM TË PËRKOHSHËM TË PRONËS
SHOQËRORE

I

Me këtë vendim z. Fatmir Poroshticës nga Gjilani i epet në shfrytëzim të përkohshëm sipërfaqja prej 50 m² në ngastrën kadastrale nr.3641, nr i fletës poseduese 1750 në vendin e quajtur “Brigadat e UÇK-së, pronë shoqërore, KK-Gjilan.

II

Sipërfaqen nga pika I e këtij vendimi, z. Fatmir Poroshtica i ndahet për ushtrimin e veprimtarisë-Ordinancë.

III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe pronë.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr.01.5788 / 07
Gjilan, më 02.07.2004

Kryetari i KK-së
Lutfi HAZIRI



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Duke u bazuar në nenin 12 alineja 1 pika (e) dhe (n) të Statutit të Komunës së Gjilanit, dhe nenin 29 të Ligjit mbi Ekspropriimin, e në bazë të Rekomandimit të Komitetit për Pronë, Banim dhe Rindërtim, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 18.11.2004, miraton këtë:

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E ÇMIMIT PËR TOKËN NDËRTIMORE TË
EKSPPROPRIUAR

I

Me këtë vendim përcaktohen zonat për caktimin e çmimit për tokën ndërtimore të ekspropriuar.

II

Sipas këtij vendimi, qyteti i Gjilanit ndahet në 5 /pesë/ zona.

Secila zonë është e përkufizuar me koordinata dhe e paraqitur grafikisht në planet kadastrale.

III

Çmimi për 1m² sipas zonave është si në vijim:

- Zona e parë, çmimi orientues nga 75-100 € për 1m² ;
- Zona e dytë, çmimi orientues nga 50-75€ për 1m² ;
- Zona e tretë, çmimi orientues nga 30-50€ për 1m² ;
- Zona e katërt, çmimi orientues nga 20-30€ për 1m² ;
- Zona e pestë, çmimi orientues nga 10-20€ për 1m² ;

IV

Vlerësimin e çmimit në kuadër të një zone për m² e cakton komisioni profesional të cilin e formon Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë

V

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, dhe Komiteti për Pronë, Banim dhe Rindërtim.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

Nr.01.9203 / 020
Gjilan, më 18.11.2004

K R Y E T A R I
Lutfi HAZIRI



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Duke u mbështetur në nenin 24 të Rregullores nr.2000/45 mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës dhe nenin 69 të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 21.12.2004, miraton këtë:

V E N D I M
PËR ZGJEDHJEN E KRYETARIT TË KOMUNËS SË GJILANIT

I

Me këtë vendim z.Xhemajl HYSENI zgjedhet Kryetar i Kuvendit të Komunës së Gjilanit.

II

Funksionin e Kryetarit të Kuvendit të Komunës së Gjilanit, z.Xhemajl HYSENI do ta ushtroj që nga dita e zgjedhjes në këtë funksion nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

III

z.Xhemajl Hyseni në këtë funksion zgjedhet me mandate të njëjtë sikurse anëtarët e Kuvendit.

IV

Për punët dhe detyrat e punë së Kryetarit të Komunës, z.Xhemajl Hyseni realizon të ardhura mujore në lartësi prej 1000€ nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës.

V

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr.01.10245 / 020
Gjilan, më 21.12.2004

K R Y E S U E S I



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Duke u mbështetur në nenin 25 të Rregullores nr.2000/45 mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës dhe nenin 72 të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 21.12.2004, miraton këtë:

V E N D I M
PËR ZGJEDHJEN E ZËVENDËSKRYETARIT TË KOMUNËS SË
GJILANIT

I

Me këtë vendim znj. Lirije KAJTAZI zgjedhet Zëvendëskryetare e Kuvendit të Komunës së Gjilanit.

II

Funksionin e Zëvendëskryetarit të Kuvendit të Komunës së Gjilanit, znj. Lirije KAJTAZI do ta ushtroj që nga dita e zgjedhjes në këtë funksion nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

III

Znj. Lirije KAJTAZI në këtë funksion zgjedhet me mandate të njëjtë sikurse anëtarët e Kuvendit të Komunës së Gjilanit.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr.01.10246 / 020
Gjilan, më 21.12.2004

K R Y E T A R I
Xhemajl HYSENI



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Duke u mbështetur në nenin 12 alineja 1 pika (ë) dhe (g) të Statutit të Komunës së Gjilanit e në bazë të Rekomandimit të Komitetit për Pronë, Banim dhe Rindërtim, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në Seancën e mbajtur më 31.01.2005, miraton këtë:

VENDIM
PËR NDARJEN E SIPËRFAQËS SË TOKËS PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT TË
SHKOLLËS FILLORE “AGIM RAMADANI”-ZHEGËR

I

Me këtë vendim ndahet sipërfaqja e e gjithëmbarshme e tokës prej 1.37.87 ha (një hektar e tridhjetë e shtatë ari e tetëdhjetë e shtatë metra) nga e cila 0.63.42 ha (gjashtëdhjetë e tre ari e dyzet e dy metra) në ngastrën kadastrale nr.245, vendi i quajtur: fshati Zhegër, e evidentuar si pasuri shoqërore KK-Gjilan-shfrytëzues Stacioni i policisë, dhe 0.74.45 ha (shtatëdhjetë e katër ari e dyzetë e pesë mëtra) në ngastrën kadastrale nr.246, Fleta poseduese nr.2, me kulturë arë, klasa e pestë, Komuna kadastrale-Zhegër, vendi i quajtur “Fshat”, e evidentuar si pasuri shoqërore KK-Gjilan, shfrytëzues Stacioni i Policisë – Zhegër.

II

Sipërfaqja e tokës e përshkruar sipas pikës I të këtij vendimi do të përdoret për ndërtimin e Shkollës Filllore “Agim Ramadani” në fshatin Zhegër.

III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë e cila edhe do të bëjë bartjen administrative të së drejtës së pronësisë pa kompensim-Drejtorisë për Arsim.

VI

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

Nr.01.854 / 020
Gjilan, më 31.01.2005

KRYETARI
Xhemajl HYSENI



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në Seancën e mbajtur më 31.01.2005, e duke mbështetur nenin 13 të Statutit të Komunës së Gjilanit, nxori këtë:

V E N D I M
PËR APROVIMIN E RREGULLORËS PËR SIGURINË NË PUNË,
SHËNDETIN DHE MJEDISIN E PUNËS NË SHËRBIMIN CIVIL
KOMUNAL

I

Me këtë vendim aprohet Rregullorja për Sigurinë në punë, shëndetin dhe mjedisin e punës në Shërbimin Civil Komunal.

II

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Rregullorja për Sigurinë në punë, shëndetin dhe mjedisin e punës në Shërbimin Civil Komunal.

III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryeshefi ekzekutiv dhe të gjitha drejtoritë komunale të KK-së Gjilan.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

Nr.01.855 / 020
Gjilan, më 31.01.2005

K R Y E T A R I
Xhemajl HYSENI



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Në bazë të dispozitave të Rregullores. Nr. 2003/33 lidhur me Ligjin mbi Sigurinë në Punë, Shëndetin dhe Mjedisin e Punës Nr. 2003/19 dhe nenit 26 të Kontratës së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, Kuvendi Komunal në mbledhjen e mbajtur me 31.01.2005, miraton këtë;

R R E G U L L O R E
PËR SIGURINË NË PUNË, SHËNDETIN DHE MJEDISIN E PUNËS NË
SHËRBIMIN CIVIL KOMUNAL

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1.

1.1. Qëllimi kësaj rregulloreje është që të parandalohen lëndimet në punë, sëmundjet profesionale në vendin e punës dhe të mbrohet ambienti i punës.

1.2. Vendi i punës në Shërbimin Civil Komunal është: çdo hapësirë punuese ku kryhet veprimtaria e punës.

Neni 2.

2.1. Siguria në punë, mbrojtja e shëndetit të nëpunësve civil dhe e ambientit të punës është pjesë integrale e organizimit të punës dhe e procesit të punës. Kjo vihet në funksion nëpërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit, përmes marrëveshjeve obliguese, rregullave të kontraktuara dhe të pranuara për sigurinë në punë, mbrojtjen e shëndetit të të punësuarve dhe ambientit të punës, masave tjera shtuese dhe udhëzimeve të përcaktuara nga punëdhënësi.

Neni 3.

3.1. Organizimi dhe procesi i punës të mbërrimet shkencore-teknike, e posaçërisht në masat dhe normat e sigurisë që kanë të bëjnë me veprimtarinë e shërbimit civil komunal, e cila u siguron punëtorëve sigurinë e duhur në punë.

3.2. Në çdo rast të riorganizimit të punës, rikonstruimit dhe blerjes së mjeteve të reja të punës, duhen të zbatohen dhe sigurohen masa përkatëse të sigurisë në punë.

Neni 4.

4.1. Procesi i punës duhet të organizohet në mënyrë që secili punëtor të punojë pa rrezik për shëndetin dhe jetën e tij dhe të punëtorëve të tjerë.

4.2. Përparimi i organizimit dhe i procesit të punës me të cilin garantohet siguria e punëtorëve në punë, është detyrë themelore e udhëheqësit të organit të punësimin, udhëheqësve të drejtorive dhe përgjegjësve tjerë në shërbimin civil komunal.

Neni 5.

5.1. Personat përgjegjës në shërbimin civil komunal bëjnë zbatimin dhe përparimin e masave të sigurisë në punë, me ndihmën profesionale të përgjegjësve për siguri në punë,

mjekut, si dhe me angazhimin e organizatave të specializuara shkencore dhe shëndetësore.

Neni 6.

6.1. Të drejtë për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të të punësuarve dhe ambientit të punës në pajtim me këtë rregullore kanë :

- 1) Punëmarrësit që kanë themeluar marrëdhënie pune në shërbimin civil komunal,
- 2) Personat në aftësim profesional te punëdhënësi (shërbimin civil komunal) të cilët nuk kanë themeluar marrëdhënie pune,
- 3) Personat në rikualifikim profesional dhe rehabilitim,
- 4) Nxënësit dhe studentët të cilët në shërbimin civil komunal kryejnë punë praktike,
- 5) Pjesëmarrësit në punë vullnetare dhe punë tjera publike të organizuar për interes të përgjithshëm,
- 6) Personat të cilët gjatë vuajtjes së dënimit angazhohen në punë,
- 7) Personat të cilët ndodhen në vendet e punës (bashkëpunëtorët e ndryshëm, përfaqësuesit e administratës shtetërore, shfrytëzuesit e shërbimeve) dhe
- 8) rastet tjera të parapara me ligj dhe kontratë të përgjithshme kolektive.

I I. TË DREJTAT, DHE PËRGJEGJËSIT E PUNËMARRËSIT

Neni 7.

7.1. Punëmarrësi ka të drejtë dhe obligim për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit dhe ambientit të punës.

7.2. Punëmarrësi është i obliguar t'i përmbahet masave të nevojshme për siguri në punë, mbrojtjes së shëndetit të të punësuarve dhe ambientit të punës, kujdeset për sigurinë dhe shëndetin e tij (saj) dhe të personave të tjerë të ndikuar nga veprimet e tij (saj) në punë, shfrytëzohen në mënyrë të duhur mjetet e sigurisë PPM- në, ato i përdorë me kujdes dhe i mbanë në gjendje funksionale. Punëmarrësit gjithashtu duhet të kenë përgjegjësi për të siguruar mbrojtjen dhe shëndetin e të gjithë personave të ndikuar nga veprimet në punën e tyre.

Neni 8.

8.1 Është e drejtë e punëmarrësve ose e organizatave të tyre (sindikata) t'i zgjedhin ose emërojnë përfaqësuesit e tyre për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të të punësuarve dhe ambientit të punës. Personi i tillë do ta mbikëqyrë zbatimin e masave të ndërmarra nga punëdhënësi dhe do të bashkëpunoj me inspektorin e punës në interes të punëmarrësve në sferën e sigurisë në punë, mbrojtjes së shëndetit të të punësuarve dhe ambientit të punës.

Neni 9.

9.1. Punëmarrësi duhet menjëherë ta njoftoj punëdhënësin e tij për çdo mangësi, rrezik shëndetësor, defekt ose ndonjë dukuri tjetër e cila mund ta rrezikoj sigurinë e tij (saj) ose të të punësuarve tjerë.

9.2. Punëmarrësi ka të drejtë ta refuzoj punën, nëse ai (ajo) ka arsye të besoj se ekziston rrezik i drejtpërdrejt për jetën dhe shëndetin e tij (saj). Nëse punëdhënësi konsideron se refuzimi i punës është i pabazuar menjëherë duhet ta lajmëroj inspektorin e punës.

Neni 10.

10.1. Punëmarrësi bashkëpunon me punëdhënësin dhe nëpunësin për siguri në punë për t'u siguruar se mjedisi i punës dhe kushtet e punës janë të sigurta dhe se masat e urdhëruara nga inspektori i punës zbatohen nga punëdhënësi.

Neni 11.

11.1. Është e drejtë e punëmarrësve dhe e organizatave të tyre që të konsultohen me punëdhënësit në të gjitha aspektet e sigurisë në punë, mbrojtjes së shëndetit të të punësuarve dhe ambientit të punës lidhur me punën e tyre.

11.2. Punëmarrësi do t'i shfrytëzoj të gjitha makinat, pajisjet, veglat, materialin punues dhe mjetet e transportit si dhe aparatet e sigurisë dhe pajisjet personale mbrojtëse (PPM) në pajtim me udhëzimet specifike të aplikimit.

Neni 12.

12.1. Punëmarrësi ka të drejtë të sugjeroj përmirësimin e situatës së mbrojtjes dhe shëndetit në vendin e punës.

12.2. Punëmarrësi ka të drejtë të raportoj mungesat e PPM- ve dhe masat e sigurisë në vendin e punës në mënyrë të drejtpërdrejtë, inspektorit të punës me kusht që ata /ato të kenë baza konkrete për të besuar se masat e mbrojtjes në punë, të zbatuara nga punëdhënësi janë të pamjaftueshme dhe si shtesë punëdhënësi nuk e ka evituar rrezikun. Në këtë rast për punëmarrësit nuk do të ketë pasoja.

Neni 13.

13.1. Punëmarrësi është i obliguar, që pa vonesë ta lajmërojë për çdo lëndim që i ndodh në punë punëdhënësin ose personin tjetër të autorizuar drejtpërdrejtë .

Neni 14.

14.1. Punëmarrësi është i obliguar ta lëshojë punën, nëse atë e kërkon punëdhënësi ose personi tjetër i autorizuar nga ai/ajo drejtpërdrejtë në rastet kur:

- Nuk i zbaton masat e parapara të sigurisë në punë;
- Nuk i shfrytëzon mjetet e sigurisë personale në punë;
- Nuk është i aftë për punë, sepse gjendet në gjendje të tillë psiko-fizike, për shkak të së cilës rrezikon veten, punëtorët tjerë dhe mjetet e punës dhe
- Punëtori i cili është nën ndikimin e alkoolit ose narkotikëve, nuk mund të fillojë punën.

III. OBLIGIMET DHE PËRGJEGJËSITË

E PUNËDHËNËSIT

Neni 15

15.1. Punëdhënësi është i obliguar të krijoj kushte për sigurinë në punë, mbrojtjen e shëndetit të të punësuarve dhe ambientit të punës për punëmarrësit e tij/saj. Punëdhënësi është i obliguar për t'i mbuluar të gjitha shpenzimet për kurimin e të lënduarve në punë

15.2. Punëdhënësi është i obliguar të organizoj dhe të ndërmerr masa të nevojshme për sigurinë në punë, mbrojtjen e shëndetit të të punësuarve dhe ambientit të punës, përfshirë parandalimin e rreziqeve në punë, ofrimin e informatave, trajnimeve, organizimit përkatës dhe masave të duhura për të siguruar, mirëmbajtur makinerinë, instrumentet, pajisjet, veglat, vendin e punës, mundësit për të shkuar në vendin e punës.

15.3. Punëdhënësi është përgjegjës për organizimin dhe zbatimin e masave për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të të punësuarve dhe ambientit të punës. Punëdhënësi do të

kontrolloj efektshmërinë e masave dhe medoemos do të ndërmerr masat e duhura për përmirësim të mëtejshëm.

15.4. Punëdhënësi dhe punëmarrësi përveç të drejtave dhe detyrave të përcaktuara me ligj, janë të obliguar t'i respektojnë edhe dispozitat e kontratës së përgjithshme kolektive mbi sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë.

15.5. Punëdhënësi do të caktojë një zyrtarë për siguri në punë në pajtim me ligjin.

Neni 16.

16.1. Punëdhënësi do të bëjë vlerësim të hollësishëm mbi rreziqet për secilin vend të punës. Vendet e punës të ngjashme mund të grupohen. Rreziqet për t'u adresuar në veçanti mund të ngritën nga :

16.1.1. konstruktimi dhe pajisjet në vendin e punës,

16.1.2. ndikimet fizike, kimike dhe biologjike,

16.1.3. konstruktimi, zgjedhja dhe përdorimi i mjeteve, materialit, përbërësve të pajisjeve dhe zbatimi i tyre,

16.1.4. konstruktimi i sistemeve të punës, vëllimit, rrjedhjes së punëve, orarit të punës dhe ndikimet e ndërsjella.

16.1.5. kualifikimi dhe trajnimi i punëmarrësve në pajtim me standardin evropian.

Neni 17

17.1. Punëdhënësi e pajisë të punësuarin me PPM, i cili është paraparë për mbrojtjen kundër ekspozimit të dëmtimeve dhe rreziqeve në punë. Punëdhënësi do t'i bartë shpenzimet dhe do të bëjë zëvendësimin e PPM-ve, në intervale të rregullta kohore dhe çdo herë kur është e domosdoshme.

Neni 18.

18.1. Punëdhënësi obligohet që t'i ketë mjetet themelore për dhënien e ndihmës së parë dhe të vendosura në një lokal emergjent afër punëmarrësve ku punojnë i cili do të shënohet me shenjën përkatëse dalluese.

Neni 19.

19.1. Punëdhënësi është i obliguar që në rast të lëndimeve ose sëmundjes së papritur , punëmarrësit t'i siguroj :

- dhënien e ndihmës së parë,
- t'i siguroj evakuimin e të punësuarit – lënduarit në mënyrë adekuate me natyrën e veprimtarisë së punëdhënësit,
- sigurojë dhe organizoj kontakte me shërbimin përkatës :
- dhënies së ndihmës urgjente,
- kujdesin urgjent mjekësor – emergjencës,
- mbrojtjen kundër zjarrit,
- aftësimin e numrit të caktuar të punëmarrësve për dhënien e ndihmës së parë, shpëtimin dhe evakuimin e punëmarrësve në rast të rrezikut të mundshëm.

Neni 20

20.1. Punëdhënësi duhet ta informoj punëmarrësin për rreziqet e punëve të cilat kryhen nga ai/ajo. Punëdhënësi duhet t'i informoj punëmarrësit, të cilët do t'i ekspozohen rrezikut të lartë sa më parë që të jetë e mundshme, rreth rreziqeve dhe masave për mbrojtje në punë për të minimizuar rrezikun. Në rast rreziku të pashmangshëm kërcënues për vete dhe për persona tjerë, punëmarrësit i lejohet për të zbatuar kundër – masa të përshtatshme, nëse mbikëqyrësi ose personi tjetër i autorizuar nuk është aty. Duke pasur parasysh trajnimin që është bërë dhe mjetet teknike në dispozicion, punëmarrësit nuk do

të pësojnë dëme për akte të tilla, përveç në rastet e neglizhencës flagrante ose sabotimit të qëllimtë.

Neni 21.

21.1. Punëdhënësi duhet ta aftësoj(trajnoj) punëmarrësin për punë në atë mënyrë e cila siguron mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të tij /saj dhe e cila parandalon fatkeqësitë në punë.

21.2. Punëdhënësi do ta informoj, menjëherë organin kompetent për të gjitha rastet e vdekjes në punë, fatkeqësitë e rënda në punë ose që kanë të bëjnë me punën, gjithashtu për të gjitha dukurit të cilat mund të rrezikojnë jetën dhe shëndetin e punëmarrësve në punë ose që janë të lidhura me punën.

Neni 22

22.1. Punëdhënësi i përgjigjet punëmarrësit për dëmin e shkaktuar me rastin e lëndimit në punë dhe sëmundjes që ka të bëjë me punën, sipas parimit të përgjegjësisë objektive të së drejtës së detyrimeve.

IV. MBROJTJA E TË RINJËVE, GRAVE, DHE PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Neni 23.

23.1. Të rinjve nën moshën 18-vjeçare, gratë shtatzëna, personat me aftësi të kufizuara për punë, nuk mund të sistemohen në punë veçanërisht të rënda , punë më të gjatë se orari i punës dhe në punë të natës.

23.2. Të drejtat dhe obligimet e personave sipas paragrafit 1 të këtij neni rregullohen më për së afërmi me dispozitat e Rregullores për shërbimin civil të Kosovës nr. 2001/36 dhe kontratës së përgjithshme kolektive.

Neni 24.

24.1. Në shërbimin civil komunal, puna e femrave është e ndaluar në këto vende:

- a) Në të gjitha punët me kushte të posaçme, nëse nuk janë marrë masat e posaçme të mbrojtjes së femrave;
- b) Puna në bartjen shkarkim-ngarkim të peshave mbi 15 kg;
- c) Puna në vendet tjera që ndikojnë dëmshëm dhe posaçërisht me rrezik të shtuar, që të dëmtojnë shëndetin e femrave.

Neni 25.

25.1. Punonjësit me aftësi të kufizuara, caktohen në punë të cilat mund t'i kryejë para rehabilitimit profesional, dhe nëse mund të punojë pa rrezik të zvogëlimit të aftësisë së mbetur të punës.

Neni 26.

26.1. Vendet e punës për punonjësit me aftësi të kufizuara, i cakton Kryeshefi i Ekzekutivit në bashkëveprim me drejtorët e drejtorive në shërbimin civil komunal.

Hapësira e punës, tualetet dhe dhomat për ndërrim

Neni 27

27.1. Punëdhënësi duhet të afroji hapësirë të nevojshme për punë minimumi 7.20 m² (për 1 punëtor).

27.2. Punëdhënësi duhet të vë në dispozicion të punësuarit, numër të mjaftueshëm të tualeteve dhe dhoma të ndërrimit ndaras për femra, ndaras për meshkuj dhe t'i

mirëmbaj ato në mënyrë adekuate. Njëherit punëdhënësi duhet të kujdeset edhe për pastrimin e rrobave të punës për raste specifike.

27.3. Vendet e ngrënies duhet të jenë me largësi të lejuar, pastërti, me nxehtë të mjaftueshme dhe të venteluar dhe të pandikuar nga atmosfera e dëmshme dhe mjete tjera të nevojshme.

**V. LËMIT E POSAÇME TË SIGURISË NË PUNË,
MBROJTJES SË SHËNDETIT TË TË PUNËSUARËVE
DHE AMBIENTIT TË PUNËS**

Neni 28

28.1. Lëmit e posaçme profesionale dhe rreziqet, do të rregullohen në mënyrë të veçantë.

Ndotja e arit

Neni 29

29.1. Nivelin e ndotjes së ajrit nga pluhuri dhe gazrat, duhet të matet dhe kontrollohet nga institucionet e autorizuar përkatëse.

29.2. Pluhuri dhe gazrat duhet të pastrohen për mes ventilimit dhe formave tjera. Në ambientet e punës ku punojnë më shumë se një i punësuar ndalohej pirja e duhanit. Punëdhënësi ka për obligim të caktoj hapësirat ku është e lejuar pirja e duhanit, dhe të jenë të siguruar ato vende nga zjarri. Hapësira ku pihet duhani duhet të kenë shenjën përkatëse.

29.3. Punëdhënësi ka për obligim të sigurojë sasi të mjaftueshme të ujit për pije.

VI. Zhurma, Dridhja dhe Drita

Ndriçimi, Rreziqet nga elektriciteti

Prodhimet kimike dhe zjarret.

Neni 30

30.1. Zhurma, dridhja dhe drita të jenë dhe të sillen në kufij të lejuar në pajtim me minimumin e standardeve evropiane.

30.2. Në vendin e punës nuk guxon të ketë ndriçim të tepërt. Duhet të sigurohet ndriçim i mjaftueshëm: natyral ose artificial.

30.3. Pajisjet elektrike duhet të kenë tiketën me simbolin CE. Instalimet e rrymës duhet bëhen në pajtim me standardet evropiane (EN).

30.4. Të gjitha substancat kimike përfshirë ; Pesticidet, alkalet, acidet dhe substancat tjera korrozive duhet të deponohen dhe të përdoren në pajtim me standardet evropiane mbi kontrollin e substancave të rrezikshme për shëndet.

30.5. Vendi i punës duhet të jetë i pajisur me mjete përkatëse kundër zjarrit në pajtim me planin emergjent. Duhet të bëhet trajnimi i punonjësve në pajtim me planin emergjent për përdorim të drejtë të mjeteve. Daljet emergjente duhet të jenë të shënuara dhe të kenë ndriçimin emergjent, Rruga kah dalja emergjente duhet të mos ketë pengesa dhe dyert e daljes emergjente nuk guxojnë të jenë të mbyllura me qelës.

30.6. Punëdhënësi që ka më shumë se 20 të punësuar ka për obligim të ketë planin për evakuim emergjent. Nëse punët kryhen në lokale të ndryshme për secilin lokal duhet të bëhet plani për evakuim emergjent të cilin e harton organi kompetent komunal për siguri dhe emergjencë nëse në atë lokal punojnë më shumë se 20 të punësuar.

VII. DOKUMENTACIONI DHE SHËNIMET

Neni 31

31.1. Punëdhënësi duhet të mbajë :

- 1) Certifikatat teknike të cilat qartë specifikojnë aplikimin e rregullave të sigurisë në punë, shëndetit të të punësuarve dhe ambientit të punës, dhomat ndihmëse në përdorim,**
- 2) Udhëzimet mbi përdorimin e gjithë makinerisë dhe të pajisjeve në procesin e punës,**
- 3) Certifikatat të cilat e vërtetojnë se instalimet janë në rregull dhe tregojnë qartë karakteristikat e makinerisë në përdorim në pajtim me standardet evropiane.**

Neni 32

32.1. Punëdhënësi duhet të mbajë evidencën për :

- 1) Programet për trajnimin e punëtorëve për kryerjen e punëve në mënyrë të sigurt,**
- 2) Kontrollimin paraprak dhe periodik mjekësor të punëtorëve të përcaktuar në punë të cilat kryhen në kushte të veçanta të punës,**
- 3) Aksidentet në punë, rastet e lëndimeve të rënda vdekja në punë, rastet e sëmundjeve profesionale,**
- 4) Raportet e të gjitha vlerësimeve për rreziqet dhe masat e ndërmarra për t'i eliminuar rreziqet e tilla dhe rezultatet e kontrollimeve mbi efektet e masave të tilla,**
- 5) Ndryshimet në proceset teknologjike të cilat rrezikojnë ose mund të paraqesin rrezik për sigurinë në punë, mbrojtjen e shëndetit të të punësuarve dhe mjetet e punës**

Neni 33

33.1. Obligohet çdo drejtor i drejtorisë në shërbimin civil komunal, që në kuptim të kësaj rregulloreje të caktojë se për cilat punë respektivisht vende të punës, nevojiten mjete dhe pajisje (varësisht nga lloji dhe shkalla e rrezikut), të cilat do të shfrytëzohen për evitimin e ndikimit të rreziqeve dhe të dëmeve të përhershme dhe cilat mjete për mbrojtje nga veprimet ose rreziqet e kohëpaskohshme ose afatshkurta.

33.2. Në harmoni me paragrafin 1 të këtij neni caktohen pajisjet personale, mbrojtjes (PPM) për vendet e caktuara të punës në shërbimin civil komunal të Gjilanit.

Nr.	Vendi i punës	Lloji i mjeteve të mbrojtjes personale	copë	Afati i vjetërsisë	Gardëroba e obliguar
1	Vozitës	Rroba vere	1	24 muaj	E obliguar
		Rroba dimri	1	24 muaj	E obliguar
		Dorëza pune	1	24 muaj	Obligative
		Gëzof lëkure	1	36 muaj	E obliguar

2	Punëtor në sigurim dhe roje nate	Rroba pune vere	1	24 muaj	E obliguar
		Rroba pune dimri	1	24 muaj	E obliguar
		Këmishë	1	12 muaj	E obliguar
		Kravatë	1	12 muaj	E obliguar
		Këpuce gome	1	24 muaj	E obliguar
		Gëzof të përshtatshëm	1	36 muaj	E obliguar
3	Zjarrfikës	Rroba pune zjarrfikësi vere	1	24 muaj	E obliguar
		Rroba dimri	1	24 muaj	E obliguar
		Këpucë gome	1	18 muaj	E obliguar
		Maska për zjarrfikës	1	12 muaj	E obliguar
		Kravatë	1	12 muaj	E obliguar
4	Punëtor në kazantore Ndezës, saldues elektrikist, ujëinstalues	Rroba pune	1	24 muaj	E obliguar
		Mantel pune	1	18 muaj	E obliguar
		Këpucë gome	1	12 muaj	E obliguar
		Kapela mbrojtëse	1	12 muaj	E obliguar
		Dorëza pune	1	18 muaj	E obliguar
		Syza mbrojtëse	1	Sipas nevojës	E obliguar
5	Inspektor (sanitar,ndërtimtarisë, bujqësisë, veterinarisë, ambientit, tregtisë, shërbimeve publike, pylltarisë dhe komunikacionit)	Rroba vere	1	24 muaj	E obliguar
		Rroba dimri	1	24 muaj	E obliguar
		Këpucë vere	1	12 muaj	E obliguar
		Këpuce dimri	1	12 muaj	E obliguar
		Çantë pune	1	36 muaj	E obliguar
		Dorëza plastike për sanitari (polivinil)	1	Një përdorim	E obliguar
		Çizme gome për sanitari	1	18 muaj	E obliguar
6	Teknik i veterinarisë	Uniform (mantel)	1	06 muaj	E obliguar
		Pantallona plastike	1	06 muaj	E obliguar
		Çizme për punë	1	12 muaj	E obliguar
		Maska përdorimi	1	Një përdorim	E obliguar
7	Likuidues i qenve endacak	Maskë	1	Sipas nevojës	E obliguar
		Çizme gome	1	18 muaj	E obliguar
		Veshje gjuetie	1	18 muaj	E obliguar
8	Manipulues me bllokazha	Jelek ndriçues	1	12 muaj	E obliguar
		Rroba pune (kombinezone)	1	24 muaj	E obliguar
		Këpucë vere	1	12 muaj	E obliguar
		Këpuce dimri	1	12 muaj	E obliguar
9	Punëtor terreni, eksepdues, inkasant dhe gjeodet	Rroba vere	1	24 muaj	E obliguar
		Rroba dimri	1	24 muaj	E obliguar
		Këpucë vere	1	12 muaj	E obliguar
		Këpucë dimri	1	12 muaj	E obliguar
		Çantë	1	36 muaj	E obliguar
		Çizme gome	1	18 muaj	E obliguar
10	Arkivist i materialit, Operator në kompjuter	Mantel për punë	1	24 muaj	E obliguar
		Dorëza pune	1	12 muaj	E obliguar
11	Mjek veterinar	Mantel të bardhë	1	06 muaj	E obliguar
		Maskë mbrojtëse	1	Sipas nevojës	E obliguar
		Çizme pune për terren	1	12 muaj	E obliguar
12	Pastrues-mirëmbajtës	Rroba pune vere	1	24 muaj	E obliguar
		Rroba pune dimri	1	24 muaj	E obliguar
		Çizme gome për punë	1	24 muaj	E obliguar

33.3. Në uniformë të punës duhet të figuroj mbishkrimi i Institucionit (përkatësisht, drejtorisë përkatëse).

Neni 34

34.1. Mjetet për pajisje personale mbrojtëse (PPM) të parapara me nenin 2.5 të Ligjit nr. 2003/19 për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të të punësuarve dhe

ambientit të punës e të përshkruara në nenin 33 të kësaj rregulloreje do të sigurohen nga punëdhënësi.

34.2. Punëdhënësi për punëmarrësit të cilët punojnë në nxehje (kaznatore) dhe me aparatin për fotokopjim e të cilët i ekspozohen gazrave, erërave të ndryshme, pluhurit, kushteve të përgjithshme higjienike dhe në rastet tjera ku konstatohet se ka koncentrim të pluhurit dhe ajrit e që dëmtojnë shëndetin e punëmarrësve ka për obligim të sigurojë nga 0.5 lit qumësht për çdo ditë pune për të punësuarin.

Neni 35

35.1. Ankesat dhe pakënaqësitë lidhur me ambientin e punës dhe PPM duhet t'i drejtohen menaxherit kadrovik të organit të punësimit dhe t'i drejtohen komisionit të ankesave.

Neni 36

36.1. Masat ndëshkimore do të jenë ato të përcaktuara me nenin 15 të ligjit nr. 2003/19 për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të të punësuarve dhe ambientit të punës.

VIII. Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

Neni 37

37.1. Punëdhënësi (Kuvendi komunal – Gjilan) obligohet që të sigurojë kushtet dhe masat e nevojshme të parapara me këtë rregullore.

37.2. Për të gjitha çështjet tjera të cilat nuk janë të përfshira me këtë rregullore do të zbatohen dispozitat e ligjit në fuqi nr. 2003/19 për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të të punësuarve dhe ambientit të punës.

Neni 38

38.1. Me aprovimin e kësaj rregulloreje ç'fuqizohet rregullorja e mëparshme mbi mbrojtjen e punëtorëve në punë nr. 02-3399/020 e dt. 29.01.2002.

Neni 39

39.2. Kjo rregullore hynë në fuqi ditën e aprovimit të saj, nga ana e Kuvendit Komunal të Gjilanit.

KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT

Nr.01.855 / 020
Gjilan, më 31.01.2005

KRYETARI
Xhemajl HYSENI



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Duke u mbështetur në nenin 54 dhe 55 të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 31.01.2005, miraton këtë:

VENDIM
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT PËR CAKTIMIN E
STRUKTURËS DHE PËRBËRJEN E KOMITETEVE

I

Me këtë vendim bëhen ndryshime dhe plotësime në Vendimin për caktimin e strukturës dhe përbërjen e Komiteteve të Kuvendit të Komunës së Gjilanit Nr.01.10134/020, i aprovuar nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit në Seancën e datës 11.12.2002, dhe ate si vijon:

1. Në Komitetin për Politikë dhe Financa, në vend të z.Lutfi Hazirit, anëtar i ri emërohet z.Isa Bunjaku;
2. Në Komitetin për Planifikim, Resurse natyrore, Urbanizëm dhe Ambient, në vend të znj.Sevdiye Hyseni, anëtar i ri emërohet z.Remzi Ahmeti;
3. Në Komitetin për Kulturë, Rini, Sport dhe Çështje gjinore, në vend të znj.Shpresë Hajdari, anëtar i ri emërohet z.Avdyl Halimi;
4. Në Komitetin për Ndërmarrje dhe Shërbime publike, në vend të z.Fahri Nuhiu, anëtar i ri emërohet z.Shefik Selimi, ndërsa po në këtë Komitet në vend të z.Avdyl Halimi, anëtar i ri emërohet z.Selver Morina;

II

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Zv..kryetari i KK-së Gjilan.

III

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr.01.852 / 020 _____
Gjilan, më 31.01.2005

KRYETARI
Xhemajl HYSENI



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Duke u mbështetur në nenin 12 alinea 1 pika (n) të Statutit të Komunës së Gjilanit, e në bazë të Rekomandimit të Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 24.02.2005, miraton këtë:

V E N D I M
PËR APROVIMIN E STRATEGJISË SË ZHVILLIMIT EKONOMIK
LOKAL 2005-2007 “DELTA II”

I

Me këtë vendim aprovohet Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal 2005-2007 “DELTA II”

II

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Projekt drafti: Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal 2005-2007 “DELTA II”.

III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryeshefi ekzekutiv i KK-Gjilan.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

Nr.01.1631 / 020
Gjilan, më 24.02.2005

KRYETARI
Xhemajl HYSENI



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Duke u mbështetur në nenin 12 alineja 1 pika (ë) të Statutit të Komunës së Gjilanit, e në bazë të Rekomandimit të Komitetit për Pronë, Banim dhe Rindërtim, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 28.04.2005, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR NDËRRIMIN E NGASTRËS KADASTRALE NR .4506/1 ME NGASTRËN
KADASTRALE NR. 3295

I

Me këtë vendim lejohet ndërrimi i ngastrës kadastrale nr. 4506/1 në sipërfaqe prej 01,50,00 (një hektar e pesëdhjetë ari), fleta poseduese nr. 516, Komuna kadastrale-Koretishtë, pronë e Kuvendit të Komunës së Gjilanit, me ngastrën kadastrale nr. 3295, në sipërfaqe prej 0.62.16 ha (gjashtëdhjetë e dy ari e gjashtëmbëdhjetë metra), fleta poseduese nr. 1736, Komuna kadastrale-Gjilan, pronë e Ndërmarrjes shoqërore - “Ekonomia e Pyjeve” në Gjilan e përfaqësuar nga Agjensioni Kosovar i Mirëbesimit (AKM).

II

Palët nga pika I të këtij vendimi (Kuvendi i Komunës së Gjilanit dhe N. SH. “Ekonomia e Pyjeve” e përfaqësuar nga AKM) procedurat e mëtejme rreth bartjes së pronësisë do t’i rregullojnë në përputhshmëri me dispozitat ligjore në fuqi.

III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryeshefi ekzekutiv dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë e KK-Gjilan.

V

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr.01.3141 / 020
Gjilan, më 28.04.2005

K R Y E T A R I
Xhemajl HYSENI



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Duke u bazuar në nenin 12 alineja 1 pika (g) të Statutit të Komunës së Gjilanit, e në bazë të Rekomandimit të Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 30.06.2005, miratoi këtë:

V E N D I M
PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT PËR VENDOSJE
NË QERDHE TË KOMUNËS SË GJILANIT

I

Me këtë vendim caktohet çmimi për vendosjen e fëmijëve në qerdhet e Komunës së Gjilanit për vitin kalendarik 2005/2006, dhe atë:

- Për fëmijun e parë, çmimi është **40.00 €**;
- Për fëmijun e dytë, tretë etj. çmimi është **30.00 €**.

II

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria Komunale e Arsimit, kurse mbikëqyrjen e bënë Kryeshefi ekzekutiv.

III

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

Nr.01.4614 / 020
Gjilan, më 30.06.2005

K R Y E T A R I
Xhemajl Hyseni



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Në mbështetje të nenit 29.9 pika (a), neni 31.1-31.5 të Ligjit për Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë, si dhe në bazë të Rekomandimit të Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi I Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 29.09.2005, nxjerr këtë ;

RREGULLORE
PËR SJELLJEN DHE DISIPLINËN E NXËNËSVE NË SHKOLLAT FILLORE
TË KOMUNËS SË GJILANIT

QËLLIMI

Neni 1

1.1. Me këto rregulla përcaktohen të drejtat ,detyrat dhe obligimet për sjellje dhe disiplinë të nxënësve në shkollë.

1.2. Marrja e masave disiplinore aplikohet nëse nxënësi nuk i respekton rregullat e sjelljes të përcaktuara me këtë rregullore.

TË DREJTAT E NXËNËSIT

Neni 2

2.1. Nxënësi ka të drejtë:

a) T'i realizojë të drejtat e përcaktuara me Ligjin mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm të Kosovës;

b) Të njohë Konventat ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve dhe të kërkoj respektimin e tyre;

c) Të shpreh mendimin me gojë dhe me shkrim për problemet që e shqetësojnë atë, klasën e tij dhe shkollën;

d) T'i respektohet dinjiteti moral dhe fizik;

e) Të merr pjesë në tubimin e nxënësve të klasës dhe të shkollës;

f) Të zgjedh dhe të zgjidhet në Këshillin e nxënësve të klasës dhe në Këshillin e nxënësve të shkollës;

g) Të marr pjesë në veprimtarit kulturore, artistike dhe sportive të cilat i organizon klasa ose shkolla;

h) Të marr mirënjohje dhe shpërblime për suksese të treguara në mësim, në gara të diturisë, në aktivitete kulturore dhe sportive etj;

i) Të marr dokumentin përkatës për klasën e kryer dhe dokumentet tjera të nevojshme për nxënësin, të cilat i lëshon shkolla;

j) T'i njihet e drejta të shikoj testin dhe për pakënaqësinë në vlerësim të ankohet te drejtori i shkollës;

k) Të realizoj të drejtat tjera, të cilat janë në interes të nxënësit.

DETYRAT DHE OBLIGIMET E NXËNËSIT

Neni 3

3.1. Nxënësi ka për detyrë dhe obligim që:

- a) Të respektojë rregullat e rendin shtëpiak të shkollës;
- b) Të respektojë orarin mësimor dhe orarin e aktiviteteve të lira;
- c) Të vijë në shkollë i pajisur me tekste dhe me mjete të domosdoshme mësimore;
- d) Të bartë uniformen ose shenjen e përcaktuar të shkollës;
- e) Të mbajë qëndrim të mire në orë mësimore, në ambientet shkollore,
- f) Të ketë sjellje korrekte ndaj shokëve të klasës, nxënësve të gjinisë tjetër, të përkatësisë tjetër etnike, fetare, ndaj arsimtarëve dhe personelit tjetër të shkollës;
- g) Të ruaj ambientin shkollore dhe pasurin e shkollës
- h) Të kryej detyrat dhe obligimet tjera të cilat i përcaktojnë organet profesionale dhe qeverisëse të shkollës.

MASAT EDUKATIVE- DISIPLINORE

Neni 4

4.1. Nëse nxënësi nuk i respekton rregullat e sjelljes në shkollë, atëherë ndaj tij shqiptohen këto **masa edukative- disiplinore** :

- a) **Paralajmërimi përkatësisht qortimi ;**
- b) **Vërejtja me shkrim;**
- c) **Përkohshëm i nxënësit nga aktivitetet e lira ;**
- d) **Thyerja e notës së sjelljes ;**
- e) **Ndërrimi i paraleles dhe**
- f) **Ndërrimi i shkollës.**

4.2. Masën disiplinore të paralajmërimit përkatësisht të qortimit e shqipton kujdestari i klasës.

4.3. Masën disiplinore vërejtje me shkrim e shqipton Këshilli i klasës.

4.4. Masat tjera disiplinore të përcaktuara në nenin 4.1. i shqipton Drejtori i shkollës .

4.5. Masa disiplinore ndërrimi i shkollës aplikohet në marrëveshje me shkollat e afërta dhe paraprakisht të njoftohet Drejtoria Komunale e Arsimit.

4.6. Masa disiplinore ndërrimi i shkollës mund të shqiptohet vetëm për nxënësit prej klasës së **VI-të** deri në klasën **e IX-të**.

Neni 5

5.1. **Paralajmërimi**, përkatësisht **qortimi** i shqiptohet nxënësit për:

- a) Mos kryerjen e obligimeve të përcaktuara nga drejtuesit e shkollës;
- b) Mospërdorimin e rregullt të uniformës shkollore përkatësisht të shenjës së shkollës;
- c) Ndotjen e ambientit shkollore;
- d) Sjellje fyese ndaj nxënësve të tjerë;
- e) Pranimin dhe sjelljen e personave të padëshiruar në shkollë;
- f) Shqetësimin që mund t'iu sjellë të tjerëve nëpërmjet zhurmës, dhe sjelljeve jo të mira.

5.2. Paralajmërimi ose qortimi, nxënësit i shqiptohet në prani të nxënësve të tjerë.

5.3. Për masën paralajmëruese njoftohet prindi i nxënësit, këshilli i klasës dhe drejtori i shkollës.

Neni 6

6.1. Masa disiplinore **vërejtje me shkrim** i shqiptohet nxënësit për:

- a) Pengimin e mësimi;
- b) Sjellje jokorrekte ndaj nxënësve të tjerë, dhe ndaj mësimitdhënësve;
- c) Pirje të duhanit në hapësirën shkollore;
- d) Deri në 10 mungesa të paarsyeshme.
- e) Përdorimi i telefonit mobil gjatë tërë kohës së mësimi.

6.2. Vërejtja me shkrim lexohet para nxënësve të shkollës dhe një kopje i dorëzohet prindit të nxënësit.

Neni 7

7.1. Përgjithësimi i përkohshëm i nxënësit për të marrë pjesë në aktivitete të lira dhe ndalimi i shkuarjes në shëti apo ekskursion të organizuar bëhet për:

- a) Prishjen e disiplinës gjatë organizimit të aktiviteteve të lira;
- b) Moskryerjen e detyrave të dhëna nga mësimitdhënësit;
- c) Cenimin e dinjitetit të nxënësve të tjerë;
- d) Moszbatimin e rregullave të aktiviteteve të lira etj.

Neni 8

8.1. Nota e sjelljes i zbritet nxënësit për:

- a) Prej 10 deri në 25 mungesa të paarsyeshme, nota e sjelljes i thehet në sjellje të mire;
- b) Mbi 25 mungesa të paarsyeshme, nota e sjelljes i thehet në sjellje jo të mire.

8.2. Nota e sjelljes nxënësit i thehet edhe për sjellje të keqe në shkollë.

Neni 9

9.1. Masa disiplinore, **ndërrimi i shkollës**, aplikohet për nxënësit të cilët:

- a) Fyejnë arsimtarët ose punëtorët tjerë të shkollës dhe i pengojnë ata në kryerjen e detyrave në shkollë dhe jashtë saj;
- b) Pengojnë me qëllim nxënësit tjerë për të hyrë në mësim dhe për të marrë pjesë në aktivitete jashtëmësimore;
- c) Falsifikojnë të dhënat në dokument shkollor (në librin e klasës, libra amë, librezë apo dëftesa etj);
- d) Vjedhin dhe shkatërrojnë dokumentacionin shkollor, pasurinë e nxënësve, të mësimitdhënësve dhe të shkollës;
- e) Shkaktojnë rrahje në ambientet e shkollës;
- f) Sjellin në shkollë armë dhe lëndë plasëse dhe gjësende tjera vdekjeprurëse;
- g) Paraqesin në provim person tjetër në vend të tij dhe anasjelltas;
- h) Sjellin në shkollë dhe përdorin pije alkoolike apo narkotike.

9.2. Nëse nxënësi shkatërron inventarin shkollor, mjetet mësimore apo ndonjë të mirë materiale të shkollës, prindi i tij është i obliguar të paguaj dëmin në shumën që e përcakton komisioni i caktuar nga ana e shkollës.

9.3. Vendimi për ndërrimin e shkollës i dorëzohet prindit të nxënësit.

9.4. Kundër vendimit të Drejtorit të shkollës, prindi i nxënësit ka të drejtë ankese në Drejtorinë Komunale të Arsimit në afatin prej 8 ditësh prej ditës së pranimi të vendimit.

9.5. Kërkesën për vazhdimin e masave disiplinore kundër nxënësit e bënë kujdestari i klasës.

Neni 10

Masa disiplinore vlen më së shumti për **një vit shkollor**.

DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 11

Nëse ndonjë dispozitë e këtyre rregullave është në kundërshtim me udhëzimet apo aktet tjera të cilat do të nxirren nga MASHT-i, atëherë do të zbatohen dispozitat e Ligjit përkatësisht të udhëzimeve të nxjerra nga MASHT-i.

Neni 12

Në fillim të vitit shkollor, secilit kujdestarë klase do ti epet nga një kopje e Rregullores dhe një kopje do të vendoset në tabelën e shpalljeve në korridor të shkollës.

Neni 13

Ç'do shkollë duhet të ketë **rendin shtëpiak** të aprovuar nga Këshilli i Shkollës dhe i njëjti të publikohet në tabelën e njoftimeve.

Neni 14

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e aprovimit në Kuvendin Komunal të Gjilanit.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

Nr .01.7248 / 15 _____

A R I

Gjilan, më 29.09.2005

K R Y E T

Xhemajl HYSENI



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Në mbështetje të nenit 29.9 pika (a), neni 31.1 dhe 31.5 të Ligjit për Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë, si dhe në bazë të Rekomandimit të Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 29.09.2005, nxjerr këtë ;

RREGULLORE
PËR SJELLJEN DHE DISIPLINËN E NXËNËSVE NË SHKOLLAT E MESME
TË KOMUNËS SË GJILANIT

QËLLIMI

Neni 1

1.1. Qëllimi i përcaktimit të rregullave të sjelljes dhe disiplinës së nxënësve definohet në:

- a) **Respektimin** e rendit të sjelljes dhe të punës edukative-arsimore të nxënësve në shkollë,

1.2. Marrja e masave disiplinore bëhet, nëse nxënësi nuk respekton rregullat e sjelljes të përcaktuara me **ligj, Udhëzime Administrative të MASHT-it dhe rregullat e përcaktuara me këtë rregullore.**

Neni 2

2.1 Me këto rregulla përcaktohen **detyrat** dhe **obligimet** e nxënësit për sjellje dhe disiplinë në shkollë.

2.2. Nxënësi ka për **detyrë dhe obligim** që :

- a) Të respektojë rregullat dhe rendin shtëpiak të shkollës;
- b) Të respektojë orarin mësimor dhe orarin e aktiviteteve të lira;
- c) Të vij në shkollë i pajisur me tekste dhe me mjete të domosdoshme mësimore;
- d) Të bartë uniformën ose shenjen e përcaktuar të shkollës;
- e) Të mbaj qëndrim të mirë në orë mësimore, në ambientet shkollore, në rrugë dhe shtëpi;
- f) Të ketë sjellje korrekte ndaj shokëve të klasës, nxënësve të gjinisë tjetër, të përkatësisë tjetër etnike, fetare, ndaj arsimtarëve dhe personelit të shkollës;
- g) Të ruaj ambientin shkollos dhe pasurinë e shkollës;
- h) Të kryej detyrat dhe obligimet tjera TV cilat i përcaktojnë organet profesionale dhe qeverisëse të shkollës.

MASAT DISIPLINORE

Neni 3

3.1. Masat disiplinore janë:

- a) **Paralajmërimi**, përkatësisht **qortimi** të cilin e shqipton kujdestari i klasës,
- b) **Vërejtja me shkrim** të cilën e shqipton arsimtari i lëndës, kujdestari i klasës ose këshilli i klasës,

- c) **Largimi i përkohshëm nga shkolla, deri në 3 ditë** (e bën drejtori i shkollës),
 - d) **Largimi nga shkolla më tepër se 3 ditë** të cilin e bënë Drejtoria Komunale e Arsimit me propozim të Këshillit të paraleles dhe Drejtorit të shkollës.
- 3.2.** Për të gjitha masat e lartshënuara njoftohet nxënësi, prindi i nxënësit, drejtori i shkollës, Këshilli i shkollës dhe kujdestari i klasës.
- 3.3.** Masa disiplinore e shqiptuar vlen më së shumti për **një vit shkollor**.

PARALAJMËRIM – QORTIMI

Neni 4

- 4.1. Paralajmërimi**, përkatësisht **qortimi** si masë disiplinore i shqiptohet nxënësit për:
- a) Moskryerjen e obligimeve të përcaktuara nga drejtuesit e shkollës,
 - b) Mungesën e paarsyeshme nga mësimi deri 10 orë në klasë.
 - c) Mos përdorimin e rregullt të uniformës së shkollës,
 - d) Ndotjen e ambientit shkollor,
 - e) Sjellje fyese ndaj shokëve të klasës,
 - f) Pranimin dhe sjelljen e personave të padëshiruar në shkollë,
 - g) Shqetësimin që iu sjellë të tjerëve nëpërmjet zhurmës, dhe sjelljeve jo të mira.
- 4.2.** Masa disiplinore paralajmërimi-qortimi mund ti shqiptohet nxënësit me:
- a) **Largimin e tij, për dy pjesëmarrje në aktivitetet jashtë mësimore.**
- 4.3. Paralajmërimi-qortimi** nxënësit i shqiptohet në klasë dhe para këshillit të nxënësve të klasave përkatëse.
- 4.4.** Për masën **paralajmëruese** njoftohet prindi i nxënësit, këshilli i klasës, drejtori i shkollës dhe kujdestari i klasës.

VËREJTJA ME SHKRIM

Neni 5

- 5.1. Vërejtja me shkrim** i shqiptohet nxënësit për sjellje të palejueshme si që janë:
- a) Organizimi i debateve politike dhe ideologjike në shkollë,
 - b) Pirja e duhanit,
 - c) Çrregullimin e mësimin në orë mësimore,
 - d) Sjellja jo korrekte ndaj shokëve të klasës, mësimdhënësve, nxënësve të gjinisë tjetër dhe të përkatësisë tjetër etnike e fetare.
 - e) 20 mungesa të paarsyeshme nga orët mësimore,
 - f) Moszbatimi i masave paralajmëruese të shqiptuara nga kujdestari i klasës
 - g) Sjellje të pamoralshme, (shkuarja nëpër kafiteri apo lokale të ngjashme gjatë procesit mësimor).
 - h) Përdorimi i telefonit mobil gjatë tërë procesit mësimor.
- 5.2. Vërejtja me shkrim** nxënësit mund t'i shqiptohet me:
- a) **Largimin për një lloj të aktivitetit të lirë.**
- 5.3. Vërejtja me shkrim** lexohet para nxënësit, nxënësve të shkollës dhe nga një kopje i dorëzohet nxënësit, prindit të nxënësit, kujdestarit të klasës dhe drejtorit të shkollës. Një kopje mbetet në dosje të shkollës.
- 5.4.** Kundër masës **vërejtje me shkrim**, nxënësi **ka të drejtë ankese**. Ankesa i paraqitet drejtorit të shkollës në afatin prej (5) pesë dite, prej ditës së shqiptimit të masës disiplinore vërejte me shkrim.
- 5.5.** Drejtori është i obliguar të vendosë për ankesë në afat prej 3 ditësh.

Neni 6

6.1. Largimi i përkohshëm i nxënësit nga shkolla bëhet në dy forma :

- a). Largimi i përkohshëm nga shkolla deri në 3 ditë (nuk evidentohet në mungesa) .
- b). Largimi nga shkolla mbi 3 (tri) ditë.

Neni 7

7.1. Largimi i përkohshëm i nxënësit nga shkolla deri në 3 ditë bëhet nga drejtori i shkollës apo përfaqësuesi të cilin ai e cakton, për këto shkelje:

- a) Për 22 mungesa të paarsyeshme ;
- b) Shkrimin e parullave dhe vizatimeve ideologjike dhe fyese në banga e në mure të shkollës, (kthimi në shkollë bëhet pasi nxënësi ta bëjë sanimin e dëmit) ;
- c) Organizimin e shëtitjeve grupore, koncerteve dhe aktiviteteve tjera në emër të shkollës, për të cilën nuk është marrë pëlqimi paraprak nga drejtori i shkollës,
- d) Sjellje të ashpër e pa respekt ndaj mësimeve, nxënësve, personave të gjinisë së kundërt dhe të përkatësisë tjetër etnike apo fetare,
- e) Ndotje me qëllim të ambientit shkollor,
- f) Mosdorëzimi ose shpërdorimi i librave të marra nga biblioteka e shkollës
- g) Për moszbatim të vërejtjes me shkrim.
- h) Shkatërrimi i inventarit shkollor, (kthimi në shkollë bëhet pasi nxënësi ta bëjë kompensimin e dëmit) ;

7.2. Largimi i përkohshëm i nxënësit nga shkolla nuk ndikon në rritjen e mungesave.

7.3. Për shqiptimin e masës disiplinore: Largimi i përkohshëm njoftohet me shkrim nxënësi, prindi i nxënësit dhe nëpërmjet tabelës së shpalljeve edhe nxënësit tjerë të shkollës.

7.4. Kundër veprimit për largim të përkohshëm , nxënësi mund të **paraqet ankesë** Drejtorit të Drejtorisë Komunale të Arsimit në afat prej (5) pesë ditësh , prej ditës së pranimit të vendimit .

7.5. Ankesa nuk e shlyen zbatimin e vendimit .

7.6. Drejtori i Drejtorisë Komunale të Arsimit duhet të vendos në ankesë në afat sa më të shkurtër , respektivisht më së largu deri në 3 ditë .

Neni 8

8.1. Nxënësi largohet nga shkolla më gjatë se 3 ditë për :

- a). 32 mungesa të paarsyeshme nga mësimi dhe nga format tjera të punës arsimore-edukative :
- b).Fyerjen e mësimeve dhe punëtorëve tjerë të shkollës dhe pengimin në kryerjen e detyrave në shkollë dhe jashtë saj :
- c).Pengimin me qëllim të nxënësve tjerë për hyrje në mësim dhe për pjesëmarrje në aktivitete jashtë mësimore :
- d).Falsifikimin e të dhënave në dokumente shkollore (në libra të klasës,libra amë, dëftesa,diploma etj.);
- e) Përdorimin dhe shpërndarjen e pijeve alkoolike dhe narkotike;
- f) Vjedhjen ose shkatërrimin e dokumentacionit shkollor,pasurisë së nxënësve,mësimeve dhe të shkollës;
- g) Për shkak të dënimit me burg për vepër penale;
- h) Shkaktimin apo pjesëmarrjen në rrahje individuale dhe kolektive;
- i) Paraqitje të personit tjetër në provim në vend të tij apo anasjelltas;

j) Sjellje në shkollë të armëve dhe lëndëve plasëse e të gjësendeve tjera vdekjeprurëse dhe

i) Cenim të nderit të nxënësve, mësimdhënësve ose personave tjerë.

8.2. Drejtori i shkollës, dokumentacionin e kompletuar për masat e deritanishme të shqiptuara ndaj nxënësit së bashku me propozimin për largimin (pezullimin) e nxënësit mbi 3 ditë ia dorëzon për vendosje Drejtorit të Drejtorisë Komunale të Arsimit.

8.3. Të drejtën për të pezulluar nxënësin për një periudhë më të gjatë se 3 ditë e kanë **vetëm organet komunale** (Drejtoria Komunale e Arsimit) me propozim të Këshillit të paraleles dhe Drejtorit të shkollës.

8.4. Për largimin e nxënësit nga shkolla më tepër se 3 ditë njoftohet me shkrim nxënësi dhe prindi i tij.

8.5. Kundër vendimit për largim (pezullim) nga shkolla më gjatë se 3 ditë **nxënësi ka të drejt ankese e cila i drejtohet drejtorisë komunale për arsim.**

8.6. Nxënësi i larguar nga shkolla ka të drejtë të regjistrohet në shkollë tjetër në profilin e njëjtë. Është detyrë e Drejtorisë komunale të arsimit të ndërmjetësoj për sistemimin e nxënësit në shkollën tjetër.

8.7. Nëse nxënësi ka shkatërruar inventarin shkollor, mjetet mësimore, dyert, dritaret apo instalime të tjera shkollore apo ndonjë të mirë materiale, është i obliguar të paguaj dëmin në shumën që e cakton komisioni për vlerësimin e dëmit. Nëse nxënësi nuk e paguan dëmin e shkaktuar, nuk do të mund të tërhiqet asnjë dokument nga shkolla dhe do t'i pamundësohet regjistrimi në tjetër shkollë

Neni 9

Nxënësi e humbë **cilësinë (statusin)** e nxënësit të rregullt në shkollë nëse :

a) largohet nga shkolla më tepër se **5 ditë.**

b) nëse përsërit të njëjtën klasë dy herë dhe

c) nëse çregjistrohet nga shkolla.

ç) nëse përdor dhe shpërndan pije alkoolike dhe narkotik.

DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 10

Nëse ndonjë dispozitë e këtyre rregullave është në kundërshtim me udhëzimet apo aktet tjera të cilat do të nxirren nga MASHT-i, atëherë do të zbatohen dispozitat e Ligjit përkatësisht të udhëzimeve të nxjerra nga MASHT-i.

Neni 11

Ç'do shkollë duhet të ketë rendin shtëpiak të aprovuar nga Këshilli i Shkollës dhe të njëjtin ta publikoj në tabelën e njoftimeve.

Neni 12

Në fillim të vitit shkollor, secilit kujdestarë klase do ti ipet nga një kopje e Rregullores dhe një kopje do të vendoset në tabelën e shpalljeve në korridor të shkollës.

Neni 13

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e aprovimit në Kuvendin Komunal të Gjilanit

KUVENDI I KOMUNËS – GJILANIT

Nr.01.7249 / 15
Gjilan, më 29.09.2005

K R Y E T A R I
Xhemajl HYSENI



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 30.06.2005, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR SHPALLJEN QYTETAR NDERI TË GJILANIT TË
PROF.DR.SC. MEHMET HALIMI

I

Për vepër jetësore shpallet Qytetar nderi i Gjilanit, Prof.dr.sc. Mehmet Halimi.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

Nr.01.4613 / 020
Gjilan, më 30.06.2005

KRYETARI
Xhemajl HYSENI



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Mbështetur në Marrëveshjen në mes të HABITAT-it dhe Kuvendit të Komunës së Gjilanit, si dhe duke u bazuar në nenin 12, alineja 1 pika (i) të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 23.02.2006, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E GJENDJES SOCIALE
DHE BANESORE TË FAMILJEVE TË CILËT KANË UZURPUAR PRONAT TË
CILAT AKTUALISHT JANË NË MENAXHIM TË “HABITATIT”

I

Me këtë vendim formohet komisioni i cili do të vlerësoj gjendjen sociale dhe banesore të familjeve të cilët kanë uzurpuar pronat që aktualisht janë në menaxhim të HABITAT-it, me këtë përbërje:

1. Jakup Bajrami,
2. Fehmi Mahmuti,
3. Arben Mehmeti,

II

Komisioni i formuar sipas pikës I të këtij vendimi pas vlerësimit të situatës në teren do t'i raportoj Kuvendit të Komunës së Gjilanit dhe HABITAT-it për gjendjen sociale dhe banesore të uzurpuesve të pronës private, shoqërore dhe komunale.

III

Komisioni do të ndihmohet nga Qendra për Mirëqenie Sociale, Drejtoria për Shëndetësi dhe Çështje Sociale dhe nga Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër, Pronë dhe Banim-Spektori i Banimit.

IV

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i KK-Gjilan.

V

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

Nr.01.348 / 020
Gjilan, më 23.02.2006

K R Y E T A R I
Xhemajl HYSANI



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Mbështetur në nenin 7 të Rregullores Nr. 2005/54 mbi Kornizën dhe parimet drejtuese të Shërbimit Policor të Kosovës, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 23.02.2006, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR EMËRIMIN E AN ËTARVE TË KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURINË
E BASHKËSIVE

I

Me këtë vendim emërohen anëtarët e Këshillit komunal për sigurinë e bashkësive (KKSB).

II

Për anëtarë të Këshillit komunal për sigurinë e bashkësive emërohen:

1. z.Xhemajl Hyseni-Kryesues i KKSB,
2. znj.Lirie Kajtazi – anëtare,
3. z.Bozhidar Periq – anëtar,
4. z.Enver Muja – anëtar,
5. z.Hazir Mustafa – anëtar,
6. z.Qemajl Mustafa – anëtar,
7. z.Fadil Gashi – anëtar,
8. z.Kemajl Shahin – anëtar,
9. z.Galip Hyseni – anëtar,

III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i KK-Gjilan.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

Nr.01.344 / 020
Gjilan, më 23.02.2006

K R Y E T A R I
Xhemajl HYSANI



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 30.03.2006, e në mbështetje të Rekomandimit të Komitetit për Politikë dhe Financa, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR ANULIMIN E VENDIMIT PËR DHËNJEN NË SHFRYTËZIM TË
STADIUMT TË QYTETIT

I

Me këtë vendim **ANULOHE**T Vendimi nr.01.5026/020 i datës 29.05.2003, për dhënien në shfrytëzim të stadiumit të qytetit, Klubit futbollistik, “Gjilani” dhe Klubit Futbollistik “Drita” nga Gjilani.

II

Pas anulimit të vendimit sipas pikës **I** të këtij vendimi, me stadiumin e qytetit do të menaxhoj Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e KK-Gjilan.

III

Po ashtu me këtë vendim **AUTORIZOHET** Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport që të formoj një Komision i cili do ta analizoj gjendjen në të cilën gjendet stadiumi i qytetit, dhe për këtë të hartoj një raport i cili do t’i paraqitet Kuvendit të Komunës.

Me marrëveshje të veçantë në mes të Drejtorisë për Kulturë, Rini e Sport dhe klubeve tjera do të caktohet mënyra e shfrytëzimit të stadiumit.

IV

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e KK-Gjilan.

V

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

Nr.01.807 / 020
Gjilan, më 30.03.2006

KRYETARI
Xhemajl HYSENI



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Mbështetur në nenin 12 alineja 1 pika (ë), alineja 2 pika (p) të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 30.03.2006, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR DHËNJEN NË SHFRYTËZIM TË HAPËSIRËS SË SHTËPISË SË
KULTURËS, TEATRIT PROFESIONIST TË QYTETIT TË GJILANIT

I

Me këtë vendim një pjesë e hapësirës së objektit të Shtëpisë së Kulturës e cila është pronë e Kuvendit të Komunës i epet në shfrytëzim Teatrit Profesionist, për ushtrimin e aktivitetit të vetë.

II

Teatri Profesionist sipas pikës **I** të këtij vendimi menaxhon me hapësirën teatrore-skenike, (pos me foajeun-byfen), dhe me të gjitha llojet e të ardhurave (të hyrave) nga kjo hapësirë, mjete këto të cilat ekskluzivisht do të destinohen në realizimin e pesë projekteve, e assesi për destinacione tjera (paga të punëtorëve apo të ngjashme).

III

Shpenzimet e rrymës, telefonit, materialit harxhues, ujit, hedhurinave dhe lëndët djegëse për gjenerator dhe ngrohtore (kaldajë) i heq vetë Teatri i Qytetit nga të hyrat vetanake.

IV

Foajeu do të menaxhohet nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, për nevoja të KK-Gjilan.

V

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi anulohen të gjitha aktet dhe veprimet tjera juridike me të cilat është rregulluar mënyra e shfrytëzimit të hapësirës së Qendrës së Kulturës, menaxhimit dhe financimit të Teatrit Profesionist të Gjilanit.

VI

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e KK-Gjilan.

VI

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr.01.804 / 020
Gjilan, më 30.03.2006

KRYETARI
Xhemajl HYSENI



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Mbështetur në nenin 50 të Ligjit për Shëndetësi nr.2004/4 dhe nenin 12, alineja 1, pika (h) të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 27.04.2006, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR HARTIMIN E STATUTIT TË
QENDRËS SË MJEKËSISË FAMILJARE

I

Me këtë vendim formohet Komisioni për hartimin e Statutit të Qendrës së Mjekësisë Familjare me këtë përbërje:

1. Ramadan Leka-Jurist në Qendrën e Mjekësisë Familjare,
2. Vehbi Haziri-Jurist në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Çështje Sociale,
3. Zija Ramadani-Jurist në Zyrën ligjore në SHCK;

II

Komisioni nga pika **I** e këtij Vendimi ka për detyrë ta hartojë Statutin e Qendrës së Mjekësisë Familjare dhe të njëjtin t’ia paraqesë për miratim Kuvendit të Komunës së Gjilanit.

III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i KK-së dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Çështje Sociale.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

Nr.01.1088 / 020 _____
Gjilan, më 27.04.2006

KRYETARI
Xhemajl HYSENI



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 27.04.2006, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR FORMIMIN E GRUPËS KOMUNALE PËR BASHKPUNIM ME
PROGRAMIN MIS-2 PËR MBËSHTETJE NË PROCESIN E KTHIMIT NË
GJILAN

I

Me këtë vendim formohet Grupi komunal për mbështetje të programit MIS-2 në procesin e kthimit në Komunën e Gjilanit, me këtë përbërje:

1. Hazir Mustafa,
2. Halim Isufi,
3. Fadil Osmani
4. Kemajl Shahin,
5. Sergjan Cvejioq;

II

Grupi komunal i formuar sipas pikës I të këtij vendimi, e ndihmon programin MIS-2 me mbështetje publike të Komunës në procesin e kthimit në Komunën e Gjilani.

III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i KK-Gjilan.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

Nr.01.1094 / 020
Gjilan, më 27.04.2006

KRYETARI
Xhemajl HYSENI



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Mbështetur në nenin 12 alineja 1 pika (ë) të Statutit të Komunës së Gjilanit, si dhe në bazë të Rekomandimit të Komitetit për Pronë, Banim dhe Rindërtim, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 29.06.2006, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR DHËNJEN E PËLQIMIT PËR HULUMTIM DHE SHFRYTËZIM TË
VENËDBURIMIT TË QËLQERËS NË FSHATIN PARALLOVË, COMPANISË
“BEJTA COMMERC”-GJILAN

I

Me këtë vendim i epet pëlqimi për hulumtim dhe shfrytëzim të vendburimit të gëlqeres në fshatin Parallovë, Kompanisë “Bejta Commmerc” nga Gjilani, dhe atë:

- në pjesën e ngastrës kadastrale nr.1279, nga sipërfaqja e gjithëmbarshme prej 02.23.38 ha, fleta poseduese nr.238, me kulturë-mal, klasa e gjashtë, vendi i quajtur “Golinë”, P.SH, KK-Parallovë;
- në pjesën e ngastrës kadastrale nr.1305, nga sipërfaqja e gjithëmbarshme prej 02.51,49 ha, me kulturë-mal, klasa e pestë, vendi i quajtur “Kamen”, P.SH, KK-Parallovë;
- në pjesën e ngastrës kadastrale nr.715, nga sipërfaqja e gjithëmbarshme prej 00.20,47 ha, me kulturë-guri, klasa e pestë, vendi i quajtur “Gurthyes”, P.SH, KK-Parallovë;
- në pjesën e ngastrës kadastrale nr. 1280, nga sipërfaqja e gjithëmbarshme prej 01.10,79 ha, me kulturë-guri, klasa e pestë, vendi i quajtur “Gurëthyes”, P.SH, KK-Parallovë;
- në pjesën e ngastrës kadastrale nr.1306, nga sipërfaqja e gjithëmbarshme prej 00.99.79 ha, me kulturë-guri, klasa e pestë, vendi i quajtur “Gurëthyes”, P.SH, KK-Parallovë.

II

Kompania “Bejta Commmerc” obligohet që të paguaj qiranë për hulumtim dhe shfrytëzim të pronës komunale konform nenit 11.2 pika 4 të Vendimit për caktimin e lartësisë së kontributeve dhe detyrimeve për shërbimet komunale, (Teksti i spastruar), nr.01.7969/020 të datës 27.10.2005.

III

Obligohet organi përkatës komunal-Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë e KK-Gjilan që për të gjitha detajet e dhënies në shfrytëzim të përkohshëm të sipërfaqeve nga pika I të këtij vendimi të lidhë kontratë me Kompaninë “Bejta Commmerc” nga Gjilani.

IV

Zbatimin e këtij vendimi e bënë Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, ndërsa për zbatimin e tij kujdeset Kryetari i KK-Gjilan.

V

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr.01.2570 / 0101 _____
Gjilan, më 29.06.2006

KRYETARI
Xhemajl HYSENI



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Duke u mbështetur në nenin 12 alineja 1 pika (ë) të Statutit të Komunës së Gjilanit, e në bazë të Rekomandimit të Komitetit për Pronë, Banim dhe Rindërtim, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 27.02.2007, miraton këtë:

V E N D I M
PËR NDARJEN E LOKACIONIT SHËRBIMIT POLICOR TË KOSOVËS-
KOMANDËS REGJIONALE NË GJILAN

I

Me këtë vendim i ndahet lokacioni SH.P.K-Komandës Regjionale në Gjilan, në sipërfaqe prej 0.50.00 ha (pesëdhjetë ari) nga sipërfaqja e gjithëmbarshme prej 0.78.88 ha (shtatëdhjetë e tetë ari e tetëdhjetë e tetë metra), pronë e Kuvendit të Komunës së Gjilanit, ngastra kadastrale nr. 1/3, vendi i quajtur “Gllama”, me kulturë-kullosë, Fleta poseduese nr.1750, Zona kadastrale Gjilan.

II

SH.K.P.-Komanda Regjionale në Gjilan, sipërfaqen nga pika I të këtij vendimi do ta shfrytëzoj për ndërtimin e objektit të Komandës Regjionale të Policisë në Gjilan.

III

Shpenzimet për ndërtimin e Objektit të Komandës Regjionale të Policisë në Gjilan do t’i bartë SH.P.K.-Komanda Regjionale në Gjilan.

IV

Zbatimin e këtij vendimi e bënë Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë e KK-Gjilan, e cila edhe obligohet që pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi të bëjë parcelimin e ngastrës nga pika I të këtij vendimi, ndërsa për zbatimin e tij do të kujdeset Kryetari i KK-Gjilan.

V

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr.01.1241 / 0101
Gjilan, më 27.02.2007

K R Y E T A R I
Xhemajl HYSENI



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Duke u mbështetur në nenin 12 alineja 1 pika (ë) të Statutit të Komunës së Gjilanit, e në bazë të Rekomandimit të Komitetit për Pronë, Banim dhe Rindërtim, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 27.02.2007, miraton këtë:

V E N D I M
PËR NDARJEN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E NËNSTACIONIT
SIZMIK NË GJILAN

I

Me këtë vendim ndahet lokacioni për ndërtimin e Nënstacionit Sizmik në Gjilan në sipërfaqe prej 0.02.00 ha (dy ari) nga sipërfaqja e gjithëmbarshme prej 13.18.52 (trembëdhjetë hektar e tetëmbëdhjetë ari e pesëdhjetë e dy metra), pronë e Kuvendit të Komunës së Gjilanit, ngastra kadastrale nr. 120, vendi i quajtur “Gllama”, me kulturë-kullosë, Fleta poseduese nr.205, Zona kadastrale Livoq i Epërm- KK-Gjilan.

II

Shpenzimet për ndërtimin e Nënstacionit Sizmik në Gjilan do t’i bartë Ministria e Energjisë dhe Minierave gjegjësisht Instituti për Sizmologji i Kosovës.

III

Zbatimin e këtij vendimi e bënë Drejtoria për Siguri Publike dhe Emergjencë dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë e KK-Gjilan, ndërsa për zbatimin e tij do të kujdeset Kryetari dhe Kryeshefi ekzekutiv i KK-Gjilan

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr.01.1240 / 0101
Gjilan, më 27.02.2007

K R Y E T A R I
Xhemajl HYSENI



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Mbështetur në nenin 39 të Statutit të Komunës së Gjilanit, në nenin 9 të Rregullores nr.2000/45 mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës, si dhe mbështetur në Rekomandimin e Komitetit për Komunitete dhe Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e datës 14.06.2007, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR ZYRTARIZIMIN E GJUHËS TURKE NË KOMUNËN E GJILANIT

I

Me këtë vendim Gjuha Turke është në përdorim zyrtarë në Komunën e Gjilanit.

II

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

Nr.01.3991 / 0101
Gjilan, më 14.06.2007

K R Y E T A R I
Xhemajl HYSENI



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Mbështetur në nenin 3.1 pika (k) të Rregullores së UNMIK-ut 2007/30 për ndryshimin e Rregullores nr.2000/45 mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës, si dhe në pikën 2.2.1.4 të Udhëzuesit për Banim social të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 10.01.2008, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR EMËRIMIN E KOMISIONIT PËR PËRCAKTIMIN E PËRFITUESVE PËR
VËNDOSJE NË OBJEKTIN PËR BANIM SOCIAL

I

Me këtë vendim formohet komisioni i cili do të bëjë përcaktimin e përfituesve për vendosje në objektin për banim social, me këtë përbërje:

4. Ibrahim Salihu-PDK
5. Florim Maloku-LDK
6. Abdyl Kadriu-LDD
7. Fatmir Redenica-AKR
8. Stojan Stojanoviq-ZLK

II

Po ashtu me këtë vendim në cilësinë e monitoruesve të procesit të përzgjedhjes së përfituesve të banimit social por, pa të drejt vote, caktohen edhe nga një përfaqësues i Institucionit të Ombudspersonit dhe një përfaqësues nga Shoqëria civile.

III

Komisioni i formuar sipas pikës **I** të këtij vendimi ka për detyrë që të bëjë përzgjedhjen e përfituesve të mundshëm për vendosjen në objektin e banimit social dhe pas hartimit të “listës me emrat e përfituesve të mundshëm” do të bëhet publikimi i kësaj liste në tabelën e shpalljeve.

VI

Komisioni do të ndihmohet edhe nga Qendra për Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Çështje Sociale.

V

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit.

VI

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

Nr.01.125 / 0101 _____
Gjilan, më 10.01.2008

Kryetari i Komunës,
Qemajl Mustafa



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 10.01.2008, duke u mbështetur në nenin 11.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2007/30 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut nr.2000/45 mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR NDRYSHIMIN DHE
PLOTËSIMIN E STATUTIT TË KOMUNËS SË GJILANIT

I

Me këtë vendim formohet Komisioni për ndryshimet dhe plotësimet e Statutit të Komunës së Gjilanit nr.01.1448/010 të datës 16.03.2001, me këtë përbërje:

1. Hevzi Matoshi-PDK,
2. Arben Mehmeti-LDK,
3. Bardhyl Sylja-LDD,
4. Salih Fazliu-AKR,
5. Mursel Zymeri-AAK,
6. Sefer Arifi-ORA,
7. Sandra Milosheviq-ZLK,
8. Besim Azizi-Shoqata e Juristëve

II

Komisioni i formuar sipas pikës **I** të këtij vendimi ka për detyrë që të bëjë ndryshimet dhe plotësimet në Statutin të Komunës dhe harmonizimin e tij me Rregulloren e UNMIK-ut 2007/30 dhe ligjet në fuqi.

III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës së Gjilanit

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr.01.119 / 0101
Gjilan, më 10.01.2008

Kryetari i Komunës,

/Qemajl Mustafa/



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 10.01.2008 e duke u mbështetur në nenin 13.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2007/30 për ndryshimin e Rregullores nr.2000/45 mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës , miratoi këtë:

V E N D I M
PËR
ZGJEDHJEN E ZËVENDËSKRYESUESIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË
GJILANIT

I

Me këtë vendim z. Islam ZUZAKU zgjidhet Zëvendëskryesues i Kuvendit të Komunës së Gjilanit.

II

Funksionin e Zëvendëskryesuesit të Kuvendit të Komunës së Gjilanit, z. Islam Zuzaku do ta ushtroj që nga dita e zgjedhjes në këtë funksion nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

III

Z. Islam Zuzaku në këtë funksion zgjidhet me mandate të njëjtë sikurse anëtarët e Kuvendit të Komunës së Gjilanit.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr.01.120 / 0101 _____
Gjilan, më 10.01.2008

Kryetari i Komunës,

/Qemajl Mustafa/



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Duke u mbështetur në nenin 27.2 dhe 29.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/30 për ndryshimin e Rregullores s UNMIK-ut nr.2000/45 mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 10.01.2008, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR EMËRIMIN E DREJTORËVE TË DREJTORIVE KOMUNALE

I

Me këtë vendim emërohen Drejtorët e Drejtorive komunale dhe atë:

1. z.Ismajl Kurteshi-Drejtor i Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës;
2. z.Ismet Maliqi-Drejtor i Drejtorisë së financave, ekonomisë dhe zhvillimit;
3. z. Omer Daku-Drejtor i Drejtorisë për urbanizëm, kadastër dhe mbrojtje të ambientit;
4. znj. Maxhide Shaqiri-Drejtoresh e Drejtorisë për shëndetësi dhe mirëqenie sociale;

II

Drejtorët e emëruar sipas pikës I të këtij vendimi do të lidhin kontratë të punës me Kuvendin e Komunës së Gjilanit, sipas së cilës do të parashihen kushtet e punës dhe do të përcaktohet kohëzgjatja e kontratës.

III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit.

IV

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

Nr.01.121 / 0101
Gjilan, më 10.01.2008

Kryetari i Komunës,

/Qemajl Mustafa/



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Duke u bazuar në nenin 21 të Rregullores nr. 2007/30, për ndryshimin e Rregullores 2000/45 mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës, Kuvendi i Komunës së Gjiçanit në seancën e mbajtur më 12.02.2008, miratoi këtë :

V E N D I M
PËR FORMIMIN DHE PËRBËRJEN E KOMITETEVE TË KUVENDIT TË
KOMUNËS SË GJILANIT

I

Me këtë vendim formohen komitetet e Kuvendit të Komunës së Gjiçanit dhe caktohet përbërja e tyre, dhe atë si vijon:

a) Komiteti për politikë dhe financa:

1. Bujar Nevzadi - PDK,
2. Sami Hoxha - PDK,
3. Fadil Osmani - PDK,
4. Arben Mehmeti - LDK,
5. Nehat Ramadani - LDK,
6. Islam Zuzaku - AKR,
7. Jakup Bajrami - LDD,
8. Srgjan Jovanović-Zëvendëskryesues i KK-së,
9. Ejup Haziri - AAK,

b) Komiteti për komunitete:

1. Makfire Uzunaliq - PDK,
2. Ilir Tahiri - PDK,
3. Rashit Sahiti - LDK,
4. Zvonko Spasiq,
5. Lubisavljeviq Milan-komuniteti serb,
6. Kemal Şahin – komuniteti turk,
7. Galip Iseni - komuniteti rom,

c) Komiteti për ndërmjetësim:

1. Ibrahim Salihu - PDK,
2. Hyrmyze Shkodra - LDK,
3. Bekim Isaku - PD,
4. Cvetković Goran - komuniteti serb,
5. Riziq Aleksander - komuniteti serb,
6. Abdylhakim Ismaili - komuniteti turk,

7. Rami Halizbeg - komuniteti rom,

d) Komitetin për Shëndetësi dhe mirëqenie sociale:

1. Abdylatifi Latifi - PDK,
2. Nusret Hajrullahu - PDK,
3. Sami Ahmeti - LDK,
4. Nazim Hajdari - LDK,
5. Besim Guda - LDD,
6. Ilaz Poroshtica - AKR,
7. Xhevat Demiri - AAK,

e) Komitetin për Arsim dhe kulturë:

1. Shukrije Rapuca - PDK,
2. Shkëlqim Latifi - PDK,
3. Agim Rexhepi - LDK,
4. Saranda Bllaca - LDD,
5. Arben Maliqi - AKR,
6. Fadil Gashi - AAK,
7. Halim Vranovci - ORA,

f) Komitetin për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtjen e Ambientit:

1. Shefik Selimi - PDK,
2. Bajram Shaqiri - PDK,
3. Agim Salihu - LDK,
4. Linda Kallaba - LDK,
5. Isah Bunjaku - LDD,
6. Xhafer Xhelili - AKR,
7. Muhamet Kastrati - AAK,

II

Komitetet nga pika I e këtij vendimi duhet të kenë përfaqësim gjinor dhe të pasqyrojnë në mënyrë sa më të përafërt proporcionin e vendeve që mbajnë partitë politike dhe koalicionet në Kuvendin Komunal.

III

Komitete e formuara si në pikën I të këtij vendimi zgjedhin kryesuesin dhe zëvendëskryesuesin nga anëtarët dhe prej anëtarëve të vet, përderisa Komitetin për Politikë dhe Financa e kryeson Kryetari i Komunës, e në mungesë të kryetarit njëri nga zëvendëskryesuesit e Kuvendit të Komunës.

IV

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit.

V

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

Nr.01.1098 / 0101
Gjilan, më 12.02.2008

Kryetari i Komunës,

/Qemajl MUSTAF



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Duke u bazuar në nenin 3.1 pika (i) të Rregullores 2007/30 për ndryshimin e Rregullores nr.2000/45 mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 12.02.2008, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR NDARJEN E BURSIVE PËR NXËNËS DHE STUDENT

I

Me këtë vendim ndahen bursa për nxënës dhe student të Komunës së Gjilanit, dhe atë si në vijim:

1. Dhjet (10) bursa në lartësi prej 50€ për student dhe njëzet (20) bursa për nxënës në lartësi prej 25€, të cilët ndjekin mësimet-studimet brenda Komunës së Gjilanit.
2. Njëzet (20) bursa në lartësi prej 70€ për nxënës-student që ndjekin mësimet-studimet brenda territorit të Kosovës.
3. Dhjetë (10) bursa në lartësi prej 100€ për nxënës-student që ndjekin mësimet-studimet jashtë territorit të Kosovës.

II

Këto bursa u ndahen nxënësve-studentëve të dalluar dhe atë që nga data 01.02.2008 e deri më 30.06.2008, ndërsa përzgjedhja do të bëhet sipas konkursit dhe nga Komisioni i formuar nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit i cili do të monitorohet nga drejtori i Drejtorisë për arsim dhe Kulturë.

Komisioni për përzgjedhjen e përfituesve të bursave do të ketë këtë përbërje:

1. **Sami Hoxha – PDK,**
2. **Nazif Sylejmani – AKR,**
3. **Xhemajl Shabani – AAK,**
4. **Rashit Sahiti - LDK**
5. **Enver Kadriu - LDD**

III

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Arsimit dhe Kulturë e KK-Gjilan.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit,

KUVEDNI I KOMUNËS-GJILAN

Nr.01.1095 / 0101
Gjilan, më 12.02.2008

Kryetari i Komunës,

/Qemajl MUSTAFA/



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Në bazë të vendimit nr. 01.119/0101 të datës 10.01.2008 për formimin e komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 12.02.2008, miratoi këtë;

VENDIM
PËR VAZHDIMIN E MANDATIT TË KOMISIONIT STATUTAR

I

Kuvendi i Komunës miraton vendimin për vazhdimin e mandatit të komisionit statutar të formuar më datë 10.01.2008.

II

Mandati i komisionit statutar vazhdohet me qëllim të hartimit të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe të Rregullores për Kompetencat dhe përgjegjësit e Drejtorive Komunale.

III

Komisioni do të i paraqesë raport për punën e tij Kuvendit të Komunës.

IV

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës.

V

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit në Kuvendin e Komunës së Gjilanit.

KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT

Nr.01.1102 / 0101
Gjilan, më 12.02.2008

Kryetari i Komunës,

/Qemajl MUSTAFA/



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Mbështetur në nenin 4 të Udhëzimit Administrativ nr.2007/11 të MAPL-ës, për përzgjedhjen dhe emërimin e Shefit të Drejtorisë për Administratë dhe personel, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 12.02.2008, miratoi këtë:

VENDIM
PËR EMËRIMIN E PANELIT PËR TË NDIHMUAR KRYETARIN E KOMUNËS
SË GJILANIT PËR TË UDHËHEQ PROCESIN E ZGJEDHJES SË DREJTORIT
TË ADMINISTRATËS DHE PËRSONELIT

I

Me këtë vendim emërohet Paneli në përbërje prej katër (katër) anëtarëve i cili do ta ndihmoj Kryetarin e Komunës së Gjilanit për të udhëheq procesin e zgjedhjes së Shefit të Administratës dhe Personelit, dhe i cili do të ketë këtë përbërje:

1. Qemajl Mustafa, kryesues i Panelit
2. Nazmije Hajdari-PDK
3. Sadudin Berisha - LDK
4. Enver Kqiku-Shoqëria Civile
5. Srgjan Jovanoviq-Komuniteti jo shumicë

II

Paneli, rekrutimin do ta bëjë me konkurs të hapur, do të shpallet vendi i punës dhe të interesuarit do të kenë mundësi të barabartë të konkurrimit duke filluar nga dita vijuese e shpalljes së konkursit.

IV

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i komunës së Gjilanit.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

Nr.01.1100 / 0101
Gjilan, më 12.02.2008

Kryetari i Komunës,

/Qemajl MUSTAFA/



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 12.02.2008 e duke u mbështetur në nenin 13.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2007/30 për ndryshimin e Rregullores nr.2000/45 mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR ZGJEDHJEN E ZËVENDËSKRYESUESIT TË DYTË TË KUVENDIT TË
KOMUNËS SË GJILANIT

I

Me këtë vendim z. Srgjan JOVANOVIQ zgjidhet Zëvendëskryesues i dytë i Kuvendit të Komunës së Gjilanit.

II

Funksionin e Zëvendëskryesuesit të dytë të Kuvendit të Komunës së Gjilanit, z.Srgjan Jovanoviq do ta ushtroj që nga dita e zgjedhjes në këtë funksion nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

III

z.Srgjan Jovanoviq në këtë funksion zgjidhet me mandate të njëjtë sikurse anëtarët e Kuvendit të Komunës së Gjilanit.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr.01.1090 / 0101
Gjilan, më 12.02.2008


Kryetari i Komunës,

/Qemajl Mustafa/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, gje.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u bazuar në nenin 3.1 pika (h) të Rregullores nr.2007/30 për ndryshimin e Rregullores nr.2000/45 mbi Vetëqeverisjen e Komuna të Kosovës, si dhe duke u bazuar në Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 16.04.2008, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR ANULIMIN E TË GJITHA KONTRATAVE QË KAN TË BËJNË MË
SHFRYTZIMIN E PRONËS PUBLIKE POR QË NUK JANË DHËNË NGA
KUVENDI KOMUNAL

I

Me këtë vendim **ANULOHEN** të gjitha kontratat e lidhur në mesë të shfrytëzuesve të hapësirave (pronave) publike dhe zyrtarëve komunal, e të cilat nuk janë dhënë në shfrytëzim në procedurë të rregullt përmes Kuvendit të Komunës së Gjilanit.

II

Hapësirat (pronat) publike si në pikën **I** të këtij vendimi definohej si hapësira që shfrytëzohen nga qytetarët (hapësirat e lira, trotualet, rrugët, ndërtesat për shfrytëzim publik, etj.).

III

Po ashtu me këtë vendim obligohen të gjitha drejtorit dhe organet tjera komunale që të bëjnë identifikimin e të gjitha kontratave të lidhura në këtë mënyrë në mes shfrytëzuesve të hapësirave (pronave) publike dhe zyrtarëve komunal, dhe me hyrjen në fuqi të këtij vendimi të fillohet procedura për anulimin e të njëjtave.

IV

Obligimet financiare të krijuara si pasojë e kontratave të lidhura si në pikën **I** të këtij vendimi, mbesin barrë e shfrytëzuesve të hapësirave publike.

V

Zbatimin e këtij vendimi e bëjnë të gjitha drejtorit dhe organet tjera komunale, ndërsa për zbatimin e tij kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit.

VI

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANI

Nr.01.3739 / 0101
Gjilan, më 16.04.2008


Kryetari i Komunës,

/Qemajl MUSTAFA/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, gje.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Mbështetur në nenin 7 të Rregullores Nr. 2005/54 mbi Kornizën dhe parimet drejtuese të Shërbimit Policor të Kosovës, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 16.04.2008, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR EMËRIMIN E ANËTARVE TË KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURINË E BASHKËSIVE

I

Me këtë vendim emërohen anëtarët e Këshillit Komunal për Sigurinë e Bashkësive (KKSB).

II

Për anëtar të Këshillit Komunal për Sigurinë e Bashkësive emërohen:

- | | |
|---|--|
| 1. Qemajl Mustafa-kryesues i KKSB | 14. Fitnete Zuka-Unioni i stud, anëtare |
| 2. Islam Zuzaku-KK, anëtarë, | 15. Enver Kqiku-Shoqëria civile, anëtarë |
| 3. Srgjan Jovanoviq-KK, anëtarë, | 16. Nazife Jonuzi-SH.G."Liria", anëtare, |
| 4. Basri Kastrati-SHPK, anëtarë, | 17. Sahit Abazi-Organ.rinore, anëtarë |
| 5. Fazli Abdullahu-KK, anëtarë | 18. Ibrahim Salihu-PDK, anëtarë, |
| 6. Ismajl Kurteshi-KK, anëtarë | 19. Remzi Hajrullahu-LDK, anëtarë |
| 7. Kemal Shahin-Kom. Turk, anëtarë | 20. Fehmi Mahmuti-LDD, anëtarë |
| 8. Galip Hiseni-Kom. Rom, anëtarë, | 21. Hetem Matoshi-AKR, anëtarë |
| 9. Naser Hasaj-TMK, anëtarë, | 22. Mursel Zymberi-AAK, anëtarë, |
| 10. Përfaqësuesi i KFOR-it, | 23. Xhevat Aliu-QRP, anëtarë, |
| 11. Agim Hyseni-BI, anëtarë, | 24. Ilir Tahir-iSHDL, anëtarë |
| 12. Svetislav Trajkoviq - kisha
Ortodokse, anëtarë | 25. Drita Klaiqi-ZBGJ, anëtare |
| 13. Ahmet Rrahmani-Mercy Corps, anëtarë | |

III

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi pushon të vlej Vendimi për emërimin e anëtarëve të Këshillit Komunal për Sigurinë e Bashkësive nr.01.344/020 i datës 23.02.2006.

IV

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilan.

V

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN


Nr.01.3745 / 0101
Gjilan, më 16.04.2008

K R Y E T A R I
Qemajl Mustafa



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, gje.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u bazuar në nenin 38.1 pika (k) të Statutit të Komunës së Gjiçanit, Kuvendi i Komunës së Gjiçanit në seancën e mbajtur më 05.06.2008, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR ZHVENDOSJEN E FAMILJEVE QË BANOJNË NË KONVIKTIN E
NXËNËSVE DHE STUDENTËVE NË GJILAN

I

Me këtë vendim bëhet zhvendosja e të gjitha familjeve të cilat aktualisht banojnë në Konviktin e nxënësve dhe studentëve në Gjiçan.

II

Zhvendosja e këtyre familjeve nga Konvikti i nxënësve dhe studentëve bëhet nga arsyeja e shpenzimeve enorme që këto familje po i krijojnë në konvikt dhe rrezikshmëria potenciale që këto familje t'i ekspozohen ndonjë epidemie të mundshme, si dhe nga nevoja për hapësirë publike nga Institucionet e komunës.

III

Kuvendi i Komunës së Gjiçanit për të gjitha familjet të cilat zhvendosen nga Konvikti i nxënësve dhe studentëve do të bëjë kompensimin e qirasë dhe një asistencë sociale për 6 muajt e ardhshëm. Për lartësinë e kompensimit të qirasë dhe asistencës sociale do të vendoset me një vendim të veçantë.

IV

Zbatimin e këtij vendimi e bënë Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, ndërsa për zbatimin e tij kujdeset Kryetari i Komunës së Gjiçanit.

V

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjiçanit.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

01.Nr. 5470
Gjiçan, më 05.06.2008


Kryetari i Komunës,

/Qemajl MUSTAFA/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, gje.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u bazuar në nenin 52 pika (e) të Statutit të Komunës së Gjilanit, si dhe në bazë të Rekomandimit të Komitetit për Politikë dhe Financa të datës 16.05.2008, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 05.06.2008, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORËS PËR SIGURINË NË
PUNË, SHËNDETIN DHE MJEDISIN E PUNËS

I

Me këtë vendim bëhet ndryshimi dhe plotësimi i nenit 34, paragrafi 34.2 i Rregullores për Sigurinë në Punë, Shëndetin dhe Mjedisin e Punës, Nr.01.855/020 të datës 31.01.2005.

II

Teksti i Paragrafi 34.2 i Rregullores nga pika **I** të këtij Vendimi, ndryshohet dhe do të ketë përmbajtje, me sa vijon:

42.2. "Punëdhënësi për punëmarrësit të cilët punojnë në nxehje (kaldajë) dhe me aparat fotokopjues e të cilët i ekspozohen gazrave, erërave të ndryshme, pluhurit, kushteve të përgjithshme higjienike dhe në rastet tjera ku konstatohet se ka koncentrim të pluhurit dhe ajrit e që dëmtojnë shëndetin e punëmarrësve, ka për obligim të sigurojë nga 1 (një) litër qumësht për çdo ditë pune për të punësuarin".

III

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit dhe do të jetë pjesë përbërëse e Rregullores për Sigurinë në Punë, Shëndetin dhe Mjedisin e Punës, Nr.01.855/020 e datës 31.01.2005.

IV

Zbatimin e këtij vendimi e bëjnë drejtoritë përkatëse komunale, ndërsa për zbatimin e tij kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

01.Nr. 5474
Gjilan, më 05.06.2008


Kryetari i Komunës,

/Qemajl MUSTAFA/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, [ëëë.gjilani-komuna.org](http://ee.gjilani-komuna.org); e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u bazuar në nenin XIV të Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores mbi përcaktimin e lartësisë së kompensimit të anëtarëve të kuvendit dhe ndalesave të stafit të Shërbimit Civil Administrativ, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 05.06.2008, miratoi këtë:

V E N D I M

PËR KOMPENSIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E OFERTAVE PËR PUNË E SHËRBIME NË ZYRËN E PROKURIMIT TË KOMUNËS SË GJILANIT

I

Me këtë vendim caktohet lartësia e kompensimit të anëtarëve të Komisionit për vlerësimin e ofertave për punë dhe shërbime në Zyrën e Prokurimit të Komunës së Gjilanit.

II

Lartësia e kompensimit të anëtarëve të Komisionit për vlerësimin e ofertave për punë dhe shërbime në Zyrën e Prokurimit në Komunën e Gjilanit do të jetë si vijon:

1. Për 5 orët e para të vlerësimit, kompensimi për një anëtar të komisionit do të jetë 10€ për një orë pune,
2. Prej 5-10 orë të vlerësimit, kompensimi për një anëtar të komisionit do të jetë 7.50€, për një orë pune,
3. Nëse vlerësimi zgjat më tepër se 10 orë pune, për çka me kërkesë të veçantë mund të zgjatet nga Zyra e Prokurimit, kompensimi për një anëtar të komisionit për çdo orë të ardhshme mbi 10 orë pune do të jetë 5.00€.

III

Nëse ndonjëri nga anëtarët e Komisionit për vlerësimin e ofertave për punë e shërbime është shërbyes civil, kompensimi sipas nenit II të këtij vendimi do t'i takoj vetëm pas orarit të rregullt të punës.

IV

Ky vendim do të jetë i përkohshëm dhe do të vlej deri në nxjerrjen e një Rregulloreje të re për kompensimin e komisioneve të formuara nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

V

Zbatimin e këtij vendimi e bënë Zyra e prokurimit, e cila edhe obligohet që të përcjell punën e Komisionit, administrata, ndërsa për zbatimin e tij kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit.


VI

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

01.Nr. 5464
Gjilan, më 05.06.2008

Kryetari i Komunës
/ Qemajl MUSTAFA/



Në bazë të nenit 6.1 dhe 6.2 të Statutit të Komunës së Gjilanit nr. 3736, si dhe në bazë të Rekomandimit të Komitetit për Politikë dhe Financa të datës 16.05.2008, Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në mbledhjen e vetë të mbajtur me datën 05.06.2008, merr këtë:

V E N D I M

Për vulat

Neni 1

Komuna dhe organet e saja kanë vulën rrethore dhe katërkëndëshe.

Vulat e rrethore do të vihen në të gjitha aktet për të vërtetuar aktin autentik zyrtar të cilin e lëshojnë institucionet e administratës komunale.

Vula e protokollit do të vihet në të gjitha aktet dalëse dhe hyrëse në komunë.

Vula e konstatimit të plotfuqishmërisë së vendimeve administrative të nxjerra nga drejtoritë e komunës.

Vula me të cilat jepet pëlqimi në dokumentacionin teknik- projektin kryesor dhe në zgjidhjet urbane sipas planeve rregulluese, të cilat do të përdoren nga Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Ambientit.

Neni 2

Vulë kanë:

- Kuvendi i Komunës,
- Kryetari i Komunës, dhe
- Drejtoritë e Komunës

Vulat e rrethore kanë diametrin prej 40 mm, 50 mm dhe 60 mm.

Vulat katërkëndëshe kënddrejtë të cilat do të jenë:

- a) Vula e protokollit të komunës do të ketë dimensionin prej 35 x 70 mm.
- b) Vula e konstatimit të plotfuqishmërisë së vendimeve administrative do të ketë dimensionin prej 35 x 70 mm.
- c) Vula me të cilën jepet pëlqimi në dokumentacionin teknik – projekt kryesor do të ketë dimensione prej 35 x 70 mm dhe
- d) Vula me të cilin jepet pëlqimi në zgjidhjen urbane sipas planeve rregulluese, do të ketë dimensione prej 35 x 70 mm.

Teksti i shkruar brenda vulave të komunës do të jetë në gjuhën shqipe, serbe dhe turke me shkronja të shtypit dhe të madhësisë standarde.

Neni 3

Teksti i shkruar brenda vulave rrethore do të jetë:

- Rrethi i jashtëm – Republika e Kosovës;
- Rrethi i dytë – Komuna e Gjilanit, Gjiçan
- Rrethi i tretë – Emërtimi i drejtorisë së komunës.

Në mes të vulës do të jetë emblema e komunës, ndërsa numri i vulës do të jetë në hapësirën ndërmjet fillimit dhe mbarimit të tekstit.

Emërtimi i drejtorive sipas kësaj pike do të jetë:

1. Drejtoria e Administratës dhe Personelit;
2. Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale;
3. Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës;

4. Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit;
5. Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit;
6. Drejtoria e Inspektionit;
7. Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë Civile;
8. Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë dhe
9. Zyra Komunale e Komuniteteve.

Secila drejtori nga kjo pikë do ta ketë nga një vulë të rumbullakët.

Neni 4

Teksti i shkruar brenda vulës së protokollit të komunës sipas nenit 2 alineja 3 pika a) të këtij vendimi do të jetë:

- Rrethi i parë – Republika e Kosovës;
- Rrethi i dytë – Komuna e Gjilanit, Gjilan
- Rrethi i tretë – zbrazëtira për shifrën e organit përkatës, në gjatësi prej 10mm, shkronjat “Nr.” zbrazëtirën për shifrën e përmbajtjes së aktit dhe shifrës së numrit në gjatësi prej 30 mm si shkronjat “Më” me zbrazëtirë për shënim të datës së pranimi në gjatësi prej 25mm.

Neni 5

Teksti i shkruar brenda vulës për konstatimin e plotfuqishmërisë sipas nenit 2 alineja 3 pika b) të këtij vendimi do të jetë:

- Rrethi i jashtëm – Republika e Kosovës;
- Rrethi i dytë – Komuna e Gjilanit, Gjilan
- Rrethi i tretë – Emërtimi i drejtorisë së komunës;
- Rrethi i katërt – Ky vendim është i plotfuqishëm (me zbrazëtirë për datë dhe nënshkrim të personit zyrtar).

Neni 6

Teksti i shkruar brenda vulës për dhënien e pëlqimit në zgjidhjen urbane sipas planeve rregulluese sipas nenit 2 alineja 3 pika c) të këtij vendimi do të jetë:

- Rrethi i jashtëm – Republika e Kosovës;
- Rrethi i dytë – Komuna e Gjilanit;
- Rrethi i tretë – Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit;
- Rrethi i katërt – Vërtetohet se dokumentacioni teknik – projekti është i punuar në pajtim me kushtet e dhëna.
- Rrethi i pestë – dt. _____ e dhënies së pëlqimit dhe nënshkrimi i personit të autorizuar.

Neni 6

Teksti brenda vulës sipas nenit 2 alineja 3 pika d) të këtij vendimi për dhënien e pëlqimit në zgjidhjen urbane do të jetë:

- Rrethi i jashtëm – Republika e Kosovës;
- Rrethi i dytë – Komuna e Gjilanit;
- Rrethi i tretë – Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit;
- Rrethi i katërt – Vërtetohet se kjo zgjidhje urbane është në harmoni me planin rregullues urban të lagjes “_____”
- dt. _____ dhe nënshkrimi i personit të autorizuar.

Neni 7

Me nxjerrjen e ligjit për vulat, e drejta për të harmonizuar këtë vendim me ligj dhe me nxjerrë vendim të ri për vulat, delegohet te Shefi i Administratës dhe Personelit.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Shefi i Administratës dhe Personelit.

KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT

01.Nr. 5473
Gjilan, më 05.06.2008


Kryetari i Komunës

/Qemajl MUSTAFA/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, www.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u bazuar në nenin 83 pika a). të Statutit të Komunës së Gjilanit, si dhe duke pasur për bazë ndikimin e drejtpërdrejtë të bizneseve hoteliere në sjelljen e adoleshentëve dhe sidomos në rininë shkollare si dhe duke e pasur për bazë se aktivitetet e biznesit (cilado qofshin ato) janë gjeneratorë të vendeve të punës dhe kontributëdhënës në konsolidimin dhe rritjen e buxhetit të komunës dhe vendit, si dhe në bazë të Rekomandimit të Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 04.07.2008, miraton këtë:

VENDIM

për kufizimin e ushtrimit të veprimtarisë për bizneset hoteliere në territorin e komunës dhe në kompleksin pranë shkollave të mesme.

I

Me këtë vendim bëhet kufizimi i veprimtarisë së aktiviteteve hoteliere në territorin e komunës dhe në kompleksin pranë shkollave të mesme në periudhën derisa zgjat viti shkollor, dhe atë si në vijim:

1. Të gjitha veprimtarive hoteliere në territorin e komunës së Gjilanit u ndalohet që të shërbejnë adoleshentët (mosha 18 vjeçare) me pije alkoolike të të gjitha llojeve. Ky qëndrim hyn në fuqi ditën kur votohet nga Kuvendi i Komunës.
2. Veprimtarive hoteliere në afërsi të kompleksit të shkollave të mesme, u ndalohet që të shërbejnë të gjitha grupmoshat me pije alkoolike të të gjitha llojeve prej orës 06.00 deri në ora 20.00 gjatë gjithë periudhës sa zgjatë viti shkollor (prej 15 Gusht të vitit aktual deri më 15 Qershor të vitit të ardhshëm).
3. Gjatë gjithë vitit mësimor, për aktivitetet hoteliere në afërsi të kompleksit shkollor ndalohet vendosja e tavolinave jashtë hapësirave të mbyllura, si dhe ndalohet zhurma e cila pengon procesin edukativo-mësimor,
4. Veprimtarive të cilat janë identifikuar ose do të identifikohen si gjeneratorë të problemeve dhe sjelljeve joadekuate të individëve ose grupeve do t'u merren lejet e punës dhe do të ristrukturohen ose ta pushojnë aktivitetin e tyre në tërësi.
5. Për nxënësit të cilët gjenden në këto lokale brenda orarit të mësimi, shkolla ndërmerr masa disiplinore ndaj vetë nxënësit dhe personelit mësimor që e kanë mundësuar një dalje të tillë nga shkolla.
6. U ndalohet personelit shkollor që të jenë pronar të ndonjë lokali hotelier-kafiterive në hapësirën e kompleksit të shkollave të mesme.

II

Si Zona e afërt me kompleksin e shkollave të mesme është zona që nga udhëkryqi i rrugëve të Xhamia e Medresesë, përgjatë rrugës që qon kah kompleksi i shkollave dhe Fakulteti i Edukimit dhe vazhdon me rrugën që qon kah Posta në Dardani, deri në përfundim të rrugës së butiqeve dhe rruga njëkahore që nis përballë furrës "AROMA" dhe përfundon te Posta e Dardanisë.

III

Zbatimin e këtij vendimi e bënë Inspeksioni komunal në bashkëpunim me Drejtorinë për Arsim dhe Kulturë, ndërsa për zbatimin e tij kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN


01.Nr. 6538
Gjilan, më 04.07.2008

Kryetari i komunës,
/Qemajl MUSTAFA/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, www.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u mbështetur në Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa të datës 27.06.2008, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 04.07.2008, miraton këtë:

VENDIM

Për dhënien e pëlqimit Organizatës Ndërkombëtare Partner Aid International (PAI) për ndërtimin e Qendrës për rehabilitimin e njerëzve të varur nga droga

I

Me këtë vendim aprovohet kërkesa nr.02-4979 e datës 22.05.2008 dhe i **epet pëlqimi** Organizatës Ndërkombëtare Partner Aid International (PAI) për ndërtimin e Qendrës për rehabilitimin e njerëzve të varur nga droga në Komunën e Gjilanit.

II

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit në Kuvendin e Komunës së Gjilanit.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

01.Nr. 6541
Gjilan, më 04.07.2008


Kryetari i komunës,

/Qemajl MUSTAFA/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, www.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u bazuar në nenin 4 të Statutit të Komunës së Gjilanit, si dhe mbështetur në Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa të datës 27.06.2008, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 04.07.2008, miraton këtë:

VENDIM

Për përkrahjen e iniciativës për anëtarësimin e Komunës së Gjilanit në Asociacionin e Komunave Turke në Botë (TDBB)

I

Me këtë vendim aprovohet kërkesa nr.03-6038 e datës 19.06.2008 dhe përkrahet e iniciativa për anëtarësim të Komunës së Gjilanit në Asociacionin e Komunave Turke në Botë-TDBB.

II

Komuna e Gjilanit pas aplikimit për anëtarësim do të jetë anëtare e plotë e Asociacionit të Komunave Turke në Botë (TDBB), nga se ky Asociacion ka karakter profesional e jo politikë.

III

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit në Kuvendin e Komunës së Gjilanit.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

01.Nr. 6537
Gjilan, më 04.07.2008


Kryetari i komunës,

/Qemajl MUSTAFA/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, gje.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u bazuar në nenin 133.3 dhe nenin 133.5 të Statutit të Komunës së Gjiçanit, si dhe në bazë të vendimit nr. 01.119/0101 të datës 10.01.2008 për formimin e komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Gjiçanit, Kuvendi i Komunës së Gjiçanit në seancën e mbajtur më 17.07.2008, miratoi këtë;

VENDIM PËR VAZHDIMIN E MANDATIT TË KOMISIONIT STATUTAR

I

Kuvendi i Komunës miraton vendimin për vazhdimin e mandatit të komisionit statutar të formuar më datë 10.01.2008.

II

Mandati i komisionit statutar vazhdohet me qëllim të harmonizimit të Statutit të Komunës së Gjiçanit, Rregullores për punën e Kuvendit të komunës dhe Rregullores për kompetencat dhe përgjegjësit e drejtorive komunale, me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale.

III

Komisioni do të i paraqesë raport për punën e tij Kuvendit të Komunës.

IV

Kompensimi për punën e Komisionit statutar do të rregullohet me vendim të veçantë i cili do të miratohet nga Kuvendi i Komunës së Gjiçanit.

V

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës.

VI

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit në Kuvendin e Komunës së Gjiçanit.

KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT

01.Nr. 6931
Gjiçan, më 17.07.2008


Kryetari i Komunës,

/Qemajl MUSTAFA/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, [gëë.gjilani-komuna.org](http://www.gjilani-komuna.org); e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u bazuar në nenin IV të vendimit 01.nr.6931 të datës 17.07.2008 për vazhdimin e mandatit të Komisionit statutar, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e jashtëzakonshme të mbajtur më 17.07.2008, miratoi këtë:

V E N D I M **PËR CAKTIMIN E LARTËSISË SË KOMPENSIMIT PËR ANËTARËT E** **KOMISIONIT STATUTAR**

I

Me këtë vendim caktohet lartësia e kompensimit për anëtarët e Komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Gjilanit i formuar me vendimin e Kuvendit të Komunës së Gjilanit në seancën e datës 10.01.2008, dhe të cilit i është vazhduar mandati edhe për harmonizimin e Statutit të Komunës së Gjilanit, Rregullores për punën e kuvendit dhe Rregullores për kompetencat dhe përgjegjësit e Drejtorive komunale.

II

Shuma e kompensimit për secilin anëtarë të Komisionit statutar caktohet në lartësi prej **400,00€ bruto**, përderisa Komisioni është i obliguar që të punoj në harmonizimin e Statutit të Komunës së Gjilanit, Rregullores për punën e kuvendit dhe Rregullores për kompetencat dhe përgjegjësit e Drejtorive komunale me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale.

III

Zbatimin e këtij vendimi e bënë Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, ndërsa për zbatimin e tij kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

01.Nr. 6932
Gjilan, më 17.07.2008


Kryetari i komunës,

/Qemajl MUSTAFA/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, [gëë.gjilani-komuna.org](http://www.gjilani-komuna.org); e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u mbështetur në Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa të datës 08.09.2008, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 19.09.2008, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR FORMIMIN E EKIPËS PROFESIONALE PËR HARTIMIN E
MONOGRAFISË TË KOMUNËS SË GJILANIT

I

Me këtë vendim formohet Ekipa Profesionale për hartimin e Monografisë të Komunës së Gjilanit, me këtë përbërje:

- | | | |
|---------------------|----------------------|----|
| 1. Sabri Tahiri, | 8. Lirije Kajtazi, | |
| 2. Mehmet Halimi, | 9. Emin Selimi, | 3. |
| Sabile Keqmezi, | 10. Reshat Ramadani, | |
| 4. Fehmi Rexhepi, | 11. Ejup Haziri, | |
| 5. Aliriza Selmani, | 12. Enver Sadiku, | |
| 6. Shefqet Mehmet, | 13. Sali Mustafa, | |
| 7. Ismajl Kurteshi, | | |

II

Ekipa profesionale e formuar sipas pikës I të këtij vendimi, do ta njoftoj rregullisht Kuvendin e Komunës së Gjilanit në lidhje me ecurinë e hartimit të monografisë së Komunës së Gjilanit.

III

Anëtarëve të Ekipës profesionale, të ngarkuar për hartimin e monografisë të Komunës së Gjilanit, do tu takoj kompensimi, për çka do të nxirret një vendim i veçantë nga KK-ja.

IV

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit.

V



Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

01.Nr. 9985
Gjilan, më 19.09.2008

Kryetari i komunës,

/Qemajl Mustafa/



Duke u bazuar në nenin 38.1 pika (i) të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 19.09.2008, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR SHPALLJEN E KONKURSIT DHE FORMIMIN E KOMISIONIT PËR
NDARJEN E BURSIVE PËR 100 NXËNËS DHE STUDENT

I

Me këtë shpallet konkursi për ndarjen e 100 bursave për nxënës dhe student të Komunës së Gjilanit për vitin shkollor 2008/2009.

II

Po ashtu me këtë vendim formohet edhe Komisioni i cili do të bëjë përzgjedhjen dhe i cili do të monitorohet nga drejtori i Drejtorisë për arsim dhe Kulturë.

Komisioni për përzgjedhjen e përfituesve të bursave do të ketë këtë përbërje e njëjtë si me Vendimin nr.01.1095/0101 të datës 12.02.2008 dhe atë si në vijim:

1. Sami Hoxha – PDK,
2. Nazif Sylejmani – AKR,
3. Xhemajl Shabani – AAK,
4. Rashit Sahiti - LDK
5. Enver Kadriu - LDD

III

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Arsime dhe Kulturë e KK-Gjilan.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit,

KUVEDNI I KOMUNËS-GJILAN

01.Nr. 9987
Gjilan, më 19.09.2008

Kryetari i Komunës,

/Qemajl MUSTAFA/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Duke u bazuar në nenin 41 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e datës 19.09.2008, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR ZGJEDHJEN E KRYESUESIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË
GJILANIT

I

Me këtë vendim, z.Bujar Nevzati zgjedhet Kryesues i Kuvendit të Komunës së Gjilanit, me mandat të njëjtë sikurse anëtarët e tjerë të kuvendit.

II

Funksionin e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Gjilanit, z.Bujar Nevzati do ta ushtroj në harmoni me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe dispozitat tjera ligjore në fuqi.

III

Ky vendim hun në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

01.Nr. 9989
Gjilan, më 19.09.2008


Kryetari i komunës,

/Qemajl Mustafa/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 30.10.2008, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR MIRATIMIN E UDHËZIMIT ADMINISTRATIV NR.16/2008 PËR
PAGESËN E STAFIT POLITIK NË KOMUNA

I

Me këtë vendim aprovohet Udhëzimi Administrativ Nr.16/2008 per pagesën e stafit politik në komuna.

II

Sipas këtij vendimi pagat dhe kompensimet e stafit politik në komunë duhet të jetë në kufijtë e përcaktuar me këtë Udhëzim

III

Zbatimin e këtij vendimi e bënë Sekretaria e Kuvendit, ndërsa për zbatimin e tij kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit

VI

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

01.Nr.____11740_____
Gjilan më, 30.10.2008


K R Y E S U E S I,

/Bujar NEVZATI/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, [gëgë.gjilani-komuna.org](http://www.gjilani-komuna.org); e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në sencën e mbajtur më 30.10.2008, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR SUBVENDCIONIMIN E PUNËTORËVE NDIHMËS TË SHKOLLAVE
FILLORE DHE TË MESME TË KOMUNËS SË GJILANIT

I

Me këtë vendim ndahen mjete financiare për subvencionimin e punëtorëve ndihmës të Shkollave fillore dhe të mesme të Komunës së Gjilanit.

II

Mjetet nga pika I e këtij vendimi ndahen nga Buxheti i Komunës-pozicioni i shërbimeve dhe mallrave dhe do të shpërndahen punëtorëve ndihmës dhe atë për secilin punëtor, për muajin , Nëntor dhe Dhjetor 2008, ose $2 \times 45 = 90$.

III

Zbatimin e këtij vendimi e bënë Drejtoria për Arsim dhe Kulturë, ndërsa për zbatimin e tij kujdeset kryetari i Komunës së Gjilanit

VI

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

01.Nr. 11739
Gjilan më, 30.10.2008


K R Y E S U E S I,

/Bujar NEVZATI/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, gje.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u bazuar në nenin 61.2 dhe 61.3 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 30.10.2008, miratoi këtë:

V E N D I M

PËR EMËRIMIN E NËNKRYETARIT TË KOMUNËS PËR KOMUNITETE

I

Me këtë vendim z.Srgjan Jovanoviq, emërohet Nënkyetar i Komunës së Gjilanit për Komunitete.

II

z.Srgjan Jovanoviq, funksionin e Nënkyetarit të Komunës për Komunitete do ta ushtroj në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, dhe mandati i tij në këtë pozitë do të jetë i njëjtë me mandatin e Kryetarit të Komunës.

III

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Kryetari i Komunës së Gjilanit.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN


01.Nr. 11808
Gjilan, më 30.10.2008

Kryesusi i Kuvendit,
/Bujar NEVZATI/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, gje.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u bazuar në nenin 52.1 pika e) të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 21.11.2008, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR GRUMBULLIMIN E FAKTEVE DHE
DËMEVE TË LUFTËS TË VITIT 1999

I

Me këtë vendim formohet Komisioni për grumbullimin e fakteve dhe të dëmeve të luftës të vitit 1999 në Komunën e Gjilanit, me këtë përbërje:

1. Sami Hoxha-PDK,
2. Sami Ahmeti-LDK,
3. Rasim Shabani-AKR
4. Xhemajl Zeqiri-LDD
5. Ejup Haziri-AAK,

II

Komisioni i formuar si në pikën I të këtij vendimi do të grumbullojë faktet e dëmeve të luftës të vitit 1999 në Komunën e Gjilanit, do t'i përpunojë dhe me ndihmën e gjykatave dhe prokurorisë, këto fakte do t'i dorëzojë në Gjykatën Ndërkombëtare.

III

Komisionit të formuar si në pikën I të këtij vendimi do t'i takoj kompensimi për punën e vet, i cili kompensim do të rregullohet me një vendim të veçantë.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

01.Nr. 12482
Gjilan, më 21.11.2008


Kryesuesi i Kuvendit,

/Bujar NEVZATI/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, gje.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Në bazë të nenint 66.1 dhe 68 të Statutit të Komunës së Gjiçanit, Kuvendi i Komunës së Gjiçanit në seancën e mbajtur më 21.11.2008, miraton këtë:

V E N D I M
për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për formimin dhe përbërjen e
Komiteteve të Kuvendit të Komunës së Gjiçanit

I

Me këtë vendim bëhet ndryshimi dhe plotësimi i vendimit për formimin dhe përbërjen e Komiteteve të Kuvendit të Komunës së Gjiçanit, nr.01.1098/0101, të datës 12.02.2008, dhe vendimit për formimin dhe përbërjen e Komitetit për zhvillim ekonomik, Komitetit për shërbime publike dhe emergjencë civile dhe Komitetit për rini, sport dhe çështje gjinore, të datës 05.06.2008, dhe atë si në vijim:

- Në Komitetin për Politikë dhe Financa, në vend të z.Islam Zuzakut, emërohet z.Arben Maliqi,
- Në Komitetin për Arsime dhe Kulturë, në vend të z.Arben Maliqit, emërohet z.Nazif Sylejmani, ndërsa në vend të z.Nazmi Musa, emërohet znj.Tulaj Hasani,
- Në Komitetin për shërbime publike dhe emergjencë civile, në vend të z.Nazif Sylejmani, emërohet z.Bujar Shkodra.

II

Ky vendim do të jetë pjesë përbërëse e vendimit për formimin dhe përbërjen e Komiteteve të Kuvendit të Komunës së Gjiçanit, nr.01.1098/0101, të datës 12.02.2008, dhe vendimit për formimin dhe përbërjen e Komitetit për zhvillim ekonomik, Komitetit për shërbime publike dhe emergjencë civile dhe Komitetit për rini, sport dhe çështje gjinore, të datës 05.06.2008.

III

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Gjiçanit dhe kryesuesit e Komiteteve të Kk-Gjiçanit.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjiçanit.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

01.Nr. 12478
Gjiçan, më 21.11.2008


Kryesuesi i kuvendit,

/Bujar NEVZATI/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, www.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Në bazë të nenit 38.1, 109.1 dhe 109.2 të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 21.11.2008, miraton këtë:

V E N D I M

për miratimin e Marrëveshjes për bashkëpunim komunal në Zonën Ekonomike Lindje

I

Me këtë vendim miratohet Marrëveshja për bashkëpunim komunal në Zonën Ekonomike Lindje e cila Zonë mbulon hapësirën e komunave: Novobërdë, Kamenicë, Hani i Elezit, Ferizaj, Gjilan, Kaçanik, Shtërpce dhe Viti, me qëllim të themelojnë Agjencinë e Zhvillimit Rajonal (AZHR), me emrin AZHR Lindje.

II

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Marrëveshja për bashkëpunim komunal në Zonën Ekonomike Lindje.

III

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

01.Nr. 12487
Gjilan, më 21.11.2008


Kryesuesi i kuvendit,

/Bujar NEVZATI/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Në bazë të nenit 17 pika b. dhe c. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28/2008, Vendimit të KK-Gjilan, nr.01.5468 të datës 05.06.2008 për lejin e ndërrimit të pronës së palujtëshme, e në vështrim të nenit 38.1 pika (b) dhe (c) të Statutit të Komunës së Gjilanit, si dhe bazuar në Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa të datës 20.12.2008, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 24.12.2008, miratoi këtë:

V E N D I M

Për sigurimin e lokacionit për nevoja të Prokurorisë Publike të Qarkut-Gjilan

I

Me këtë vendim, Komunës së Gjilanit i l e j o h e t sigurimi i lokacionit, në sipërfaqe prej 0.21.52 ha për nevoja të ndërtimit të objektit të Prokurorisë Publike të Qarkut në Gjilan.

II

Lokacioni nga pika I. të këtij vendimi i cili gjendet në kuadër të pronave të palujtëshme, përkatësisht ngastrat kadastrale nr.1943; 1973; 1942; 1941/1; 1940; 1939; 1938 dhe 1945, ZK-Gjilan, në sipërfaqe të përgjithshme prej 01.84.53 ha, të regjistruar në Fletën Poseduese nr.3643, në emër të NSH: Shoqata Auto Moto "Drita" në Gjilan, e të cilat janë në procedurë e sipër për ndërrim me Agjencionin Kosovar të Pronës (ish Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit).

III

Sigurimi i lokacionit nga pika I. e këtij vendimi, bëhet me qëllim të realizimit të projektit për ndërtimin e Objektit për nevoja të Prokurorisë Publike të Qarkut në Gjilan, Prokurorisë Publike Komunale, Shërbimit Sprovues dhe Zyrës për Mbrojtjen e Viktimave.

IV

Autorizohet Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi, Pronë dhe Banime KK-Gjilan, që pas përfundimit të procedurës së ndërrimit të pronave nga pika II. e këtij vendimi, të bëjë formimin e ngastrës kadastrale të veçantë, përcaktimin e kushteve të lokacionit, përkatësisht përcaktimin e vijës së ndërtimit, vijës së rregullimit, gabaritit, atazhitetit dhe kushteve dhe përmbajtjeve tjera përcjellëse për shfrytëzimin racional dhe të pa pengua të ngastrës në kuadër të lokacioni në fjalë.

V

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit dhe Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi, Pronë dhe Banime KK-Gjilan.

VI

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

01.Nr. 13526
Gjilan, më 24.12.2008


Kryesuesi i kuvendit,

/Bujar NEVZATI/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, gje.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u bazuar në nenin 38.1 pika (c) të Statutit të Komunës së Gjilanit, si dhe bazuar në Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa të datës 20.12.2008, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 24.12.2008, miratoi këtë:

V E N D I M

Për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të pronës komunale për vendosjen e tetë (8) Gjeneratorëve me Erë

I

Me këtë vendim Kompanisë për prodhimin e energjisë së ripërtritshme WIND POWER SH.A. me seli në Fushë Kosovë, Rr. "Nëna Terezë", Ndërtesa "Euro-Med" kati I-rë, nr.17, i IPET në shfrytëzim të përkohshëm pjesët e Ngastres Kadastrale nr. 809, në sipërfaqe prej 800m², Zona Kadastrale "Nasalë", vendi i quajtur "G.Rid", e evidentuar sipas Qertifikatës së pronësisë nr.55 në emër si P.SH. e Kuvendit të Komunës së Gjilanit, me qëllim të vendosjes së tetë (8) Gjeneratorëve për prodhimin e energjisë me Erë.

II

Vendosja e gjeneratorëve me erë, nga pika I e këtij vendimi dhe organizimi i rregullimit dhe mbrojtjes së hapësirës për rreth tyre do të bëhet sipas paraqitjes grafike në kopje të planit nr.11-6770 të datës 14.07.2008, të lëshuar nga Drejtoria për gjeodezi e KK-Gjilan dhe pikave të koordinatave të shënuara në shkresën e datës 05/2008 të WIND-POWR-SH.A. Fushë Kosovë të datës 18.11.2008 të cilat janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.

III

Autorizohet Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi, Pronë dhe Banime e KK-Gjilan që në emër të komunës së Gjilanit të bëjë nënshkrimin e kontratës për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të tetë (8) hapësirave nga 100 m² nga palujtëshmëria nga pika I e këtij vendimi në afat prej 2 vitesh nga dita e nënshkrimit të kontratës.

Kushtet e dhënies në shfrytëzim të përkohshëm dhe mënyra e kompensimit do të caktohen më përparësisht me kontratë nga paragrafi 1.1 të kësaj pike

IV

Zbatimin e këtij vendimi e bënë Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi, Pronë dhe Banime, ndërsa për zbatimin e tij kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

01.Nr. 13524
Gjilan, më 24.12.2008


Kryesuesi i kuvendit,

/Bujar NEVZATI/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, gje.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u bazuar në nenin 38.1 pika (k) dhe (m) të Statutit të Komunës së Gjilanit, si dhe bazuar në Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa të datës 20.12.2008, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 24.12.2008, miratoi këtë:

V E N D I M

PËR APROVIMIN E STRATEGJISË DREJT PËRMIRËSIMIT TË MIRËQENJËS SË FËMIJËS DHE PLANI I ZHVILLIMIT TË SHËRBIMEVE PËR FËMIJË DHE FAMILJE NË KOMUNËN E GJILANIT 2008-2010 NGA OJQ "SAVE THE CHILDREN"

I

Me këtë vendim aprovet projekti i Strategjisë drejt përmirësimit të mirëqenies së fëmijës dhe plani i zhvillimit të shërbimeve për fëmijë dhe familje në Komunën e Gjilanit 2008-2010 nga OJQ "Save the Children".

II

Obligohet Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale që ta përcjell aktivitetin e OJQ "Save the Children" dhe për çdo tre (3) muaj të paraqes raport para Kuvendit të Komunës për punën dhe ecurinë e punës së OJQ "Save the Children".

III

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është projekti i Strategjisë drejt përmirësimit të mirëqenës së fëmijës dhe plani i zhvillimit të shërbimeve për fëmijë dhe familje në Komunën e Gjilanit 2008-2010 nga OJQ "Save the Children".

IV

Zbatimin e këtij vendimi e bënë Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Drejtoria e Arsimit, ndërsa për zbatimin e tij kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit.

V

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

01.Nr. 13525
Gjilan, më 24.12.2008


Kryesuesi i kuvendit,

/Bujar NEVZATI/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, gje.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Në bazë të nenit 12.1. pika c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 52.2 pika a) dhe 69.1 të Statutit të Kuvendit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në mbledhjen e mbajtur më 29.01.2009, miraton

RR E G U L L O R E N
PËR KOMPETENCAT, PËRGJEGJËSITË DHE PUNËN E
KOMITETEVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË GJILANIT

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohen kompetencat, përgjegjësitë dhe mënyra e funksionimit të Komiteteve të Kuvendit të Komunës së Gjilanit.

Përkufizimet

Neni 2

Me këtë rregullore përcaktohen disa nga përkufizimet më sa vijon:

“Komitetet” janë trupa ndihmëse të Kuvendit të Komunës, të cilët punojnë për Kuvendin dhe në emër të Kuvendit.

“Material” paraqet të gjitha dokumentet të cilat i paraqiten komitetit përkatës nga drejtoria e cila është në vijë të linjës me atë komitet dhe nga institucionet tjera.

Qëllimi i themelimit të komiteteve

Neni 3

3.1. Komitetet themelohen në pajtim me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale dhe Statutin e Komunës, me qëllim që të lehtësojnë punën e Kuvendit të Komunës në lidhje me procesin e marrjes së vendimeve, pasi që Kuvendi nuk është në gjendje që në tërësi dhe në mënyrë adekuate, të merret me numrin e madh të çështjeve që mund të parashtrihen në Komunë. Shumë çështje me të cilat përballlet Komuna janë të një natyre teknike, që kërkojnë angazhimin e ekspertëve, të cilët mund të mos jenë anëtarë të Kuvendit, por që shërbejnë si anëtarë të komiteteve përkatëse. Prandaj, komitetet e lehtësojnë punën e Kuvendit, duke e racionalizuar kohën e marrjes së vendimeve, për t’u ofruar Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit analiza profesionale, konsultime dhe angazhim për çështjet specifike.

Karakteristikat e përbashkëta

Neni 4

Shumica e anëtarëve të komiteteve, do të jenë anëtarë të Kuvendit të Komunës. Anëtarësia e secilit komitet do të reflektojë përbërjen e Kuvendit të Komunës, që kanë partitë politike dhe koalicionet në Kuvendin e Komunës, duke siguruar pjesëmarrje të barabartë gjinore, nëse kjo nuk është e rregulluar ndryshe me ligj. Emërimi i anëtarëve të disa komiteteve do t’i përgjigjet specifikimit të tyre, siç është rasti me komitetet e përhershme obligative.

Neni 5

Në pajtim me LVL dhe Statutin e Komunës së Gjilanit, janë të themeluara këto komitete:

- a. Komitetet e përhershme obligative :**
 - 1. Komiteti për Politikë dhe Financa dhe**
 - 2. Komiteti për Komunitete**
- b. Komitetet tjera**
 - 1. Komitetin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale,**
 - 2. Komitetin për Arsim,**
 - 3. Komitetin për Zhvillim Ekonomik,**
 - 4. Komitetin për Planifikim Urban, dhe Mbrojtje të Mjedisit**
 - 5. Komitetin për Shërbime Publike, Komunale, Mbrojtje dhe Shpëtim**
 - 6. Komitetin për Kulturë, Rini, Sport dhe Çështje Gjinore dhe**
 - 7. Komitetin për Pronë, Kadastër dhe Banim.**

Kompetencat dhe përgjegjësitë e komiteteve

a) Komiteti për Politikë dhe Financa

Neni 6

6.1. Komiteti për Politikë dhe Financa në pajtim me LVL dhe Statutin e Komunës është përgjegjës:

për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet dhe planifikimin strategjik, kornizën vjetore buxhetore afatmesme, planin vjetor të prokurimit, rregulloren vjetore për tatimet, tarifatat dhe pagesat, planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal, si dhe për marrjen e raporteve nga kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e Komunës.

6.2. Përpos përgjegjësive të cekura në nenin 5.1 të kësaj rregulloreje, Komiteti për Politikë dhe Financa, ushtron edhe këto përgjegjësi: shqyrton dhe rekomandon ndihma të menjëhershme, të cilat i kalojnë autorizimet e kryetarit të Komunës, dhe për këtë e njofton Kuvendin; inicion kontroll të përgjithshëm ekonomik dhe financiar për ndërmarrjet komunale përmes Bordeve mbikëqyrëse; shqyrton çështjet themelore ekonomike dhe sociale të komunës, si dhe çështjet me rëndësi të veçantë; jep mbështetje për zhvillimin ekonomik brenda komunës, duke përfshirë strukturimin ekonomik; këshillon Kuvendin, në mënyrë të përgjithshme në lidhje me zbatimin e procedurave financiare dhe ekonomike; Inicion kontrollin financiar të pronës dhe të burimeve tjera të Kuvendit; shqyrton dhe propozon rendin e ditës për mbledhjet e Kuvendit të Komunës; trajton çështjet që kanë të bëjnë me shërbimet e anëtarëve të Kuvendit dhe mëditjet; shqyrton partneritetet në mes të qyteteve e komunave; ushtron të gjitha funksionet e Kuvendit të Komunës në raste emergjente, të cilat përcaktohen nga kryetari i Komunës, përpos atyre që nuk delegohen; propozon shlyerjen e borxheve; ushtron edhe përgjegjësi tjera nëse ndryshe nuk është rregulluar me LVL dhe me Statut të Komunës.

b) Komiteti për Komunitete

Neni 7

Komiteti i komuniteteve është përgjegjës për shqyrtimin e përputhshmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatim dhe për shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t'u siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht. Komiteti gjithashtu i rekomandon Kuvendit të Komunës, masat që duhet të ndërmerren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komuniteteve për t'u avancuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor si dhe për të siguruar mbrojtje adekuate të të drejtave të komuniteteve brenda komunës dhe ushtron edhe përgjegjësi tjera nëse ndryshe nuk është rregulluar me LVL dhe me Statut të Komunës.

Komitetet tjera jo të përhershme:

1) Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Neni 8

Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale është përgjegjës për fushat që lidhen me kujdesin parësor dhe në kuadër të bashkëpunimit dhe të kujdesit shëndetësor.

1. Përkujdeset për zbatimin e shërbimeve për kujdesin parësor shëndetësor në komunë;
2. Shqyrton propozimet e drejtorit të QKMF dhe të Entit për Emergjencë nëpërmjet DSHMS;
3. Shqyrton buxhetin për Sektorin e shëndetësisë dhe ia dorëzon atë Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit për miratim;
4. Shqyrton dhe jep propozime dhe sugjerime për Projekt-planin vjetor të punës, të përgatitur nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale;
5. Shqyrton raportin vjetor, të përgatitur nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe mund të propozojë ndryshime ose plotësime, dhe t'ia dërgojë KPF – së dhe Kuvendit për miratim;
6. Shqyrton dhe propozon programe për mbështetjen komunale grupeve të varfra të njerëzve (invalidët e luftës, viktimat e dhunës familjare, fëmijët jetimë, të pastrehët, të rikthyerit, pensionistët etj.) dhe propozon masa përkatëse;
7. Mbështet Drejtorinë në ushtrimin e kompetencave dhe detyrave në lidhje me strehimin;
8. Vlerëson propozimet e drejtorisë për strategjitë dhe planet e strehimit, duke përfshirë ndërtimin e shtëpive, renovimin e tyre si dhe mënyrën e shfrytëzimit të tyre për këto qëllime;
9. Shqyrton programet, në raste emergjente, për strehim të refugjatëve, planet dhe zgjidhjet emergjente për fluksin e refugjatëve dhe rikthimin në vendet e tyre dhe
10. ushtron përgjegjësi tjera nëse ndryshe nuk është rregulluar me LVL dhe me Statut të Komunës.

2) Komiteti për Arsim

Neni 9

Komiteti për Arsim është përgjegjës në fushat që kanë të bëjnë me edukimin parashkollor, kopshtet e fëmijëve, arsimin fillor, të mesëm të ulët si dhe arsimin e mesëm të lartë .

1. Ndihmon drejtorinë për hartimin e rregulloreve komunale, në pajtim me ligjet në fuqi për arsim;
2. Shqyrton apelet dhe propozimet e nxënësve në lidhje me cilësinë e mësimi dhe masat disiplinore;
3. Mbështet bashkëpunimin shkollë – shoqëri, në mes të institucioneve arsimore dhe shoqërisë përreth, me institucionet publike dhe private që merren me arsimimin e personave
4. Ndihmon në planifikimin dhe vlerësimin e nevojave arsimore të Komunës.
5. Shqyrton propozimet dhe inicion planet lokale arsimore.
6. Propozon programet dhe projektet për autoritetet qendrore dhe drejtoritë që kanë të bëjnë me punën e këtij Kuvendi;
7. Mbështet bashkëpunimin shkollë – prindër, bashkëpunimin në mes të shkollave dhe komunitetit.
8. Shqyrton programet dhe projektet të cilat subvencionohen nga Komuna dhe propozon mbështetjen e tyre eventuale;
9. Shqyrton prioritetet e programeve komunale në sferën arsimit dhe edukimit;
10. Shqyrton programet komunale për investimeve kapitale në arsim, , në mënyrë që t'u ofrojë institucioneve kushtet e nevojshme; dhe
11. Ushtron përgjegjësi tjera, nëse ndryshe nuk është rregulluar me LVL dhe me Statut të Komunës.

Komiteti për Zhvillim Ekonomik është përgjegjës për:

1. përkrahjen e programeve të zhvillimit ekonomik të komunës, përfshirë këtu organizimin e panairëve të tregtisë dhe tregjeve, inkurajimin e biznesit dhe zhvillimin e turizmit, bashkëpunimin me bizneset lokale apo të përfaqësuara në nivel lokal;
2. iniciimin e programeve të projekteve zhvillimore ekonomike, për zonat urbane dhe rurale;
3. shqyrtimin dhe propozimin e masave për sigurimin dhe mbrojtjen e pyjeve;
4. shqyrtimin dhe propozimin e masave për zhvillimin e bujqësisë;
5. shqyrtimin dhe propozimin e masave për zhvillimin ekonomik dhe të infrastrukturës në zonat industriale dhe në zonat e veçanta rurale;
6. mbështetjen e rindërtimit të pjesëve të qytetit dhe të fshatrave;
7. shqyrtimin e programeve të zhvillimit ekonomik në përgjithësi dhe
8. ushtron përgjegjësi tjera, nëse ndryshe nuk është rregulluar me LVL dhe me Statut të Komunës.

4) Komiteti për Planifikim Urban, dhe Mbrojtje të Mjedisit

Neni 11

Komiteti për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit ushtron këto përgjegjësi:

1. shqyrton propozim-vendimin për qasje në hartimin e planeve urbanistike, propozim-vendimet për miratim të projekt - planeve urbanistike dhe atyre për miratim të këtyre llojeve të planeve;
2. shqyrton propozimet e Drejtorisë së Urbanizëm, Mbrojtje të Mjedisit për prioritet dhe strategjitë e nxjerrjes, ndryshimit plotësimi dhe implementimit të planit zhvillimor komunal, urban dhe planeve rregulluese;
3. shqyrton propozim-planin e punës dhe raportin e punës të drejtorisë së linjës, para prezantimit të tij për miratim nga Kuvendi i Komunës;
4. shqyrton dhe inicion propozime për sigurimin e informatave të nevojshme lidhur me zhvillimet e ndërtimeve ilegale dhe marrjen e masave për parandalimin e tyre;
5. inicion dhe propozon masa për mbrojtjen e ambientit, me qëllim të parandalimit të ndotjes së mjedisit, si dhe të zbatimit të ligjit dhe akteve tjera nënligjore nga ky lëmë.
6. shqyrton informatat mbi zbatimin e rregullave të ndërtimit dhe kontrollin e standardeve të ndërtimit, dhe propozon masa për zbatim dhe kontrollin e tyre.
7. përkujdeset dhe propozon masa për ruajtjen e objektit, të shpallura me interes arkitektonik apo historik dhe
8. ushtron përgjegjësi tjera nëse ndryshe nuk është rregulluar me LVL dhe me Statut të Komunës.

5) Komiteti për Shërbime Publike, Komunale, Mbrojtje dhe Shpëtim

Neni 12

Komiteti për Shërbime Publike, Komunale, Mbrojtje dhe Shpëtim është përgjegjës:

1. këshillon dhe konsultohet me drejtorinë e linjës;
2. shqyrton planet dhe raportet e punës së drejtorisë të linjës;
3. përcjell zhvillimin dhe zbatimin e planeve të veprimit, në lidhje me shfrytëzimin e shërbimeve dhe veprimeve;
4. shqyrton propozimet për Bordin e drejtorëve dhe për ndërmarrjet publike që kryejnë shërbime komunale;
5. monitoron dhe vlerëson efikasitetin e metodave dhe procedurave për ofrimin e shërbimeve; cakton burimet në përputhje me rrethanat;

6. shqyrton programet e ofrimit të shërbimeve për ujë dhe projektet për menaxhimin e ujërave të zeza;
7. shqyrton buxhetin e propozuar vjetor për shërbime, parashikimet e fondeve të nevojshme për personel, mallra dhe shërbime dhe investime;
8. shqyrton raportet për Kuvendin e Komunës, për sistemet operative dhe përmirësimet;
9. këshillon dhe konsultohet në lidhje me çështjen e mbledhjes së kuotave në arkëtim në të gjitha ndërmarrjet shërbyese;
10. shqyrton çështjet që kanë të bëjnë me transportin publik dhe propozimet strategjike për rrugët lokale;
11. shqyrton programet për ndërtimin dhe rindërtimin e infrastrukturës;
12. shqyrton realizimin e projekteve të infrastrukturës;
13. shqyrton kërkesat e komuniteteve për ndërtimin e infrastrukturës;
14. monitoron realizimin e programeve për parqet, fushat rekreative dhe të argëtimit, shëtitoret publike, hapësirat publike të Komunës etj.
15. propozon masat e veçanta për mbrojtjen nga zjarri dhe fatkeqësitë tjera natyrore, kujdeset për zbatimin dhe përparimin e këtyre masave;
16. shqyrton planet e veçanta dhe i propozon drejtorisë së linjës dhe Kuvendit të Komunës nxjerrjen e planit për mbrojtje nga zjarri dhe fatkeqësitë tjera natyrore, në mbështetje të vlerësimit të rrezikut nga zjarri dhe fatkeqësitë tjera natyrore në pajtim me udhëzimet e lëshuara nga Ministria; dhe
17. ushtron përgjegjësi tjera nëse ndryshe nuk është rregulluar me LVL dhe me Statut të Komunës.

6) **Komiteti për Kulturë, Rini, Sport dhe Çështje Gjinore**

Neni 13

Komiteti për Kulturë, Rini, Sport dhe Çështje Gjinore është përgjegjës:

1. për fushat që kanë të bëjnë kulturën, rininë, sportin dhe gjininë;
2. ndihmon drejtorinë e linjës për hartimin e rregulloreve komunale, në pajtim me ligjet në fuqi për kulturë, rini, sport dhe barazi gjinore;
3. mbështet bashkëpunimin kulturë - shoqëri, në mes të institucioneve kulturore dhe shoqërisë përreth, me institucionet publike dhe private që merren me arsimim dhe kulturë;
4. ndihmon në planifikimin dhe vlerësimin e nevojave që lidhen me kulturë, rini, sport dhe barazi gjinore në Komunë;
5. shqyrton propozimet dhe inicion planet lokale kulturore, rinore sportive dhe barazi gjinore;
6. propozon programet dhe projektet për autoritetet lokale dhe qendrore që kanë të bëjnë me kulturë, rini, sport dhe barazi gjinore në Komunë;
7. mbështet kremtimin e festave shtetërore, lokale dhe ndërkombëtare, të njohura ndërkombëtarisht dhe propozon masat e nevojshme për realizimin e programeve kulturore, rinore, sportive dhe çështje gjinore;
8. shqyrton programet dhe projektet të cilat subvencionohen nga Komuna dhe propozon mbështetjen e tyre eventuale;
9. përcjell zhvillimet ndërkombëtare që bëhen në lëmin e kulturës, rinisë sportit dhe çështje gjinore që janë me interes për komunën;
10. përkujdeset që trashëgimisë kulturore dhe historike të qytetit t'i kushtohet rëndësi e veçantë;
11. shqyrton prioritetet e programeve komunale në sferën e kulturës, rinisë, sportit dhe çështjeve gjinore;
12. shqyrton programet komunale për investime kapitale kulturë, rini, sport dhe çështje gjinore në mënyrë që t'u ofrojë institucioneve kushtet e nevojshme;

13. shqyrton propozimet për anëtarët e Bordeve të ndërmarrjeve komunale nga sfera e kulturës dhe e sportit; dhe
14. ushtron përgjegjësi tjera nëse ndryshe nuk është rregulluar me LVL dhe me Statut të Komunës.

7) Komiteti për Pronë, Kadastër dhe Banim

Neni 14

Komiteti për Pronë, Kadastër dhe Banim është përgjegjës:

1. mbështet zhvillimin e ardhshëm të komunës, posaçërisht në lidhje me ruajtjen dhe shfrytëzimin racional të pronës – paluajtshmërisë komunale;
2. shqyrton propozim-vendimet për dhënien në shfrytëzim të pronësisë komunale, para miratimit të tyre nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.
3. shqyrton propozim-vendimet për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik të paluajtshmërive në pronësi private, për të cilat destinohet realizimi i përmbytjeve të caktuara të objekteve me interes të përgjithshëm;
4. shqyrton masat për ruajtjen dhe kthimin e pronave komunale;
5. shqyrton propozim-vendimet për dhënien e tokës në pronësi komunale, në shfrytëzim për ndërtime të objekteve të interesit të përgjithshëm;
6. përcjell dhe përpunon zbatimin e legjislacionit që rregullon sferën e pronësisë në Kosovë, gjegjësisht në komunë;
7. trajton çështjen e uzurpimeve arbitrare të pronësisë komunale dhe propozon masa për kthimin e asaj prone dhe masat tjera ligjore ndaj uzurpuesve;
8. në bashkëpunim me Komitetin për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, përkujdeset për mbajtjen e evidencave të pronës komunale, ruajtjen e regjistrave të tyre dhe transaksionet eventuale të kësaj prone.
9. shqyrton çështjet që kanë të bëjnë me evidencimin dhe mirëmbajtjen e regjistrave të pronave të Komunës dhe
10. ushtron përgjegjësi tjera nëse ndryshe nuk është rregulluar me LVL dhe me Statut të Komunës.

Neni 15

Komitetet përkatëse sipas nenit 5 pika b, përpos kompetencave dhe përgjegjësi të përcaktuara me këtë rregullore, mund të shqyrtojnë edhe kategoritë e subvencioneve nga linja e drejtorive përkatëse

Neni 16

Kompensimi i anëtarëve të komiteteve përkatëse, do të bëhet me vendim të veçanët të Kuvendit të Komunës në pajtim me ligjin dhe aktet nënligjore.

Puna e Komiteteve

Mbledhjet dhe rendi në mbledhje

Neni 17

17.1. Në parim, mbledhjet e komiteteve mbahen njëherë (1) herë në muaj dhe sipas nevojës edhe më shumë. Mbledhjet e komiteteve kryesohen nga Kryesuesit, kurse në mungesë të tyre nga zëvendës kryesuesit.

17.2. Në rast të mungesës së drejtorit në mbledhje të komitetit përkatës, duhet ta caktoi përfaqësuesin e vet të autorizuar, për pjesëmarrje vetëm në atë mbledhje të komitetit përkatës,

17.3. Zyrtarët dhe personat tjerë që nuk janë anëtarë të komiteteve, por që janë të pranishëm në mbledhje, do të lejohen nga ana e kryesuesit të flasin dhe t'i paraqesin qëndrimet dhe propozimet e tyre.

17.4. Kryesuesi i komitetit përkatës mund ta urdhërojë një anëtar ose zyrtar tjetër i cili sipas mendimit të tij bënë veprime që prishin rendin gjatë mbledhjes së komitetit dhe që janë në kundërshtim me kodin e sjelljes që t'i përmbahet rregullave të punës në komitet. Në rast se

anëtari ose zyrtari tjetër edhe pas urdhrit që t'i përmbahet rregullave të punës në komitet, vazhdon t'i shkelë rregullat e punës së komitetit, kryesuesi mund ta urdhërojë që ta lëshojë mbledhjen e komitetit vetëm për atë takim.

Neni 18

Shqyrtimi i ndonjë akti të përgjithshëm juridik ose ndonjë propozim tjetër përmbajtjesor të shkruar, të dorëzuar në komitetin përkatës nga ana e drejtorisë së linjës ose nga institucionet dhe shoqatat e ndryshme, do të bëhet në pajtim me rendin si vijon:

- 1) propozuesi i projekt-aktit të përgjithshëm ose propozimit tjetër përmbajtjesor do të flasë i pari,
- 2) në rast se propozuesi nuk është anëtar i komitetit, drejtori i drejtorisë së linjës do të ketë të drejtë të flasë i dyti dhe kryesuesi i treti dhe anëtarët e tjerë, sipas radhës dhe zyrtarët profesional të drejtorive të linjës;
- 3) në fund të debatit, propozuesi i projekt-aktit të përgjithshëm ose i propozimit tjetër përmbajtjesor, do të ketë të drejtë të përgjigjet dhe të bëjë komente dhe pastaj kryesuesi i komitetit përkatës përmbyll debatin (shqyrtimin).

Neni 19

Një anëtar i komitetit, mund të flasë vetëm një herë gjatë rrjedhës së një debati, për një pikë të rendit të ditës, me qëllim të qartësimit dhe të sqarimeve apo të dhënies së përgjigjeve do të ketë të drejtën edhe njëherë të diskutoj. Fjalimet e anëtarëve të komitetit dhe të drejtorit të linjës, zgjasin më së shumti pesë (5) minuta. Personat tjerë në komitet mund të flasin më së shumti tre (3) minuta.

Neni 20

20.1. Kryesuesi i komitetit duhet të kujdeset që ta mbaje rendin në komitet. Anëtari i komitetit, zyrtarët dhe personat tjerë janë të detyruar t'i respektojnë rregullat e punës në komitet dhe t'i zbatojnë urdhrat eventuale të kryesuesit të komitetit.

20.2. Kryesuesi i komitetit përkatës mund të urdhërojë një anëtar i cili sipas mendimit të tij veprimet e tij ose saj janë në kundërshtim me kodin e sjelljes që t'i përmbahet rregullave të punës në komitet.

20.3. Anëtarëve të komiteteve ju ndalohet pirja e duhanit dhe përdorimi i celularëve në mbledhje.

Neni 21

21.1. Në rast të ndonjë parregullsie serioze që paraqitet në komitet, kryesuesi i komitetit mund ta shtyj mbledhjen në tërësi, ose mund ta pezullojë atë për një kohë të caktuar dhe e njofton kryesuesin e kuvendit të Komunës.

21.2. Në rast se në mbledhjet e komiteteve marrin pjesë zyrtarët e organeve ose institucioneve tjera, personat tjerë dhe përfaqësuesit e shtypit, duhet të respektojnë kodin e mirësjelljes, nëse nuk ka rregulla tjera të sjelljes përkitazi me pjesëmarrjen dhe sjelljen e zyrtarëve të organeve ose institucioneve tjera, për persona tjerë dhe përfaqësues të shtypit që ndjekin mbledhjet e komitetit.

21.3. Kryesuesi i komitetit kërkon nga të gjithë personat që t'i respektojnë rregullat e tilla, e në rast se nuk i respektojnë të largohen nga mbledhja.

Përcaktimi i rendit të ditës

Neni 22

22.1. Kryesuesi i komitetit përkatës në bashkëveprim me strukturat relevante dhe drejtoritë e linjës propozon rendin e ditës për mbledhje.

22.2. Kryesuesi i komitetit, do të kujdeset që në rendin e ditës të jenë çështjet me prioritet të përcaktuara nga ana e drejtoritë të linjës dhe organeve tjera të komunës posaçërisht kuvendit të komunës.

22.3. Anëtarët e komitetit mund të miratojnë rendin e propozuar ose të kërkojnë modifikimin e tij

duke bërë propozimin konkretë, por që nuk është në kundërshtim me përgjegjësit e komitetit përkatës.

22.4. Për çështjet e rendit të ditës për të cilat nuk mund të arrihet pajtimi mund të barten në mbledhjen e ardhshme të komitetit, kurse kryesuesi ndërkohë duhet të zhvillojë konsultime për të arritur pajtime për çështjen e bartur.

Çështjet e ngutshme

Neni 23

23.1. Në të gjitha mbledhjet e komitetit, çdo anëtarë që paraprakisht e ka marrë lejen kryesuesit të komitetit, mund të propozojë që komiteti menjëherë të marrë parasysh një çështje të ngutshme me interes të veçantë publik, e cila është paraqitur në kohën midis dy mbledhjeve të komitetit. Nëse kryesuesi së bashku me anëtarët e komitetit, konsideron se çështja meriton vëmendjen e menjëhershme të komitetit, ai do të lejojë anëtarin në fjalë që të arsyetojë propozimin e tij në komitet, dhe pastaj do të vë në votim atë çështje.

23.2. Përjashtimisht, kur propozimi i bërë nuk është bërë nga një anëtar i komitetit, atëherë drejtorit të

drejtorisë së linjës, do t'i lejohet të paraqes pikëpamjet e veta, para se të votohet. Nëse komiteti vendos të marrë parasysh çështjen, atëherë duhet ta bëjë një gjë të tillë gjatë takimit, ndërsa orari i punës duhet të përshtatet sipas kësaj.

Votimi

Neni 24

24.1. Komitetet nuk janë organe vendim – marrëse brenda komunës. Për çështjet e shqyrtuara bëjnë rekomandime në KPF dhe në Kuvendin e Komunës duke dhënë arsyetime përkatëse.

24.2. Nëse komiteti për çështje të caktuara duhet të votojë për rekomandimin përkatës, vendimi duhet të merret me konsensus të të gjithë anëtarëve të komitetit, mirëpo nëse kjo nuk mund të arrihet, vendimet merren me votimin e shumicës së anëtarëve të pranishëm.

24.3. Votimi bëhet sipas mënyrës “për” – “kundër” – “abstenim” me ngritje dore. Në rast të numrit të barabartë të votave të hedhura “për” dhe “kundër” ndonjë propozimi, kryesuesi e ka një votë shtesë në rast të numrit të njëjtë të votave.

Ndihma teknike për komitete

Neni 25

Drejtoria e Administratës së Përgjithshme, përkatësisht shërbimi i kuvendit të komunës, do të ofrojë mbështetje të nevojshme logjistike dhe administrative për sigurimin e kushteve të nevojshme për mbajtjen e mbledhjeve të komiteteve, duke përfshirë: shpërndarjen e materialeve për mbledhje, vendtakimet, procesmbajtësin, vendosjen e procesverbaleve në dosje dhe të materialeve të tjera të komiteteve.

Gjuhët e përdorura në komitete

Neni 26

Mbledhjet në komitetit mbahen në gjuhët zyrtare, duke siguruar përkthimin adekuat, sipas nevojës. Të gjitha dokumentet zyrtare të komitetit shkruhen në gjuhët zyrtare.

Ndryshimi i rregullores së punës së Komiteteve

Neni 27

27.1. Kryesuesi i komitetit, e shqyrton vazhdimisht rregulloren e punës dhe kohë pas kohe mund t'i propozojë Kuvendit ndryshime, me arsyetim përkatës. Me propozimin për ndryshimin e kësaj rregulloreje duhet të njoftohen edhe komitetet tjera para se Kuvendi të marrë vendim për ndryshimin apo plotësimin e kësaj rregulloreje.

27.2. Propozimin për ndryshimin e rregullores sipas paragrafit **27.1** të kësaj rregulloreje, mund ta paraqes çdo anëtar i komitetit përkatës, mbështetur nga së paku 1/3 e anëtarëve të tjerë. Vendimin përfundimtar për ndryshimin e rregullores e merr Kuvendi i Komunës.

Dispozitat kalimtare dhe të fundit

Neni 28

28.1. Çdo dispozitë e kësaj rregulloreje që është në kundërshtim me LVL dhe Statutin e Komunës, nuk do të zbatohet.

28.2. Kjo rregullore, hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT

01.Nr. 1027

Gjilan, më 29.01.2009


Kryesuesi i kuvendit,

/Bujar NEVZATI/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



bazë të nenit 35 të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve dhe nenit 47.4 të Statutit të Kuvendit të Komunës së Gjilanit, në mbledhjen e vetë të mbajtur me **29.01.20009**, miraton:

RR E G U L L O R E N

PËR PËRDORIM ZYRTAR TË GJUHËVE NË KOMUNËN E GJILANIT

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Qëllimi i kësaj rregulloreje është që të sigurojë: përdorimin e gjuhëve zyrtare, si dhe të gjuhëve të komuniteteve, gjuha amtare e të cilave nuk është gjuhë zyrtare, në institucionet e Komunës, në ndërmarrje dhe organizata të tjera që realizojnë funksione dhe shërbime publike komunale në Komunën e Gjilanit.

Neni 2

Në Komunën e Gjilanit, përpos gjuhës shqipe dhe serbe si gjuhë zyrtare në Kosovë, të gjitha komunitetet kanë të drejta të barabarta sa i përket përdorimit të gjuhëve të tyre në të gjitha institucionet e Komunës, ndërmarrje dhe organizata të tjera që realizojnë funksione dhe shërbime publike komunale në Komunën e Gjilanit, të drejtën për të ruajtur, mbrojtur dhe promovuar identitetin e tyre gjuhësor; karakterin shumë gjuhësor në komunë, që paraqet vlerat e saj unike shpirtërore, intelektuale, historike dhe kulturore.

Neni 3

Në Komunën e Gjilanit përpos gjuhës shqipe dhe serbe, gjuha turke do të jetë gjuhë në përdorim zyrtar, sipas kushteve të përcaktuara me ligj dhe me Statut të Komunës.

Neni 4

Institucionet e Komunës, ndërmarrjet dhe organizata të tjera që realizojnë funksione dhe shërbime publike komunale në Komunën e Gjilanit, do të kujdesen dhe do të marrin të gjitha masat e nevojshme në pajtim me këtë rregullore dhe me ligj për ndalimin e çdo diskriminimi në baza gjuhësore.

Dispozitat e veçanta

Përdorimi i gjuhëve në institucionet e komunës

Neni 5

5.1. Në institucionet e komunës, ndërmarrje dhe organizata të tjera që realizojnë funksione dhe shërbime publike komunale në Komunën e Gjilanit, do të zbatohet barazia e gjuhëve zyrtare të komunës.

5.2. Vulat e organeve të komunës, janë të shkruara në gjuhët zyrtare dhe në gjuhën turke në pajtim me vendimin e KK-së dhe Statutin e Komunës.

5.3. Web faqja e komunës duhet të jetë në gjuhët zyrtare dhe në gjuhët e komuniteteve, gjuha e të cilëve nuk është gjuhë zyrtare nëse janë plotësuar kushtet në pajtim me nenin 2.4 të ligjit për gjuhët.

Neni 6

6.1. Çdo person ka të drejtë të komunikojë dhe të pranojë shërbimet e mundshme dhe dokumentet publike nga institucionet e komunës dhe nga zyrtarët në cilëndo gjuhë zyrtare.

6.2. Kuvendi i Komunës dhe ekzekutivi i komunës ka për detyrë të sigurojë se çdo person mund të komunikojë dhe të pranojë shërbimet në dispozicion dhe dokumentet publike, nga çdo institucion dhe organ i komunës në cilëndo gjuhë zyrtare.

Neni 7

7.1. Gjuhët zyrtare në Komunën e Gjilanit, do të përdoren në baza të barabarta në takimet dhe në punën e Kuvendit të Komunës dhe ekzekutivit të Komunës së Gjilanit. Bartësit e institucioneve të komunës, do të mundësojnë përkthimin nga një gjuhë zyrtare në tjetrën, nëse kjo kërkohet në takimet e këtyre, po ashtu edhe në takimet publike që organizohen nga komuna.

7.2. Shënimet e takimeve dhe shënimet zyrtare të Kuvendit të Komunës së Gjilanit dhe ekzekutivit të komunës, regjistrat publikë dhe dokumente të tjera zyrtare, mbahen dhe lëshohen në të gjitha gjuhët zyrtare të komunës.

Neni 8

8.1. Institucionet e Komunës së Gjilanit, sigurojnë që mjedisi i tyre i punës, të kontribuojë në përdorimin efektiv të gjuhëve zyrtare, si dhe të mundësojë përdorimin e cilës do gjuhë zyrtare nga zyrtarët dhe punëtorët e tyre.

8.2. Rregulloret, vendimet si dhe aktet tjera të miratuara nga Kuvendi i komunës dhe ekzekutivi i Komunës, nxirren dhe publikohen në gjuhët zyrtare të komunës.

Neni 9

9.1. Në Komunën e Gjilanit, personat të cilët iu takojnë komuniteteve, gjuha e të cilëve është në përdorim zyrtar, në pajtueshmëri me nenin 2.4 të ligjit për gjuhët, kanë të drejtë të paraqesin të gjitha kërkesat dhe dokumentet në formë të shkruar apo gojore, si dhe të pranojnë përgjigjet në gjuhën zyrtare nga institucionet e komunës dhe nga zyrtarët e komunës, nëse kërkojnë kështu. (neni 8 i LGJZ).

9.2. Kuvendi i Komunës dhe ekzekutivi i komunës, ka për detyrë të sigurojë që personat e tillë të mund të paraqesin kërkesat dhe dokumentet në formë të shkruar apo gojore si dhe të marrin përgjigjet në gjuhët e tyre (neni 8.2 i LGJZ).

9.3. Rregulloret, vendimet si dhe aktet ndihmëse, duhet të nxirren dhe të publikohen në gjuhët e komuniteteve të tilla, nëse atë e kërkojnë kështu. (neni 8.3 LGJZ).

9.4. Në punën dhe në takimet e Kuvendit të Komunës dhe komiteteve të tyre, si dhe në takimet publike të organizuara nga komuna, anëtarët e të cilët iu takojnë komuniteteve, gjuha amtare e të cilave nuk është gjuhë zyrtare, kanë të drejtë të përdorin gjuhën e tyre në punë dhe në takimet e Kuvendit të Komunës dhe komiteteve të tyre si dhe në takimet publike të organizuara nga komuna. Mjetet duhet të sigurohen për të mundësuar përkthimin nga gjuha zyrtare në gjuhën e anëtarit, nëse kërkohet një shërbim i tillë. Çdo dokument i dorëzuar nga anëtari i tillë përkthehet në gjuhët zyrtare dhe të gjitha përgjigjet e kërkuara do të kthehen në gjuhën e përdorur nga ana e tij. (neni 8.4 LGJZ).

Neni 10

10.1. Emrat zyrtar të institucioneve dhe të organeve të komunës, paraqiten në gjuhët zyrtare dhe në gjuhët që kanë statusin e gjuhës zyrtare sipas ligjit. (neni 2.3 i LGJZ).

10.2. Shenjat zyrtare që shënojnë apo përfshijnë emrin e vetë Komunës së Gjilanit, fshatrave, rrugëve, rrugicave dhe të vendeve të tjera publike, paraqiten në gjuhët zyrtare dhe në gjuhët e komuniteteve, gjuha e të cilave ka statusin e gjuhës zyrtare në Komunën e Gjilanit, në pajtueshmëri me ligjin (LPGJ neni 2.3).


Përdorimi i gjuhëve në ndërmarrjet publike të komunës

Neni 11



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, gje.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u bazuar në nenin 38.1 pika c) dhe h) të Statutit të Komunës së Gjilanit si bazuar në Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa të datës 21.01.2009, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 29.01.2009, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR NDARJEN E SIPËRFAQËS SË TOKËS, SH.M. TË BUJQËSISË
"ARBËRIA" NË GJILAN

I

Me këtë vendim Shkollës së mesme të bujqësisë "Arbëria" në Gjilan i ndahet sipërfaqja prej **10.41.67** ha, në ngastrën nr.01444-0, Fleta poseduese nr.04212, në vendin e quajtur "SANTAGIN ZABEL" me kulturë "Pyjor", Zona kadastrale-Gjilan, P.SH.- "Sekretariati i Mbrojtjes Popullore"-Gjilan, si dhe sipërfaqja prej **03.59.50** ha në ngastrën nr.3-01382-0, Fleta poseduese nr.01382-0, në vendin e quajtur "SANTAGIN ZABEL", P.SH.- "Sekretariati i Mbrojtjes Popullore"-Gjilan.

II

Po ashtu me këtë vendim autorizohet Drejtoria e Arsimit dhe Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi, Pronë dhe Banim që për nevojat e SH.M. të bujqësisë t'i bëjnë kërkesë Agjensionit Kosovar të Privatizimit për lejin e shfrytëzimit edhe të sipërfaqes prej 21 ha në ngastrat kadastrale nr.02033-0, 02034-1 dhe 02034-2, P.SH.- "Kombinati i Drurit"

III

Sipërfaqja nga pika I e këtij vendimi i ndahet SH.M. të bujqësisë "Arbëria" në Gjilan, me qëllim të realizimit të praktikës profesionale dhe ndërtimin e fermës eksperimentale (serrë për perime)-donacion i Qeverisë Daneze.

IV

Zbatimin e këtij vendimi e bëjnë Drejtoria e Arsimit dhe Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi, Pronë dhe Banim, ndërsa për zbatimin e tij kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit.

V

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

01.Nr. 1033
Gjilan, më 29.01.2009


Kryeuesi i kuvendit,

/ Bujar NEVZATI/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, [ëëë.gjilani-komuna.org](http://ee.gjilani-komuna.org); e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u bazuar në nenin 38.1, shkronja k), nenin 52.2 shkronja e) të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 29.01.2009, miratoi këtë:

V E N D I M

Për vazhdimin e mandatit të punës Komisionit për përcaktimin e përfituesve për vendosje në objektin e Banimit Social, edhe për hartimin e Listës së rasteve sociale në komunën e Gjilanit

I

Me këtë vendim i vazhdohet mandati i punës Komisionit për përcaktimin e përfituesve për vendosje në objektin për banimi social, **edhe për hartimin e Listës së rasteve sociale në komunën e Gjilanit.**

Komisioni do të ketë përbërjen e njëjtë, dhe atë:

9. Ibrahim Salihu-PDK
10. Florim Maloku-LDK
11. Abdyl Kadriu-LDD
12. Fatmir Redenica-AKR
13. Stojan Stojanoviq-ZLK

II

Komisioni si në pikën I të këtij vendimi ka për detyrë që të bëjë hulumtimin e të gjitha rasteve sociale si dhe shqyrtimin e të gjitha kërkesave të cilat i drejtohen Institucioneve komunale si dhe hartimin e Listës me të gjitha rastet sociale në Komunën e Gjilanit.

III

Komisionit për punën e vetë do t'i takoj kompensimi, dhe për këtë do të nxirret një vendim i veçantë nga Kryetari i Komunës së Gjilanit.

IV

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit.

V

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

01.Nr. 1035
Gjilan, më 29.01.2009


Kryesuesi i kuvendit,

/Bujar NEVZATI/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, gje.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u bazuar në nenin 52.2 pika g), nenin 72 të Statutit të Komunës së Gjilanit, si dhe duke u bazuar në nenin 54 dhe 55 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 29.01.2009, miratoi këtë:

V E N D I M

PËR ZGJEDHJEN E ZËVENDËSKRYESUESIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË GJILANIT PËR KOMUNITETE

I

Me këtë vendim **z.Abdylhaqim ISMAILI** zgjidhet Zëvendëskryesues i Kuvendit të Komunës së Gjilanit për komunitete.

II

Funksionin e Zëvendëskryesuesit të Kuvendit të Komunës së Gjilanit, z.Abdylhaqim Ismaili do ta ushtroj që nga dita e zgjedhjes në këtë funksion nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit, si dhe në harmoni me dispozitat e Statutit të komunës dhe Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale.

III

z.Abdylhaqim Ismaili në këtë funksion zgjidhet me mandate të njëjtë sikurse anëtarët e Kuvendit të Komunës së Gjilanit.

IV


Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

01.Nr. 1024
Gjilan, më 29.01.2009

Kryesuei i kuvendit,

/Bujar NEVZATI/



Në bazë të neni 68.4 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen e Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 të datës 4 qershor 2008), dispozitave të Ligjit për Qasjen në Dokumente Zyrtare, nr. 2003/12, nenit 39 të Statutit të Komunës së Gjilanit 01. nr. 124/79 të datës 21.11.2008 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 2008/03 për Ndryshimin e Udhëzimit Administrativ nr. 2006/03 për Transparencën në Komuna, Kuvendi i Komunës në Gjilan në mbledhjen e mbajtur më datën 12.03.2009, miraton:

RR E G U L L O R E N PËR TRANPARENCËN NË KOMUNËN E GJILANIT

Qëllimi dhe fushëveprimi

Neni 1

- 1.1. Kjo rregullore në pajtim me Ligjin e vetëqeverisje Lokale dhe Statutin e Komunës, ka për qëllim forcimin e transparencës së organeve të komunës së Gjilanit, rritjen e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje dhe lehtësimin e qasjes së publikut në dokumentet zyrtare të komunës së Gjilanit.
- 1.2. Kjo rregullore rregullon pjesëmarrjen e publikut në mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe komiteteve të tij, mbledhjet me publikun, detyrimin për njoftim publik, konsultimin e publikut para miratimit të akteve të komunës, pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje dhe qasjen në dokumentet zyrtare të Komunës së Gjilanit.

Mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe komiteteve të tij

Neni 2

- 2.1. Mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe komiteteve të tij janë të hapura për publikun dhe përfaqësuesit e mjeteve të informimit dhe subjektet e interesuara për çështjen që është objekt diskutimi.
- 2.2. Kryesuesi i mbledhjes së Kuvendit të Komunës ose komitetit përkatës siguron pjesëmarrjen e publikut në mbledhjet e tij në përputhje me kushtet dhe mundësitë fizike të vendit ku mbahet mbledhja.
- 2.3. Kryesuesi i mbledhjes së Kuvendit të Komunës ose komitetit përkatës, nëpërmjet zyrës përgjegjëse për informim njofton publikun të paktën 7 ditë para mbledhjeve të rregullta ose 3 ditë para mbledhjeve të jashtëzakonshme ndër të tjera edhe përmes:

- a) Shpalljeve publike në vendet më të frekuentuara brenda territorit të komunës;
- b) Medieve të shkruara dhe elektronike lokale dhe
- c) Ueb – faqes zyrtare të komunës .

Neni 3

- 3.1. Njoftimet publike duhet sipas paragrafit 2.3 të kësaj rregulloreje dhe paragrafit 64.3 të Statutit të Komunës domosdo duhet të përmbajnë:
 - a) datën e mbledhjes;
 - b) kohën e mbledhjes dhe
 - c) vendin e mbajtjes së mbledhjes;
 - d) rendin e ditës me material përkatës.

- 3.2. Mbledhjet e Kuvendit të Komunës ose të komiteteve të tij mund të jenë të mbyllura pjesërisht ose tërësisht vetëm për shkaqet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Në këto raste, me vendim të arsyetuar, Kuvendi i Komunës ose komiteti përkatës i shpall mbledhjet pjesërisht ose atërisht të mbyllura për publikun.

Publikimi i akteve të komunës

Neni 4

- 4.1. Të gjitha rregulloret, vendimet dhe aktet tjetra të Kuvendit të Komunës, publikimi i të cilave nuk është i kufizuar nga legjislacioni në fuqi për qasjen në dokumentet zyrtare bëhen publike një javë pas mbledhjes në të cilën janë marrë vendimet, ndër të tjera përmes:
- a) Shpalljeve publike në vendet më të frekuentuara brenda territorit të komunës;
 - b) Medieve të shkruara dhe elektronike lokale dhe
 - c) Ueb – faqes zyrtare të komunës.
- 4.2. Buxheti i Komunës dhe planet e komunës janë dokumente publike pa kufizime. Komuna duhet të sigurojë mjete financiare për ti vënë këto dokumente në dispozicion të publikut, mjeteve të informimit dhe palëve të interesuara në formë të plotë ose të shkurtuar sipas kërkesës.
- 4.3. Vendimi për Aktet komunale në të cilat nuk lejohet qasja e publikut, mund të merret vetëm kur është në pyetje mbrojtja e interesit publik në pajtim me ligjin për qasje në dokumente zyrtare (neni 4).

Kërkesat për informim dhe Peticionet

Neni 5

- 5.1. Në pajtim me ligjin dhe dispozitat e nenit 33.1 të Statutit të Komunës, çdo person apo organizatë e interesuar ka të drejtë t'i parashtojë peticion Kuvendit të Komunës, për çështje që janë përgjegjësi e Komunës. Kërkesat ose peticionet shqyrtohen nga kuvendi i Komunës brenda afatit të përcaktuar me ligj.
- 5.2. pas diskutimit në Kuvend, Kryetari i Komunës ose një zyrtar i autorizuar prej tij, jo më vonë se 30 ditë nga dita e shqyrtimit, njofton me shkrim parashtruesin e kërkesës ose peticionit.
- 5.3. Në rastet kur peticioni ose kërkesa lidhet me çështjet për të cilat nuk është drejtpërdrejtë kompetente, Kryetari i Komunës ose një zyrtar i autorizuar prej tij, brenda afatit të përcaktuar në paragrafin 5.2 të kësaj rregulloreje njofton me shkrim parashtruesin e kërkesës ose peticionit se është jo kompetentë dhe e procedon atë tek organi kompetent duke informuar edhe parashtruesin.

Tubimet me publikun

Neni 6

- 6.1. Në pajtim me nenin 68.1 të Ligjit për Vetëqeverisjes Lokale dhe nenin 22.1 të Statutit të Komunës, Komuna detyrimisht mban të paktën dy tubime me publikun për çështje të interesit të përgjithshëm.
- 6.2. Përveç dy tubimeve të detyrueshme me publikun, Kuvendi i Komunës duhet të shqyrtojë mundësinë për të mbajtur mbledhje shtesë, sa më pranë qytetarëve (vendbanimeve, fshatra, lagje), për çështje që lidhen me përdorimin e buxhetit të komunës, zhvillimin ekonomik lokal, përdorimin e pronës të komunës, planifikimin hapësinor, investimet, të hyrat e komunës si dhe çështje të tjera në interes të përgjithshëm.
- 6.3. Komuna duhet të sigurojë me shpenzimet e veta hapësirat të mjaftueshme brenda territorit të komunës për pjesëmarrje të gjerë dhe aktivitet të publikut.
- 6.4. Dy javë para datës së mbajtjes së tubimit publik, Kuvendi i Komunës, nëpërmjet zyrës përgjegjëse për informim informon publikun ndër të tjera edhe përmes:
- a) Shpalljeve publike në vendet më të frekuentuara brenda territorit të komunës;
 - b) Medieve të shkruara dhe elektronike lokale; dhe
 - c) Ueb – faqes zyrtare të komunës.

6.5. Njoftimi i publikut sipas paragrafit 6.4. të kësaj rregulloreje, domosdo duhet të përmbajnë:

- a) Datën e mbledhjes;
- b) Kohën e mbledhjes;
- c) Vendin e mbajtjes së mbledhjes dhe
- d) Rendin e ditës me material përkatës.

6.6. Pjesëmarrja e zyrtarëve më të lartë të komunës të tillë si : Kryetarit të komunës, Kryesuesit të KK-së, Zëvendës-kryesuesit të KK-së, Drejtorët e drejtorive, Kryesuesit e Komiteteve Udhëheqësi i personelit dhe zyrtarët kompetentë për çështjen në diskutim është obligueshme.

6.7. Kërkesat dhe rekomandimet e dhëna nga publiku do të evidentohen nga personat e autorizuar dhe shqyrtohen nga Kuvendi i Komunës në pajtim me dispozitat e statutit që rregullojnë çështjen e tubimeve me publikun.

Konsultimi Publik para Miratimit të Akteve

Neni 7

7.1. Në Pajtim me nenin 15 të statutit të Komunës, aktet normative të Komunës ose të organeve tjera të komunës, përfshirë rregulloret dhe vendimet, i nënshtrohen diskutimit publik para miratimit.

7.2. Zyra përgjegjëse për informim njofton publikun dy javë para se seancës së konsultimit publik ndër të tjera edhe përmes:

- d) Shpalljeve publike në vendet më të frekuentuara brenda territorit të komunës,
- e) Medieve të shkruara dhe elektronike lokale dhe
- f) Ueb – faqes zyrtare të komunës.

7.3. Njoftimi i publikut sipas paragrafit 7.2 të kësaj rregulloreje, domosdo duhet të përmbajnë:

- a) Datën e mbledhjes;
- b) Kohën e mbledhjes;
- c) Vendin e mbajtjes së mbledhjes dhe
- d) Rendin e ditës me material përkatës.

7.3. Organi propozues i aktit merr pjesë aktivisht në konsultim, shpjegon përmbajtjen e aktit para publikut dhe evidenton propozimet e dhëna nga publiku gjatë konsultimeve. Propozimet shqyrtohen brenda një afati të arsyeshëm nga përfundimi i konsultimit.

7.4. Organi propozues i aktit duhet të informojë Kuvendin e Komunës për propozimet e dhëna në diskutim publik, duke përfshirë propozimet e refuzuara si dhe ato të marra parasysh. Me rastin e Miratimit të aktit, Kuvendi i Komunës kujdeset që propozimet e argumentuara të përfshihen në tekstin përfundimtar të projektit.

Qasja në dokumentet Zyrtare të Komunës.

Neni 8

Në pajtim me Ligjin për Qasjen në Dokumente Zyrtare, nr. 2003/12 , komuna garanton të drejtën e qytetarëve për qasje në dokumentet zyrtare të komunës. Kryetari i Komunës ose një zyrtar i caktuar prej tij zbaton detyrimet ligjore që rrjedhin nga ligji dhe udhëzimeve administrative për qasje në dokumente zyrtare.

Plani i Transparencës

Neni 9

9.1. Komuna ka obligim të hartojë planin e saj për përforcimin e transparencës në Komunë. Shqyrtimi dhe miratimi i planit bëhet nga Kuvendi i Komunës me qëllim që procesi vendim – marrjes dhe veprimtaria e komunës të bëhet me transparencë.

9.2. Komuna duhet të mirëmbajë ueb – faqen e saj zyrtare.

9.3. Plani i transparencës mund të përfshijë ndër të tjera veprimet e mëposhtme si dhe iniciativa të tjera të dizajnuara për të përmirësuar qasjen e publikut dhe transparencën në komunë.

- a) Raportin më të shpeshtë në media për çështje që lidhen me përdorimin e buxhetit të komunës, zhvillimin ekonomik, përdorimin e pronës të komunës, planifikimin urban, investimet, të hyrat e komunës si dhe çështje tjera me interes të përngjithshëm;
 - b) Mbajtjen e konferencave periodike të shtypit (çdo dy javë ose çdo muaj) me gazetarë dhe përfaqësues të mjeteve lokale të informimit;
 - c) Organizimi i seancave pyetje – përgjigje me publikun e gjerë ose grupe të interesit për çështjen në interes;
 - d) Organizimi i debateve në radio dhe televizione për çështje e lartshënuara;
 - e) Ndërtimi i ueb faqes zyrtare të komunës ose freskimi i saj ekzistuese ku të publikohen planet, dhe raportet e punës së komunës, kalendari i mbledhjeve, numërori telefonik dhe informacione të personave të kontaktit sipas fushave të caktuara;
 - f) Botimi dhe shpërndarja e fletëpalosjeve orientuese në lidhje me organogramin, rregulloren e punës së Kuvendit të Komunës, numërorin telefonik, përshkrimin e detyrave për Shërbyesit Civil Komunës nga të cilët qytetarët mund të marrin informacion, taksat e komunës, taksat për shërbime të komunës dhe informacione tjera të dobishme.
- 9.4. Me planet për transparencë, komuna duhet ti mundësojë publikut monitorimin e zbatimit të legjislacionit në fuqi nga komuna duke përfshirë ndër të tjera legjislacionin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi, prokurimin, shërbimin civil, qasjen në dokumente zyrtare, ligjin mbi ndërtimet ligjin për planifikimin hapësinor etj.

Neni 10

- 10.1. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje do të q`fuqizohet rregullorja për zbatimin e dispozitave të statutit të komunës për konsultim dhe pjesëmarrje të publikut nr. 01.5795/020 e datës 02.07.2004..
- 10.2. Asnjë dispozitë e kësaj rregullore e cila është në kundërshtim me LVL dhe dispozitat e statutit të Komunës të cilat rregullojnë çështjen e transparencës nuk do të ketë epërsi gjatë zbatimit.
- 10.3. Kjo rregullore hynë në fuqi ditën e miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës dhe nënshkrimit të saj nga ana e Kryesuesit të KK-së.

01. nr. 2681
Gjilan, 12.03.2008


Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

/Bujar Nevzati /



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, gje.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Në pajtim me nenin 17 pika k) dhe 40.2 pika a) të LVL dhe nenit 38.1 pika k) dhe 39.1 të Statutit të Komunës së Gjiçanit, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datën 30.03.2009, miraton këtë:

RREGOLLORE

MBI DHËNIEN E NDIHMËS SË PËRKOHSHE PËR FAMILJET E DËSHMOREVE DHE INVALIDËVE TË LUFTËS

DISPOZITAT E PËRGJITRSHME

Neni 1

- 1.1. Me këtë rregullore, rregullohet dhënia e ndihmës për familjet e ngushta të dëshmorëve dhe invalidëve të luftës të rënë gjatë luftës për liri dhe të drejta në trojet shqiptare jashtë kufijve të Republikës së Kosovës e të cilët janë banor të komunës së Gjiçanit.
- 1.2. Me këtë rregullore do të përfitojnë edhe familjet e dëshmorëve të rënë për liri dhe të drejta gjatë viteve 1980 – 1999 që janë banor të Komunës së Gjiçanit.

Neni 2

Përfituesit e ndihmës sipas nenit 1 të kësaj rregulloreje do të jenë familjet e ngushtat të dëshmorëve, invalidët e luftës dhe familjet e ngushta të dëshmorëve të rënë për liri dhe të drejta gjatë viteve 1980 – 1999 por të cilët nuk janë përfshirë në asnjë skemë të ndihmës sociale e tjetër.

Neni 3

- 3.1. Të afërmit familjarë të dëshmorëve dhe invalidëve të luftës si në nenin 1 të kësaj rregulloreje, konsiderohet:
 - bashkëshorti-ja
 - fëmijët nën moshën 18 vjeçare, edhe deri në moshën 26 vjeçare nëse vazhdojnë shkollimin, dhe
 - prindërit që kanë jetuar në bashkësinë familjare me dëshmorin.
- 3.2. Fëmijë konsiderohen, fëmijët e lindur në martesë dhe jashtëmartesor (për të cilët vërtetohet në procedurë gjyqësore) dhe të adoptuar me ligj.

Neni 4

Të drejtë për të paraqitur kërkesë për njohjen e kësaj ndihme sipas nenit 1 të kësaj rregulloreje do të kenë:

- bashkëshorti-ja që kujdeset për fëmijët nën moshën 18 vjeçare;
- bashkëshorti-ja pa fëmijët ose me fëmijë mbi moshën 18 vjeçare;

- fëmijët nën moshën 18 vjeçare pa dy prindër (paraqet kërkesë kujdestari i rregulluar sipas ligjit për kujdestarinë);
- njëri nga prindërit e dëshmorit, dhe
- invalidi i luftës.

LARTËSIA E PAGESËS PËR NDIHMË

Neni 5

Pagesat financiare për familjet e dëshmorëve, dhe invalidëve të luftës do të jetë mujore.

Neni 6

- 6.1. Ndhimja për familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës sipas kësaj rregulloreje do të jetë 130,00 €, bruto.

Neni 7

- 7.1. Ndhimja për përfituesit do të caktohet në bazë të listës së pranuar nga ana e OVL – UÇK –së dega në Gjilan.
- 7.2. Ndhimën përfituesit do ta realizojnë që nga data 01.04.2009.

Neni 8

Kjo Rregullore do të ketë karakter të përkohshëm dhe do të zbatohet deri sa statusi i përfituesve të kësaj ndihme nuk rregullohet me ligj.

Neni 9

Për zbatimin e kësaj rregullore do të kujdeset: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie sociale në Gjilan.

KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT

01. nr. 3378
Gjilan, më 30.03.2009


Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

/Bujar NEVZATI/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, gje.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Në bazë të nenit 3 paragrafi 2 të Ligjit për Eksproprijimin dhe nenit 38.1 pika (h) të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në seancën e mbajtur më datë 30.03.2009, miraton këtë:

V E N D I M

Për lejimin e ndërrimit dhe të blerjes të pronës së paluajtshme

I.

Me këtë Vendim, Komunës së Gjilanit i **Lejohet ndërrimi** i kësaj prone të paluajtshme:

a. sipërfaqes prej: **0.66.75** ha, të ngastrës kadastrale nr. 04503-0, parcelë, vendi i quajtur: "Kaljilo", ZK-Koretisht, e evidentuar në Fletë Posedimin nr. 516, në emër të: Pasuri Shoqërore-Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në përpjesëtim me 1:3 (ne favor të Isufi Qamil)

me

b. pjesën e sipërfaqes prej **0.16.53** ha, të ngastrës kadastrale nr. **02291-0**, me kulturë: tokë bujqësore, vendi i quajtur: "Bashte", ZK. Gjilan, e evidentuar në Fletë Posedimin nr. **7784**, në emër të Isuf Qamili:

c. pjesën e sipërfaqes prej 0.07.25 ha, të ngastrës kadastrale nr. **002294-2**, me kulturë: parcel, vendi i quajtur: "Bashqe", ZK. Gjilan, e evidentuar në Fletën Poseduese nr. 313, në emër të Zylfiu Kadri:

d. pjesën e sipërfaqes prej 0.01.03 ha, të ngastrës kadastrale nr. **02290-3**, me kulturë: tokë bujqësore, vendi i quajtur: "Bashte", ZK. Gjilan, e evidentuar në fletën Poseduese nr. 7784, në emër të Isufi Qamil:

e. pjesën e sipërfaqes prej 0.16.53 ha, të ngastrës kadastrale nr. **02290-5**, me kulturë: tokë bujqësore, vendi i quajtur: "Bashte", ZK. Gjilan, e evidentuar në fletën Poseduese nr. 7784 në emër të Isufi Qamil.

II.

Po ashtu me këtë vendim Komunës së Gjilanit i LEJOHET blerja e pronës së paluajtshme në pjesët e mbetura pas ndërrimit, në ngastrat kadastrale nr. 02291-0, 002294-2, 002290-3 dhe 002290-5 nga pronarët si në nenin I, pika b.c.d. dhe e. të këtij vendimi me çmim prej **100 €** për një (1) metër katror, pos sipërfaqes prej 0.10.00 ha të cilën pronari Isufi Qamil e jep falë Kuvendit të Komunës së Gjilanit.

III.

Ndërrimi dhe blerja e paluajtshmërive nga pika I. dhe II. e këtij vendimi, bëhet me qëllim të ndërtimit të infrastrukturës shkollore për nevojat e Arsimit në Komunën e Gjilanit.

III.

Autorizohet Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi, Pronë dhe Banim e KK-ës Gjilan, që në emër të Komunës së Gjilanit, të bëjë nënshkrimin e marrëveshjes për ndërrimin dhe blerjen e paluajtshmërive nga pika I. dhe II. e këtij vendimi dhe të bëjë regjistrimin e pronave të ndërruara dhe të blera në emër të pronarëve të rinj.

IV.

Mbi zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit, Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi, Pronë dhe Banim e KK-ës Gjilan

V.

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT

01.Nr. 3376
Gjilan, më 30.03.2009


Kryesuesi i kuvendit,

/Bujar NEVZATI/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, gje.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Në bazë të nenit 3 paragrafi 2 të Ligjit për Eksproprijimin dhe nenit 38.1 pika (h) të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në seancën e mbajtur më datë 30.03.2009, miraton këtë:

V E N D I M

Për lejimin e ndërrimit dhe blerjes të pronës së paluajtshme

I.

Me këtë Vendim, Komunës së Gjilanit i **Lejohe t ndërrimi** i kësaj prone të paluajtshme:

a. sipërfaqes prej: **0.34.52** ha, të ngastrës kadastrale nr. 02028-2, parcelë, vendi i quajtur: "Rasadnik", ZK-Gjilan e evidentuar në Fletë Posedimin nr. 1750, në emër të: Pasuri Shoqërore-Kuvendi i Komunës së Gjilanit,

me

b. sipërfaqen prej **0.36.43** ha, të ngastrës kadastrale nr. **00729-0**, në sipërfaqe prej gjithsejtë **0.56.03** me kulturë: tokë bujqësore, vendi i quajtur: "Gumno", ZK. Gjilan, e evidentuar në Fletë Posedimin nr. **953**, në emër të Rukovci Arben, me $\frac{1}{4}$ të pjesës së pronës, Cuckiq Bora me $\frac{1}{4}$ e pjesë së pronës dhe Cuckiq Milosav me $\frac{2}{4}$ të pjesës së pronës, që të gjithë nga Gjilani, dhe:

të pjesës së ngastrës kadastrale nr. **00728-1**, me sipërfaqe prej gjithsejtë: **0.53.64** ha, me kulturë: parcel, vendi i quajtur: "Poza Guvno" ZK-Gjilan, e evidentuar në Fletën Poseduese nr. **6074**, në emër të Cuckiq Branko me $\frac{1}{2}$ e pjesës së pronës dhe Cuckiq Rade me $\frac{1}{2}$ të pjesës së pronës, që të dy nga Gjilani.

II.

Po ashtu me këtë vendim Komunës së Gjilanit i **LEJOHET** blerja e pronës së paluajtshme në pjesët e mbetura pas ndërrimit në ngastrat kadastrale nr. 00729-0 dhe 00728-1 nga pronarët si në nenin I, pika b. të këtij vendimi me çmim prej **46 €** për një (1) metër katror.

III.

Ndërrimi dhe blerja e paluajtshmërive nga pika I. dhe II. e këtij vendimi, bëhet me qëllim të ndërtimit të infrastrukturës shkollore për nevojat e Arsimit në Komunën e Gjilanit.

III.

Autorizohet Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi, Pronë dhe Banim e KK-ës Gjilan, që në emër të Komunës së Gjilanit, të bëjë nënshkrimin e marrëveshjes për ndërrimin dhe blerjen e paluajtshmërive nga pika I. dhe II. e këtij vendimi dhe të bëjë regjistrimin e pronave të ndërruara dhe të blera në emër të pronarëve të rij.

IV.

Mbi zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit, Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi, Pronë dhe Banim e KK-ës Gjilan

V.

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT

01.Nr. 3375
Gjilan, më 30.03.2009


Kryesuesi i kuvendit,

/Bujar NEVZATI/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, gje.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u bazuar në nenin 62 të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 30.03.2009, miratoi këtë :

V E N D I M
PËR FORMIMIN DHE PËRBËRJEN E KOMITETEVE TË KUVENDIT TË
KOMUNËS SË GJILANIT

I

Me këtë vendim formohen Komitetet e Kuvendit të Komunës së Gjilanit dhe caktohet përbërja e tyre, dhe atë si vijon:

I

KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA			
	Emri e mbiemri	Ant. i kuvendit	Subjekti politik
1	Bujar Nevzadi	po	PDK
2	Sami Hoxha	po	PDK
3	Arzije Nuhui	po	PDK
4	Ejup Haziri	po	PDK
5	Arben Mehmeti	po	LDK
6	Nehat Ramadani	po	LDK
7	Arben Maliqi	po	AKR
8	Jakup Bajrami	po	LDD
9	Srgjan Jovanović	Zëvendëskryetarë i Komunës -jo	komuniteti serb

II

KOMITETI PËR KOMUNITETE			
	Emri e mbiemri	Ant. i kuvendit	Subjekti politik
1	Makfire Uzunaliq	po	PDK
2	Luljeta Kadriu	po	PDK
3	Rashit Sahiti	jo	LDK
4	Zvonko Spasiq	jo	komuniteti serb
5	Lubisavljeviq Milan	jo	komuniteti serb
6	Kemal Şahin	jo	komuniteti turk
7	Galip Iseni	jo	komuniteti rom

III

KOMITETI PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE			
	Emri e mbiemri	Ant. i kuvendit	Subjekti politik
1	Nusret Hajrullahu	po	PDK
2	Abdylatif Latifi	po	PDK
3	Sami Ahmeti	jo	LDK
4	Nazim Hajdari	jo	LDK
5	Besim Guda	po	LDD

6	Ilaz Poroshtica	po	AKR
7	Xhevat Demiri	jo	AAK

IV

KOMITETI PËR ARSIM DHE KULTURË			
	Emri e mbiemri	Ant. i kuvendit	Subjekti politik
1	Shukruje Rapuca	po	PDK
2	Shkëlqim Latifi	po	PDK
3	Agim Rexhepi	po	LDK
4	Tylaj Hasani	jo	LDD
5	Nazif Sylejmani	po	AKR
6	Fadil Gashi	po	AAK
7	Halim Vranovci	jo	ORA

V

KOMITETI PËR PLANIFIKIM DHE URBANIZËM			
	Emri e mbiemri	Ant. i kuvendit	Subjekti politik
1	Shefik Selimi	po	PDK
2	Bajram Shaqiri	po	PDK
3	Murat Hoxha	jo	LDK
4	Bekim Isaku	po	LDK
5	Samir Ramadani	jo	LDD
6	Xhafer Xhelili	jo	AKR
7		jo	

VI

KOMITETI PËR ZHVILLIM EKONOMIK			
	Emri e mbiemri	Ant. i kuvendit	Subjekti politik
1	Shemsedin Qerimi	jo	PDK
2	Refik Kryeziu	jo	PDK
3	Bashkim Shala	jo	PDK
4	Musa Shkodra	po	LDK
5	Xhalal Selmani	jo	LDK
6	Zijadin Maliqi	jo	LDD
7	Blerton Ajeti	jo	AKR

VII

KOMITETI PËR SHËRBIME PUBLIKE DHE EMERGJENCË CIVILE			
	Emri e mbiemri	Ant. i kuvendit	Subjekti politik
1	Rozelita Hasani	po	PDK
2	Mirvete Kurteshi	po	PDK
3	Adnan Hoxha	jo	PDK
4	Burhan Selmani	jo	PDK
5	Linda Kallaba	po	LDK
6	Bujar Shkodra	po	AKR
7	Abdyl Kadriu	jo	LDD

VIII

KOMITETI PËR RINI,SPORT DHE ÇËSHTJE GJINORE			
	Emri e mbiemri	Ant. i kuvendit	Subjekti politik
1	Nushe Hamdiu	po	PDK
2	Ilir Tahiri	po	PDK
3	Arta Rexhepi-Berisha	po	LDK

4	Afërdita Balaj	jo	LDK
5	Saranda Bllaca	po	LDD
6	Mimoza Shkodra	po	AKR
7	Mimoza Kadriu	po	AAK

IX

KOMITETI PËR PRONË , BANIM DHE RINDËRTIM			
	Emri e mbiemri	Ant. i kuvendit	Subjekti politik
1	Ali Arifi	po	PDK
2	Shedik Surdulli	jo	PDK
3	Ramadan Ajvazi	jo	LDK
4	Mirsad Rexhepi	jo	LDK
5	Isa Bunjaku	po	LDD
6	Izeir Zeqiri	jo	AKR
7	Fatmir Redenica	jo	AKR

II

Komitetet nga pika I e këtij vendimi duhet të kenë përfaqësim gjinor dhe të pasqyrojnë në mënyrë sa më të përafërt proporcionin e vendeve që mbajnë partitë politike dhe koalicionet në Kuvendin Komunal.

III

Komitete e formuara si në pikën I të këtij vendimi zgjedhin kryesuesin dhe zëvendëskryesuesin nga anëtarët dhe prej anëtarëve të vet, përderisa Komitetin për Politikë dhe Financa e kryeson kryesuesi i Kuvendit, e në mungesë të tij, njëri nga anëtarët e Komitetit.

IV

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit, dhe Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Gjilanit.

V

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, pushon të vlej Vendimi për formimin dhe përbërjen e Komiteteve të Kuvendit të Komunës së Gjilanit, nr. 01.1098/0101 i datës 12.02.2008, Vendimi për formimin dhe përbërjen e Komitetit për zhvillim ekonomik, Komitetit për shërbime publike dhe emergjencë civile dhe Komitetit për rini, sport dhe çështje gjinore, 01. nr.5478 i datës 05.06.2008, si dhe Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit për formimin dhe përbërjen e Komiteteve të Kuvendit të Komunës së Gjilanit, 01.nr. 12478 i datës 21.11.2008.

VI

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

01.Nr. 3432
Gjilan, më 30.03..2009


Kryesuesi i Kuvendit,

/Bujar NEVZATI/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, gje.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Në bazë të nenit 17 pika j) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 të datës 4 qershor 2008), nenit 50.1 dhe 50.3 të Ligjit nr. 2004/4 për Shëndetësi dhe me propozim të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Gjilan, Kuvendit i Komunës së Gjilanit në mbledhjen me **29.04.2009**, aprovon:

S T A T U T I N **E QENDRËS KRYESORE TË MJEKËSISË FAMILJARE NË GJILAN**

I. Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Me këtë Statut rregullohet organizimi, mënyra e udhëheqjes dhe e vendosjes, çështjet tjera lidhur me zbatimin e kujdesit parësor shëndetësor dhe punët e afarizmit në pajtim me ligjin në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare si institucion shëndetësor publik i kujdesit primar shëndetësor (në tekstin e mëtejme: QKMF).

Neni 2

2.1. Themelues i QKMF në pajtim me ligjin dhe aktet tjera nënligjore është Kuvendi i Komunës së Gjilanit (në tekstin e mëtejme: Themeluesi).

2.2. Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare ka statusin e personit juridik e cila mund të paditet dhe të padisë, të posedojë dhe të menaxhojë pasurinë dhe përcakton kushtet e menaxhimit dhe shfrytëzimit të saj, të lidhë kontrata, të punësojë stafin dhe të angazhohet në aktivitete të tjera që janë të domosdoshme për realizimin e përgjegjësisë së sajë nëse nuk është e rregulluar ndryshe me ligj.

Neni 3

QKMF është trashëgimtare e shtëpisë së shëndetit.

II. Emri, Selia dhe vula e QKMF

Neni 4

4.1. QKMF është institucion shëndetësor publik e cila ushtron veprimtari shëndetësore e cila punon dhe paraqitet në qarkullimin juridik me emrin: Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare" shkurtesa (QKMF).

4.2. Emri i QKMF duhet të vihet në objektin shëndetësor në të cilin është selia e saj përkatësisht në të cilën ushtron veprimtarinë dhe në objekte tjera shëndetësore të cilat janë nën mbikëqyrjen e saj.

Neni 5

Selia e QKMF është në Gjilan, rruga "Brigadat e UÇK-së" p. n.

Neni 6

6.1. QKMF, Qendrat e mjekësisë familjare dhe nën-qendrat të cilat janë nën përgjegjësinë e saj kanë vulën e formës së rrumbullakët dhe katrore.

6.2. Teksti i vulave duhet të jetë në gjuhën shqipe serbe dhe turke.

6.3. Çdo vulë identifikohet me emrin e Institucionit në kuadër të KPSH.

6.4. Përmasat, përmbajtja e tekstit dhe mënyra e mbajtjes dhe udhëheqjes së vulave, do të përcaktohet me vendim të veçantë të drejtorit të QKMF në pajtim me ligjin.

III. Veprimtaria dhe shërbimet QKMF

Neni 7

7.1. QKMF ushtron veprimtari shëndetësore në nivelin parësor shëndetësor në pajtim me ligjin duke bërë sigurimin e ofrimit të kujdesit parësor shëndetësor si dhe përcjelljen e gjendjes shëndetësore të qytetarëve në territorin e tyre duke u bazuar në konceptin e mjekësisë familjare.

7.2. Kujdesi parësor shëndetësor zbatohet përmes shërbimeve të mjekësisë familjare ku përfshinë:

- a) Përparimin, parandalimin, mjekimin, shërimin dhe rehabilitimin që kanë të bëjnë me sëmundjet, çrregullimet dhe me lëndimet;
- b) Edukimin shëndetësor, imunizimin dhe vaksinimin;
- c) Përcaktimin e diagnozës fillestare dhe kujdesin elementar shëndetësor përfshirë edhe ndërhyrjet e vogla kirurgjike;
- d) Promovimin e shëndetit oral dhe kujdesin themelor stomatologjik;
- e) Kujdesin për shëndetin mendor të bazuar në bashkësi;
- f) Rehabilitimin e bazuar në bashkësi;
- g) Zbulimi i hershëm i sëmundjeve ngjitëse;
- h) Kryen shërbime specialistike dhe diagnostiko – analiza laboratorike dhe rentgenologjike në kuadër të kujdesit parësor shëndetësor.
- i) Kujdesin shëndetësor riprodhues që përfshinë kujdesin shëndetësor gjatë shtatëzanisë, lindjes, dhe lehonave si dhe metodat e planifikimit të familjes dhe
- j) Ofron shërbime tjera të cilat mundë të barten në QKMF në pajtim me ligjin.

7.3. Kujdesi shëndetësor në QKMF sigurohet gjatë 24 orëve, pa ndërprerje duke organizuar punë në ndërrime dhe në sistemin e kujdestarisë.

Neni 8

8.1. Kujdesi shëndetësor në QKMF zbatohet nga profesionistët në pajtim me ligjin i përbërë:

- a) specialisti i mjekësisë familjare;
- b) në mungesë të specialistit të MF-së, specializanti në MF ose doktori i mjekësisë;
- c) doktor **dhe specialist** i stomatologjisë;
- d) Infermierët familjarë;
- e) teknikët mjekësor në pajtim me neni 9 pika h) të këtij statuti dhe në pajtim me ligjin.

8.2. Punëtorët në kujdesin parësor shëndetësor bashkëpunojnë me punëtorët shëndetësorë në nivelin dytësor dhe tretë të kujdesit shëndetësor në mënyrë të përcaktuar me akt të veçantë nën-ligjor.

8.3. Standardet e organizimit dhe të funksionimit të shërbimit të mjekësisë familjare në komuna përcaktohen me akt nën-ligjorë të nxjerrë nga Ministria e Shëndetësisë.

8.4. Specialistët konsultues ekzistues, dhe atë: Specialist i sëmundjeve të brendshme; specialistë i mjekësisë së punës, do tu jepet mundësia të ndjekin Modulin orientues të mjekësisë familjare. Pas kësaj ata do të mund të përfundojë karrierën në ekipet e mjekësisë familjare.

Neni 9

9.1 Kujdesi parësor shëndetësor sigurohet dhe zbatohet nga ekipi i mjekësisë familjare i përbërë nga punëtorët shëndetësorë si vijon:

- a) doktori i mjekësisë;
- b) doktor **dhe specialist** i stomatologjisë;
- c) specialisti i mjekësisë familjare;
- d) magjistri i farmacisë;
- e) pediatri;
- f) gjinekologu-obstetër;
- g) specialisti i biokimisë klinike;
- h) infermierët, mamitë si dhe fizioterapeutët dhe teknikët mjekësor nga neni 86 i ligjit.

9.2. Kujdesi parësor shëndetësor në pajtim me ligjin zbatohet duke u udhëhequr nga parimet vijuese:

- a) Barazia;
- b) Cilësia;
- c) Ndershmëria dhe përgjegjësia;
- d) Gjithë përfshirja dhe jo diskriminimi;
- e) Financimi i qëndrueshëm;
- f) Financimi kosto-efektiv dhe
- g) Bashkëfinancimi.

Neni 10

10.1. Përpos ushtrimit të veprimtarive sipas nenit 7 të këtij statuti, QKMF kryen edhe punë profesionale administrative shërbyese dhe ndihmëse në pajtim me ligjin.

10.2. QKMF mundet të zgjeroi ose ndryshoi veprimtarinë në mënyrën e përcaktuar me ligj, për të cilën vendimin e merr themeluesi sipas propozimit të QKMF.

IV. Menaxhimi, prezantimi dhe përfaqësimi

Neni 11

11.1. QKMF menaxhohet, prezantohet dhe përfaqësohet nga drejtori, në kuadër të autorizimeve të përcaktuara me ligj, me këtë statut dhe aktet tjera të përgjithshme të QKMF.

11.2. Asnjë kontratë me të cilin fitohen, tjetërsohen apo shiten objektet dhe pajisjet (kapitale) të QKMF nuk është ligjshme në rast se nuk është miratuar nga themeluesi.

Neni 12

12.1. Drejtori i QKMF në kuadër të kompetencave të tija, mund ti jep personit tjetër autorizim me shkrim për përfaqësim të QKMF me njoftim paraprak të themeluesit.

12.2. Autorizimi përmban: të drejtën për të lidhë kontrata dhe për ta përfaqësuar QKMF para ligjit dhe për të vepruar në emër të saj lidhur me veprimtarinë e QKMF.

12.3. Asnjë punë juridike që është lidhur sipas autorimit nuk do të prodhoi efekt juridik në rast se është dëmtuar imazhi i QKMF dhe interesi publik.

V. Organizmi i brendshëm

Neni 13

QKMF për t'a realizuar funksionin e mbrojtjes shëndetësore për qytetarët e vetë është e organizuar nëpërmjet:

A. Departamentit të Mjekësisë familjare ku përbëhet:

1. Sektorit të Mjekësisë Familjare,
2. Njësia e SISH.
3. Njësia e Imunizimit dhe Vaksinit,
4. Sektori i Kujdesit Emergjent,
5. Sektorit Konsultativ përfshinë:
 - a. Pediatrin;
 - b. Gjinekologun dhe
 - c. Mjekët ekzistues të lëmenjve tjerë në pajtim me ligjin.
6. Sektori i Diagnostikues ku përfshinë:
 - a. Kabinetin Radiologjik dhe
 - b. Laboratorin

B. Shërbimi stomatologjik

1. Shërbimi preventiv,
2. Shërbimi i protetikës
3. Teknika e dhëmbëve
4. Shërbimi i kirurgjisë orale
5. Shërbimi i ortodontisë
6. Shërbimi sëmundjeve të gojës dhe dhëmbëve

C. Barnatorja qendrore, si njësi organizative e QKMF mund të themelohet dhe të funksionon sipas ligjit që rregullon aktivitetin farmaceutik. Në BQ mund të shpërndahen vetëm barnat nga lista esenciale e barërave e lejuar nga ministria dhe të përshkruara në receta unike nga mjekët e njësisë së mjekësisë familjare. Çdo tregtim me barna komerciale në barnatore brenda QKMF është e ndaluar dhe sanksionohet sipas ligjit. Me punën Barnatores Qendrore udhëheq Shefi.

D. Për të përmbushur obligimet që dalin nga Neni 27.4 të Ligjit për Shëndetësi në QKMF në Gjilan funksionon edhe Qendra e Trajnimit të Mjekësisë Familjare (QTMF) (8 QKMF) si Njësi e Qendrës së Zhvillimit të Mjekësisë Familjare (QZHMF) ku mbahet trajnimi i Mjekëve dhe Infermierëve, në programet e Mjekësisë/Infermierisë Familjare.

E. Në kuadër të QKMF administrata përfshinë:

- a. Zyrën për punë të përgjithshme juridike dhe personel;
- b. Zyra për Buxhet dhe Financa dhe
- c. Zyra për shërbime teknike.

Neni 14

14.1. Me propozim të QKMF dhe me pëlqim të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Çështje Sociale, mund të themelohen Qendra shëndetësore familjare dhe nën-qendra për bashkësitë e largëta dhe bashkësitë që kanë arritshmërinë të dobët sipas UA 16/2000.

14.2. Vendimi sipas paragrafit 14.1 të këtij neni e merr themeluesi.

Neni 15

Pjesë e këtij statuti do të jetë edhe lista e qendrave dhe nën-qendrave të cilat përbëjnë rrjetin shëndetësor familjar në territorin e komunës së Gjilanit të cilat qendra ose nën – qendra mund të fuzionohen ose zgjerohen vetëm me pëlqim të themeluesit.

Neni 16

Të gjitha shërbimet elementare shëndetësore që kryhen nëpërmjet rrjetit të qendrave shëndetësore familjare dhe nën-qendrave të tyre janë të përcaktuara me ligj dhe me udhëzime përkatëse të lëshuara nga ministria përkatëse.

Sistemi i Informimit shëndetësor në QKMF

Neni 17

17.1. QKMF në Gjilan, zbaton sistem unik të informimit shëndetësor në pajtim me ligjin dhe aktet nënligjore.

17.2. Drejtoria për Shëndetësi dhe çështje sociale dhe QKMF në Gjilan në bashkëpunim me Ministrinë do të zhvillojnë sistemin unik të kodeve për QKMF dhe departamentet e saja.

17.3. Në QKMF sistemin e informimit e përbëjnë:

- a) Sistemi i evidencave me të cilat rregullohen evidentimi i të dhënave,
- b) Sistemi me të cilën rregullohet dërgimi, gjegjësisht grumbullimi i të dhënave përpunimi dhe publikimi i tyre.

17.4. QKMF bënë mbledhjen, evidentimin vendosjen e të dhënave statistikore në sistemin e informimit (SISH) në programin kompjuterik të ministrisë i cili përmban të dhënat e nevojshme për shfrytëzimin e shërbimeve shëndetësore.

17.5. QKMF pas mbledhjes, evidentimit dhe vendosjes së të dhënave statistikore, është e obliguar që përmes raporteve të caktuara periodike dhe në formular të përcaktuar nga ministria ti dërgojë ato në Drejtorinë për shëndetësi dhe çështje sociale në komunë dhe në ministri në departamentin e shëndetësisë publike përkatës.

17.6. Çdo profesionist gjatë raportimit duhet të ruajë fshehtësinë profesionale, duke mos cenuar të drejtat e pacientit përveç rasteve të rregulluara me ligj.

VI. Organet e QKMF

Neni 18

18.1. Organet e QKMF janë:

- 1. Drejtori dhe
- 2. Këshilli mbikëqyrës

Drejtori

Neni 19

19.1. QKMF e udhëheq Drejtori.

19.2. Drejtorin e QKMF e zgjedh dhe e shkarkon Drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale të deleguar nga Kuvendi i Komunës në pajtim me ligjin mbi Shërbimin Civil të Kosovës, akteve nënligjore dhe dispozitave të parapara me këtë Statut.

19.3. Një person për tu zgjedh drejtor i QKMF duhet plotësuar kushtet e përgjithshme të punësimit në Shërbimin civil dhe atë:

- a) Të ketë kualifikimin për mjek specialist nga mjekësia familjare;
- b) Preferohet 5 vite përvojë pune në shëndetësi;

- c) përparësi do ti jepet kandidatëve me përvojë në menaxhimin modern në pajtim me nenin 9.1 të këtij statuti,
- d) Të ketë njohuri në menaxhimin shëndetësor dhe Shëndetësi Publike dhe
- e) Profesionist tjerë me kualifikim superior.

19.4. QKMF duhet të ketë edhe postin e zëvendës drejtorit. Procedura e zgjedhjes së zëvendës drejtorit të QKMF dhe kushtet janë të njëjta si për drejtor të parapara me paragrafin 19.3 të këtij neni.

Neni 20

20.1. Në pajtim me nenin 19.1. të këtij statuti Vendimin për shpalljen e konkursit dhe udhëheqjen e procedurave për Drejtor të QKMF i merr DSHMS.

Neni 21

21.1. Drejtori i QKMF është përgjegjës për të siguruar ligjshmërinë në punë dhe afarizmin e QKMF, si dhe për punën profesionale të QKMF, e cila duhet të organizohet dhe udhëhiqet në pajtim me dispozitat e këtij Statuti dhe akteve tjera ligjore.

21.2. Drejtori i QKMF është përgjegjës për përkujdesjen efektive të shëndetësisë primare në sektorin publik, për të gjithë banoret e Komunës së Gjilanit dhe përgjigjet për detyrat që vijnë:

- a) Në pajtim me Politikën Shëndetësore, Ligjin për Shëndetësi të Kosovës dhe Strategjinë e Kujdesit Parësor Shëndetësor, Drejtori i QKMF i propozon për miratim Drejtorisë Komunale për Shëndetësi Planin e Punës dhe Buxhetin e QKMF për vitin vijues.
- b) Drejtori është përgjegjës për implementimin e planit të burimeve njerëzore;
- c) Nën mbikëqyrjen dhe autorizimin e Drejtorit të DSHMS zbaton buxhetin e QKMF;
- d) Të jetë përgjegjës për udhëheqjen e përditshme të procesit të punës në QKMF;
- e) Të mundësojë zhvillimin e vazhdueshëm profesional dhe trajnimin e personelit të QKMF;
- f) Të vendos mekanizma të sigurimit të cilësisë në objektet e KPSH të Komunës në harmoni me DSHMS;
- g) Të jap kontribut për zhvillimin e sistemit të informimit shëndetësor të QKMF sipas standardeve të pranuar dhe të sigurojë mbledhjen e informatave.
- h) Ta avancojë punën ekipore.

21.3. Drejtori i QKMF përpos përgjegjësisë të parapara me paragrafin 21.2 të këtij neni kryen këto punë dhe vendos për:

1. Zbaton politikën punuese të QKMF,
2. Propozon ndryshimet e statutit të QKMF,
3. Përgatitë dhe dorëzon raportin e punës dhe llogaritë vjetore të QKMF dhe i raporton DSHMS dhe autoriteteve tjera në pajtim me ligjin,
4. Vendos për shfrytëzimin e mjeteve në kuadër të ligjit,
5. Harton programin e punës dhe planin financiar,
6. Miraton rregulloret e përgjithshme dhe akte tjera në përputhshmëri me ligjin dhe këtë Statut,
7. Përpilon planin e burimeve njerëzore sipas propozimit të Këshillit Profesional, brenda resurseve të disponueshme dhe në përputhje me politikat e DSHMS MSH,
8. Propozon çmimet e shërbimeve shëndetësore të cilat i ofron QKMF e të cilat nuk janë të përcaktuara nga ana e MSH me akte nënligjore (udhëzime) dhe të cilat duhet të miratohen nga Kuvendi i Komunës.

9. Propozon planin mbi Zhvillimin e Vazhdueshëm Profesional të kuadrit medicinal dhe bashkëpunëtorëve shëndetësor dhe siguron aplikimin e tij në bashkëpunim me DSHMS.
10. Miraton planin dhe programin e masave për mbrojtje në punë në harmoni me ligjin;
11. Emëron komisione të përkohshme dhe këshilla tjera punuese që janë me interes për QKMF.

21.4. Programi i punës së QKMF realizohet duke u bazuar në politikat zhvillimore të sistemit shëndetësor të nxjerra nga Ministria

21.5. Në programin vjetor të punës duhet të përcaktohen:

- a. Masat, aktivitetet, dhe rezultatet e pritura të kujdesit shëndetësor në QKMF;
- b. Plani vjetor i punës;
- c. Organizimi dhe udhëheqja;
- d. Burimet njerëzore;
- e. Plani financiar;
- f. Raportet mujore, vjetore të punës dhe raportet financiare

21.6. Për kryerjen e punëve të tij drejtori i QKMF i përgjigjet Drejtorit DSHMS.

21.7. Procedurën për ndërmarrjen masave, siç janë vërejtja verbale, vërejtja me shkrim, apo masa tjera administrative ndaj Drejtorit të QKMF mund t'i inicion apo ndërmerr, Këshilli Mbikëqyrës, Kuvendi komunal përmes DSHMS ose MSH, (Neni 18.2 të Ligjit për Shëndetësisë) ndërsa procedurën për shkarkimin e Drejtorit të QKMF mund ta ndërmerr DSHMS, kur konstatohet shkelja e procedurave në dhënien e kujdesit shëndetësor sipas Ligjit të Shëndetësisë dhe akteve tjera ligjore.

Neni 22

22.1. Drejtori i QKMF mban konsultime të përhershme ose takime në formë të kolegjiut me shefat e departamenteve ose të sektorëve në kuadër të QKMF.

22.2. Drejtori ka për detyrë që gjatë ushtrimit të përgjegjësisë të tija të kujdeset që të gjitha aktet e propozuara të jenë në pajtim me ligjin.

22.3. Drejtori është përgjegjës për afarizmin dhe punën profesionale të QKMF në pajtim me ligjin, aktet nënligjore dhe këtë statut.

Këshilli mbikëqyrës

Neni 23

23.1. Këshilli është organ mbikëqyrës i QKMF i paraparë me ligj. Vendimin për themelimin e tij e merr themeluesi.

23.2. Anëtarët e KM të Institucionit shëndetësor të kujdesit parësor shëndetësor (QKMF) i propozon DSHMS kurse emërohen nga themeluesi.

23.3. KM përbëhet prej pesë (5) anëtarëve:

1. Përfaqësuesi i DSHMS, kryesues
2. Përfaqësuesi i Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale,
3. Drejtori i QKMF,
4. Një përfaqësuesi i sindikatës së pavarur të punëtorëve shëndetësor dhe
5. Një përfaqësues nga pakicat.

23.4. Mandati i anëtarëve të këshillit do të jetë dy (2) vite me mundësi të riemërimit edhe për një mandat tjetër dy (2) vjeçar.

23.5. Detyrat e KM është që të bëjë mbikëqyrjen e QKMF përmes:

1. Mbikëqyrjes së përmbushjes së funksioneve të veta në përputhje me politikën shëndetësore të Kosovës, strategjisë zhvillimore të sistemit shëndetësor dhe dokumenteve tjera juridike relevante për veprimtarinë e të nxjerra nga institucionet kompetente të Kosovës,
2. Të pranojë dhe vlerësojë planin e punës së QKMF,
3. Të pranojë dhe vlerësojë raportet periodike të punës së QKMF,
4. Të bëjë vlerësimin e përmbushjes së objektivave të QKMF,
5. I rekomandon themeluesit të QKMF për masat që duhet të ndërmerren në përmirësimin e funksioneve të QKMF,
6. Përgatitë raportet periodike tremujoresh për themelimin e QKMF,
7. Kryen detyra shtesë në sferën e mbikëqyrjes që mund ti jepet KM nga themeluesi me propozimi të DSHMS dhe QKMFS dhe me anë të ligjit.

23.6. Drejtori i QKMF në KM ka rolin e sekretarit i cili ofron ndihmë dhe lehtësia për takimet e KM.

23.7. DSHMS duhet të kujdeset që të sigurojë zbatimin e veprimit të KM në Institucionin Shëndetësor të Kujdesit parësor (QKMF).

Roli në mes DSHMS dhe Institucionit të KPSH

Neni 24

24.1. DSHMS ka përgjegjësi që brenda synimeve të politikës shëndetësore të sigurojë ofrimin e shërbimeve shëndetësore kualitative popullatës së saj, në mënyrë të drejtë dhe të barabartë dhe jo diskriminuese dhe të sigurojë zbatimin e kujdesit shëndetësor duke dhënë përparësi zbatimit të masave parandaluese nëpërmjet zbatimit të konceptit të mjekësisë familjare në pajtim me ligjin.

24.2. DSHMS është përgjegjës për:

1. Vlerësimin e nevojave lokale lidhur me kujdesin parësor shëndetësor;
2. Vendosjen e objektivave lokale për KPSH;
3. Të zhvillon buxhetin bazuar në nevojat lokale duke ju përmbajtur udhëzimeve përkatëse nga MEF dhe MSH;
4. Apropojë buxhetin dhe zbatoj buxhetin;
5. të monitorojë procedurat e rekrutimit për stafin civil të QKMF;
6. Të vendos dhe mbledhë bashkë-pagesat brenda kornizës së caktuar nga MESH;
7. Siguron ofrimin e shërbimeve shëndetësore;
8. Raporton mbi të arriturat objektive të përcaktuara nga KK, dhe MSH;
9. Mbikëqyrë situatën epidemiologjike në nivel të komunës;
10. Zbaton normat dhe standardet e infrastrukturës, resurseve humane të aprovuara nga MSH;
11. Shërbehet me informatat për të përcaktuara prioritetet lokale dhe objektivat konform strategjisë shëndetësore;
12. Shërbehet me të dhënat e nivelit të qarkut dhe të Kosovës për të analizuar kualitetin e shërbimeve për përdorimin efektiv të resurseve;
13. Ndërmerr masat mbrojtëse lidhur me sigurimin e ujit të sigurt dhe higjienës, ushqimit të sigurt dhe nutricionit dhe
14. Ndërmerr aktivitetin në dezinfektimin, dezisektimin dhe deratizimin.

Trupat profesionale të QKMF

Neni 25

25.1. Për përmbushjen e detyrave të veçanta, Drejtori mund të formojë trupa profesionale në kuadër të QKMF, siç janë:

- a) Këshilli profesional,
- b) Kolegji profesional;
- c) Komisionin për rekrutim të punëtorëve shëndetësor dhe administrativ,
- d) Komisioni disiplinor i QKMF;
- e) Komiteti për Sigurimin e Cilësisë së shërbimeve;
- f) Komiteti për Zhvillim të Vazhdueshëm Profesional dhe
- g) Komisioni Etiko -Profesional, etj.

25.2. Anëtarët e trupave profesionale emërohen nga Drejtori duke u konsultuar me DSHMS.

25.3. Drejtorit i QKMF sipas nevojës mund të formojë edhe trupa tjerë profesionale në kuadër të QKMF.

Këshilli profesional

Neni 26

26.1. Këshilli profesional është trup këshillëdhënës për drejtorin e QKMF. Këshilli profesional përbëhet nga Kryeshefat e Departamenteve, Shefat e Sektorëve, Barnatores, QMF-ve dhe Kryeinfermierit/ja e QKMF.

26.2. Kryesuesi i këshillit profesional sipas detyrës zyrtare është Kryeshefi i Departamentit të Mjekësisë Familjare i QKMF.

26.3. Këshilli profesional e bien rregulloren për punën e Këshillit.

26.4. Kryesuesi Këshillit Profesional i kryen këto punë:

- 1. Përgatitë, thërret dhe udhëheq mbledhjet e Këshillit Profesional;
- 2. E verifikon rendin e ditës së mbledhjeve dhe
- 3. Siguron mbajtjen e procesverbalit të mbledhjes.

26.5. Kryetari i Këshillit profesional është i obliguar ta thërras mbledhjen brenda 3 (tre) dite pasi të ketë kërkuar Drejtori i QKMF.

Neni 27

Këshilli profesional i QKMF përveç detyrave të parapara me ligj i kryen edhe këto detyra:

- a) Diskuton dhe vendos për nevojën dhe arsyet profesionale të implementimit të metodave dhe procedurave të reja diagnostifikuese dhe terapeutike,
- b) Propozon Drejtorit marrjen e masave profesionale për përmirësimin e organizimit të punës dhe kushteve për zhvillimin e veprimtarisë,
- c) Propozon strukturën e mbikëqyrjes së brendshme lidhur me punën e punëtorëve shëndetësor si dhe masat për përmirësimin e punës profesionale,
- d) Shqyrton nevojën për zhvillim të vazhdueshëm profesional dhe propozon drejtorit dërgimin e punëtorëve shëndetësor në përsosje profesionale dhe shkencore,
- e) Shqyrton dhe vendos lidhur me çështjet tjera të cilat drejtori ia parashtrohet Këshillit Profesional.

Kolegji profesional

Neni 28

28.1. Me qëllim të shqyrtimit të çështjeve në lëmin e punës profesionale në çdo Sektor themelohet komisioni profesional.

28.2. Kolegjin profesional e përbëjnë: Shefi i Sektorit, Kryeinfermieri/ja e Sektorit dhe punëtorët profesional të atij Sektori.

28.3 Kolegji profesional i kryen këto punë:

- a) Shqyrton çështjet lidhur me udhëheqjen e punës profesionale në Sektor/njësi, merr qëndrim dhe propozim lidhur me zgjidhjen e këtyre çështjeve,
- b) Shqyrton, dhe përmes shefit të Sektorit i propozon Këshillit Profesional, për nevojën dhe arsyeshmërinë profesionale të implementimit të metodave të reja diagnostifikuese dhe terapeutike,
- c) Përmes shefit të Sektorit, propozon Këshillit Profesional dhe Drejtorit marrjen e masave profesionale për përmirësimin e organizimit të punës dhe kushteve për zhvillimin e veprimtarisë.

28.4. Udhëheqësi i Sektorit sipas nenit 11 të këtij Statuti është edhe kryetar i kolegjit Profesional dhe i përgjigjet Kryeshefit të Departamentit të mjekësisë familjare sipas këtij Statuti.

Këshilli etik

Neni 29

29.1. Këshilli etik është trup i cili siguron kryerjen e veprimtarisë së QKMF mbi bazat e etikës dhe deontologjisë.

29.2. Anëtarët e këshillit etik i emëron Drejtori.

29.3. Këshilli etik përbëhet nga 5 anëtar:

1. Katër përfaqësues të QKMF (3 nga profesioni mjekësor dhe një nga profesioni jo mjekësor);
2. Një person i cili është i profesionit jo mjekësor nga Shoqëria Civile, i/e cili/a është individ i/e spikatur për punën shkencore ose shoqërore;
3. 1/3 e anëtarëve të Këshillit etik duhet të jenë të gjinisë së kundërt.

Neni 30

30.1. Këshilli etik i QKMF i kryen këto punë:

1. Përcjell zbatimin e veprimtarive etike dhe deontologjik në lëmin e shëndetësisë gjatë ushtrimit të veprimtarisë në QKMF.
2. Miraton kërkime shkencore në QKMF sipas dispozitave Ligjore që rregullojnë këtë lëmi.
3. Shqyrton dhe çështje të tjera etike lidhur me veprimtarinë e QKMF.

30.2. Këshilli etik bien rregulloren e punës të Këshillit.

30.3. Detyrat dhe përgjegjësitë e trupave tjera përcaktohen me akte nënligjore të nxjerra nga Drejtorit i QKMF, nëse ato nuk janë të përcaktuara me akte të tjera nga Ministria e Shëndetësisë.

Neni 31

31.1. Në QKMF mund të organizohet Organizata sindikale ku punëtorët me anëtarësimin e tyre vullnetar do t'i realizojnë të drejtat dhe interesat e veta të garantuara me konventat ndërkombëtare të punës.

31.2. Në rast greve të punëtorëve, në QKMF duhet të sigurohet minimumi i kryerjes së detyrave të punës apo shërbimeve.

VII Zhvillimi i vazhdueshëm profesional

Neni 32

32.1. Në kuadër të QKMF organizohet Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional i të gjithë punëtorëve shëndetësor, bazuar në dispozitat e Ligjit për shëndetësi dhe akteve tjera nën ligjorë që rregullojnë këtë lëmi.

32.2. Aktivitetet e Zhvillimit të Vazhdueshëm Profesional (ZHVP), të Edukimit Specialistik Pasdiplomik (ESP) dhe atij të Edukimit Themelor (ETH), për punëtorët shëndetësor në KPSH, mbahen në QZHMF, Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, Qendrën për Edukim të Vazhdueshëm Infermierik, Qendrën e Trajnimit të Mjekësisë Familjare dhe Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës.

32.3. Për mbajtjen e aktiviteteve nga neni 32.2 përgjegjës janë Koordinatorët dhe trajnuesit në programet e Mjekësisë Familjare dhe të Infermierisë Familjare të përcaktuar nga Qendra e Zhvillimit të Mjekësisë Familjare dhe Qendra për Edukim të Vazhdueshëm Infermierik pranë Ministrisë së Shëndetësisë në bashkëpunim me QKMF, të cilët kanë përgatitje adekuate akademike dhe profesionale.

32.4. Ministria bazuar në Udhëzimet administrative përkatëse, me propozim të Komiteteve specialistike të lëmenjve përkatëse emërton Mentorët klinik për Specializantët e Mjekësisë Familjare.

32.5. Titujt profesional dhe akademik do të njihen me sistematizimin e vendeve të punës në QKMF, dhe njëherësh do të gradohen sipas ligjeve dhe rregulloreve që rregullojnë këtë lëmi.

32.6. Financimi i ZHVP të punëtorëve bëhet nga buxheti i QKMF dhe burime tjera në disponim.

VIII. Mbikëqyrja e QKMF dhe inspektimi

Neni 33

33.1. QKMF i nënshtrohet mbikëqyrjes ligjore dhe profesionale që sigurohet nga DSHMS dhe nga Ministria e Shëndetësisë në pajtim me ligjin.

33.2. Mbikëqyrja dhe monitorimi i QKMF përfshinë;

- Mbikëqyrjen dhe inspektimin e objekteve të shëndetit parësor lidhur me infrastrukturën dhe menaxhimin e objekteve,
- Mbikëqyrjen dhe inspektimin e ofrimit cilësisë së shërbimeve shëndetësore sipas normave dhe standardeve të përcaktuara nga Ministria,
- Mbikëqyrjen dhe monitorimin e raporteve, dhe procedurave financiare lidhur me zbatimin e ligjit mbi financat publike dhe rregullat e Prokurimit Publik.

33.3. Në rast se hasen vështirësi në realizimin e detyrave të QKMF, Ligjit për Shëndetësi si dhe detyrave dhe obligimeve që përcaktohen me këtë Statut, DSHMS do të ndërmarrë masat për eliminimin e tyre, e nëse edhe kjo drejtori nuk mund të sanojë situatën në afat prej 4 jave nga vërejtjet e bëra nga Ministrisë e Shëndetësisë, atëherë Ministria e Shëndetësisë do të ndërmerr masat e duhura administrative për eliminimin e parregullsive në bazë të Ligjit për Shëndetësi.

33.4. Drejtori i QKMF ka për obligim që të lejoj çfarëdo mbikëqyrje si nga brenda dhe nga jashtë nga organet e autorizuar me ligj, duke ofruar bashkëpunim dhe transparencë të plotë.

IX Aktet e përgjithshme

Neni 34

34.1. Aktet e përgjithshme të QKMF janë: Statuti, Urdhëresat Administrative, rregulloret e punës dhe vendimet përmes të cilave rregullohen çështjet nga veprimtaria e QKMF.

34.2. Statuti si akt më i lartë juridik nënligjor i QKMF miratohet nga ana e themeluesit me shumicë të votave të anëtarëve që marrin pjesë në votim nëse ndryshe nuk është përcaktuar me ligj.

34.3. QKMF duhet ti ketë këto akte;

1. Rregulloren mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës;
2. Rregulloren për punë;
3. Rregulloren për gradim, pagesa dhe të drejta tjera materiale të punëtorëve nëse me akte tjera nuk është rregulluar ndryshe;
4. Rregulloren për mbrojtjen në punë;
5. Rregulloren për mbrojtje kundër zjarrit;
6. Rregulloren për menaxhimin e brendshëm;
7. Rregulloren për rendin shtëpiak;
8. Rregulloren për mbikëqyrjen e brendshme;
9. Rregulloren për parandalimin e infeksioneve;
10. Rregullore tjera për mbarëvajtjen e punës në QKMF.

34.3. Drejtori, mund të autorizoj persona profesional në hartimin e akteve të përgjithshme të QKMF dhe pas marrjes së pëlqimit për aktin konkret nga DSHMS i miraton ato.

X. Pronësia, Buxheti dhe Financat

Prona

Neni 35

35.1. Pasurinë e QKMF e përbëjnë gjërat, të drejtat dhe të mirat materiale, të cilat kanë qenë të evidentuara si pronë shoqërore (publike) me të cilat QKMF ka pas të drejtë të disponojë në datën e hyrjes në fuqi të Ligjit për Shëndetësi të Kosovës.

35.2. Po ashtu pasurinë e QKMF e përbëjnë gjërat, të drejtat dhe të mirat materiale, të cilat pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Shëndetësi të Kosovës, Ligji i Vetëqeverisje Lokale që QKMF i ka fituar me punë, ose nga të hyra të tjera.

Buxheti

Neni 36

36.1 Çështjet buxhetore dhe financiare të QKMF administrohen në mënyrë transparente në pajtim me rregulloret mbi përdorimin e fondeve nga Buxheti i Republikës së Kosovës si dhe me të gjitha procedurat, në përputhje me udhëzuesit e MEF.

36.2 Buxheti dhe llogaritë e QKMF duhet të përfshijnë tërë shpenzimet operative të Njësive punuese.

36.3. Prokurimi i QKMF bëhet konform rregullave të Ligjit të Prokurimit Publik të Kosovës.

36.4. QKMF ia prezanton buxhetin vjetor DSHMS, për miratim.

36.5. Drejtori mund të kërkojë Revizion të jashtëm që të monitorojë shfrytëzimin e drejtë të mjeteve.

Financimi

Neni 37

37.1. QKMF shfrytëzon burimet financiare konform Ligjit për Shëndetësi të Kosovës, nga Buxheti i Republikës së Kosovës, dhe burimet tjera të parapara me Ligjet përkatëse.

37.2. Bashkë-pagesa për shërbimet e ofruara në QKMF, si burim i financimit të aktiviteteve të QKMF, do të bëhet në bazë të çmimoreve të aprovuar nga Ministria e Shëndetësisë nëse ndryshe nuk është e rregulluar me ligj.

37.3. QKMF do të nxjerr akte të veçanta të detajizuara për llojin dhe shumën e pagesave të ndryshme që do të jetë në pajtim me rregulloret përkatëse të nxjerra nga Ministria.

XI Transparenca në punë

Neni 38

38.1. Puna e QKMF është publike.

38.2. QKMF në Gjilan, si institucion shëndetësor publik është e obliguar që qytetarëve të interesuar, organeve dhe subjekteve tjera, sipas kërkesës së tyre t'ju ofroi informata lidhur kushtet dhe mënyrën e ofrimit të shërbimeve dhe ushtrimit të veprimtarisë në nivel të qendrës dhe nën-qendrave të saja që janë të themeluara në territorin e komunës së Gjilanit, përveç kur bëhet fjalë për sekret afarist dhe profesional

Neni 39

39.1. Informatat dhe të dhënat mbi veprimtarinë si dhe shikimi në dokumentacionin mbi veprimtarinë shëndetësore, personave të autorizuar apo mjeteve të informimit mund të iu jep vetëm Drejtori ose punëtori i QKMF të cilin ai e autorizon.

XII . Sekret i afarist dhe profesional

Neni 40

40.1 Zbulim i sekretit afarist konsiderohet dhënia e dokumentacionit dhe të dhënave të tjera në shikim personave të paautorizuar, veprim i cili do të shkaktonte dëm reputacionit dhe interesit afarist të QKMF.

Neni 41

41.1. Sekret afarist konsiderohen:

- i. Dokumentet të cilat Drejtori i vlerëson si sekret afarist;
- ii. Të dhënat të cilat organi kompetent i konsideron sekrete dhe ia ofron Institucionit si të tillë;
- iii. Masat dhe mënyra e veprimit në raste të krijimit të situatave të jashtëzakonshme.

- iv. Dokumentacionin që përmban planin e mbrojtjes fiziko-teknike të punëtorëve dhe pasurisë së Institucionit;
- v. Të dhëna të tjera, publikimi i të cilave do të ishte në kundërshtim me interesat e Institucionit dhe themeluesit të tij dhe
- vi. Dokumentet ose të dhënat tjera të cilat me ligj parashihen si konfidenciale.

Neni 42

42.1. Mos ruajtja e sekretit afarist konsiderohet si shkelje e rëndë e detyrave të punës.

42.2. Për ruajtjen e sekretit afarist drejtpërsëdrejti kujdeset Drejtori.

XIII. Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

Neni 43

Në rastet kur ekziston ndonjë konflikt midis dispozitave të këtij Statuti me dispozitat e Ligjit për Shëndetësi, do të zbatohen dispozitat e ligjit.

Neni 44

44.1. Në ditën e hyrjes në fuqi të këtij Statuti përfundon fuqia e akteve tjera që rregullojnë punën e QKMF, e që janë në kundërshtim me këtë Statut.

44.2. Ndryshimet dhe plotësimet eventuale në këtë statut bëhen në atë mënyrë siç është miratuar ky statut.

44.2. Aktet e përgjithshme të parapara me nenin 34.2 të këtij Statuti do të hartohen ose ndryshohen në afat prej 120 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi e këtij statuti.

Neni 45

45.1. Ky Statut vjen në fuqi, pas aprovimit nga themeluesi dhe nënshkrimit të tij.

01. nr. 4820

Gjilan, me 29.04.2009

Kuvendi i Komunës së Gjilanit

/ Bujar NEVZATI/

LISTA E QENDRAVE DHE NENQENDRAVE TË MJEKËSISË FAMILJARE


Nr.	Emri i Qendrës	Vendi	Nr.
1	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare	Gjilan	1
2	Qendra e Mjekësisë Familjare	Gjilan, rr. 28. Nëntori	2
3	Qendra e Mjekësisë Familjare	Gjilan, rr. Dardania	3
4	Qendra e Mjekësisë Familjare	Gjilan, rr. Dheu i bardhë	4
5	Qendra e Mjekësisë Familjare	Gjilan, Arbëria	5
6	Qendra e Mjekësisë Familjare	Cërnice	6
7	Punkti i Mjekësisë Familjare	Partesh	7
8	Punkti i Mjekësisë Familjare	Budrikë e poshtme	8
9	Qendra e Mjekësisë Familjare	Zhegër	9
10	Qendra e Mjekësisë Familjare	Pasjan	10
11	Qendra e Mjekësisë Familjare	Malishevë	11

12	Qendra e Mjekësisë Familjare	Pogragjë	12
13	Qendra e Mjekësisë Familjare	Mireshe	13
14	Qendra e Mjekësisë Familjare	Përlepnice	14
15	Punkti i Mjekësisë Familjare	Shillovë	15
16	Qendra e Mjekësisë Familjare	Kufcë e epërme	16
17	Punkti i Mjekësisë Familjare	Koretishtë	17
18	Qendra e Mjekësisë Familjare	Bresalc,	18
19	Punkti i Mjekësisë Familjare	Shurdhan	19
20	Punkti i Mjekësisë Familjare	Myqibabë	20
21	Punkti i Mjekësisë Familjare	Livoqi i poshtëm	21
22	Punkti i Mjekësisë Familjare	Livoqi i epërm	22
23	Punkti i Mjekësisë Familjare	Ponesh	23
24	Punkti i Mjekësisë Familjare	Kishna Polë	24
25	Punkti i Mjekësisë Familjare	Vërbica e Zhegovcit	25
26	Punkti i Mjekësisë Familjare	Parallovë	26
27	Punkti i Mjekësisë Familjare	Strazhë	27
28	Punkti i Mjekësisë Familjare	Makresh i epërm	28
29	Punkti i Mjekësisë Familjare	Familjare Uglarë,	29



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, gje.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 29.04.2009, duke u bazuar në kërkesën e Drejtorit të Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, si dhe bazuar në Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa të datës 21.04.2009, miratoi këtë:

V E N D I M **PËR KOMPENZIMIN E EKSPROPRIJIMEVE TË VJËTRA, ME TOKË TË KK-së**

I

Për shkak të mundësive të vogla financiare për kompensimin e eksproprijimeve të viteve të paraluftës, Kuvendit të Komunës së Gjilanit, i **LEJOHET**, që të gjitha eksproprijimet e e ndodhura para luftës, t'i kompensojë me tokë komunale.

II

Po ashtu me këtë obligohet Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi, Pronë dhe Banim, që në bashkëpunim me Komitetin e Pronës, të hartoj Listën e pronarëve, pronat e të cilëve janë eksproprijuar para luftës, dhe të njëjtëve, **pas verifikimit nga gjykatat**, t'ju ofroj zgjidhje për kompensim të atyre pronave me prona komunale.

III

Me këtë vendim të njoftohen pronarët e pronave të eksproprijuar para luftës, gjykatat dhe thesari.

IV

Zbatimin e këtij vendimi e bënë Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi, Pronë dhe Banim dhe Komiteti për Pronë, ndërsa për zbatimin e tij kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit.

V

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit, ndërsa zbatohet në mënyrë retroaktive për të gjitha rastet e pronave të eksproprijuar para luftës.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

01.Nr. 4823
Gjilan, më 29.04.2009


Kryesuesi i kuvendit,

/Bujar NEVZATI/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, www.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u bazuar në kërkesë Zyrës së Projekteve, si dhe bazuar në Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa të datës 21.04.2009, Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në seancën e mbajtur më 29.04.2009, miratoi këtë:

V E N D I M

Për lejimin e ndërtimit të Objektit të Zyrës Lokale në Fshatin Zhegër dhe Partesh

I

Me këtë vendim lejohet ndërtimi i Objektit të Zyrës Lokale në fshatin Zhegër, dhe ndërtimi i Objektit të Zyrës Lokale në Fshatin Partesh.

II

Ndërtimi e objekteve si në pikën I të këtij vendimi financohet nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, e cila edhe posedon projektin kryesor për ndërtimin.

III

Po ashtu me këtë vendim obligohet Zyra e projekteve që në bashkëpunim me drejtoritë komunale të sigurojnë hapësirën mjaftueshme dhe dokumentacionin e nevojshëm për ndërtimin e objekteve të Zyrave Lokale në fshatin Zhegër dhe Partesh

IV

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Zyra e Projekteve e cila në çdo kohë e njofton MAPL mbi ecurinë e implementimit të projektit, bashkë me Drejtoritë përgjegjëse të Kuvendit të Komunës së Gjilanit, ndërsa për zbatimin e tij kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilani.

V

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

01.Nr. 4826
Gjilan, më 29.04.2009


Kryesuesi i kuvendit,

/ Bujar NEVZATI/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, gje.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u bazuar në nenin 38.1 pika c) të Statutit të Komunës së Gjilanit si dhe bazuar në Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa të datës 22.05.2009, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 26.05.2009 nxjerr këtë:

V E N D I M

Për aprovimin e kriterëve për shfrytëzimin e pronës publike

I

Me këtë vendim aprovohen kriteret për shfrytëzimin e pronës publike të Komunës së Gjilanit, dhe atë kriteret si në vijim:

1. Që secila pronë publike të shfrytëzohet në harmoni me Planin hapësinor të komunës së Gjilanit, ose pasi të bëhet ndryshimi eventual, por në harmoni me Ligjin mbi planifikimin hapësinor,
2. Që prona publike të shfrytëzohet vetëm pasi të merret pëlqimi nga Kuvendi komunal dhe në konsultim me përfaqësuesit legjitim të lokalitetit në të cilin gjendet prona,
3. Nëse prona kërkohet të shfrytëzohet nga ndonjë person fizik apo juridik, paraprakisht duhet të bëhet njoftimi publik për dhënien e asaj prone në shfrytëzim, me garancionin se investuesi do t'i përmbahet dinamikës së caktuar, dhe për njoftim publik të lihet një afat kohor prej 15 ditësh për mundësin e aplikimit për shfrytëzimin e asaj prone nga pretenduesit tjerë eventual,
4. Nëse kërkesa për shfrytëzimin e pronës publike ka të bëjë me ndonjë ndërtim eventual në atë pronë, patjetër të kërkohet edhe leja ndërtimore para fillimit të punimeve, siç është paraparë me ligj.

II

Kriteret si në pikën I të këtij Vendimi do të jenë parakusht i domosdoshëm për lidhjen e kontratës në mesë të pretenduesit për shfrytëzimin e pronës dhe Kuvendit të Komunës së Gjilanit, dhe në kontratë do të saktësohen të gjitha parametrat relevante për shfrytëzim, si dhe afati kohor për shfrytëzimin e pronës publike, i cili nuk mundë të jetë më i gjatë se nëntë (9) vite.

III

Zbatimin e këtij vendimi e bënë Komiteti për pronë, kadastër dhe banim dhe Drejtoria për kadastër, gjeodezi, pronë dhe banim, ndërsa për implementimin e tij kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

01.Nr. 5818
Gjilan, më 26.05.2009


Kryesuesi i kuvendit,

/Bujar NEVZATI/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, [gëgë.gjilani-komuna.org](http://www.gjilani-komuna.org); e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u bazuar në nenin 52.3 të Statutit të Komunës së Gjilanit, si dhe në bazë të Rekomandimit të Komitetit për Politikë dhe Financa të datës 22.05.2009, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e jashtëzakonshme të mbajtur më 26.05.2009, miratoi këtë:

VENDIM
PËR AUTORIZIMIN E KOMITETIT PËR PRONË, KADASTËR DHE BANIM
PËR HARTIMIN E STRATEGJISË PËR EVIDENTIMIN E PRONAVE
KOMUNALE

I

Me këtë vendim **AUTORIZOHET** Komiteti për pronë, kadastër dhe banim që të hartoj Strategjinë për evidentimin e të gjitha pronave dhe aseteve në pronësi të Kuvendit të Komunës së Gjilanit.

II

Obligohet Komiteti për pronë, kadastër dhe banim që në aftë prej dy muajve të bëjë hartimin e Strategjisë për evidentimin e të gjitha pronave dhe aseteve në pronësi të Kuvendit të Komunës së Gjilanit, të njëjtën ta paraqes para anëtarëve të KK-Gjilan.

III

Po ashtu me këtë vendim obligohet Komiteti për pronë, kadastër dhe banim që gjatë hartimit të Strategjisë si në pikën I të këtij vendimi të bashkëpunoj ngushtë me Drejtorinë për kadastër, gjeodezi, pronë dhe banim dhe me organet tjera të KK-Gjilan.

IV

Zbatimin e këtij vendimi e bënë Komiteti për pronë, kadastër e banim në bashkëpunim me Drejtorinë për kadastër, gjeodezi, pronë dhe banim, ndërsa për zbatimin e tij kujdeset kryetari i Komunës së Gjilanit.

V

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit në Kuvendin e Komunës së Gjilanit.

KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT

01.Nr. 5819
Gjilan, më 26.05.2009


Kryesuesi i kuvendit,

/Bujar NEVZATI/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, www.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u bazuar në nenin 38.1 pika c) dhe f) të Statutit të Komunës së Gjilanit, si dhe bazuar në Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa të datës 22.05.2009, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 26.05.2009, miratoi këtë:

V E N D I M

Për lejimin e ndërrimit të pronave të paluajtshme

I

Me këtë vendim, Komunës së Gjilanit i **Lejohet ndërrimi** i këtyre pronave të paluajtshme:

1. Ngastra kadastrave nr.P.70403013-02500-2 e cila ndodhet në vendin e quajtur: Bashqe, me kulturë: arë e kl. I (parë) me sip. të tërësishme prej 296 m², Certifikata Ul.70403013-02372, ZK Gjilan në emër të Milaim A.Neziri nga Gjilani me:
2. Ngastrat Kadstrale: P.70403034-04015-2, me kulturë kullosë e klasit të 5 (pestë) në sip prej 313 m², Certifikata Ul. 704.03034- 0516, ZK Koretishtë në emër të P.SH. KK-Gjilan, pastaj P.70403034- 04505-3, me sip. prej 34 m², Certifikata Ul.70403034-0593 ZK Koretishtë në emër të PSH KK-Gjilan, dhe P.70403016-0107-2, me kulturë kullosë e kl.3 (tretë) me sip. prej 245m², Certifikata Ul.70403016-0205,ZK Livoq i Epërm në emër të PSH, KK-Gjilan të cilat në tërësi përfshijnë sipërfaqen prej 592 m².

II

Ndërrimi i paluajtshmërive nga pika I e këtij vendimi bëhet me qëllim të hapjes dhe ndërtimit të rrugës publike Jugu-1 në Gjilan..

III

Autorizohet Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi, Pronë dhe banim e KK-Gjilan, që në emër të Komunës së Gjilanit të bëjë nënshkrimin e Marrëveshjes për ndërrimin e paluajtshmërive nga pika I e këtij vendimi.

IV

Zbatimin e këtij vendimi e bënë Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi, Pronë dhe banim, ndërsa për zbatimin e tij kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit.

IV

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

01.Nr. 5820
Gjilan, më 26.05.2009


Kryesuesi i kuvendit,

/Bujar NEVZATI/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, gje.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u bazuar në nenin 52.3 të Statutit të Komunës së Gjilanit, si dhe në bazë të nenit 14 të Rregullores për kompetencat, përgjegjësit dhe punën e Komiteteve të Kuvendit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 04.06.2009, miratoi këtë:

VENDIM

PËR AUTORIZIMIN E KOMITETIT PËR PRONË, KADASTËR DHE BANIM PËR HARTIMIN E ELABORATIT PËR GJENDJEN NË RRUGËN "AGIM RASHITI"

I

Me këtë vendim **AUTORIZOHET** Komiteti për pronë, kadastër dhe banim që të hartoj Elaboratin për gjendjen në Rr. "Agim Rashiti" në Gjilan.

II

Obligohet Komiteti për pronë, kadastër dhe banim që në aftë sa më të shkurtër të bëjë incizimin e gjendjes në Rr. "Agim Rashiti" dhe të bëjë definimin e pronës komunale dhe private për gjatë gjithë rrugës dhe, Elaboratin e hartuar për gjendjen në këtë rrugë, me masat e propozuara, t'ia paraqes për miratim Kuvendit të Komunës së Gjilanit..

III

Po ashtu me këtë vendim obligohet Komiteti për pronë, kadastër dhe banim që gjatë hartimit të Elaboratit për gjendjen në rr. "Agim Rashiti" të bashkëpunoj ngushtë me Drejtorinë për kadastër, gjeodezi, pronë dhe banim dhe me organet tjera të KK-Gjilan.

IV

Zbatimin e këtij vendimi e bënë Komiteti për pronë, kadastër e banim në bashkëpunim me Drejtorinë për kadastër, gjeodezi, pronë dhe banim, ndërsa për zbatimin e tij kujdeset kryetari i Komunës së Gjilanit.

V

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit në Kuvendin e Komunës së Gjilanit.

KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT

01.Nr. 6227
Gjilan, më 04.06.2009


Kryesuesi i kuvendit,

/Bujar NEVZATI/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, gje.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u bazuar në nenin 38.1 pika c) të Statutit të Komunës së Gjilanit si dhe bazuar në Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa të datës 22.05.2009, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 04.06.2009, miratoi këtë:

V E N D I M

Për ndarjen e lokacionit për ndërtimin e Qendrës për strehimin dhe mbarështimin e kafshëve endacake

I

Me këtë vendim për nevojat e Drejtorisë për Bujqësi dhe Pylltari ndahet lokacioni me sipërfaqe prej 02.00.00 ha, nga sipërfaqja e gjithmbarshme prej 17.62.13 ha, në ngastrën kadastrave nr.215, vendi i quajtur "Ilina Gllava", me kulturë: parcelë, Zona kadastrave: Velekincë, P.SH. Kuvendi i Komunës-Gjilan.

II

Sipërfaqen si në pikën I të këtij vendimi, Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë do ta shfrytëzojë për ndërtimin e Qendrës për strehimin dhe mbarështimin e kafshëve endacake dhe kafshëve të shoqërimit (qenë dhe mace).

III

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë, Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi, Pronë dhe Banim, ndërsa për implementimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

01.Nr. 6225
Gjilan, më 04.06.2009


Kryesuesi i kuvendit,

/Bujar NEVZATI/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, www.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 483

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 14.07.2009, pas shqyrtimit të kërkesës nga Grupi joformal i grave të Kuvendit të Komunës së Gjilanit, si dhe bazuar në Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe financa të datues 07.07.2009, miratoi këtë:

V E N D I M

Për përkrahjen e iniciativës të grupit joformal të grave të Kuvendit të Komunës së Gjilanit

I

Me këtë vendim përkrahet iniciativa e grupit joformal të grave të Kuvendit të Komunës së Gjilanit për ndryshimin e nenit 110. pika 4 të Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

II

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është kërkesa nga Grupi joformal i grave të Kuvendit të Komunës së Gjilanit, për përkrahje të iniciativës për ndryshimin e Ligjit Zgjedhor.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

01.Nr. 7843
Gjilan, më 14.07.2009


Kryesuesi kuvendit,

/Bujar NEVZATI/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, www.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Në bazë të nenit 3 paragrafi 2 të Ligjit për Eksproprijimin dhe nenit 38.1 pika (h) të Statutit të Komunës së Gjilanit, e në vështrim të pikës III. të vendimit për ndarjen e zonave dhe caktimin e çmimit (kompensimit) për tokën ndërtimore të eksproprijuar, nr.01-1101/0101 të datës 12.02.2008 dhe vendimit 01.Nr.4823 të datës 129.04.2009, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 14.07.2009, miraton këtë:

V E N D I M

Për lejimin e ndërrimit-kompensimit të pronës së paluajtshme

I.

Me këtë Vendim, Komunës së Gjilanit i **L e j o h e t: ndërrimi** apo kompensimi i pronave private të paluajtshme, në vendin e quajtur: "LUGI MAL", Zona kadastrave: Velekincë, të përfshira në trasenë e rrugës për në "Deponinë e Qytetit të Gjilanit, nga rruga ekzistuese deri te pjesa ku rruga kalon në pronën komunale.

II.

Ndërrimi apo kompensimi i paluajtshmërive nga pika 1 e këtij vendimi, bëhet me qëllim të kryerjes së obligimeve të Komunës ndaj pronarëve të këtyre pronave, me rastin e hapjes së rrugës në fjalë dhe realizimit të projektit të ndërtimit të deponime nga donatori.

III

Autorizohet Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi, Pronë dhe Banim e KK-ës Gjilan, që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme juridiko-ligjore, të përgatis shënimet dhe të caktoj shumën e kompensimit apo ndërrimin e paluajatshmërive në mënyrë të përshtatshme apo ekuivalente në emër të Komunës së Gjilanit, dhe të bëjë nënshkrimin dhe zbatimin e marrëveshjes për ndërrimin apo kompensim të paluajtshmërive nga pika I. e këtij vendimi.

IV.

Mbi zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit, Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi, Pronë dhe Banim e KK-ës Gjilan

V.

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT

01.Nr. 7833
Gjilan, më 14.07.2009


Kryesuesi i kuvendit,

/Bujar NEVZATI/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa:rr."Adem Jashari" pn, www.gjilani-komuna.org; e-mail:zip_gjilan@hotmail.com,tel.0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 483

Duke u bazuar në nenin 52.2 pika a) të Statutit të Komunës së Gjiçanit, si dhe bazuar në Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa të datës 07.07.2009, Kuvendi i Komunës së Gjiçanit, në seancën e mbajtur më 14.07.2009, miratoi këtë:

RREGULLORE PER MENYREN DHE KUSHTET E SHFRYTEZIMIT TE PALESTRES SE SPORTEVE "BASHKIM SELISHTA-PETRITI" NE GJILAN

NENI I

1.1 Me këtë rregullore përcaktohet mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të Palestrës së Sporteve "Bashkim Selishta-Petriti" në Gjiçan për aktivitetet sportive të klubeve të regjistruara në Federatat gjegjëse si dhe manifestimeve të ndryshme të kulturës ,tubimeve partiake, revistave si dhe rekreacionit.

NENI II

2.1 Klubet dhe subjektet tjera të interesuara për shfrytëzimin e Palestrës Sportive duhet që së paku 3 ditë para ditës së organizimit të manifestimit,tubimit apo ndeshjes t'i drejtohen me kërkesë përgjegjësit të Palestrës ose DRKS-së të cilët janë të obliguar që të kthejnë përgjigjen me shkrim brenda 48 orëve.

2.2 Klubet e regjistruara në DRKS- Sektori i Sportit - në Komunën e Gjiçanit ,që janë të licencuara në Federatat përkatëse e që kanë kalendar të rregullt të garave do të shfrytëzojnë Palestrën ..në bazë të një orari të rregullt të rregulluar nga Përgjegjësi i Palestrës në bashkëveprim me udhëheqësit e këtyre klubeve dhe të vërtetuara nga DRKS.

NENI III

3.1 Të gjitha klubet sportive që zhvillojnë veprimtarinë e tyre në palestër ..dhe që janë të regjistruara në DRKS, respektivisht Federatat përkatëse e që janë të Komunës së Gjiçanit, mund ta shfrytëzojnë Palestrën ...për stërvitje dhe gara në kuadër të sistemit të garave të përcaktuara nga Federatat përkatëse mbështetur në këto kritere:

- a) Për stërvitje sportive pa pagesë. (3 stërvitje në javë deri në ora 22.00h)
- b)Për zhvillimin e ndeshjeve pa bileta -pa pagesë
- c)Për zhvillimin e ndeshjeve me bileta, 30% nga mjetet e inkasuar nga shitja e biletave.
- d) Të gjitha shkollat e klubeve, që u nënshtrohen rregullave e Rregulloreve të Federatave përkatëse nuk paguajnë 3 (tre) stërvitje në javë, ndërsa Shkollat private paguajnë sipas nenit 3.3 pika (a).
- e) Salla e vogël, fitnes kabineti dhe holet nga klubet e regjistruara shfrytëzohen pa pagesë, po në bazë të një orari të parapërgatitur nga Përgjegjësi i palestres në bashkëpunim me klubet dhe i vërtetuar nga DRKS.

3.2 Terrenet e hapura për Klubet e regjistruara si dhe shkollat e tyre të sportit shfrytëzohen pa pagesë,(në rast se një gjë e tillë nuk rregullohet ndryshe)ndërsa për aktivitete rekreative të klubeve, shoqatave ose organizatave punuese(të pa regjistruara në DRKS) paguhet shuma prej 10 E për një orë.

3.3. Palestra e Sporteve (Salla e madhe) mund të shfrytëzohet edhe për manifestime dhe ngjarje të tjera të ndryshme kulturo-sportive duke paguar:

- a) Aktivitete rekreative- sportive pa ndriçim-15€ për një orë dhe aktivitete rekreative sportive me ndriçim - 20 € për një orë.
- b) Aktivitete dhe ngjarje komerciale (për një orë) 200€.
- c) Aktivitete dhe ngjarje jo komerciale(për një orë) 100€.
- d) Aktivitete dhe ngjarje humanitare - pa pagesë
- e) Për Koncerte 30% nga inkasimi i biletave ose pagesa fikse 1000 €.

NENI IV

Të gjitha Klubet Sportive që nuk janë të Komunës së Gjilanit mund ta shfrytëzojnë Palestrën ...duke paguar shumën fikse prej 100€ për një orë shfrytëzimi .

NENI V

Transmetimi i ngjarjeve në Palestër nga Kompanitë televizive në rast se nuk janë ftuar nga Subjekti që organizon aktivitetin , paguajnë tarifë fikse 100€ për transmetim

NENI VI

Reklamat lëvizëse të Sponsorëve të klubeve mund të ekspozohen vetëm gjatë orarit të ndeshjeve të tyre ,ndërsa për reklama statike paguhet tarifa ashtu siç parasheh Rregullorja nr. 01. 1099 010 për Tarifa , Ngarkesa dhe Gjoha komunale...

NENI VII

7.1 Prej të gjitha obligimeve financiare lirohen organizimet Shtetërore që bënë Komuna për Festa Shtetërore e Kombëtare, qofshin ato me karakter kulturor apo sportiv, por nëse organizatori nuk përfiton nga shitja e biletave.

7.2 Me ndonjë arësyeshmëri të veçantë nga pagesa mund të lirohet ndonjë subjekt (Shoqatat e dala nga Lufta, FSK ,njësi special Policorë, KFOR-i, Personat me aftësi të veçanta).Por pas aprovimit nga Drejtoria e RKS-së.

NENI VIII

8. Në Palestrën e Sporteve ndalohet bartja e armëve dhe mjeteve të tjera eksplozive . pirja e duhanit, dhe alkooli ,dhe personat që thyejnë këtë rregull largohen nga Palestra... nga zyrtarët për siguri.

NENI IX

9.1. Dëmet e regjistruara gjatë ushtrimeve ose lojërave zyrtare vlerësohen nga një Komision prej 3-tre anëtarëve që themelohet nga Drejtori i DRKS-së. dhe ky Komision përgatitë Procesverbal të posaçëm për dëmet e regjistruara.

9.2 Dëmet e regjistruara nga Komisioni i formuar nga Drejtori i RKS Klubin ose Subjektin që ka qenë i ngarkuar me përgjegjësi dhe ka shfrytëzuar Palestrën në kohën e shkakimit të atyre dëmeve e ngarkojnë dhe e obligojnë që në afat prej 7 ditësh t'i kompensojnë ato.

9.3. Në rast të mos kompensimit të dëmeve siç parasheh neni IX pika 9.2 Përgjegjësi i Palestrës ,Klubit a Subjektit përgjegjës i ndalon aktivitetin në Palestër ndërsa DRKS-ja përcjell procedurën në Institucionet gjyqësore .

NENI X

10. Për shfrytëzimin e Palestrës së Sporteve , Klubet dhe subjektet tjera që kanë orar të rregullt të shfrytëzimit të këtij objekti , nënshkruajnë Kontrata me DRKS-në mbështetur në këtë Rregullore .

NENI XI

11. DRKS- mund të lëshojë me qira Terrenet e hapura Sportive të Palestrës ...nëse vlerëson se të hyrat financiare për Komunën janë më të mëdha se sa nga rekreacioni, pas një vendimi paraprak nga Kuvendi i Komunës

NENI XII

12. Ndryshimet dhe plotësimet eventuale të kësaj Rregulloreje bëhen sipas procedurës së njëjtë të nxjerrjes së saj.

NENI XIII

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore, pushojnë të vlejnë dispozitat e rregullores për mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të pallatit të sporteve në Gjilan, nr.01.470/020 të datës 16.01.2004.

NENI XIV

Për zbatimin e kësaj Rregulloreje kujdeset Drejtoria për rini, Kulturë dhe Sport, ndërsa Kryetari I Komunës e përcjell implementimin e saj.

NENI XV

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi I Komunës së Gjilanit.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

01.Nr. 7834

Gjilan, më 14.07.2009


Kryesuesi i kuvendit,

/Bujar NEVZATI/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, gje.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 483

Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në seancën e mbajtur më 14.07.2009, miratoi këtë:

V E N D I M

për faljen e borxheve, Klubeve sportive të Komunës së Gjilanit, ndaj Palestrës së Sporteve "Bashkim Selishta-Petriti" në Gjilan

I

Me këtë vendim, Klubeve sportive të Komunës së Gjilanit, u falen të gjitha borgjet që kanë ndaj Palestrës së Sporteve "Bashkim Selishta-Petriti" në Gjilan.

II

Po ashtu me këtë vendim obligohen Klubet sportive të Komunës së Gjilanit, që më hyrjen në fuqi të Rregullores për mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të Palestrës së Sporteve "Bashkim Selishta-Petriti" në Gjilan, shfrytëzimin e palestrës për aktivitete të veta ta bëjnë në harmoni me dispozitat e kësaj Rregullore.

III

Zbatimin e këtij vendimi e bënë Drejtoria për Rini, Kulturë dhe Sport, ndërsa për implementimin e tij kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit..

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

01.Nr. 7835
Gjilan, më 14.07.2009


Kryesuesi i kuvendit

/Bujar NEVZATI/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, gje.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 483

Duke u bazuar në nenin 9.1, nenin 38.1 pika c) dhe h) të Statutit të Komunës së Gjilanit, si dhe bazuar në Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa të datës 07.07.2009, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 14.07.2009, nxori këtë:

V E N D I M **për shpalljen e zonave me interes të veçanet**

I

Me këtë vendim shpallen zona me interes të veçantë, këto parcela:

a. Pronat e evidentuara në emër të: P.SH. Kombinati Bujqësor Industrial, sipas:

1. Certifikatës Poseduese nr.01351-0, me sipërfaqe prej 13169m²,
2. Certifikatës Poseduese nr.01347-0, me sipërfaqe prej 59180m²,
3. Certifikatës Poseduese nr.01353-2, me sipërfaqe prej 4393m²,
4. Certifikatës Poseduese nr.01353-1, me sipërfaqe prej 10373m²,
5. Certifikatës Poseduese nr.01349-1, me sipërfaqe prej 97934m²,
6. Certifikatës Poseduese nr.01349-3, me sipërfaqe prej 4886m²,
7. Certifikatës Poseduese nr.01356-4, me sipërfaqe prej 7241m²,
8. Certifikatës Poseduese nr.01355-0, me sipërfaqe prej 5762m²,
9. Certifikatës Poseduese nr.01364-0, me sipërfaqe prej 500m²,
10. Certifikatës Poseduese nr.01358-1, me sipërfaqe prej 13992m²,
11. Certifikatës Poseduese nr.01352-3, me sipërfaqe prej 2254m²,
12. Certifikatës Poseduese nr.01380-0, me sipërfaqe prej 75196m²,

b. Pronat e evidentuara në emër të: D.S-Sekretariat Narodne Odbrane, sipas:

1. Certifikatës Poseduese nr.01382-0, me sipërfaqe prej 35950m²,

c. Pronat e evidentuara në emër të: Sekretariati i Mbrojtjes Popullore, sipas:

1. Certifikatës Poseduese nr.01444-0, me sipërfaqe prej 104167m².

d. Pronat e evidentuara në emër të: D.S-Drveni Kombinat Pog.Shum.Uro, sipas:

1. Certifikatës Poseduese nr.02034-1, me sipërfaqe prej 815735m².
2. Certifikatës Poseduese nr.02034-2, me sipërfaqe prej 163619m².
3. Certifikatës Poseduese nr.02035-0, me sipërfaqe prej 100020m².

II

Parcelat e shpallura me si Zona me Interes të veçanet, do të shfrytëzohen për nevojat e Drejtorisë për Arsim të KK-Gjilan.

III

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Arsim dhe Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi, Pronë dhe Banim, ndërsa për implementimin e tij kujdeset Kryetari i komunës së Gjilanit.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditëm e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

01.Nr. 7840
Gjilan, më 14.07.2009


Kryesuesi i kuvendit,

/Bujar NEVZATI/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, www.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 483

Duke u bazuar në nenin 9.1, nenin 38.1 pika c) dhe h) të Statutit të Komunës së Gjilanit, si dhe bazuar në Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa të datës 07.07.2009, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 14.07.2009, nxori këtë:

V E N D I M
PËR SHPALLJEN E ZONËS SË INTERESIT TË VEÇANËT NË NGASTRËN
KADASTRALE NR.4945-7 DHE NË ZONAT TJERA NË QYTET

I

Me këtë vendim shpallet Zonë e interesit të veçanet, ngastra kadastrale nr.4945-7, Fleta poseduese nr.2134, në sipërfaqe prej 0.90.20 ha, në vendin e quajtur: "Arapske Livade", P.SH. "Industria e Tekstilit INTEGJ", Gjilan.

II

Parcela e shpallur si Zona me Interes të veçanet, si në pikën I të këtij vendimi do të shfrytëzohen për nevojat e Drejtorisë për Arsim të KK-Gjilan.

III

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Arsim dhe Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi, Pronë dhe Banim, ndërsa për implementimin e tij kujdeset Kryetari i komunës së Gjilanit.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditëm e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

01.Nr. 7841
Gjilan, më 14.07.2009


Kryesuesi i kuvendit,

/Bujar NEVZATI/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, gje.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u bazuar në nenin 38.1 shkronja (h) të Statutit të Komunës së Gjilanit, si dhe pas shqyrtimit të kërkesës së Drejtorisë për Arsim, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 12.10.2009, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR NDARJEN E 50 (PESËDHJETË) BURSIVE PËR STUDENTË DHE
FORMIMIN E KOMISIONIT PËR NDARJEN E BURSIVE

I

Me këtë vendim lejohet ndarja e 50 (pesëdhjetë) bursave për student të Komunës së Gjilanit për vitin akademik 2009/2010.

II

Po ashtu me këtë vendim i vazhdohet afati edhe Komisionit i cili do të bëjë përzgjedhjen e studentëve përfitues dhe i cili do të monitorohet nga drejtori i Drejtorisë për Arsim

Komisioni për përzgjedhjen e përfituesve të bursave do të ketë përbërje të njëjtë si me Vendimin nr.01.1095/0101 të datës 12.02.2008 dhe vendimit 01.Nr.9987 i datës 19.09.2008, dhe atë si në vijim:

6. Sami Hoxha – PDK,
7. Nazif Sylejmani – AKR,
8. Xhemajl Shabani – AAK,
9. Rashit Sahiti - LDK
10. Enver Kadriu - LDD

III

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Arsim, ndërsa për implementimin e tij kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit,

KUVEDNI I KOMUNËS-GJILAN

01.Nr. 12081
Gjilan, më 12.10.2009


Kryesuesi i kuvendit,

/Bujar NEVZATI/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, www.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Në mbështetje të nenit 11, neni 12, pika 1 dhe 2, shkronja c dhe d, të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, neni 39, pika 1 dhe 2 të Statutit të Komunës së Gjilanit, si dhe në bazë të nenit 5, shkronja i të Ligjit mbi Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, neni 31.5 të Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm, neni 28.2 dhe 28.3 të Ligjit mbi Arsimin dhe Aftësimin Profesional si dhe të Udhëzimit Administrativ nr7/2009 për kodin e mirësjelljes dhe masat disiplinore për nxënës të shkollave të larta, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në mbledhjen e mbajtur me 12.10.2009 miraton këtë:

RR E G U L L O R E

PËR TË DREJTAT, DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E NXËNËSVE NË SHKOLLA TË MESME TË KOMUNËS SË GJILANIT

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSME

Neni 1.

Me këtë Rregullore përcaktohen të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e nxënësve në shkolla të mesme të komunës së Gjilanit (në tekstin e mëtejshëm: shkollë), shkeljet e punëve dhe detyrave të nxënësve, llojet e masave disiplinore, procedura për vërtetimin e përgjegjësisë së nxënësit, kompetencat e organeve të shkollës mbi iniciimin, zhvillimin e procedurës disiplinore dhe shqiptimin e masës disiplinore, të drejtat e nxënësit në ankesë, përgjegjësia materiale për dëmin material të shkaktuar shkollës si dhe dispozita tjera.

Neni 2

Nxënësit janë pjesëmarrës aktiv në punën arsimore-edukative dhe së bashku me arsimtarët, bashkëpunëtorët profesional dhe punëtorët tjerë janë përgjegjës për rezultatet e punës arsimore-edukative.

Neni 3.

Shkolla është e obliguar që në fillim të vitit shkollor dhe kohë pas kohe nga Kujdestari i klasës t'i njoftojë nxënësit me të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e tyre të përcaktuara me këtë Rregullore.

Neni 4.

Kujdestari i klasës nga radha e arsimtarëve ka për obligim që në fillim të vitit shkollor e veçanërisht gjatë mbajtjes së orëve të kujdestarisë, t'i njoftojë nxënësit me Rregulloren e shkollës.

II. DISPOZITAT E VEÇANTA

III. TË DREJTAT E NXËNËSIT

Neni 5.

e drejta për shkollim sipas dispozitave ligjore në fuqi;
të shfaqë lirisht mendimin e tij në të gjitha format, me gojë, me shkrim, publikisht për problemet që e shqetëson atë, klasën e tij apo shkollën në tërësi.

të kërkojë mbrojtjen e vet nga dhuna fizike e psikologjike dhe t'i respektohet dinjiteti i nxënësit në shkollë.

të njohë konventat e të drejtave të fëmijëve dhe të kërkojë respektimin e saj prej të tjerëve.

të marrë pjesë në mbledhjet e ndryshme të klasës dhe të shkollës.

të ankohet në drejtorinë e shkollës ose në organet më të larta të arsimit kur gjykon se ka të drejtë.

- të marrë pjesë në veprimtaritë kulturore, artistike, sportive që zhvillon klasa ose shkolla të kërkojë dhe të marrë dokumentin përkatës pedagogjike-shkollor për mbarimin e klasës, shkollës apo kur largohet në një shkollë tjetër.
- të marrë nga arsimtari punimet me shkrim për të studiuar e menduar ato,
- të ndjek rregullisht mësimin dhe format tjera të organizuara të punës arsimore-edukative të përcaktuara me programin vjetor të punës së shkollës,
- të shfrytëzojë mjetet mësimore,
- të punës dhe mjetet tjera të organizatës edukativo-arsimore me të cilat zhvillohet programi i punës arsimore-edukative;
- të ketë sigurim shëndetësor gjatë praktikës profesionale në shkollë ose në punëtori;
- të zgjedhë dhe të jetë i zgjedhur në organizatat rinore të shkollës dhe në organet tjera dhe e drejta të marrë pjesë në gara të diturisë, sportive dhe kulturore për të cilat edhe mund të shpërblehet.

IV. OBLIGIMET E NXËNËSIT

Neni 6.

të njoh dhe respektoj kodin e mirësjelljes dhe rregullat e shkollës;

të respektoj orarin e mësimi;

të ketë paraqitje të jashtme të rregullt dhe të pastër;

të respektojë arsimtarët dhe punëtorët tjerë të shkollës, shokët e shoqet e klasës;

të vijë në shkollë i pajisur me tekste, fletore e mjete të tjera të domosdoshme;

të mbajë qëndrim të mirë dhe të mos bëhet pengesë për zhvillimin normal të orës

së mësimi;

të ketë uniformën shkollore gjatë zhvillimit të procesit edukativo-arsimor;

të ketë uniformën e caktuar në lëndën e edukatës fizike dhe uniformen shkollore.

kur është i sëmurë, me kohë të paraqes raportin mjekësor, me anë të prindit tek kujdestari i klasës;

të njoftojë me kohë prindin e vet dhe t'ia dërgon ftesën apo thirrjen nga ana e mësimdhënësit, kujdestarit të klasës, drejtorit të shkollës dhe organeve tjera të shkollës;

të mbajë pastër ambientin e klasës dhe tërë shkollës;

të kultivojë, ruaj dhe zhvillojë vlerat kombëtare e demokratike;

të ruaj pasurinë e shkollës;

të lajmërojë dëmin e shkaktuar inventarit të shkollës;

të zbatojë rregullat e sjelljes dhe të punës në shkollë.

V. VEPRIMET E NDALUARA:

Neni 7.

Nxënësit i ndalohet:

- të prishë disiplinën gjatë orës së mësimi (të përtypet,të bëjë zhurmë etj.);

- të mbaj armë të zjarrit, të ftohta dhe sende tjera të rrezikshme për jetën e - -

- nxënësve dhe personelit tjetër në shkollë;

- të ofendoj shokët, shoqet ose arsimtarët;

- të hyjë në klasë pasi ka rënë zilja;

- të konsumojë duhan, pije alkoolike, mjete narkotike, të mbajë armë zjarri

- apo të ftohta;

- të kopjoj gjatë detyrave me shkrim në klasë;

- të marrë pjesë në lojëra me karakter bixhozi;

- të bisedoj me zë të lartë në mjediset e shkollës;

- të dëmtojë bazën materiale teknike dhe didaktike të shkollës,

- të bëjë mungesa pa arsye të qëndrojë në korridore të shkollës pa nevojë të

- lëvizë nëpër shkallët e arsimtarëve dhe në aneksin e administratës së shkollës pa nevojë;

- të hyjë në shkollë nga hyrja e dedikuar për personelin arsimor;

- të hyjë në sallën e arsimtarëve pa prezencën e kujdestarit të klasës apo të

- arsimtarit kujdestar të ditës dhe pa lejen e drejtorit të shkollës;
- të sjellë persona të huaj (të panjohur) në shkollë pa paralajmërim në drejtorinë e shkollës;
- të përvetësojë sendet e huaja në mënyrë të palejuar;
- të falsifikoj të dhënat në dokumentet pedagogjike-shkollore (ditarë, libër amë, dëftesë, diplomë etj);
- të përdoret telefoni celular në orë të mësimi dhe të orës praktike;
- futja dhe konsumimi i gjërave ushqimore në shkollë dhe
- ndalesat tjera të cilat i bie drejtori i shkollës.

VI. SHKELJET E PUNËVE DHE DETYRAVE PUNUESE TË NXËNËSIT

Neni 8.

Shkeljet e detyrave punuese të nxënësit mund të jenë të lehta dhe të rënda.

Neni 9.

Shkeljet e lehta të detyrave punuese të nxënësit janë:

vonesa e paarsyeshme në orën mësimore; prishja e disiplinës gjatë orës së mësimi (të hajë çamçakëz, të pëshpërit me shokun e bankës),

hyrja në klasë pasi ka rënë zilha

kopjimi gjatë detyrave me shkrim në klasë.

prishja e rendit dhe e qetësisë në lokalet e shkollës duke lëshuar zë të lartë;

hyrja në shkollë nga hyrja e dedikuar për personelin arsimor.

qëndrimi i gjatë dhe pa arsye në korridore të shkollës duke penguar procesin edukativo- arsimor;

hyrja në sallën e arsimtarëve pa prezencën e kujdestarit të klasës apo të arsimtarit kujdestar të ditës dhe pa lejen e drejtorit të shkollës

qëndrimi dhe lëvizjet nëpër shkallët e arsimtarëve dhe në aneksin

administratës së shkollës pa nevojë;

mos respektimi i udhëzimeve të kujdestarit të ditës;

sjellja jo korrekte e nxënësit gjatë pyetjeve dhe notimit nga mësimdhënësit;

sjellja jo korrekte ndaj shokëve dhe shoqeve;

sjellja e personave të panjohur në shkollë pa paralajmërim në drejtorinë e shkollës.

konsumimi i duhanit në oborrin e shkollës;

marrja në vërejtje nga arsimtari i lëndës ;

mungesa e paarsyeshme nga mësimi mbi 15 orë mësimore gjatë vitit shkollor etj.

Neni 10.

Shkeljet e rënda të detyrave punuese të nxënësit janë:

1. përmirësimi, ndryshimi (falsifikimi) i të dhënave në dokumentet publike të evidencës pedagogjike-shkollore: ditarë, libër amë, dëftesë, diplomë etj.
2. përvetësimi jo i lejuar (vjedhja) e pasurisë së nxënësit, arsimtarit dhe shkollës;
3. mbajtja dhe përdormi i alkooli dhe substancave narkotike.
4. nxitja dhe marrja pjesë në rrahje në shkollë dhe forma tjera të mësimi;
5. mbajtja e armëve të zjarra, të ftohta si dhe mjeteve tjera që e rrezikojnë jetën e nxënësve dhe personelit tjetër në shkollë;
6. organizimi krye në vete, i manipuluar dhe jo i drejtë, i lëshimit frontal të orëve mësimore apo i protestës ndaj mësimdhënësve pa të drejtë;
7. konsumimi i duhanit në lokalet e shkollës;
8. dëmtimi i bazës materiale teknike dhe didaktike të shkollës;
9. mungesa pa arsye nga mësimi dhe nga format tjera të punës arsimore- edukative mbi 32 orë mësimi gjatë vitit shkollor;
10. marrja në vërejtje nga arsimtari i lëndës disa here;
11. shkaravitja dhe mbishkrimi i mureve, dyerve, dritareve dhe të inventarit të shkollës;
12. përsëritja e lëndimeve të lehta disa herë;
13. si dhe sjellje tjera asociale-devijonte që drejtori i shkollës, Këshilli i Klasave dhe Këshilli i Arsimtarëve i cilësojnë si shkelje të rënda dhe sjellje të dëmshme për mbarëvajtjen e jetës dhe punës në shkollë.

VII. MASAT DISPLINORE

Neni 11.

Për mos vijueshmëri me rregull në orët e mësimi teorik dhe praktikës

profesionale:

1. nxënësi i cili mungon pa arsye 15 - 24 orë mësimi vlerësohet me sjellje e

mirë;

2. nxënësi i cili mungon pa arsye 25 e më tepër orë mësimi vlerësohet me

sjellje jo e mirë dhe

3. nxënësi i cili i bënë më tepër se 32 mungesa të paarsyeshme e humbë

statusin e nxënësit të Rregullt.

Neni 12

Nxënësve të cilët bëjnë shkelje të rregullave të sjelljes në shkollë u shqiptohen

këto masa disiplinore:

1. vërejtje gojore(qortimi) nga kujdestari i klasës;
- 2 .vërejtje me shkrim nga drejtori i shkollës;
3. pezullim i përkohshëm nga DA dhe
4. pezullim(largim) për një vit shkollor nga shkolla shqiptohet nga DA.

Neni 13.

Masa disiplinore nga pika 3 dhe 4 nuk mund ti shqiptohet nxënësit nëse mungon deklarata me shkrim nga ana e nxënësit. Përveç në rastet kur nxënësi në asnjë mënyrë nuk i përgjigjet kërkesës për deklaratë me shkrim.

Neni 14.

Nxënësit mund ti shqiptohet njëra nga masat disiplinore pas zbatimit të

procedurës në të cilën patjetër duhet të vërtetohen faktet dhe rrethanat mbi

shkeljen e kryer me qëllim të shqiptimit të masës adekuate nga organi kompetent.

VIII. PROCEDURA PËR INICIMIN,ZHVILLIMIN, VËRTETIMIN E PËRGJEGJËSISË DHE SHQIPTIMIN E MASAVE DISIPLINORE

Neni 15.

Çdo nxënës dhe punëtorë i shkollës ka të drejtë dhe detyrë që posa të merr vesh

mbi shkeljen e kryer ta lajmëron kujdestarin e klasës apo drejtorin e shkollës.

Inicimin e procedurës disiplinore mund ta bënë: Kujdestari i klasës,Kujdestari i ditës, Këshilli i

Paraleles, Këshilli i Klasës, Këshilli i Arsimitarëve.

Organi kompetent për shqiptimin e masës disiplinore ka për detyrë që kërkesën

me shkrim për inicimin e procedurës disiplinore ta shqyrtojë dhe të merr vendim

brenda afatit prej 8 ditësh nga dita e paraqitjes së kërkesës.

Neni 16.

Zhvillimin e procedurës për vërtetimin e përgjegjësisë e bëjnë organet kompetente për shqiptimin e masave disiplinore të përcaktuara me këtë Rregullore.

Për iniciimin dhe zhvillimin e procedurës disiplinore dhe shqiptimin e masave

disiplinore ndaj nxënësit organet kompetente janë të obliguara ta njoftojnë prindin

e nxënësit.

Prindi i nxënësit thirret me letërthirrje të cilën nxënësi është i obliguar të ia

dërgon prindit të vet me kohë të cilën duhet ta nënshkruan prindi, se e ka marrë

thirrjen, ndërsa pjesën tjetër (reversin) nxënësi duhet ta kthejë në shkollë,

përkatësisht organit i cili ka bërë thirrjen-ftesën. Në alternativë mund të përdoret komunikimi telefonik.

Në qoftë se vërtetohet se nxënësi i bishtnon njoftimit të prindit dhe të njëjtit nuk

ia dërgon thirrjen-ftesë, atëherë ky obligim i bie kujdestarit të klasës i cili në

prezencën e nxënësve i **kërkon nxënësit** të firmosë se prindi i tij është njoftuar. Nëse nxënësi refuzon atëherë kujdestari i klasës e konstaton me shkrim në ditar në prani të nxënësve tjerë.

Neni 17.

Për vërtetimin e përgjegjësisë duhet të zhvillohet procedura disiplinore dhe në te të ndërmerren të gjitha veprimet e nevojshme dhe provat.

Për vërtetimin e përgjegjësisë mund të merren këto prova:

1. dokumentet mbi evidencën pedagogjike-shkollore: ditari, libri amë, dëftesa, diploma etj;
2. dëshmitarët (deklaratat e dëshmitarëve)
3. shikimi në vendin e ngjarjes etj.

Neni 18.

Para shqiptimit të masës disiplinore nga neni 17. i kësaj Rregullore , nxënësi duhet të dëgjohet dhe të jep mendimin e vet me gojë apo me shkrim.

Nxënësi thirret për të dhënë mendimin e vet me gojë apo me shkrim, menjëherë pas paraqitjes së kërkesës për iniciimin e procedurës nga organi kompetent.

Neni 19.

Për shkelje të lehta të detyrave punese, nxënësit i shqiptohet këto masa

disiplinore:

1. vërejtje gojore(qortim).
2. vërejtje me shkrim

Vërejtjen gojore (qortim) e shqipton Kujdestari i klasës i cili në prezencën

nxënësve të klasës i jep vërejtje gojore(qortim) nëse vazhdon me sjellje të tillë

apo mungon nga orët mësimore i propozon Drejtorit të shkollës që ndaj tij të shqiptohet masa disiplinore-vërejtje me shkrim..

Për këtë masë të shqiptuar njoftohet prindi i nxënësit.

Neni 20.

Në qoftë se nxënësi edhe pse ka marrë vërejtje gojore(qortim) nga kujdestari i

klasës nuk përmirësohet,por vazhdimisht i përsërit shkeljet e rregullave në

shkollë,atëherë kujdestari i klasës i propozon drejtorit të shkollës që nxënësit t'i

shqiptohet masa disiplinore –Vërejtje me shkrim të cilën e shqipton drejtori i

shkollës.

Vërejtja me shkrim i shqiptohet nxënësit nëse nga arsimtarët e lëndëve është

marrë në vërejtje si dhe nëse ka munguar pa arsye nga mësimi më tepër se 25 orë

mësimore.

Neni 21.

Kujdestari i Klasës është i obliguar që masat e shqiptuara, t'i evidentojë në librin e klasës (ditar) në rubrikën: Procesverbali i Këshillit të Klasës (faqe 163 – 167) dhe rubrikën: Evidencimi i momenteve më karakteristike të punës së paraleles (faqe 221 – 224)

Neni 22.

Për shkelje të rënda të detyrave punuese, nxënësit mund ti shqiptohet këto masa

disiplinore:

1. pezullim(largim) i përkohshëm nga shkolla dhe
2. pezullim(largim) për një vit shkollor nga shkolla;

Neni 23.

Shqiptimi e masës disiplinore-Pezullim i përkohshëm nga shkolla i shqiptohet nxënësit i cili nuk i përfill rregullat e shkollës, edhe pse më parë i është shqiptuar masa disiplinore:vërejtje gojore dhe vërejtje me shkrim.

Masa disiplinore –Pezullim i përkohshëm nga shkolla, shqiptohet në dy mënyra:

1. pezullim i përkohshëm nga garat sportive, kulturore, ekskursionet, vizitat,

shëtitjet etj. dhe

2. pezullim nga shkolla deri në një muaj.

Masën disiplinore-Pezullim i përkohshëm nga garat sportive, ekskursionet, vizitat dhe shëtitjet e shqipton drejtori i shkollës, kurse masën disiplinore-Pezullim nga shkolla deri në një muaj e shqipton DA-ja.

Neni 24.

Shqiptimi i masës disiplinore-Pezullim (largim) për një vit shkollor nga shkolla i shqiptohet nxënësit i cili bënë shkelje të rëndë të rregullave të shkollës të parapara në nenin 4 të Udhëzimit Administrativ

nr. 04/2007 dhe në nenin 10 të kësaj Rregullore.

Shqiptimin e masës disiplinore-Pezullim për një vit shkollor nga shkolla, e shqipton **Komisioni Komunal.**

IX. PËRGJEGJËSIA PËR SHKAKTIM TË DËMIT MATERIAL TË INVENTARIT TË SHKOLLËS

Neni 25.

Nxënësi i cili me qëllim ose nga pakujdesia e tepruar i ka shkaktuar dëm material shkollës është i obliguar që të njëjtin ta kompensojë:

Në qoftë se dëmin material e kanë shkaktuar disa nxënës, atëherë të njëjtin janë të obliguar ta kompensojnë secili për pjesën e fajit të vet.

Në qoftë se nuk mund të zbulohet fajtori i shkaktimit të dëmit material, atëherë të gjithë nxënësit e klasës janë të obliguar të bëjnë kompensimin e dëmit material të shkaktuar.

Për kompensimin e dëmit material, kërkesa i bëhet drejtorit të shkollës i cili për vlerësimin e dëmit e formon një komision prej tre anëtarësh i cili do të bënë vlerësimin e lartësisë së çmimit të dëmit të shkaktuar material.

Neni 26.

Për shqiptimin e masave disiplinore organi kompetent është i obliguar që nxënësve të ndëshkuar të ju lëshohet vendim (aktvendim) me shkrim. Për ekzekutimin e tyre kujdeset drejtori i shkollës.

X. TË DREJTAT E NXËNËSIT NË ANKESË

Neni 27.

Nxënësi apo prindi i tij ka të drejtë të ushtroi Ankesë me shkrim kundër shqiptimit të masës disiplinore –për Vërejtje me shkrim dhe masës disiplinore –Pezullim i përkohshëm nga garat sportive, ekskursionet dhe shëtitjeve i bëhet në afat prej 3 dite, **Këshillit të shkollës** përmes Drejtorit të shkollës.

Ndërsa kundër masës disiplinore largim nga shkolla për një muaj në afat prej 3 ditësh përmes të DA-së i bëhet Komisionit gjegjës komunal dhe kundër shqiptimit të masës disiplinore-Pezullim për një vit shkollor nga shkolla për mes të Komisionit komunal i bëhet Komisionit për Ankesa në MASHT në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimi të vendimit(aktvendimit).

Komisioni i MASHT –it duhet të merr vendim dhe ta njoftojë shkollën me shkrim më së largu brenda 10 ditëve.

Neni 28.

Paraqitja e ankesës e shtynë ekzekutimin e vendimit deri në plotfuqishmërinë e tij nëse nxënësi në ndërkohë nuk bënë shkelje tjera.

Vendimi bëhet i plotfuqishëm atëherë:

1. kur kalon afati i ankesës dhe ankesa nuk është bërë;
2. kur organi ka vendosur mbi ankesën dhe të njëjtën nuk e ka aprovuar duke e lënë në fuqi

Vendimin e shkallës së mëparshme.

XI. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 29.

Komentimin, interpretimin ndryshimin, plotësimin dhe harmonizimin e mëtutjeshëm me dispozita më të reja ligjore dhe me udhëzime administrative të kësaj Rregulloreje e bënë Këshilli i shkollës.

Kjo Rregullore hynë në fuqi menjëherë pas miratimit të Kuvendit Komunal.

Neni 30

Qdo dispozitë e kësaj rregulloreje që është në kundërshtim me dispozitat e ligjit dhe të udhëzimeve administrative përkatëse, do të vlejë dispozitat e ligjit dhe udhëzimit përkatës.

Kryesues i Kuvendit të Komunës së Gjilanit

/Bujar NEVZATI/


01.nr. 12080

Gjilan, më 12.10.2009



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa:rr."Adem Jashari" pn, [ëëë.gjilani-komuna.org](http://ee.gjilani-komuna.org); e-mail:zip_gjilan@hotmail.com,tel.0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Në bazë të nenit 40.paragrafi 40.2 shkronja a të ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040 dhe nenit 52 paragrafi 52.2 shkronja a të Statutit të K K Gjilan,si dhe nenit 24 të ligjit për sport,Kuvendi Komunal Gjilan në mbledhjen e mbajtur më 12.10.2009, miratoi këtë:

**RREGULLORE
PËR MËNYRËN DHE KUSHTET E SHFRYTËZIMIT TË STADIUMIT TË
FUTBOLLIT NË GJILAN**

Neni 1.

1.1. Me këtë rregullore përcaktohet mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të stadiumit të futbollit të qytetit në Gjilan nga klubet sportive të themeluara në bazë të ligjit mbi sportin me qëllim të zhvillimit të aktiviteteve të tyre sportive.

1.2. Në raste të veçanta stadiumi i qytetit mund të shfrytëzohet edhe për manifestime të ndryshme kulturore,tubime partiake dhe revista të ndryshme.

Neni 2.

2.1. Klubet sportive dhe subjektet tjera të interesuara për stadium ,duhet që së paku tri ditë para ditës së mbajtjes së ndeshjes, manifestimit apo tubimit t'i drejtohen me kërkesë DRKS-së përgjegjësit për sport ,i cili është i obliguar që brenda 24 orëve nga marrja e kërkesës ta njoftoj parashtruesin e saj me shkrim lidhur me mbajtjen apo jo të aktivitetit të kërkuar.

Neni 3.

Drejtorja për Rini Kulturë dhe Sport propozon tarifat e shfrytëzimit të stadiumit të qytetit të cilat aprovohen nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

Neni 4.

4.1. Klubet publike të qytetit mund ta shfrytëzojnë stadiumin e qytetit për stërvitje dhe garim pa pagesë të kategorive Juniorë dhe Seniorë.

4.2. Orarin për zhvillimin e aktiviteteve sportive e harton Koordinatori i Stadiumit të Qytetit në bashkëveprim me klubet publike dhe Drejtorinë për Rini,Kulturë dhe Sport.

4.3. Klubet private sportive të qytetit dhe jashtë qytetit (qoftë individuale apo aksionare) për zhvillimin e aktivitetit sportiv duhet të paguajnë K.K-së-Drejtorisë për Rini ,Kulturë dhe Sport nga 300 euro për çdo aktivitet –lojë, dhe për stërvitje të rregullta duhet të paguajnë 50 euro.

4.4. Klubet e paregjistruara në Federatat Sportive dhe në Drejtorinë e Rinisë,Kulturës dhe Sportit të K.K të Gjilanit duhet të paguajnë 300 euro për një lojë.

Neni 5.

5.1. Stadiumi ndihmës në kuadër të stadiumit të qytetit mund të shfrytëzohet nga shkollat e regjistruara të futbollit (fatos,pionierë e kadet) me pagesë prej 10 euro për stërvitje 90 minuta ditën ,dhe 15 euro për stërvitje për mbrëmje nën dritat e reflektorëve.

Neni 6.

6.1. Reklamat lëvizëse të sponsorëve të klubeve mund të ekspozohen vetëm gjat orarit të ndeshjeve të tyre, ndërsa për reklama statike paguhet tarifa në DRKS ashtu si parasheh Rregullorja për Tarifa Ngarkesa dhe Gjoha Komunale nr.01/1099/010.

Neni 7.

7.1 Klubet publike sportive të futbollit dhe Liga Rajonale Futbollistike e Komunës së Gjilanit kanë zyrat e tyre në ndërtesën administrative të stadiumit të qytetit dhe paguajnë kosto mujore 100 euro ose 4 euro për metër katror, ku hyn rryma uji dhe bërlloku.

Neni 8.

8.1. Paratë e grumbulluara nga shitja e biletave spektatorëve inkasohen në xhirollogarinë e DRKS-së 30%,ndërsa paraprakisht caktohet komisioni prej tre vetëve për shitjen e biletave ku njëri nga ta është nga DRKS-ja.

Neni 9.

9.1. Çdo klub dhe organizator i manifestimit apo tubimit obligohet që të caktojë kujdestarët e vet për mbajtjen e rendit dhe qetësisë në stadium dhe në objektet përcjellëse që nga momenti i hyrjes së shikuesve dhe personelit tjetër gjer në largimin e tyre nga stadiumi në përgjegjësi të plotë,materiale dhe penale të tyre.

Neni 10.

10.1. Në stadium nuk lejohet bartja e çfarëdo lloji të armëve,mjeteve eksplozive,alkoolit apo mjeteve tjera të ngurta,andaj personat që hasen me këto mjete nuk duhet lejuar të hyjnë në stadium dhe të njëjtit duhet larguar nga stadiumi,përgjashtimisht formacioneve policore.

Neni 11.

11.1. Stadiumi i qytetit mund t'u lejohet për shfrytëzim edhe organizatorëve të ndryshëm për shfrytëzim –koncerte, por të njëjtit më parë duhet t'i paguajnë 1000 euro në arkën e Stadiumit të qytetit të cilat mjete derdhen në buxhetin e K.K-së Gjilan. Nga kjo pagesë përjashtohen organizimet e festave shtetërore dhe shfaqjet me karakter humanitar.

Neni 12 .

12.1. Për dëmet eventuale të shkaktuara gjatë kohës së shfrytëzimit të stadiumit nga klubet sportive apo subjektet tjera përkatëse-organizatorët;përgjegjësia bie mbi ta dmth shfrytëzuesin gjatë asaj kohe,andaj edhe kompensimet duhet bërë në afat prej 7 ditësh nga dita e konstatimit të dëmit.

Dëmet e shkaktuara vlerësohen prej komisionit profesional Ad-hoc prej 3 anëtarëve të cilët hartojnë procesverbal të posaçëm mbi dëmet e shkaktuara.

Në rast të mospërmbushjes të dëmeve të shkaktuara në afat prej 7 ditësh, procedura e kompensimit do të vendoset përmes organeve gjyqësore duke llogaritur edhe kamatën ligjore.

Neni 13.

13.1. Për çdo shfrytëzues të stadiumit të qytetit paraprakisht lidhet kontratë me shkrim mes përgjegjësit për sport respektivisht Drejtorit të DRKS-së, si dhënës i objektit në shfrytëzim në njërën anë,dhe të autorizuarit të klubit apo të subjektit tjetër përkatës në anën tjetër si shfrytëzues.

13.2. Klubet publike të qytetit dhe Lidhja regjionale e futbollit që garojnë(në super ligë, liga e parë),ligat respektabile të Kosovës nënshkruajnë kontratë ose marrëveshje vjetore mbështetur në këtë rregullore.

Neni 14.

14.1. Ndryshimet dhe plotësimet eventuale në këtë rregullore bëhen sipas procedurës së nxjerrjes së saj.

Neni 15.

15.1. Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit Komunal.

15.2. Në rast mosrespektimi të kësaj rregulloreje kompetente për zgjidhjen e lëndës është Gjykata Komunale në Gjilan.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

01.Nr. 12078
Gjilan, më 12.10.2009


Kryesuesi i kuvendit,

/Bujar NEVZATI/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, gje.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u bazuar në nenin 41 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 55 të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e jashtëzakonshme të datës 26.02.2010, miratoi këtë:

V E N D I M

PËR ZGJEDHJEN E KRYESUESIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË GJILANIT

I

Me këtë vendim, z. Izmi Zeka zgjidhet Kryesues i Kuvendit të Komunës së Gjilanit, me mandat të njëjtë, sikurse anëtarët e tjerë të Kuvendit.

II

Funksionin e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Gjilanit, z. Izmi Zeka, do ta ushtroj në harmoni me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës së Gjilanit dhe dispozitat tjera ligjore që janë në fuqi.

III

Ky vendim hun në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

01.Nr. 2555
Gjilan, më 26.02.2010


Kryesuesi i seancës

/Xhyzide ISMAJLI/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, [gëg.gjilani-komuna.org](http://www.gjilani-komuna.org); e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u bazuar në nenin 62, 66.3, 67.2 dhe 68.1 të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e jashtëzakonshme të datës 26.02.2010, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR APROVIMIN NË PARIM TË NUMRIT TË KOMITETEVE TË KK-GJILAN
DHE NUMRIN E ANËTARËVE TË KOMITETEVE

I

Me këtë vendim, aprovohet në parim numri i përgjithshëm i Komiteteve të KK-Gjilan, si dhe numri i anëtarëve të secilit komitet.

II

Sipas këtij vendimi, Kuvendi i Komunës së Gjilanit do të ketë dy (2) Komitete të përhershme: Komitetin për Politikë dhe Financa, me nëntë (9) anëtarë dhe Komitetin për Komunitete më shtatë (7) anëtarë si dhe: Komitetin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Komitetin për Arsim, Komitetin për Zhvillim Ekonomik, Komitetin për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, Komitetin për Shërbime Publike Komunale, Mbrojtje dhe Shpëtim, Komitetin për Kulturë, Rini, Sport dhe Çështje Gjinore, dhe Komitetin për Pronë, Kadastër dhe Banim, të cilat do të kenë nga shtatë (7) anëtarë.

III

Përfaqësuesit e grupimeve politike gjatë caktimit të përbërjes së numrit të anëtarëve të secilit komitet me marrëveshje mund të bëjnë dizajnin e përbërjes së tyre, përderisa lëvizjet përbrenda komiteteve mund të bëhen në secilën kohë.

IV

Ky vendim hun në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

01.Nr. 2556
Gjilan, më 26.02.2010


Kuvendi i Komunës,

Izmi Zeka, Kryesues



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, gje.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u bazuar në nenin 66, 67 dhe 68 të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 26.03.2010, miratoi këtë :

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E PËRBËRJES SË KOMITETEVE TË KUVENDIT TË
KOMUNËS SË GJILANIT

I

Me këtë vendim caktohet përbërja e Komiteteve të Kuvendit të Komunës së Gjilanit, dhe atë si vijon:

I

KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA			
	Emri e mbiemri	Anëtarët e Kuvendit	Subjekti politik
1	Izmi Zeka	po	PDK
2	Sabedin Kadriu	po	PDK
3	Riad Rashiti	po	PDK
4	Sadudin Berisha	po	LDK
5	Arben Mehmeti	po	LDK
6	Sokol Haziri	po	AAK
7	Arben Maliqi	po	AKR
8	Jakup Bajrami	po	LDD
9	Ibrahim Neziri	po	G+3

II

KOMITETI PËR KOMUNITETE			
	Emri e mbiemri	Anëtarët e Kuvendit	Subjekti politik
1	Enver Hajrullahu	po	PDK
2	Bardhyl Kadriu	jo	LDK
3	Fadil Gashi	jo	AAK
4	Tasiq Zvonko	jo	komuniteti serb
5	Simonoviq Zoran	jo	komuniteti serb
6	Galip Hiseni	jo	komuniteti rom
7	Kemal Sahin	jo	KDTP

III

KOMITETI PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE			
	Emri e mbiemri	Anëtarët e Kuvendit	Subjekti politik
1	Shkëlqim Latifi	po	PDK
2	Abdylatif Latifi	jo	PDK
3	Hajriz Ibrahim	jo	PDK
4	Jashar Jashari	po	LDK
5	Sami Ahmeti	jo	LDK
6	Ilaz Poroshtica	jo	AKR

7	Nexhat Halili	jo	LDD
---	---------------	----	-----

IV

KOMITETI PËR ARSIM			
	Emri e mbiemri	Anëtarët e Kuvendit	Subjekti politik
1	Ejup Haziri	po	PDK
2	Shukrije Rapuca	po	PDK
3	Rashit Sahiti	po	LDK
4	Agim Rexhepi	jo	LDK
5	Saranda Bllaca	po	LDD
6	Nazif Sylejmani	jo	AKR
7	Ajtene Shahiqi	jo	AAK

V

KOMITETI PËR PLANIFIKIM URBAN DHE MBROJTJE TË MJEDISIT			
	Emri e mbiemri	Anëtarët e Kuvendit	Subjekti politik
1	Florina Zymberi	po	PDK
2	Naser Sylejmani	jo	PDK
3	Ramiz Ramadani	po	LDK
4	Bekim Isaku	jo	LDK
5	Xhafer Xhelili	jo	AKR
6	Rexhep Kadriu	jo	AAK
7	Fatlum Jashari	po	G+3

VI

KOMITETI PËR ZHVILLIM EKONOMIK			
	Emri e mbiemri	Anëtarët e Kuvendit	Subjekti politik
1	Elisah Ymeri	po	PDK
2	Burhan Selmani	jo	PDK
3	Abdyl Aliu	po	LDK
4	Fidan Qerimi	jo	LDK
5	Mevlide Zejnullahu	jo	AAK
6		jo	AKR
7	Berat Dindar	jo	KDTP

VII

KOMITETI PËR SHËRBIME PUBLIKE , KOMUNALE , MBROJTJE DHE SHPËTIM			
	Emri e mbiemri	Ant. i kuvendit	Subjekti politik
1	Shpresa Jahiri	po	PDK
2	Shaqir Ukshini	jo	PDK
3	Ramadan Ajvazi	jo	LDK
4	Selami Xhemaili	jo	AAK
5	Zijadin Maliqi	po	LDD
6	Bujar Shkodra	jo	AKR
7	Sejdi Selimi	jo	G+3

VIII

KOMITETI PËR KULTURË, RINI, SPORT DHE ÇËSHTJE GJINORE			
	Emri e mbiemri	Ant. i kuvendit	Subjekti politik
1	Tair Arifi	po	PDK
2	Arzie Nuhiu	po	PDK
3	Jehona Hyseni	po	LDK
4	Shpresa Hajdari	po	LDK

5	Hamid Azemi	jo	AAK
6	Shpresa Kurteshi	po	LDD
7	Naim Ejupi	jo	G+3

IX

KOMITETI PËR PRONË , KADASTËR DHE RINDËRTIM

	Emri e mbiemri	Ant. i kuvendit	Subjekti politik
1	Xhyzide Ismajli	po	PDK
2	Ali Arifi	jo	PDK
3	Fahri Shaqiri	jo	PDK
4	Nevzad Rushiti	jo	LDK
5	Isa Bunjaku	jo	LDD
6	Luljeta Dubova	jo	AAK
7	Tefik Maksuti	po	G+3

II

Komitetet nga pika I e këtij vendimi duhet të kenë përfaqësim gjinor dhe të pasqyrojnë në mënyrë sa më të përafërt proporcionin e vendeve që mbajnë partitë politike dhe koalicionet në Kuvendin Komunal.

III

Komitetet e formuara si në pikën I të këtij vendimi zgjedhin kryesuesin dhe zëvendëskryesuesin nga anëtarët dhe prej anëtarëve të vet, përderisa Komitetin për Politikë dhe Financa e kryeson kryesuesi i Kuvendit, e në mungesë të tij, njëri nga anëtarët e Komitetit.

IV

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, pushon të vlejë Vendimi për formimin dhe përbërjen e Komiteteve të Kuvendit të Komunës së Gjilanit, 01.Nr.3432 i datës 30.03.2009.

V

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit, dhe Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Gjilanit

VI

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

01.Nr. 3642
Gjilan, më 26.03.2010


Kuvendi i Komunës,

Izmi Zeka, Kryesues,



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, www.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u bazuar në nenin 61.2 dhe 61.3 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 84 të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 19.05.2010, miratoi këtë:

V E N D I M

PËR EMËRIMIN E NËNKRYETARIT TË KOMUNËS PËR KOMUNITETE

I

Me këtë vendim z.Nenad Cvetković, emërohet Nënkyetar i Komunës së Gjilanit për Komunitete.

II

z.Nenad Cvetković, funksionin e Nënkyetarit të Komunës për Komunitete do ta ushtroj në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi dhe mandati i tij në këtë pozitë, do të jetë i njëjtë me mandatin e Kryetarit të Komunës.

III

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Kryetari i Komunës së Gjilanit.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

01.Nr. 5790
Gjilan, më 19.05.2010


Kuvendi i Komunës,

Izmi Zeka, Kryesues



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, www.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u bazuar në nenin 17, shkronja s) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 38.1, shkronja l) të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e datës 19.05.2010, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR RUAJTJEN E VENDEVE TË PUNËS PËR TË GJITHË
SHËRBYESIT CIVILË TË CILËT JANË ZGJEDHUR ANËTARË TË KUVENDIT
TË KOMUNËS SË GJILANIT

I

Me këtë vendim u ruhen vendet e punës të të gjithë shërbyesve civilë të cilët kanë kontrata valide tri (3) vjeçare të punës, e të cilët janë zgjedhur anëtarë të Kuvendit të Komunës së Gjilanit, në zgjedhjet lokale të datës 15.11.2009, dhe që janë përcaktuar që të jenë anëtarë të Kuvendit të Komunës së Gjilanit, duke hequr dorë nga pozitat e dyfishta.

II

Zbatimin e këtij vendimi e bënë kryetari i Komunës së Gjilanit.

III

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.


01.Nr. 5796
Gjilan, më 19.05.2010

Kuvendi i komunës,
Izmi Zeka, Kryesues



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, gje.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u mbështetur në nenin 38.1, shkronja d) dhe e) të Statutit të Komunës së Gjilanit, si dhe në pikën 2.2.1.4 të Udhëzuesit për Banim Social të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 19.05.2010 miratoi këtë:

V E N D I M
PËR EMËRIMIN E KOMISIONIT PËR PËRCAKTIMIN E PËRFITUESVE PËR
VËNDOSJE NË OBJEKTIN PËR BANIM SOCIAL

I

Me këtë vendim formohet komisioni i cili do të bëjë përcaktimin e përfituesve për vendosje në objektin për banimi social, me këtë përbërje:

- 14. Ibrahim Salihu, kryesues
- 15. Florim Maloku, anëtar
- 16. Ejup Sylejmani, anëtar
- 17. Nazif Sylejmani, anëtarë
- 18. Mimoza Kadriu, anëtare
- 19. Vesimir Saviq, anëtar

II

Komisioni i formuar sipas pikës I të këtij vendimi, ka për detyrë që të bëjë përzgjedhjen e përfituesve të mundshëm për vendosjen në objektin e banimit social dhe pas hartimit të "listës me emrat e përfituesve të mundshëm" do të bëhet publikimi i kësaj liste në tabelën e shpalljeve.

III

Komisioni po ashtu ka për detyrë që të bëjë hulumtimin e të gjitha rasteve sociale si dhe shqyrtimin e të gjitha kërkesave të cilat i drejtohen Institucioneve komunale si dhe hartimin e Listës edhe me të gjitha rastet sociale në Komunën e Gjilanit

IV

Komisioni do të ndihmohet edhe nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Çështje Sociale dhe Qendra për Punë dhe Mirëqenie Sociale në Gjilan.

V

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit.

VI

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

01.Nr. 5798
Gjilan, më 19.05.2010


Kuvendi i komunës,

Izmi ZEKA, Kryesues



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, gje.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Në bazë të nenit 40 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 52/2009), nenit 38. pika c të Statutit të Komunës së Gjilanit, si dhe bazuar në rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa të datës 10.06.2010, Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në seancën e vetë të mbajtur më: 18.06.2010, miraton këtë:

V E N D I M

Për lejimin e kompensimit të pronës së paluajtshme përmes ndërrimit

I.

Me këtë Vendim, Komunës së Gjilanit i **Le j o h e t: kompensimi përmes ndërrimit** të pronave të paluajtshme dhe atë:

Pjesa e Parcelës Kadastrale nr.4517, në sipërfaqe prej gjithsej: 01.47.25 ha, me kulturë: Kullosë e kl. IV-të, vendi i quajtur: "Kalilo", Zona Kadastrale-Koretishtë, e evidentuar në Fletë posedimin nr. 516, si Pasuri Shoqërore e Kuvendit të Komunës së Gjilanit

Me

Pjesën e Parcelës Kadastrale nr. 4495, me kulturë: kullosë e kl. V-të, vendi i quajtur: "Kalilo", Zona Kadastrale-Koretishtë, në sipërfaqe prej 0. 21.47 ha, e regjistruar në Fletë posedimin nr. 242, në emër të Hazire Mehmeti nga Pasjaku.

II.

Kompensimi përmes ndërrimit të paluajtshmërive nga pika I. e këtij vendimi, bëhet më qëllim të kryerjes së obligimeve të Komunës ndaj pronarit të mëparshëm të kësaj prone, të shpronësuara për realizimin e interesit publik, me rastin e caktimit të lokacionit të Deponisë në fshatin Pasjak.

III.

Caktimin e vlerës-ekuivalencës së paluajtshmërive të shpronësuara nga pika I. të këtij vendimi të do ta bëjë Komisioni Profesional i KK-së Gjilan, në bazë të nenit 5.1. të Ligjit për Shpronësimin e pronës së paluajtshme.

IV.

Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër, Pronë dhe Banim e KK-ës Gjilan, që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme administrativo-teknike të përgatitjes së shënimeve për ndërrimin e paluajtshmërisë nga pika I. e këtij vendimi dhe regjistrimin e ndryshimeve të të njëjtave prona në emër të pronarëve të rinj, menjëherë pas nënshkrimit të marrëveshjes për ndërrim me pronarët e mëhershëm.

V.

Mbi zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit,
Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronësi e KK-ës Gjilan.

VI.

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e miratimit.

Nr. 01. 7288
Gjilan, më 18.06.2010


Kuvendi i Komunës,

Izmi ZEKA, Kryesues



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, gje.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u bazuar në Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa të datës 10.06.2010, si dhe bazuar në kërkesën e Drejtorisë për Arsim, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e datës 18.06.2010, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR RUAJTJEN E VENDEVE TË PUNËS PËR DREJTORËT DHE
ZËVENDËSDREJTORET E INSTITUCIONEVE EDUKATIVO-ARSIMORE
DHE AFTËSUESE

I

Me këtë vendim, me qëllim të inkurajimit për të konkurruar të kandidatëve sa më të suksesshëm u ruhen vendet e punës të gjithë kandidatëve të cilët zgjidhen në pozitat e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese.

II

Po ashtu me këtë vendim, u ruhen vendet e punës edhe kandidatëve që aktualisht janë në pozitat e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve në institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese.

III

Sipas këtij vendimi të gjithë drejtorët dhe zëvendësdrejtorët pas përfundimit të mandatit do të kenë përparësi punësimi në institucionet arsimore në momentin e krijimit të kushteve, në ato vende të punës që u përgjigjen kualifikimit të tyre.

IV

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Arsimit

V

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

01.Nr. 7289
Gjilan, më 18.06.2010


Kuvendi i Komunës,

Izmi Zeka, Kryesues



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, [gëgë.gjilani-komuna.org](http://www.gjilani-komuna.org); e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u bazuar në nenin 17, shkronja s) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 38.1, shkronja l) të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e datës 18.06.2010, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR RUAJTJEN E VENDEVE TË PUNËS PËR TË GJITHË DREJTORËT E
DREJTORIVE KOMUNALE

I

Me këtë vendim u ruhen vendet e punës të gjithë shërbyesve civilë dhe punëtorëve të arsimit të cilët me vendimin e Kryetarit të Komunës janë emëruar në pozitat e Drejtorëve të drejtorive komunale.

II

Zbatimin e këtij vendimi e bënë Kryetari i Komunës së Gjilanit.


III

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

01.Nr. 7293
Gjilan, më 18.06.2010

Kuvendi i Komunës,

Izmi Zeka, Kryesues



Në bazë të nenit 11, 12.2 pika c) dhe 34.4 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen e Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/2008), Udhëzimit Administrativ të MAPL-së nr. 2008/08 për Marrëveshjet e Bashkëpunimit të Komunës me fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane, të nenit 10.4, 52.2 shkronja a) të Statutit të Komunës së Gjilanit, 01. nr. 12479 te dt. 21.11.2008 Kuvendi i Komunës së Gjilanit në mbledhjen e vetë të mbajtur me 09.07.2010, miraton:

R R E G U L L O R E N
PËR ORGANIZIMIN DHE BASHKËPUNIMIN E KOMUNËS ME
FSHATRAT, VENDBANIMET DHE LAGJET URBANE
NË TERRITORIN KOMUNËS SË GJILANIT

I. Dispozitat e përgjithshme

Qëllimi

Neni 1

Kjo rregullore, rregullon organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës së Gjilanit me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e saj, zgjedhjen e këshillave, kompetencat dhe përgjegjësit e këshillit, në ushtrimin e aktiviteteve që janë në kompetencë të komunës.

Konstituimi (themelimi) i këshillave Lokale

Neni 2

- 2.1. Për të realizuar sa ma mirë funksionet e parapara me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës dhe rregulloret komunale, Komuna e Gjilanit në fshatra, vendbanime apo lagje urbane do të zgjedh këshillat dhe kryetarin e këshillit.
- 2.2. Në pamundësi që në çdo fshat, vendbanim ose lagje urbane të zgjedhën këshillat, atëherë një këshill mund të përfshijë një e më tepër fshatra, vendbanime apo lagje urbane.

Neni 3

- 3.1. Këshillat i fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane, do të kenë mund të ketë prej 5 deri në 7 anëtar.
- 3.2. Përbërja e këshillave, duhet të reflektojë përfaqësimin gjinor.
- 3.3. Në rast se në fshat, vendbanim, apo lagje urbane jetojnë anëtarë të pakicave, ata duhet të jenë të përfaqësuar në këshill së paku me një (1) anëtar.

- 3.4. Këshilli i fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane zgjidhet në tubimet e qytetarëve të tyre në mënyrë dhe procedurë, që është e përcaktuar me këtë rregullore.
- 3.5. Tubimin publik do ta hapë qytetari më i vjetër i cili merr pjesë në tubimin dhe kryeson me tubimin deri në zgjedhjen e këshillit.
- 3.6. Këshilli zgjidhet në mandat për (4) katër vite dhe nga radhët e anëtarëve të tij, zgjedh kryetarin me mandat për katër (4) vite. Deri te zgjedhja e kryetarit të këshillit, me të udhëheq anëtari më i vjetër i këshillit.
- 3.7. Për kryetar të këshillit, zgjidhet kandidati i cili ka fituar shumicën e votave, nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane në tubimin zgjedhor. Nëse në rrethin e parë asnjë nga kandidatët për kryetar të këshillit nuk ka fituar numrin e duhur të votave, organizohet rrethi i dytë i votimit për dy kandidatë, të cilët kanë fituar numër më të madh të votave.
- 3.8. Kryetari i këshillit thërret dhe udhëheq me mbledhjet e këshillit dhe kujdeset për organizimin dhe punën e këshillit. Po ashtu, ai i nënshkruan aktet e miratuara nga ana e këshillit dhe është i obliguar në afat prej 14 ditëve, nga dita e miratimit të tyre, t'i dorëzojë te kryetari i Komunës, për shkak të publikimit të tyre në gazetën zyrtare ose web faqen e Komunës.
- 3.9. Shkarkimi i këshillit dhe kryetarit të këshillit bëhet sipas procedurës së njëjtë të zgjedhjes së këshillit dhe kryetarit.

Neni 4

Numri Këshillave të fshatrave, vendbanimeve apo lagjeve urbane dhe përbërja e tyre do të paraqitet në listë të veçantë e cila do të jetë pjesë e kësaj rregulloreje.

Neni 5

- 5.1. Kuvendi i Komunës emëron një komision për të udhëhequr dhe koordinuar punën në terren në zgjedhjen e këshillave. Komisioni duhet të përfshijë anëtarë të spektrit politik, etnik dhe gjinor të përfaqësuar në Kuvendin e Komunës.
- 5.2. Komisioni emërohet me vendim të veçantë të Kuvendit të Komunës.

Neni 6

6.1. Dy javë para datës së mbajtjes së tubimit të qytetarëve për zgjedhjen e këshillave, Kuvendi i Komunës, nëpërmjet zyrës për informim, informon qytetarët ndër të tjera edhe përmes:

- a). shpalljeve publike në vendet më të frekuentuara brenda territorit të komunës;
- b). medieve të shkruara dhe elektronike lokale dhe
- c). web – faqes zyrtare të Komunës.

6.2. Njoftimi i publikut sipas paragrafit 6.1 të kësaj rregulloreje, domosdo duhet të përmbajë:

- a) datën e tubimit të qytetarëve;
- b) kohën e tubimit të qytetarëve;

- c) vendin e mbajtjes së tubimit të qytetarëve dhe
- d) rendin e ditës.

Neni 7

- 7.1. Procesverbalin i hartuar nga tubimi i qytetarëve, duhet të përshkruaj: numrin e qytetarëve që kanë marrë pjesë në tubim, të dhënat për zgjedhjen e këshillit , procedurat e votimit dhe çështje tjera të nevojshme, që duhet të shënohen në procesverbal.
- 7.2. Procesverbalin e nënshkruan kryesuesi i tubimit dhe procesmbajtësi, ndërsa komisioni i përcaktuar sipas nenit 5 të kësaj rregulloreje i raporton Kuvendit të Komunës për rrjedhën e tubimeve për zgjedhjen e këshillave të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane.

Kompetencat dhe përgjegjësit e Këshillit

Neni 8

Këshilli i fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane ushtron kompetencat dhe përgjegjësitë e përcaktuara si më poshtë:

- a) kujdeset për planifikimin urban dhe rural;
- b) kujdeset për furnizim me ujë, rregullimin e kanalizimit, drenazhimet etj;
- c) kujdeset për ofrimin e shërbimeve publike efikase;
- d) kujdeset që qytetarëve t'ju ofrohet mbrojtja shëndetësore primare;
- e) kujdeset për mbrojtjen lokale të ambientit;
- f) kujdeset për zhvillimin e turizmit;
- g) kujdeset për sigurimin e hapësirave të hapura dhe varrezave;
- h) kujdeset për organizimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive;
- i) bashkëpunon me organet e Komunës dhe organizatat tjera për çështjet me interes për lokalitetin;
- j) evidenton dhe paraqet prioritetet e lokalitetit para organeve të Komunës;
- k) merr pjesë në emër të qytetarëve të lokalitetit në financimin e çështjeve që janë pjesë e marrëveshjes së bashkëpunimit në mes Komunës;
- l) kujdeset për organizimin e aksioneve vullnetare në interes për lokalitetin dhe
- m) kryen edhe detyra tjera të cilat mund të jenë të bartura nga Kuvendi i Komunës ose Kryetari i Komunës, në pajtim me ligjin dhe Statutin e Komunës.

Neni 9

Në bazë të nevojave dhe të kërkesës së qytetarëve apo me iniciativën e Këshillit mundë të përcaktohet grumbullimi i vetë kontributit të qytetarëve në pajtueshmëri me legjislacionin e zbatueshëm në Kosovë. Vendimin e merr këshilli.

Përgjegjësit e bartura nga komuna në Këshill

Neni 10

10.1. Me kërkesën e Këshillit dhe rekomandimin e Kryetarit të komunës apo ndonjë komiteti të komunës, Kuvendi i komunës me vendim mund të bartë disa përgjegjësi për t'i ushtruar Këshillat e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane.

10.2. Komuna ofron burime të mjaftueshme për fshatrat, vendbanimet apo lagjet urbane, me qëllim të përmbushjes së përgjegjësisë së bartur.

Bashkëpunimi i organeve të administratës komunale me këshilla

Neni 11

Fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të komunës së Gjilanit, me pëlqimin e tyre mund të organizohen dhe bashkëpunojnë në mes veti për ushtrimin e aktiviteteve të përbashkëta të bartura nga komuna. Vendimin për bashkëpunimin e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane e miraton Kuvendi i Komunës në bazë të kërkesës së fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane.

Mospërmbushja e përgjegjësisë

Neni 12

Për të gjitha punët e bartura në Këshill nga Kuvendi i Komunës, Këshilli i fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane përkatëse mban obligime dhe përgjegjësi ligjore në rast të keqpërdorimit eventual. Përgjegjësia mund të jetë individuale apo kolektive para qytetarëve dhe organeve përkatëse.

II. Dispozitat përfundimtare dhe kalimtare

Neni 13

Në rast konflikti të dispozitave të kësaj rregulloreje me Ligjin për vetëqeverisjen lokale dhe Statutin e Komunës mbizotërojnë dispozitat e ligjit apo statutit.

Neni 14

Ndryshimet dhe plotësimet eventuale në këtë Rregullore do të bëhen sipas procedurës së nxjerrjes të së njëjtës.

Neni 15

Kjo rregullore hynë në fuqi ditën e miratimit nga ana e Kuvendi Komunës.

01. nr. 8356
Gjilan, më 09.07.2010

Kuvendi i Komunës

Izmi Zeka, Kryesues

Lista

N/R	Këshillat e fshatit, vendbanimeve apo lagjeve urbane në territorin e komunës së Gjilanit
1	Këshilli i Bashkësisë Urbane "Arbëria"
2	Këshilli i Bashkësisë Urbane "Zabeli i Sait Agës"
3	Këshilli i Bashkësisë Urbane "Qarku"


4	Këshilli i Bashkësisë Urbane “Dardania”
5	Këshilli i Bashkësisë Urbane “Kodra e Dëshmorëve”
6	Këshilli i Bashkësisë Urbane “Dheu i Bardh”
7	Këshilli i Bashkësisë Urbane “Qendra 1 ”
8	Këshilli i Bashkësisë Urbane “Qendra 2 ”
N/R	KËSHILLAT E FSHATRAVE DHE VENDBANIMEVE
1	Bashkësia Lokale Cernicë
	Vrapqiq
	Kravaricë
	Gumnishtë
2	Bashkësia Lokale Bresalc
	Poneshi
3	Bashkësia Lokale Pogragjë
	Bilinicë
	Llovcë
	Sllubicë
	Stublinë
	Inatoc - Kokaj
4	Bashkësia Lokale Dobërqan
	Bukovik
	Muhagjirët e Dobërqanit (D. I vogël)
5	Bashkësia Lokale Muqibabë
	Burincë
	Lipovicë
6	Bashkësia Lokale Perlepticë
7	Kosaqë
8	Kodra e Përlepticës
9	Bashkësia Lokale Kmetoc
	Vërbicë e Kmetocit
	Muhagjirët e Shilloves

10	Bashkësia Lokale Malishevë
	Caparë
	Malishevë e epërme
11	Bashkësia Lokale Uglarë
12	Bashkësia Lokale Velekincë
13	Bashkësia Lokale Llashticë
14	Bashkësia Lokale Lladovë
	Nasalë
15	Bashkësia Lokale Zhegër
	Demiraj
	Haxhaj
	Kurexh
	Terziaj
	Selishtë
16	Bashkësia Lokale Shurdhan
	Çelik
	Dunav
	Goden i Ulët
	Pidiq
	Stanqiq
	Isufaj
17	Bashkësia Lokale Kishnapolë
	Gadish
	Sllakoc i Epërm
	Sllakoc i Ulët
18	Bashkësia Lokale Verbicë e Zhegocit
	Zhegoc
19	Bashkësia Lokale Livoq i poshtëm
20	Bashkësia Lokale Livoq i epërm
21	Bashkësia Lokale Shillovë



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, www.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u bazuar në nenin 52.2, shkronja a) të Statutit të Komunës së Gjilanit, si dhe bazuar në Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa të datës 30.06.2010, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 09.07.2010 miratoi këtë:

VENDIM

Për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores mbi mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të Palestrës së sporteve "Bashkim Selishta-Petriti" në Gjilan

I

Me këtë vendim bëhet ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores mbi mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të Palestrës së sporteve "Bashkim Selishta-Petriti" në Gjilan, 01.Nr.7834 të datës 14.07.2009 dhe atë:

- në nenin 3.3, shkronja a) në vend të tekstit: "**pa ndriçim 15€**", duhet të jetë: "**pa ndriçim 8€**", dhe në vend të tekstit: "**me ndriçim 20€**", duhet të jetë: "**me ndriçim 12€**".

II

Ky vendim do të jetë pjesë përbërëse e Rregullores mbi mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të Palestrës së sporteve "Bashkim Selishta-Petriti" në Gjilan, 01.Nr.7834 të datës 14.07.2009.

III

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, ndërsa Kryetari i Komunës e përcjell zbatimin e tij.


IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

Nr.01. 8363
Gjilan, më 09.07.2010

Kuvendi i Komunës,

Izmi Zeka, Kryesues



Në mbështetje të nenit 11, 12 shkronja c) dhe nenit 17 shkronja r)) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008) dhe nenit 38 shkronja k) dhe 39.1 të Statutit të Komunës së Gjilanit 01. nr. 12479 të dt. 21.11.2008, Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në mbledhjen e mbajtur më 09.07.2010, miraton;

R R E G U L L O R E
PËR SHFRYTËZIMIN/HUAZIMIN E SALLËS SË MADHE
TË TEATRIT PROFESIONIST TË GJILANIT

Neni 1.

Salla e madhe e Teatrit Profesionist të Gjilanit mund të shfrytëzohet nga të interesuarit:

- me pagesë dhe
- pa pagesë

Neni 2.

Salla e Teatrit mund të shfrytëzohet pa pagesë vetëm në këto raste:

- a. Me rastin e manifestimeve/festave shtetërore,
- b. Me rastin e organizimeve me qëllime humanitare/jo profitabile apo komerciale nga organizatat, shoqatat humanitare apo O.J.Q.-të e ndryshme.
- c. Me vendim të Kryetarit të Komunës së Gjilanit.

Neni 3.

Salla e Teatrit mund të shfrytëzohet nga qytetarët/institucionet/organizatat me pagesë:

1. Me çmim fiks, duke paguar 296 euro, që do të thotë 1€ për ulëse për dy(2) orë shfrytëzim (kjo do të thotë vetëm sallën e ndriçuar dhe të pastruar). Për çdo zgjatje nga shfrytëzuesi duhet të merret leje nga Drejtoria e Teatrit dhe për çdo orë shtesë shfrytëzuesi duhet të paguaj 100 euro shtesë.
2. Me përqindje nga numri i tërësishëm i shitjes së biletave 70% për shfrytëzuesin dhe 30% për Teatrin.

Neni 4.

- 4.1. Shfrytëzimi i sallës nga Neni 2(dy), pika (a) i kësaj rregulloreje bëhet ekskluzivisht për festat më të rëndësishme shtetërore dhe ato me Vendim të Kryetarit të Komunës. Çdo manifestim tjetër duhet t'i nënshtrohet Neni 3(tre), që do të thotë pagesë fikse.
- 4.2. Shfrytëzimi i sallës nga Neni 2 (dy), pika (b), bëhet në atë mënyrë që organizatat dhe shoqatat humanitare, si dhe O.J.Q.-të e ndryshme, duhet ta parashtrojnë kërkesën në afatin që përcakton kjo rregullore në Drejtorinë e Teatrit për të marr lejen e shfrytëzimit. Kjo nënkupton vetëm aktivitetet që kanë qëllime humanitare

dhe jo profitabile, përndryshe shfrytëzuesi duhet t'i nënshtrohet Neni 3 (tre) pikës (1), që do të thotë pagese fikse.

- 4.3. Shfrytëzimi i sallës nga Neni 2(dy), pika (c), bëhet në atë mënyrë që Kryetari i Komunës merr vendim dhe me shkrim e njofton drejtorinë e Teatrit së paku dy javë përpara, me qëllim që me kohë të bëhen përgatitjet për shfrytëzimin e sallës dhe të riorganizohet orari i aktiviteteve skenike në Teatër.
- 4.4. Po ashtu edhe çdo kërkesë tjetër nga të interesuarit për shfrytëzim duhet të bëhet së paku dy (2) javë përpara datës së shfrytëzimit, përndryshe kërkesa nuk do të merret parasysh. Edhe nëse kërkesa bëhet me kohë, kjo nuk siguron edhe miratimin e saj, përderisa kjo pengon procesin në të cilin ndodhet aktiviteti teatror dhe përderisa drejtorja nuk e njofton parashtruesin e kërkesës.

Neni 5.

Shfrytëzimi i sallës nga neni 3 (tre) i kësaj rregulloreje mund të bëhet si në vijim:

- a. Të interesuarit mund ta shfrytëzojnë sallën e Teatrit Profesionist të Gjilanit me përqindje 70/30, ku 70% i takojnë shfrytëzuesit, kurse 30% i takojnë Teatrit Profesionist të Gjilanit. Kjo vlen vetëm për Teatrot Profesioniste dhe për institucionet tjera që Drejtorja e Teatrit i konsideron si të rëndësishme dhe që përputhen me politikat e përgjithshme zhvillimore të Teatrit. Këtu kryesisht përfshihen shfaqjet teatrale, të baletit, operës, muzikës dhe muzikës serioze.
- b. Të interesuarit mund ta shfrytëzojnë sallën e Teatrit Profesionist të Gjilanit me çmim fiks duke paguar 296euro që do të thotë 1€ për një ulëse. Kjo vlen për të gjithë shfrytëzuesit tjerë, përpos për institucionet e shënuara në Nenin 5(pesë), Pika (a), si dh neni 4(katër), Pika 1(një).
- c. Salla nuk do të jepet në shfrytëzim për koncerte përveç atyre të muzikës serioze, përpos nëse Drejtorja e Teatrit konstaton se ai aktivitet nuk dëmton sallën dhe politikën zhvillimore dhe artistike të Teatrit Profesionist të Gjilanit.

Neni 6.

- 6.1.Salla dhe skena do të kontrollohen paraprakisht dhe shfrytëzuesi do të njoftohet mbi gjendjen e përgjithshme. Pas aktivitetit shfrytëzuesi ka për detyrë që të lajmëroj përfundimin e aktivitetit në drejtori dhe me personin adekuat nga Teatri Profesionist i Gjilanit do të bëhet një kontroll mbi gjendjen e përgjithshme në sallë dhe skenë.
- 6.2.Po që se vlerësohet se janë bërë dëme apo mungon diçka atëherë shfrytëzuesi merr të gjitha përgjegjësitë dhe obligohet që t'i paguaj, riprodhoj apo riparoj të gjitha dëmet e shkaktuara gjatë kohës së shfrytëzimit të sallës.

Neni 7.

- 7.1. Në rast se gjatë shfrytëzimit të sallës përdoret skena dhe prapaskena, e sidomos nga të rinjtë apo fëmijët, shfrytëzuesi është i obliguar që të ketë në dispozicion mbikëqyrës të rritur kompetent. Për 15 fëmijë apo të rinj duhet të ketë 1(një) mbikëqyrës të rritur.
- 7.2. Në rast se shfrytëzuesi kërkon të përdoren grimoret, duhet të negocioj me drejtorinë për të marrë leje. Të gjitha rregullat që gjenden në Nenin 6(gjashtë). vlejnë edhe për grimoret.
- 7.3. Në sallë, skenë, prapaskenë dhe grimore ndalohet rreptësisht pirja e duhanit dhe ngrënia e gjërave ushqimore.

Neni 8

- 8.1. Për zbatimin e kësaj rregulloreje do të kujdeset Organi Ekzekutiv i Teatrit dhe Drejtoria për Rini, Kulturë dhe Sport.
- 8.2. Mbikëqyrjen e realizimit të kësaj rregulloreje e bënë Kryetari i Komunës.

Neni 9

Kjo Rregullore hynë në fuqi ditën e miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës, dhe mund të ndryshohet në mënyrën e njëjtë siç është nxjerrë..

01.Nr. 8366
Gjilan, më 09.07.2010


Kuvendi i Komunës

Izmi Zeka, Kryesues



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, www.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 09.07.2010, duke u bazuar në Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa të datës 30.06.2010, miratoi këtë:

VENDIM

Për ndalimin e shitjes të pronave publike nga AKP-ja

I

Me këtë vendim ndalohet shitja e të gjitha pronave publike dhe shoqërore në procesin e privatizimit nga AKP-ja, të cilat paraqesin interes të veçantë për Komunën e Gjilanit, pa konsultimin paraprak me institucionet komunale.

II

Po ashtu me këtë vendim obligohet Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi, Pronë dhe Banim, që të hartoj një Listë me të gjitha pronat publike të cilat paraqesin interes të veçantë për Komunën e Gjilanit dhe të njëjtën t'ua dorëzoj autoriteteve përgjegjëse të AKP-s.

III

Ky vendim bazohet në nevojat e skajshme të shoqërisë së Gjilanit për tokë, në pronësi të komunës në të cilën ajo i ka planifikuar (dhe i planifikon edhe në të ardhmen) zhvillimet e aspekteve publike (hapësira industriale, shkolla, çerdhe, rrugë etj).

IV

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër, Pronë dhe Banim dhe Kryetari i Komunës së Gjilanit.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

Nr.01. 8367
Gjilan, më 09.07.2010


Kuvendi i Komunës,

Izmi Zeka, Kryesues



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, [gëgë.gjilani-komuna.org](http://www.gjilani-komuna.org); e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u bazuar në vendimin e Qeverisë së Kosovës numër 03/273, si dhe bazuar në Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa të 30.06.2010, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 09.07.2010, miraton këtë:

V E N D I M
PËR ZBATIMIN E VENDIMIT TË QEVERISË SË KOSOVËS NR. 03/273 TË
26.09.2007

I

Me këtë vendim Kuvendi i Komunës së Gjilanit e zbaton vendimin e Qeverisë së Kosovës numër 03/273 të 26.09.2007, sipas të cilit pronat e stacioneve të autobusëve u barten në menaxhim komunave të Kosovës.

II

Sipas këtij vendimi Stacioni i Autobusëve në Gjilan i bartet në menaxhim Kuvendit të Komunës së Gjilanit, përkatësisht Drejtorisë për Shërbime Publike.

III

Zbatimin e këtij vendimi e bën Drejtoria për Shërbime Publike, ndërsa për zbatimin e tij kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit në Kuvendin e Komunës së Gjilanit

01.Nr. 8368
Gjilan, më 09.07.2010


Kuvendi i Komunës,

Izmi Zeka, Kryesues



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, [gëgë.gjilani-komuna.org](http://www.gjilani-komuna.org); e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u bazuar në nenin 61.2 dhe 61.3 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 84 të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 08.10.2010, miratoi këtë:

V E N D I M **PËR EMËRIMIN E NËNKRYETARIT TË KOMUNËS SË GJILANIT PËR** **KOMUNITETE**

I

Me këtë vendim z.Milan Stojanoviq, emërohet Nënkyetar i Komunës së Gjilanit për Komunitete.

II

z.Milan Stojanoviq, funksionin e Nënkyetarit të Komunës për Komunitete do ta ushtroj në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, dhe mandati i tij në këtë pozitë do të jetë i njëjtë me mandatin e Kryetarit të Komunës.

III

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi pushon të vlej vendimi 01.Nr.5790 i datës 19.05.2010 për emërimin e z.Nenad Cvetkoviq për Nënkyetar të Komunës së Gjilanit për Komunitete.

IV

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Kryetari i Komunës së Gjilanit.

V

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

01.Nr. 13222
Gjilan, më 08.10.2010


Kuvendi i komunës,

Izmi Zeka, Kryesues



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, [ëëë.gjilani-komuna.org](http://ee.gjilani-komuna.org); e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u bazuar në nenin 52.2 pika g), nenin 72 të Statutit të Komunës së Gjilanit, si dhe duke u bazuar në nenin 54 dhe 55 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 08.10.2010, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR ZGJEDHJEN E ZËVENDËSKRYESUESIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS
SË GJILANIT PËR KOMUNITETE

I

Me këtë vendim **z. Kadir HYSEINI** zgjidhet Zëvendëskryesues i Kuvendit të Komunës së Gjilanit për Komunitete.

II

Funksionin e Zëvendëskryesuesit të Kuvendit të Komunës së Gjilanit për Komunitete, z. Kadir Hyseini do ta ushtroj që nga dita e zgjedhjes në këtë funksion nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit, si dhe në harmoni me dispozitat e Statutit të komunës dhe Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale.

III

z. Kadir Hyseini në këtë funksion zgjidhet me mandate të njëjtë sikurse anëtarët e Kuvendit të Komunës së Gjilanit.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

01.Nr. 13224
Gjilan, më 08.10.2010


Kuvendi i Komunës,

Izmi Zeka, Kryesues,



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, gje.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u bazuar në nenin 38.1 shkronja q) të Statutit të Komunës së Gjilanit si dhe duke u bazuar në Rekomandimin e Komiteti për Politikë dhe Financa të datës 21.10.2010, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 08.10.2010, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR APROVIMIN E PROJEKTIT PËR MBJELLJEN E DRUNJËVE
DEKORATIV

I

Me këtë vendim aprovohet Projekti për mbjelljen e drunjve dekorativ në Qytetin e Gjilanit.

II

Projekti si në pikën I të këtij vendimi do të realizohet në Qendrën e qytetit, duke filluar nga Parku (ish Arkivi Regjional) e deri te Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, dhe prej rrugës së Tregut të Gjelbër e deri te Posta Kryesore, në të dy anët e rrugës.

III

Mjetet për realizimin e Projektit në lartësi prej 9.990,00€ ndahen nga Buxheti i Komunës së Gjilanit.

IV

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Projekti për mbjelljen e drunjve dekorativ në Qytetin e Gjilanit i hartuar nga Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari.

V

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari, ndërsa për implementimin e tij kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit.


VI

Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

01.Nr. 13228
Gjilan, më 08.10.2010

Kuvendi i komunës,

Izmi ZEKA, Kryesues



Në mbështetje të nenit 7 të Ligjit për Policinë nr. 03/L – 035, nenit 11 të Udhëzimit Administrativ nr. 08/2009 të MPB dhe nr. 02/2009 të MAPL të datës 20.03.2009, nenit 12.2 pika c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/2008), dhe nenit 39 të Statutit të Komunës së Gjilanit nr. 12479 dt. 21.11.2009, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në mbledhjen e mbajtur me **12.11.2010**, miratoi:

RR E G U L L O R E N
PËR PËRBËRJEN, DETYRAT, PËRGJEGJËSIT DHE PUNËN E KËSHILLIT
KOMUNAL TË GJILANIT PËR SIGURI NË BASHKËSI

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

- 1.1. Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi në tekstin e më tejme KKSB, është trup kryesor konsultues i Komunës për çështje të sigurisë, që në bashkëpunim me policinë dhe institucionet tjera të sigurisë shqyrton të gjitha çështjet e sigurisë për Bashkësi, në të mirë të gjithë qytetarëve të komunës së Gjilanit.
- 1.2. Angazhimet e KKSB-së mbështeten në legjislacionin në fuqi, ligjin për policinë, Udhëzimin Administrativ për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi dhe dokumentet tjera të miratuara nga vetë KKSB-ja.

Përbërja

Neni 2

2.1. Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi përbëhet nga anëtarët e poshtëshënuar:

- Kryetari i Komunës së Gjilanit;
- Nënkryetarët e Komunës;
- Kryesuesi dhe zëvendës-kryesuesi i Kuvendit të Komunës;
- Komandanti i stacionit të policisë në Komunë;
- Komandanti regional i policisë;
- Përfaqësuesi i FSK-së;
- Nga një përfaqësues të secilës parti politike të Komunës;
- Nga një përfaqësues të secilës bashkësi fetare të Komunës,
- Përfaqësuesi i Komitetit Lokal për Siguri Publike,
- Përfaqësuesi i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi (nëse vepron në komunë)
- Drejtori i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim,
- Nga një përfaqësues të secilit komunitet etnik të Komunës,
- Gjashtë përfaqësues të Shoqërisë Civile (që përfshijn një nga organizatat rinore, një nga organizatat e grave, një nga media lokale, një nga organizatat e dala nga lufta, një nga komuniteti i biznesit dhe një nga organizatat jo qeveritare të komunitetit jo shumicë të Komunës)

Neni 3

3.1. Kryetari i Komunës është kryesuesi i KKSB-së.

3.2. Kryetari i Komunës përgatitë raportin për Kuvendin e Komunës mbi diskutimet, rezultatet, rekomandimet dhe vendimet pas secilit takim të KKSB-së.

3.3. Takimet e KKSB-se janë të hapura.

Neni 4

Mandati i anëtarëve të Këshillit zgjatë sa edhe mandati i Kryetarit të Komunës.

Detyrat dhe përgjegjësitë

Neni 5

Detyrat dhe përgjegjësitë e KKSB-së janë:

- 1) rritja e vetëdijesimit të qytetarëve lidhur me natyrën e krimeve, parregullsitë dhe sjelljet e dhunshme në komunitetin lokal;
- 2) identifikimi i brengave lidhur me sigurinë publike dhe rekomandojë planet e veprimit, për ti adresuar këto brenga në bashkëpunim me autoritetet komunale, komuniteteve lokale dhe Policinë e Kosovës;
- 3) ndërtimi i besimit në mes policisë dhe qytetarëve për mes ndërtimit të partneritetit dhe iniciativave të përbashkëta për zgjedhjen e problemeve të sigurisë për çdo bashkësi;
- 4) inkurajimi të bashkëpunojë me KKSB-të e komunave fqinje për çështjet e sigurisë që i tejkalojnë kufijtë e komunës së tyre dhe rekomandon lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit për veprim të përbashkët për çështjet e sigurisë;
- 5) organizimi i së paku dy (2) takimeve me qytetarët për të biseduar lidhur me çështjet e sigurisë dhe për të informuar qytetarët për punën e KKSB-së;
- 6) e drejta në parashtrimin e kërkesës në Kuvendin e Komunës, ose në ndonjë organizatë tjetër qeveritare dhe joqeveritare për financimin e projekteve lidhur me sigurinë e bashkësisë;
- 7) propozon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë pas konsultimit paraprak me qytetarët e zonave të caktuara të Komunës për themelimin e Komitetit lokal për siguri publike;
- 8) në takime kur shqyrtohen çështje për të cilat konsideron se do të kontribuojnë përfaqësues të shoqërisë civile dhe zyrtar qeveritar i fton ata që të jenë pjesë e debatit me KKSB-në;
- 9) bashkëpunon ngushtë me policinë e Kosovës dhe me institucionet tjera të sigurisë në Kosovë për çështje lidhur me sigurinë e bashkësisë;
- 10) përgatitja e planit vjetor të veprimit për siguri në bashkësi, i cili i paraqitet Kuvendit të Komunës për miratim;
- 11) kryen edhe punë tjera nga lëmi i sigurisë për bashkësi, në bashkëpunim me subjektet tjera kompetente që veprojnë në territorin e Komunës.

Rregullat e punës

Neni 6

Secili anëtar i KKSB-së apo pjesëmarrës tjetër në takim, duhet ta shënoj emrin e tij/saj në librin e dedikuar për këtë qëllim.

Neni 7

7.1. Mbledhjet e KKSB-së i cakton dhe i kryeson Kryetari i Komunës. Kryesuesi i KKSB (kryetari i i Komunës) thërret mbledhjet dhe përkujdeset për caktimin e rendit të ditës në konsultim me anëtarët e KKSB-së.

7.2.Mbledhjet e Këshillit mund të thirren edhe me kërkesën e shumicës së anëtarëve si mbledhje të jashtëzakonshme.

Neni 8

8.1.Këshilli zhvillon punën e vetë në bazë të rendit të ditës, të miratuar nga anëtarët e këshillit të KKSB-së.

8.2.Procesverbali që mbahet në takimet e KKSB-së, futet në dosje dhe duhet të jetë i disponueshëm për anëtarët e Kuvendit të Komunës, sipas nevojës dhe kërkesës. Një kopje e procesverbalit i dërgohet edhe Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

Neni 9

KKSB, mund të mbajë takime nëse në to marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve të këshillit, përkatësisht nëse për rekomandimet e propozuara votojnë shumica e të pranishmëve. Në rast të rezultatit të barabartë të votimit, vota e kryesuesit është vendimtare.

Neni 10

- 8.1. Në takimet e këshillit, diskutimet për çështjet e shtruara sipas rendit të ditës dhe çështjet tjera me interes për siguri të komuniteteve mund të zgjasin 5 minuta.
- 8.2. Secili anëtar i KKSB-së ka të drejtë që për të njëjtën çështje të diskutoj vetëm njëherë.
- 8.3. Në rast se ndonjëri prej anëtarëve të KKSB, dëshiron të bëjë replikë lidhur me diskutimin e një anëtari tjetër të KKSB, replika nuk mund të zgjasë më shumë se 2 minuta.

Sjellja, kufizimet dhe përjashtimi i anëtarit të KKSB-së

Neni 11

Anëtarët e KKSB, nuk duhet ta ndërpresin fjalën e kryesuesit të mbledhjes ose të diskutuesve të tjerë, të përdorin fjalë ofenduese, të ndërmarrin sulme personale apo veprime ndaj ndonjë anëtari, të përhapin informacione që cenojnë jetën private të cilitdo anëtar, të sillen në mënyrë të padenjë ose të shkaktojnë rrëmujë në mjediset ku mbahet mbledhja e KKSB-së.

Neni 12

Përveç kufizimeve të parapara me nenin 9 të UA nr. 08/2009 të MPB, kryesuesi i Mbledhjes (kryetari i Komunës) për shkelje të dispozitës së nenit 13 të kësaj rregulloreje, mund të ndërmerr masat e parapara në nenin 11.

Neni 13

Masat disiplinore që ndërmerren ndaj anëtarëve të KKSB-së janë:

- a) Tërheqje e vëmendjes;
- b) Vërejtje;
- c) Marrja e fjalës
- d) përjashtim nga punimet e mbledhjes.

Gjuhët e përdorura

Neni 14

Mbledhjet e KKSB mbahen në gjuhën shqipe, duke siguruar përkthimin adekuat, sipas nevojës edhe në gjuhët e komuniteteve tjera.

Dispozitat kalimtare

Neni 15

15.1. Ndryshimet dhe plotësimet eventuale në këtë Rregullore do të bëhen sipas procedurës së nxjerrjes të së njëjtës.

15.2. Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.


01.Nr. 16-14839
Gjilan, më 12.11.2010

Kuvendi i Komunës,
Izmi ZEKA, Kryesues



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, gje.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Në bazë të nenit 52.4 shkronja të Statutit të Komunës së Gjiçanit, si dhe bazuar në Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa të datës 22.10.2010, Kuvendi i Komunës së Gjiçanit në seancën e mbajtur më 12.11.2010, miraton këtë:

V E N D I M

Për ndarjen e mjeteve financiare për mbështetjen e projektit për ngritjen e pemëtoreve të reja për fermerët me kushte të rënda ekonomike

I

Me këtë vendim nga Buxheti i Komunës së Gjiçanit ndahen mjete financiare në lartësi prej 20.000,00€ për mbështetjen e projektit për ngritjen e pemëtoreve të reja (mollë) për fermerët në kushte të rënda ekonomike.

II

Projekti si në pikën I të këtij vendimi do të ekzekutohet përmes Ftesës publike për aplikim, ndërsa përzgjedhja e fermerëve do të bëhet nga një Komision miks i përbërë nga ekspertë të bujqësisë, përfaqësues nga KK-Gjiçan, përfaqësues të sindikatës së bujqve dhe përfaqësues të fshatrave, bazuar në kriteret e përcaktuara nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë

III

Zbatimin e këtij vendimi do ta bëjë Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë, ndërsa për implementimin e tij kujdeset Kryetari i Komunës së Gjiçanit.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit në Kuvendin e Komunës së Gjiçanit

01.Nr. 16-14840
Gjiçan, më 12.11.2010


Kuvendi i komunës,

Izmi ZEKA, Kryesues



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, www.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Në bazë të nenit 38.1, shkronja s), nenit 52.4 shkronja të Statutit të Komunës së Gjilanit, si dhe bazuar në Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa të datës 09.11.2010, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 25.11.2010, miraton këtë:

V E N D I M

Për subvencionimin e një pjese të dëmit të shkaktuar nga zjarri në pemishten e fermerit Blerim Shefkiu

I

Me këtë vendim nga Buxheti i Komunës së Gjilanit ndahen mjete financiare në lartësi prej 7.000,00€ (dëmet e përgjithshëm: 28.470,00 €) për subvencionimin e një pjese të dëmit të shkaktuar nga zjarri në pemishten e fermerit Blerim Shefkiu nga fshati Përlepnice

II

Subvencionimi i dëmit do të bëhet bazuar në tabelën e dëmeve të shkaktuar në pemishte, të cilën tabelë e ka hartuar Komisioni profesional i formuar nga Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari dhe e cila do të jetë pjesë përbërëse e këtij vendimi.

III

Zbatimin e këtij vendimi do ta bëjë Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë, ndërsa për implementimin e tij kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit në Kuvendin e Komunës së Gjilanit

01.Nr. 16-15295
Gjilan, më 25.11.2010


Kuvendi i komunës,

Izmi ZEKA, Kryesues



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, gje.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Në pajtim me nenin 38.1 pika c, të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në seancën e vetë të mbajtur më 25.11.2010 merr këtë:

V E N D I M

Për zbatimin e Aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës Komunale të Gjilanit C.nr.63/93 dt.11.06/93 lidhur dorëzimin e pronave të paluajtshme të KK-ës Gjilan

I.

Në bazë të aktgjykimit C.nr.63/93 dt.11.06.1993 të Gjykatës Komunale në Gjilan, si dhe Aktvendimin për Ekzekutim të Gjykatës Komunale Gjilan I. Nr.209/2003 të dt. 09.07.2003, Komuna e Gjilanit si debitorë obligohet që bashkëpronarëve (kreditorëve) : Stevanovic Sreten, Stevanovic Antanas, Stamenkovic Dobrica, Jagodic Vesna, Aleksic Momcilo, Mihajlovic Vidosava, Stevanovic Slobodanka, Hrabric Radica dhe Jagodic Dragana t'ua dorëzoj ngastrat kadastrale : P.70403013- 01564 -0 , në sipërfaqe 7203 m² dhe pjesën e ngastrës kadastrale P.70403013- 01573-0 në sipërfaqe 4826m², vendi i quajtur "Bregu i Djegur" ZK Gjilan, sipërfaqja e tërësishme 12029 m² dhe atë si bashkëpronar me nga 1/9 pjesë ideale.

II.

Bazuar në Aktgjykimin dhe Aktvendimin e cekur në pikën I. të këtij Vendimi, Komuna obligohet që kreditorëve të lartcekur t'ua dorëzoj ngastrën kadastrale P.70403013-02684-0 me sip.12103 m² mirëpo kjo ngastër kadastrale tani e sa vite është duke u shfrytëzuar për Varreza të qytetit të Gjilanit kështu që në pamundësi që e njëjta t'iu dorëzohet kreditorëve të cekur në pikën I. Vendosi që si zëvendësim t'iu dorëzohen ngastrat kadastrale: P.70403013-01564-0, dhe P.70403013-01573-0 në sipërfaqe të tërësishme 12029 m² të cilat aktualisht në vendin e ngjarjes janë të lira dhe të njëjtat evidentohen në emër të P.SH. Kuvendi i Komunës Gjilan, sipas Certifikatës LNJ.1750, ZK-Gjilan.

III.

Për Zbatimin e këtij Vendimi autorizohet Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi, Pronë dhe Banim në Gjilan.

IV.

Ky vendim hynë në fuqi në ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe pas nënshkrimit të tij nga kryesuesi i KK-së Gjilan.

01. Nr. 16-15297
Gjilan, më 25.11.2010


Kuvendi i Komunës,

Izmi ZEKA, Kryesues



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, www.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Në mbështetje të nenit 11, 12.2 shkronja c) dhe nenit 17 shkronja s) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008) dhe nenit 38 shkronja i) dhe 39.1 të Statutit të Komunës së Gjilanit 01. nr. 12479 të dt. 21.11.2008, Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në mbledhjen e mbajtur më 25.11.2010 miraton;

V E N D I M

PËR APROVIMIN E RREGULLORES PËR SHFRYTËZIMIN DHE MENAXHIMIN E OBJEKTIT KOMUNAL NGA SHOQATAT PËR PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA

I

Me këtë vendim aprovet Rregullorja për shfrytëzimin dhe menaxhimin e objektit komunal nga Shoqatat për persona me aftësi të kufizuara.

II

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Rregullorja për shfrytëzimin dhe menaxhimin e objektit komunal nga Shoqatat për persona me aftësi të kufizuara.

III

Zbatimin e këtij vendimi e bënë Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, ndërsa për zbatimin e tij do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

01. Nr. 16-15287
Gjilan, më 25.11.2010

Kuvendi i Komunës,

Izmi ZEKA, Kryesues

Në mbështetje të nenit 11, 12.2 shkronja c) dhe nenit 17 shkronja s) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008) dhe nenit 38 shkronja i) dhe 39.1 të Statutit të Komunës së Gjilanit 01. nr. 12479 të dt. 21.11.2008, Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në mbledhjen e mbajtur më 25.11.2010, miraton;

RR E G U L L O R E
PËR SHFRYTEZIMIN DHE MENAXHIMIN E OBJEKTIT KOMUNAL
NGA SHOQATAT PËR PËRSONA
ME AFTËSI KUFIZUARA

Neni 1.

Me këtë rregullore përcaktohet mënyra e menaxhimit, dhe shfrytëzimit të këtij objekti nga shoqatat që ofrojnë shërbime për persona me aftësi të kufizuara.

Emri i objektit

Neni 2

Objekti komunal i dedikuar për ofrimin e shërbimeve do të quhet **"Qendra për ofrimin e shërbimeve për persona me aftësi të kufizuara"**. Në tekstin vijues "Qendra".

Menaxhimi me qendër

Neni 3

3.1. Me qendrën për ofrimin e shërbimeve për persona me aftësi të kufizuara menaxhon bordi i cili do të ketë shtatë (7) anëtar i përfaqësuar me nga menaxheri, 3 (tre) anëtarë nga shoqatat të cilat janë shfrytëzues të objektit, një(1) anëtarë nga Komitetit, një (1) anëtarë nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, dhe një (1) anëtarë caktohet nga Drejtori i DSHMS

3.1. Mbikëqyrjen e qendrës e bënë Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

3.3. Drejtori i DSHMS-së ose personi i autorizuar nga ai është kryesuesi i bordit.

3.4. Takimet e bordit janë te hapura.

Mënyra e shfrytëzimit të qendrës

Neni 4

4.1. Mënyra e shfrytëzimit të objektit bëhet sipas rregullave të përgjithshme mbi shfrytëzimin e objekteve publike ne bazë të dedikimit.

4.2. Shfrytëzues dhe përfitues janë shoqatat Handikos Gjilan, shoqata Ndërkomunale e të verbërve dhe me të parë të dobësuar Gjilan, dhe shoqata e te "Shurdhërve" Gjilan

4.3. Nëse ndonjëra nga këto shoqata për arsye të ndryshme nuk funksionon (ndërpret apo i ndërpritet aktiviteti në objekt) boshllëkun e krijuar e plotëson kryetari i komunës në koordinim me DSHMS-në ne bashkëpunim me shoqatat që janë në shfrytëzim të objektit.

4.4. Kati i parë i qendrës shfrytëzohet nga shoqata Handikos kurse kati i dytë nga shoqata e te verbërve dhe e të shurdhërve.

Dhënia në shfrytëzim e hapësirave në qendër

Neni 5

5.1. Dhënia me qira për shfrytëzim të hapësirave në qendër (salla e sportit, salla për konferenca etj) rregullohet me rregullore të veçanet nga bordi për menaxhimin e qendrës.

5.2. Tarifat për shfrytëzimin e hapësirave në qendër sipas paragrafi 1 të këtij neni propozohen nga bordi menaxhues dhe të njëjtat do të inkorporohen në rregulloren komunale për tarifa komunale.

Autonomia e shoqatave

Neni 6

shoqatat janë të pavarura në zbatimin e programeve të tyre në përputhje me ligjin.

Rregullat e sjelljes në qendër

Neni 7

7.1. Disiplina dhe rregullat e mirësjelljes si brenda ashtu edhe në raport me qytetarë rregullohen me një rendë shtëpiak të miratuar nga bordi menaxhues i qendrës.

7.2. Për mos disiplinë dhe shkelje të rendit shtëpiak mundë të pasoj largimi i shoqatës nga qendra.

Të hyrat financiare

Neni 8

8.1. Mjetet financiare si të hyra nga dhënia në shfrytëzim e hapësirave në qendër sipas nenit 5 të kësaj rregullore dhe të hyrat tjera do të trajtohen si të hyra publike dhe do të menaxhohen dhe mbikëqyren nga komuna.

Zbatimi dhe hyrja në fuqi e rregullores

Neni 9

9.1. Përgjegjës për zbatimin e rregullores është DSHMS me bordin menaxhues.

9.2. Komponenten për implementim të rregullores e bënë DSHMS me bordin menaxhues dhe kryetarin e komunës.

9.3. Kjo rregullore hynë në fuqi me miratimin e saj nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

01.Nr. 16-15287
Gjilan, më 25.11.2010


Kuvendi i Komunës,

Izmi ZEKA, Kryesues



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, www.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u bazuar në nenin 9, nenin 38.1 shkronja (c), 39.1, dhe nenin 52.2 shkronja (e) të Statutit të Komunës së Gjilanit, si dhe mbështetur në Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa të datës 23.12.2010, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 28.12.2010, miratoi këtë:

V E N D I M

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR BLERJEN E TOKAVE PËR INTERES PUBLIK

I

Me këtë vendim formohet Komisioni për blerjen e tokave me interes publik për nevojat e Komunës së Gjilanit me këtë përbërje:

1. Elisah Ymeri, PDK,
2. Faik Ahmeti, AKR,
3. Sadullah Salihu, AAK,
4. Ramadan Ajvazi, LDK,
5. Zijadin Maliqi, LDD,

II

Komisioni i formuar sipas pikës I të këtij vendimi do të negocioj me pronaret e tokave për mundësin e eksproprijimit të parcelave me interes publik për Komunën e Gjilanit.

III

Përfaqësuesit e grupimeve politike gjatë caktimit të përbërjes së numrit të anëtarëve të këtij Komisioni me marrëveshje mund të bëjnë dizajnimin e përbërjes së tij, përderisa lëvizjet përbrenda komisionit mund të bëhen në secilën kohë.

IV

Mandati i anëtarëve të Komisionit për blerjen e tokave me interes publik për Komunën e Gjilanit do të jetë i njëjtë me mandatin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Gjilanit.

V

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Kryetari i Komunës së Gjilanit.

VI

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

01.Nr. 16935
Gjilan, më 28.12.2010

Kuvendi i Komunës,

Izmi Zeka, Kryesues